

***“ANALIZA E SISTEMIT TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE NË KËNDVËSHTRIMIN
EKONOMIK DHE JURIDIK”***

MONIKA KRYEMADHI

ABSTRAKT

E drejta e sigurimeve shoqërore është një fushë e cila ka prioritet të madh në arenën ndërkombëtare dhe atë të Bashkimit Europian. Si një element i rëndësishëm i të drejtave themelore, përbën fokus të rëndësishëm për çdo shtet. Angazhimet për funksionimin sa më të mirë të këtij sistemi sa vijjnë e shtohen, duke u renditur ndër detyrat kryesore dhe të rëndësishme të shtetit Shqiptar. Nënshkrimi i marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ka rritur ndjeshëm rolin e shtetit në drejtim të përmirësimit të legjislacionit të sigurimeve shoqërore me normat e Acquis Comunitare, me qëllim krijimin e një klime mbrojtëse për shoqërinë.

Evidentimi dhe analiza e elementeve kryesore të skemës së sigurimeve shoqërore në lidhje me organizimin dhe funksionimin e këtij sistemi dhe trajtimi i kësaj analize në një vështrim tjetër doktrinal, janë arsytet e përzgjedhjes së kësaj teme.

Ky punim gërsheton në një analizë juridike dhe ekonomike elementet bazë të këtij sistemi si dhe paraqet një panoramë të situatës aktuale dhe të problematikave me të cilat përballlet ky sistem. Analiza e elementeve përbërës të këtij sistemi realizohet në tërësinë e tyre, duke studiuar rolin dhe rëndësinë e këtyre elementeve jo vetëm në drejtim të skemës së sigurimeve shoqërore, por edhe në drejtim të individëve pjesëmarrës në skemë.

Në përfundim të punimit rezulton se kuadri ligjor në lidhje me skemën e sigurimeve shoqërore është përafëruar pothuajse plotësisht, por problemi i tij shihet në mënyrën se si do të implementohet, efikasiteti dhe jetëgjatësia e skemave të reja ekonomike.

HYRJE**“ANALIZA E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË KËNDVËSHTRIMIN EKONOMIK DHE JURIDIK”**

Është punimi që do të lexoni në vijim.

Duke ju referuar termit Sigurim Shoqëror në pamjen e parë të krijohet ideja e një nocioni social, por në fakt termi sigurim shoqëror nuk është thjesht një nocion social, në të janë të ndërthura tri elemente të pandara nga njëri-tjetri: elementi juridik, social dhe ekonomik.

Kemi synuar që këtë punim ta shohim nga një këndvështrim i gërshetuar, dhe jo vetëm tërësisht ekonomik, por duke bërë ndërthurje të vogla e të paevitueshme edhe me këndvështrimin social dhe atë juridik. Kjo për shkak të cilësive specifike të kësaj fushe.

Fusha e sigurimeve shoqërore është një fushë relativisht e rrahur në masmedia, e trajtuar në literaturën shkencore shqiptare në forma të ndryshme, tërësisht ekonomike ose tërësisht juridike. Idea për të sjellë një studim të gërshetuar ishte një nga motivet që na shtyu për të dhënë një panorama ndryshe të këtij sistemi.

Po ashtu nuk duhet anashkaluar fakti se të gjithë ne jemi pjesë e sistemit të sigurimeve shoqërore, të gjithë ne përfitojmë edhe kontribuojmë në këtë sistem, prandaj duhet të njohim të mirat dhe të metat e këtij sistemi.

Gjithashtu e rëndësishme është që duke e studiuar dhe analizuar këtë sistem, të nxirren konkluzione të qarta pse jo edhe rekomandime për ndryshimin e tij, në mënyrë që në të ardhmen ky sistem të jetë efikas për të gjithë ne. Kjo do të thotë që, të gjithë të kemi mundësi për përfitime sa më të larta kur për arsye moshe ose shëndeti, të mos jemi më të aftë për të realizuar të ardhura me punën tonë.

Mendoj se përmes këtij punimi, nuk jepen vetëm të dhëna informuese, por kryhet edhe një analizë e hollësishme të pjesëve përbërëse të këtij sistemi. Duke qenë një punim shkencor por edhe informues, shpresoj të jetë i vlefshëm për studiuesit e fushës, politikëbërësit dhe qytetarët e thjeshtë. Por më shumë për këta të fundit. Realisht unë shpresoj se diçka e re në këtë fushë do të arrij të sjellë edhe punimi im. Unë jam përpjekur shumë, ndaj shpresoj të kem arritur atje ku kam synuar.

Në përfundim do të doja shumë të shprehja falenderimet e mia të përzemërta dhe mirnjohje të thellë për Prof. Dr. Dhori Kule, udhëheqësin tim, për besimin e madh që ka treguar ndaj meje. Po ashtu falenderime i shkojnë për inkurajimin Prof. Dr. Sulo Haderit, Dekan i Fakultetit Ekonomik si dhe Përgjegjësit të Departamentit të Menaxhimit në Fakultetin e Ekonomisë, Prof. Dr. Shyqyri Llacit.

Të fundit, por jo më pak të rëndësishmit në radhën e falenderimeve, janë ata që më kanë mbështetur moralisht, megjithëse kam marrë kohë nga koha e tyre, bashkëshorti dhe fëmijët e mi Bora, Besari dhe Era, të cilëve nuk u kam kushtuar shumë vëmendje gjatë kohës që kam punuar këtë studim. Ju jam mirënjohës që më mbështetët!

Rëndësia e studimit

Ky studim ka një rëndësi në ofrimin e një panorame të plotë dhe deri diku edhe të hollësishme të elementeve përbërës të skemës së sigurimeve shoqërore. Kjo është arritur nëpërmjet analizës ligjore dhe ekonomike të elementeve përbërës dhe një sërë faktorësh të rëndësishëm të këtij sistemi, duke përqëndruar vëmendjen në problematikat me të cilat ai ballafaqohet dhe duke zgjeruar mendimin më tej në drejtim të gjetjes së rrugëve për përmirësimin e këtij sistemi. Studime të shumta janë realizuar me sukses nga autor të ndryshëm në këtë fushë. Gërshetimi i koncepteve juridike dhe ekonomike si element të pandashëm nga njeri-tjetri japin një tablo më të qartë në lidhje me mënyrën si organizohet dhe funksionon ky sistem. Kjo temë sot është më bashkëkohore për faktin se e gjithë skema e sigurimeve shoqërore ka pësuar ndryshime rrënjësore përse i përket përfitimeve në drejtim të subjekteve edhe pse periudha në të cilën nga miratimi i ligjit është shumë e shkurtër për të kuptuar nëse ky sistem është i sukseshëm ose jo vëmendja e shtetit dhe e institucioneve që organizojnë këtë sistem është rritur ndjeshëm. Për këtë fakt ky studim merr një rëndësi ndryshe dhe mund të konsiderohet si një burim për përmirësimin e mëtejshëm të këtij sistemi.

Kufizimet e studimit

Pavarësisht punës dhe materialit që unë kam paraqitur mendoj që kjo fushë është shumë e gjerë. Ky sistem ka një sërë elementësh të cilat nuk kanë qënë fokusi i studimit për shkak të volumit të madh që mund të zinin këto elementë në punim. Përse i përket elementeve të skemës të trajtuar në këtë punim mund të themi se jemi përpjekur të bëjmë më të mirën.

Qëllimi

Ky punim ka për qëllim evidentimin e sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri pasqyrimin e disa elementeve përbërës të tij, parimet bazë mbi të cilat udhëhiqet ky sistem faktorët që ndikojnë dhe ecuria e këtij sistemi pas ndryshimeve ligjore në lidhje me mënyrën e financimit.

Objektivat

- *Mënyra e zbatimit të parimeve bazë të sistemit të sigurimeve shoqërore.*
- *Evidentimin e faktorëve që ndikojnë në këtë sistem, problematikat që sjellin këto faktorë dhe gjetjen e rrugëve për eliminimin e efekteve negative në skemë.*
- *Analiza e sistemit NDC dhe përshatshmëria e tij në nivelin ekonomik dhe social të vendit tonë.*
- *Sygerimet për përmirësimin e këtij sistemi në në dobi të subjekteve pjesëmarrës në të ardhmen.*

Pyetjet kërkimore

- *A është i përshtatshëm sistemi i ri i sigurimeve NDC bazuar në kushtet ekonomike, demografike, politike dhe sociale?*
- *Cilat janë impaktet pozitive të këtij ligji dhe çfarë anësh pozitive priten në të ardhmen?*
- *Si funksionon sistemi i ri i financimit të sigurimeve NDC, cilat janë tiparet avantazhet dhe disavantazhet e tij?*
- *A garanton ky sistem i ri efikasitetin e skemës për periudhë afatgjatë?*

Metodologjia

Ky punim nga vetë karakteristikat dhe tiparet që mbart është mbështetur në disa metoda studimi.

Në fazën e parë janë mbledhur të gjitha materialet, literatura, ligjet që do të ishin pjesë e këtij studimi. Gjatë hartimit të qëllimit dhe hipotezës, për ti dhënë përgjigje pyetjeve hipotetike me të cilat ballafaqoheshim dhe për të pasur përgjigje reale dhe aktuale më lindi ideja e përgatitjes së një pyetësi. Në këtë pyetësor pjesëmarrësit u pyetën nëpërmjet intervistave ballë për ballë, të cilat u realizuan në shtëpinë e tyre.

Një pyetësor i dizenuar me pyetje të mbyllura u përdor për të mbledhur të dhënat e nevojshme. Paraprakisht përgjatë periudhës Dhjetor 2013 u realizuan 4 fokus grupe me qytetarë të Tiranës (meshkuj dhe femra) për të hulumtuar paraprakisht mbi njohuritë e sigurimeve shoqërore. Si rezultat i studimit kualitativ, u hartua edhe pyetësori sasior/kuantitativ për marrjen e informacionit në fusha të caktuara.

Intervistat u realizuan përgjatë muajit Shkurt 2014.

Gjatë përgatitjes së punimit vëmendje i kemi kushtuar metodës cilësore si një element i rëndësishëm për përgatitjen e këtij punimi.

Metoda cilësore, përfshin brenda saj, metodën hulumtuese, përshkruese interpretuese dhe krahasimore që e shoqërojnë çdo pjesë të këtij punimi.

Metoda hulumtuese është përdorur në fazën e parë të këtij punimi gjatë mbledhjes së materialeve bazë për temën. Hulumtimi është një proces që ka shoqëruar dhe në hartimin e bibliografisë të punimit.

Metoda analitike krahasimore ka gjetur një zbatim të gjerë në këtë temë sepse analiza juridike dhe ekonomike është realizuar nëpërmjet metodës përshkruese, analitike, statistikore dhe empirike. Këto analiza janë përdorur në këtë material për të evidentuar mënyrat e llogaritjes së përfitimeve.

Analiza krahasuese është pothuajse metodologjia më e përdorur e këtij punimi për faktin se ky punim ka pasur si qëllim të analizojë dhe krahasoj të shkuarën dhe të tashmen e sistemit të sigurimeve.

Korrelacioni është një tjetër metodë e përdorur nëpërmjet të cilës evidentohen lidhjet e individit me sistemin.

PËRMBAJTJA

ANALIZA E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË KËNDVËSHTRIMIN EKONOMIK DHE JURIDIK

KAPITULLI I	1
1.1. LINDJA DHE ZHVILLIMI I SKEMAVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
1.2. SOCIOLOGJIA E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
KAPITULLI II	35
2.1 KONCEPTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE	
2.2 OBJEKTI DHE SUBJEKTET E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
2.3 PARIMET E PËRGJITHSHME TË SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
2.4 BURIMET NDËRKOMBËTARE NË SISTEMIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE	
2.5 ROLI I SKEMAVE PROFESIONALE TË PENSIONEVE	
2.6 ROLI I QEVERISË DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE	
2.7 ROLI I PARTNERITETEVE NË RREGULLIMIN E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
KAPITULLI III	69
3.1 GJINIA DHE SHTETI SOCIAL	
3.2 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME MBI BARAZINË GJINORE NË FUSHËN E SIGURIMIT SHOQËROR	
3.3 PANORAMË E PËRGJITHSHME MBI TRAJTIMIN E PARIMIT TË BARAZISË GJINORE NGA LEGJISLACIONI I BASHKIMIT EUROPIAN	
KAPITULLI IV	103
4.1 SFIDAT E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
4.2 SFIDA EKONOMIKE	
4.3 SFIDA DEMOGRAFIKE	
4.4 SFIDA POLITIKE	
4.5 SFIDA SOCIALE	

KAPITULLI V	127
5.1 VLERËSIM TEORIK I SKEMAVE TË PENSIONEVE	
5.2 ÇËSHTJETFINANCIARE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	
5.3 KONCEPTI I KAPITALIT NACIONAL DHE KARAKTERISTIKAT BAZË	
5.4 MEKANIKA E FUNKSIONIMIT TË NJËSISTEMI NDC	
5.5 LLOGARITJA E PËRFITIMEVE BAZUAR NË SKEMËN NDC	
5.6 SISTEMI ME LLOGARI NACIONALE AVANTAZHET E TIJ KRAHASUAR ME SISTEMIN DB	
5.7 REFORMIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË SHQIPËRI DREJT NJË SISTEMI ME LLOGARI NACIONALE	
KAPITULLI VI	173
6.1 KONKLUSIONE	
6.2 REKOMANDIME	
RAPORT-SIGURIMET SHOQËRORE NË SHQIPËRI.	178
PËRGATITUR NGA MONIKA KRYEMADHI	
KONKLUSIONE	195
BIBLIOGRAFIA	198

KAPITULLI

1

1.1 LINDJA DHE ZHVILLIMI I SKEMAVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

1.2 SOCIOLOGJIA E SISTEMITË SIGURIMEVE SHOQËRORE

KAPITULLI I

Hyrje

Në kapitullin e parë kemi trajtuar mënyrën se si lindën dhe u zhvilluan sistemet e sigurimeve shoqërore në botë dhe në Shqipëri.

Në këtë kapitull janë marrë në analizë burimet e para zyrtare të këtij sistemi në botë dhe në vendin tonë. Për sa i përket Shqipërisë vëmendja është përqëndruar në buirmet e para ligjore siç janë:

- *Ligji për dorëheqje në ushtri dhe gjindarmari i vitit 1923*
- *Ligji i pensioneve i vitit 1927*
- *Rregullore mbi zbatimin e ligjit "Mbi Pensionet Civile dhe Ushtarake" viti 1934*

Në këtë kapitull zë një vend të veçantë edhe analiza e dy modeleve kryesore të sistemeve në fushën e Sigurimeve Shoqërore atë të Bismarkut dhe Beverige.

Po në fokusin historik janë analizuar edhe dy lloje të tjera të rëndësishme të sistemeve të sigurimeve shoqërore.

Sistemi i Pensioneve sipas shpërndarjes dhe sipas kapitalizmit ku evidentohet roli i tyre i përfitimit dhe disavantazhet e këtyre sistemeve që u implementuan në vende të ndryshme të botës.

Në këtë kapitull do të përshkruajmë edhe sociologjinë e sistemit të sigurimeve shoqërore, duke u fokusuar tek rëndësia dhe dinamika e sistemit si dhe ndikimi i faktorëve ekonomik, politik dhe barazia gjinore.

Nëpërmjet analizës sociologjike është dhënë edhe një panoramë e përmbledhur e teorive shtetërore të krijuara në faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik shoqëror.

1.1 LINDJA DHE ZHVILLIMI I SKEMAVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Fillesat e sistemit të Sigurimeve Shoqërore në botë

Të gjithë popujt në historinë e tyre të zhvillimit, janë përballur me situata të pasigurta të shkaktuara nga fenomene negative si: papunësia, sëmundja, invaliditeti, vdekja dhe moshë e vjetër. Këto fenomene, konsiderohen "*rreziqe sociale*" si pasojë e të cilave individët bëhen të paaftë për të nxjerrë të ardhura financiare nëpërmjet punës, duke ndikuar kështu negativisht në nivelin e mirëqenies.

Fakti që rreziqet sociale përbënin kërcënim ekonomik për cilindo që ballafaqohej me to, kushtëzuan lindjen e "*detyrimit shtetëror për mbrojtjen e shoqërisë*". Tentativat e para të detyrimit shtetëror për mbrojtjen e shoqërisë nga rreziqet sociale, kanë qenë të ndryshme, në vende të ndryshme, në varësi të zhvillimit ekonomik-shoqëror.

Format e para të detyrimit shtetëror për mbrojtjen e shoqërisë, i gjejmë që në periudhën e Perandorisë Romake. "*Kujdesi për të varfërit*", mund të konsiderohet një ndër hapat e parë të detyrimit shtetëror për mbrojtjen e

shtetasve të tij. Kujdesi për të varfërit, nënkuptonte dhënien e ndihmave me karakter minimanlist për personat të cilët nuk kishin mundësi të krijojnë të ardhura për të jetuar si pasojë e paaftësisë për punë.

Edhe pse kujdesi i shtetit ndaj asaj pjese të shoqërisë në nevojë ishte minimalist, ai ishte një tregues i angazhimit për mbrojtjen e shoqërisë. Nëpërmjet “sistemit të ndihmave”, shtetasat në nevojë përfitonin ndihma në veshje dhe ushqime për të sëmurët, jetimët, të moshuarit etj. Për këtë arsye, kjo mënyrë përkujdesje, konsiderohet si hap i parë i ndërhyrjes së shtetit, në ndihmë të shpresave në nevojë.

Në periudhën e Dinastisë Song, në vitin 1000, u evidentuan disa programe të asistencës sociale të cilat u pasuan me ngritjen e disa institucioneve sociale si; shtëpitë e daljes në pension, klinikat publike dhe varreza për të varfërit.

Në shekullin VII, në legjislacionin Islamik të Kalifatit Rashidun², praktikohet një tjetër koncept i mirëqenies shtetërore në dobi të shoqërisë në lidhje me “pensionet”.

Në legjislacionin Islamik, pensioni ofrohet nga thesari dhe përdoret për personat në nevojë si; jetimët, të sëmurët, personat e ve dhe invalidët. Të ardhurat e ndihmave në drejtim të kategorive të mësipërme siguroheshin nëpërmjet mbledhjes së tatimeve, kur një pjesë e tyre ruhet në *Bayt al-mal*³ por edhe nga të ardhurat që mbledheshin si donacione për bamirësi⁴.

Gjatë Kalifatit Rashidun, programe të ndryshme të mirëqenies u prezantua nga Kalifi Umer, i cili siguroi popullin se thesari publik nuk ishte përdorur për “lüks” të panevojshëm. Ai besonte se paratë do të shpenzohen më mirë në qoftë se ato shkojnë në drejtim të mirëqenies së njerëzve se sa drejt tullave pa jetë.

Në këtë periudhë ndeshemi për herë të parë me “sigurimin e papunësisë”, një reformë e Kalifit Umer gjatë Kalifatit Rashidun. Në Kalifatin Rashidun, kur qytetarët ishin të plagosur apo kishin humbur aftësinë e tyre për të punuar, sigurimi i nevojave të tyre minimale u bë përgjegjësi e shtetit. Kështu, të gjithë personat e dëmtuar përfitonin të ardhura nga thesari i shtetit. Gjithashtu edhe personave të dalë në pension u jepej një pagë nga thesari publik. Pra, për herë të parë në këtë periudhë evidentohet “pensioni i pleqërisë” si një element i detyrimit shtetëror.

Në Evropën mesjetare, sistemi feudal ishte baza e sigurisë ekonomike, me zotin feudal përgjegjës për mbijetesën ekonomike të bujkrobërve, që punonin në tokat e tij. Feudali kishte sigurinë ekonomike për aq kohë sa kishte një furnizim të qëndrueshëm nga puna e bujkrobërve. Ndërsa bujkrobërit kishin sigurinë ekonomike të mjaftueshme, vetëm për aq kohë sa ata ishin të aftë për të siguruar punën e tyre. Në këtë periudhë u shfaq për herë të parë dhe u zhvillua ideja e “bamirësisë”, si një marrëveshje formale ekonomike, në ndihmë të personave në nevojë ekstreme.

1 www.wikipedia.org

2 Periudha e studimit “Kalifati Rashidun” në shekullin VIII vitet 632-661/www.wikipedia.org

3 Përkthehet si “Shtëpia e parave” ose “Shtëpia e Pasurisë”. Historikisht, kjo shtëpi luante rolin e një institucioni financiar përgjegjës për administrimin e tatimeve në shtetet islamike, veçanërisht në fillim të Kalifatit Islam. Ajo shërbeu si Thesari mbretëror i kalifëve dhe sulltanëve, për menaxhimin e financave personale dhe të shpenzimeve qeveritare.

4 5 Format e bamirësisë që praktikoheshin në legjislacionin Islam njiheshin si Zekati dhe Xhizja

5 Skema e papunësisë u pa për herë të parë në Kalifatin Islam. Ky koncept u përdor në Perëndim në shekullin e 19-të.

Më tej kjo traditë pati vazhdimësi nëpërmjet institucioneve fetare të besimeve të ndryshme. Ky sistem, ofronte ndihma në ushqime, kujdes ndaj të sëmurëve, kujdes ndaj personave në moshë e të paaftë për të punuar, strehim të përkohshëm, veshëmbathje etj. Përveç ndihmave që ofroheshin nga Institucionet fetare, siguria ekonomike personale ishte elementi kryesor ku shoqëria mbështetej për t'u bërë ballë rreziqeve sociale.

Siguria ekonomike personale shihej në disa forma:

Solidari familjar: anëtarët e familjes dhe të afërmit kanë ndjerë gjithmonë një shkallë përgjegjësie ndaj njëri-tjetrit. Kjo formë ishte shpesh burim i sigurisë ekonomike, sidomos për të moshuarit apo të sëmurët.

Prona: toka në vetvete ishte një formë e rëndësishme e sigurisë ekonomike për ata që kishin në pronësi atë ose për ata që kanë jetuar në ferma.

Puna e familjes: ishte një tjetër siguri ekonomike për përballjen me rreziqet sociale. Edhe pse në dukje pasoja e një sigurie ekonomike realizohej në disa forma, përsëri në tërësinë e tyre, për shumicën e shoqërisë, ato ishin të pamjaftueshme.

Ndihmat që ofronin institucionet fetare, familja, puna, konsideroheshin të domosdoshme, por shpeshherë ishin të pamjaftueshme, të përkohshme dhe mbi të gjitha, të pa organizuara.

Me zhvillimin e ekonomisë, shoqërisë, politikës, shtoheshin dhe problemet e ndryshme ekonomike, politike e sociale, si pasojë e pandarë e shoqërisë në zhvillim. Në të shumtën e rasteve problemet ekonomiko-sociale, ishin një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të sistemit të mirëqenies shtetërore.

Fakti se me zhvillimin e ekonomisë, jeta bëhej e pasigurtë e kërcënuar në çdo moment, nga papunësia dhe varfëria. Rastet e mospagimit të paaftësisë për punë, dëmshpërblimi për dëmtimet në punë dhe sigurimi i një pagese për kohën e paaftësisë për shkak të moshës (pension), dilnin në pah në mënyrë të vazhdueshme te një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë. Ndaj lindi nevoja që këto probleme të mos konsideroheshin më thjeshtë si probleme personale të çdo individit.

Presioni i shoqërisë mbi klasën drejtuese të shtetit filloi të rritej në drejtim të disa problematikave si: përfitimi i të ardhurave kur personat bëheshin të paaftë për punë si pasojë e sëmundjes, kur goditeshin nga fatkeqësitë (humbja e jetës) apo pagesa për pension. Këto dukuri të cilat sillnin kufizim ekonomik, kushtëzonin zgjidhje të menjëhershme nëpërmjet realizimit të disa reformave me objekt evidentimin dhe mbrojtjen e personave në nevojë.

Pas revolucionit Industrial, mbrojtja e të Drejtave të Njeriut, mori përmasa të mëdha duke zgjeruar diapazonin e saj mbrojtës si në aspektin ekonomik, social dhe ligjor. Në këtë periudhë u zgjerua ndjeshëm, si numri i subjekteve përfituese dhe numri i shërbimeve në drejtim të këtyre subjekteve, shërbime të cilat nuk i kishin përfituar më parë si: *pagesën*

6 Fakti që nuk plotësoheshin kërkesat e shoqërisë me ndihmën ekonomike sa herë që shfaqej fenomeni negativ nënkupton nevojën e lindjes së një sistemi gjithpërfshirës.

7 Çdo i punësuar, ishte i detyruar që të krijonte vetë një sasi të ardhurash për të përballuar rastet e rreziqeve sociale, të cilat në të shumtën e rasteve shoqëroheshin me ndërprerje të punës dhe për rrjedhojë edhe të ndimës ekonomike.

për paaftësi, si pasojë e dëmtimeve të pësuarat gjatëpunës, dhe pagesën për paaftësi, si shkak i sëmundjes biologjike.

Në mënyrë që të gjitha këto shërbime të ofroheshin në mënyrë uniforme në të gjithë shoqërinë, lindi domosdoshmëria e disa reformave ligjore, ekonomike, politike e sociale.

Këto reforma do të ofronin alternativa të ndryshme mbrojtjeje për shoqërinë në rrezik social, zbatimi i të cilave do të bënte të mundur që në mënyrë graduale të rrënjosej historia dhe tradita e sistemit të mbrojtjes shoqërore, si një sistem jetik me rëndësi të madhe, pas atij të marrëdhënieve të punës.

Reformat ligjore dhe ekonomike u evidentuan në "skemat e përfitimeve ekonomiko-sociale", si një element i drejtpërdrejt në jetën e individit. Këto skema, ofronin të ardhura për sëmundjet profesionale, pagesa për pension, pagesa në raste fatkeqësish etj.

Një fakt i cili duhet evidentuar është se jo të gjithë shtetet mund të ofronin ligje dhe sisteme ekonomike rentabël për shtresat në nevojë, kjo për arsye të zhvillimit ekonomiko-shoqëror që i karakterizonin ato.

Sistemet e para ekonomike të cilat u vendosën në shtetet e zhvilluara ekonomikisht, mbështesnin funksionimin e skemave sociale me "fonde publike" dhe jo personale. Fondet publike organizoheshin në buxhetin e shtetit. Nëpërmjet buxhetit, planifikohej një sasi të ardhurash të cilat i shpërndaheshin shtresave në nevojë, kur ata prekeshin nga rreziku social.

Këto skema funksiononin në bazë të parimit të solidaritetit. Kjo do të thotë se, për të përballur shpenzimet për rreziqe sociale do të përdroheshin paratë publike në mënyrë solidare, rast pas rasti, nëpërmjet një hetimi të gjëndjes së të ardhurave personale. Pra, këto fonde ofroheshin me kushte. Ndërsa hapat e industrializimit shpejtoheshin, presioni i shoqërisë për mbulim ekonomik nga rreziqet sociale rritej me shpejtësi. Skemat me fondet publike nuk e përmbushnin siçduhej qëllimin për të cilin ishin krijuar.

Në përpjekje të vazhdueshme të shoqërisë për t'u mbrojtur nga varfëria dhe në përpjekje të shtetit për të minimizuar presionin shoqëror, u krijua sistemi i "bankës së kursimeve". Ky sistem, kishte për qëllim mbulimin ekonomik të shoqërisë së punësuar në rastet e prekjes nga rreziku social. Krijimi dhe organizimi i sistemit të bankës së kursimeve u sponsorizua nga qeveria, ndërsa të ardhurat që mbulonin pagesat ekonomike për ata që prekeshin nga rreziqet sociale, paguheshin nga punëmarrësit.

Në analizë të thellë të mënyrës së funksionimit të këtij sistemi, konkludohet se në thelb ai ishte diskriminues për punëdhënësit. Kjo për faktin se vetëm punëdhënësit kishin detyrimin që të dorëzonin të ardhura, të cilat do të përdroheshin më vonë për të mbajtur punëtorët e sëmurë ose të dëmtuar. Për kohën dhe qëllimin për të cilin u krijua, ky sistem u konsiderua rezultativ në drejtim të përmbushjes së kërkesave të shoqërisë së punësuar.

Me zhvillimin e ekonomisë, rritej presioni i grupeve të interesit mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të skemave sociale. Ky fakt, kërkonte përgatitjen e politikave të reja ekonomike sidomos mbas

krizave të mëdha botërore. Në këtë periudhë u hartuan disa programe përfitimesh, të cilat mundësuan mbulimet financiare për popullatën në përgjithësi edhe për grupe të caktuara interesi në veçanti. Termi “*Sigurim Shoqëror*” ishte rezultat i kësaj periudhe.

Zhvillimet ekonomike, politike dhe shoqërore, kërkonin masa më të qëndrueshme në kuadër të sigurimeve shoqërore. Kështu, në të gjitha vendet e zhvilluara filloi të mendohej më seriozisht për mbrojtjen e shtetasve nga rreziqet sociale, të cilat bëheshin më të shpeshta si pasojë e kushteve të punës. Në mënyrë graduale në periudha të ndryshme filluan të hidheshin hapat e para të sistemeve të sigurimeve shoqërore.

1.1/1 Sistemi i Sigurimeve i Bismarkut

Gjermania ka pasur një traditë të programeve për mbrojtjen e shoqërisë nga rreziku social, që nga fillimi i vitit 1840. Me ndryshimet historike të Gjermanisë, këto programe u evidentuan edhe në Saksoni.

Programet e para sociale të sigurimit shoqëror startuan në vitin 1880 nga qeveria e Gjermanisë nën drejtimin e Kancelarit Britanik. Megjithatë, vetëm në fund të viteve 1800, mund të flitet për sigurime shoqërore të detyrueshme të cilat u zhvilluan në Prusinë e Bismarkut. Shteti me këtë sistem sigurimesh, synonte të plotësonte nevojat e qytetarëve që binin në vështirësi duke ju ofruar shërbime të ndryshme, të përkohshme apo afatgjata. Ky sistem sigurimesh financohej me kontributet e vetë punëtorëve.

Kjo reformë e ndërmarrë në Prusi për ngritjen e sistemit të sigurimeve, mbështetet në filozofinë e ndërhyrjes së shtetit si rregullator i marrëdhënieve ekonomike, në kushtet e acarimit të kontraditave midis punëmarrësve dhe punëdhënësve.

Bismarku sanksionoi me ligj, sistemin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Në këtë proces u arrit kompromisi i madh i tripartizmit midis punëmarrësve, punëdhënësve dhe shtetit. Punëtorët (sindikatat e tyre) arritën të përfaqësoheshin në këshilla administrative të fondit të sigurimeve. Përfaqësuesit e punëdhënësve në këshilla administrative marrin pjesë në vendimarrje, zhvillonin dhe kontrollonin fondin e sigurimeve. Shteti si aktori i tretë merre pjesë si drejtues, kontrollues e monitorues i procesit.

Modeli i Bismarkut u sanksionua në disa ligje të cilat u miratuan në Parlamentin e Prusisë së atëhershme brenda një periudhe 10-vjeçare (1881-1889). Në vitin 1881 u miratua ligji për sigurimin shoqëror të detyrueshëm; Në vitin 1883, u miratua ligji për sigurimin e sëmundjeve; Në vitin 1884 u miratua ligji për aksidentet në punë; dhe në 1889 ligji për pensionin e pleqërisë dhe invaliditetit.

Mbrojtja sociale e ligjëruar nga Parlamenti i Prusisë, siguron të drejtat për të gjithë personat që paguajnë sigurimet shoqërore. Masa e mbulimit, nuk mbështetet në nevojat e kontribuesve, por mbi bazën e kontribuesve të secilit dhe individ.

Duke komentuar këtë reformë të Bismarkut, analistët e kohës, theksojnë se politika të tilla kishin për qëllim shmangien e tensioneve sociale dhe zbutjen e pabarazive sociale të krijuara nga zhvillimi industrial i kohës. Këto programe u bënë model për vendet e tjera dhe u konsideruan si

baza e organizimit të shtetit modern social.

Sistemi i Bismarkut u përhap në tërë Evropën. Në Anglinë në 1911, shpallet sigurimi i papunësisë në disa profesione dhe më pas më 1938 ky sistem u shtri për të gjithë punëtorët.

1.1/2 Modeli Beveridge

Bazat e mendimit modern të zhvillimit të sigurimeve shoqërore, ku u përcaktuan drejtimit themelore të shtetit social "Welfare State" u hodhën në vitin 1942 në Raportin "Mbi varfërin" që mbajti Lorg Beveridge në Angli.

Në këtë raport Beveridge thekson se për çdo qytetar duhet të garantohet "një kufi ndihme", "një minimum jetese" në çdo fazë të jetës, nga lindja deri në vdekje. Në këtë mënyrë hidhet një hap i rëndësishëm përpara. Nga koncepti i sigurimit vetëm për rastet në rrezik, kalohet në konceptin e mbulimit të nevojës së anëtarëve të shoqërisë.

Në raportin e varfërisë evidentohen disa fusha që duhen mbuluar:

- *varfëria duke plotësuar nevojat jetësore bazë nëpërmjet mbështetjes me të ardhura;*
- *sëmundjet që janë pjesë e sistemit të kujdesit shëndetësor;*
- *anafalbetizmi, duke zhvilluar politika arsimore;*
- *papunësia, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nxitjes së punësimit;*
- *aftësia e kufizuar, nëpërmjet shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror.*

Këto propozime hodhën bazat për ngritjen e një sistemi të unifikuar të mbrojtjes shoqërore. Në këtë mënyrë u fut parimi i përgjithshëm i shërbimeve.

Politikat sociale tashmë, gjithnjë e më tepër filluan të bazohen mbi solidaritetin e gjithë shoqërisë, përmes ndërhyrjes financiare të Shtetit i cili merr përsipër dhe garanton siguri ekonomike për qytetarët e vet, në rastet kur atyre u mungojnë të ardhurat.

Idetë e Beveridge-it, kanë në qendër traditën liberale, rishpërndarjen e të ardhurave me politikat "Welfare", zbutjen e diferencave në të ardhurat midis shtresave të varfra dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

Në një kohë të shkurtër këto përgjegjësi u sanksionuan në:

Deklaratën mbi të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara në vitin 1948,

Konventën mbi standartet minimale të Mbrojtjes shoqërore të 1952 dhe 1LO-

Rregulloren e Komitetit European (71) mbi mbrojtjen e punëtorëve emigrantë

Kartën Sociale Europiane (të rishikuar).

Më 5 Korrik 1948 -Anglia vendosi sistemin kombëtar të mbrojtjes shoqërore dhe kjo datë konsiderohet si dita e "lindjes së shtetit social". Ky sistem

më pas u shtri dhe në vende të tjera, të cilat ndërmorën reforma duke ndërtuar shtetin e mirëqenies sociale, sipas specifikave dhe mundësive të secilit vend.

Shteti i mirëqenies sociale, është pjesë e një shteti demokratik në formë, në përmbajtje dhe për format e ndërhyrjes në ekonominë kapitaliste, me synim zhvillim ekonomik të vazhdueshëm të vendit, duke siguruar punësim të vazhdueshëm e të plotë të antarëve të saj.

Këto politika shkojnë në harmoni me politikat Keinsianiste të mbështetjes së kërkesës për të arritur punësim të plotë, ndërkaq që shpenzimet publike orientohen për politika "Welfare" për ofrimin e shërbimeve ndaj personit, punësimin dhe mbështetjen e familjeve të varfra për plotësimin e nevojave bazë jetësore.

Në këtë mënyrë me shtet social tashmë kuptojmë: "Tërësinë e ndërhyrjeve publike që modernizojnë e sigurojnë mbrojtjen sociale në formën e ndihmës, mbrojtjes dhe sigurisë sociale duke përfshirë të drejtat e veçanta të përcaktuara si dhe detyrime të posaçme të kontributit financiar".

Përvoja historike tregon se përfitimet familjare kanë ardhur më vonë. Ato e kanë zanafillën pas viteve 1950, kur Franca filloi të mbështesë familjet e ushtarakëve. Kjo mbështetet në filozofinë që paga duhet të mbulojë jo vetëm nevojat e punëtorit, por edhe nevojat e pjesëtarëve të tjerë të familjes. Në këtë periudhë, me fondet e krijuara me kontributet e punëtorëve, filluan të paguhen shtesa mbi paga në varësi të antarëve të tjerë në ngarkim të familjes.

Ndërkaq, modeli i Bismarkut (pas 1918) u përshtat edhe nga vendet e tjera të Evropës Lindore, që i përkisnin kampit socialist. Punëtorët në këto vende nuk paguanin kontribute, por vetë shteti u garantonte sigurimet shoqërore për disa degë sigurimesh, si: pensionin, aftësinë e përkohshme në punë, përfitimet familjare, edukimin e fëmijëve, shërbime shëndetësore etj.

Vlerësimi i eksperiencave dhe dallimeve mes sistemeve të ndryshme të mbrojtjes sociale është bërë nga Richard Titmuss, i cili përcakton tri modele:

i) modeli residual Welfare, i quajtur ndryshe asistencë publike, i cili mbështetet në ideologjinë konservatore sipas së cilës shteti ofron mbështetje të përkohshme për plotësimin e nevojave individuale, vetëm në raste kur tregu dhe familja nuk funksionojnë. Vetëm në këto raste lind nevoja e funksionimit të sistemit të mbrojtjes sociale për mbështetjen e familjeve dhe individëve të varfër.

Ky model i përmbahet idesë që vetë individi dhe familja duhet të marrë masa për të zgjidhur problemet e veta sociale. Roli i shtetit është i kufizuar dhe angazhohet vetëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

ii) modeli shpërblyes, në të cilin programet publike welfare kanë rol plotësues në sistemin ekonomik dhe ofrojnë mbrojtje sociale sipas meritave dhe niveleve të kontributit të individëve.

iii) modeli rindarës, ku programet publike welfare ofrojnë shërbime të përgjithshme sipas parimit të mbulimit të nevojës, pavarësisht nga tregu.

Mbështetur në modelet e mësipërme por edhe duke vënë theksin mbi përfituesit, italiani Mauricio Ferrera, i riklasifikon këto modele në kontekstin e përvojave të sotme Europiane në:

i) modele punësimi të pastra ose modele punësimi të përziera që bazohen në sigurime të përcaktuara për kategoritë e ndryshme të punëtorëve.

Modeli i punësimit i cili i referohet modelit "shpërblyes" Titmus, mbulon gati të gjithë nevojat sociale, por shkalla e mbulimit nuk është e plotë. Të punësuarit mbulohen nga një llojshmëri e gjerë sigurimesh në bazë të kontributeve që kanë derdhur gjatë kohës së punës.

ii) modele të përgjithëshme të pastra dhe modele të përgjithëshme të përziera. Në këtë rast modelet bazohen në skemat e sigurimeve të pensioneve dhe të shëndetësisë. Modelet e përgjithëshme që i referohen modelit "rindarës" Titmus, përcaktojnë një rindarje midis grupeve sociale, midis brezave, midis personave me nevoja të veçanta dhe pjesës tjetër të popullsisë.

Mbështetur në këtë analizë të modeleve të paraqitura nga Titmus, Ferrera riklasifikon modelet e mbrojtjes sociale që veprojnë aktualisht si më poshtë:

- në sisteme punësimi të pastra, ku përfshihet Franca, Belgjika, Gjermania dhe Austria;
- në sisteme punësimi të përziera, ku përfshihen Zvicra, Italia dhe Irlanda;
- në sisteme universale të pastra, ku përfshihen Finlanda, Danimarka, Suedia dhe Norvegjia;
- në sisteme universale të përziera, ku përfshihen Britania e madhe, Kanadaja dhe Zelanda e Re.

Në këtë mënyrë "Welfare state" mund të kuptohet si evolucion i njëkohësishëm dhe i vazhdueshëm në procesin e zhvillimit të të drejtave që u njihen qytetarëve dhe që Tomas Humphrey Marshall i përcakton si:

Të drejtat politike (e drejta e votës, e drejta e lirisë për të ushtruar detyra publike);

Të drejta civile (e drejta e pronës private, e drejta e lirisë së fjalës);

Të drejta sociale (të drejtat e veçanta të individit për të patur një nivel të përcaktuar minimal mirëqënie dhe sigurie ekonomike, sistem shkollor efikas dhe cilësor);

Të drejta për shërbime shëndetësore, për punësimin dhe për pagesën minimale për papunësinë;

E drejta për përcaktimin e pagesës minimale etj.

1.1 / 3 Sistemi i pensioneve sipas shpërndarjes dhe sipas kapitalizmit

Aktualisht ekzistojnë dy sisteme të ndryshme pensionesh: *sistemi sipas shpërndarjes dhe sistemi sipas kapitalizmit.*

Sistemi shpërndarës është një sistem kolektiv ku aktivët e sotëm kontribuojnë jo për veten e tyre por për pensionistët e sotëm. Shumica e vendeve të zhvilluara, përfshirë dhe Shtetet e Bashkuara, e përdorin

pjesërisht sistemin e shpërndarjes.

Në sistemin sipas kapitalizimit secili nga personat aktiv në punë, kontribuon për pensionin e tij. Kontributet vendosen në tregjet financiare të cilat menaxhohen me ndërmjetësimin e organizmave për "fondet e pensionit". Ky sistem është i implementuar gjerësisht në vendet anglo-sanksione.

Mbështetësit e sistemit të kapitalizimit, argumentojnë se ky sistem favorizon kursimin e mjeteve për investime, të cilat ndikojnë në rritjen ekonomike dhe për pasojë në përmirësimin e fondit për pensionistët.

Të tjerë argumentojnë se meqënëse sistemi aktual i pensioneve sipas kapitalizimit funksionon mirë mbi bazën e një administrimi privat të fondeve, sugjerojnë që edhe pensionet "publike" që i përkasin skemës shpërndarëse, të administrohet nga institucionet publike në të njëjtën mënyrë, me qëllim që të mënjanohen mangësitë eventuale.

Por, kalimi nga sistemi i shpërndarjes në atë të kapitalizimit nuk mund të bëhet njëherësh dhe brenda një kohe të shkurtër. Një kalim i menjëhershëm do të bënte që një individ të paguante një herë për veten e tij dhe një herë për të tjerët.

Sistemi i shpërndarjes është i padrejtë për dy kategori individësh:

Së pari, për personat (grupet) me jetëgjatësi më të shkurtër se mesatarja. Në këtë rast fitojnë më shumë gratë se burrat, pasi këta të fundit jetojnë më pak. Po ashtu, përfitojnë më shumë disa kategori që e kanë jetëgjatësinë më të lartë se kategoritë socio-profesionale, ku jetëgjatësia e tyre është tradicionalisht nën mesatare;

Së dyti, është i padrejtë për personat që nuk mund të dalin në pension me kohë të plotë, pasi nuk kanë plotësuar numrin e viteve të domosdoshme për të dalë në pension.

Mjaft autorë konstatojnë se sistemi i shpërndarjes mund të mos mbijetojë dhe të mos i rezistojë kontekstit demografik aktual, ndërsa të tjerë theksojnë se edhe sistemi sipas kapitalizimit mbart rrisje të mëdha në rastin e një destabilizimi të tregjeve financiare. Në këtë rast një punonjës që ka kontribuar gjithë jetën e tij për pensionin e vet, mund të gjendet i privuar, i mbetur pa gjë nga një pjesë e madhe e kursimeve të tij.

Zhvillimet demografike të identifikuara në 30 vitet e fundit në vendet e zhvilluara, por edhe në ato në zhvillim, kanë evidentuar reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të moshuarit. Kjo dukuri u rikonfirmua edhe një herë në Samitin e Madrit të OKB në vitin 2002.

Momentalisht shtrohet problemi i zgjedhjes së njërit prej dy sistemeve: sistemit shpërndarës ose sistemit kapitalizues. Në këtë kontest aktualisht, diskutohet për një sistem të përzier që një pjesë e pensioneve të financohet nga sistemi i shpërndarjes, ndërsa pjesa tjetër të financohet nga sistemi kapitalizues.

Por kjo përzierje nuk mund të jetë e vetmja që mund ta zgjidhë problemin. Sistemi duhet kompletuar me elemente të tjera që lidhen me zgjatjen e kohës së punës, ose përfshirjen në sistem të më shumë elementeve të solidaritetit të gjeneratave brenda bërthamës së familjes.

Në këtë sfond aktualisht prej vitesh është diskutuar për skemën e pensioneve në Shqipëri për një sistem të përzier, që një pjesë e pensioneve të financohet nga sistemi i shpërndarjes dhe pjesa tjetër të financohet nga sistemi kapitalizues.

Sistemi miks i pensioneve mendohej të kishte tri shtylla:

- shtylla e parë e pensioneve të jetë shtetërore;
- shtylla e dytë të jetë e detyrueshme dhe e administruar nga privatë;
- shtylla e tretë të jetë vullnetare.

Në vitin 1930, Sigurimet Shoqërore ishin përhapur edhe në Amerikën Latine, SHBA dhe Kanada, Afrikë, Azi dhe në zonën e Karaibeve. Në këto shtete sistemi i Sigurimeve Shoqërore ishte i ndryshëm nga një skemë në tjetrën, por brenda këtij sistemi pati edhe elemente parësore të përbashkëta. Si të tilla mund të përmendim "pagesën e kontributit nga punëdhënësit dhe punëmarrësit" dhe "kontributin shtetëror". Çdo pagesë kontributi e realizuar nga subjektet si punëdhënës dhe punëmarrës, regjistrohej në "librin e rekordeve".

1.1 / 4 Fillesat e sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri

Përsa i përket vendit tonë skemat e sigurimeve shoqërore janë evidentuar që në periudhën e sundimit Otoman, por nuk ka të dhëna të shkruara në lidhje me këtë fakt. Gjithashtu, ekzistojnë të dhëna të tërthorta¹⁰, në lidhje me zbatimin e skemave të sigurimit shoqëror për rastet e aksidenteve në punë në disa kompani të huaja, të cilat kanë operuar në Shqipëri në mënyrë vullnetare.

Fakti, se në Shqipëri kanë vepruar skema të sistemit të sigurimeve shoqërore përforcohet nga Ligji i parë i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri, në vitin 1923¹¹, i miratuar nga Leka Zogu.

Në nenin 28 të Ligjit "Për Dorëheqje dhe Pension për Ushtri dhe Gjindarmëri", datë 05.02.1923, sqarohet se "Të gjitha pensionet që ishin lidhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të rregullohen më me këtë ligj"¹². Ligji për sigurimet shoqërore, në periudhën e Ahmet Zogut, është frymëzuar nga përvoja franceze dhe ajo zviceriane, të cilat në vetvete zbatonin sistemin e sigurimeve sipas modelit Gjerman.

Kuptohet se përshtatja e këtij ligji u bë referuar kushteve ekonomike dhe politike të vendit tonë në atë periudhë. Në bazë të këtij ligji ofroheshin 2 lloje sisteme pensionesh:

- Sistemi i pensioneve ushtarake; (pleqërie, invaliditeti dhe familiar)
- Sistemi i pensioneve civile; (pensionet e nëpunësve civilë).

Skema më e zhvilluar me nivelin më të madh të të ardhurave, ishte skema e pensioneve ushtarake. Arsyeja ishte vëmendja e shtetit të asaj kohe ndaj ushtrisë. Ndërsa përsa i përket pensioneve civile, duhet thënë se ato zinin një vend shumë të vogël për faktin se shteti në atë kohë kishte natyrë

¹⁰ Ekzistenca e kompanive të huaja në Shqipëri është e provuar nga dokumentet arkivore .Sigurimi i rasteve të aksidenteve në punë zbatohet nga këto për shkak të kushteve primitive të punës.

¹¹ Ligji "Për Dorëheqje dhe Pension për Ushtri dhe Gjindarmëri", datë 05.02.1923

¹² Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka ekzistuar një sistem tjetër në fushën e sigurimeve: "Sistemi Otoman"

ushtarake, por edhe se vetë ligji kishte kufizuar rrethin e subjekteve civile që do të paguanin kontribute për sigurime shoqërore.

Në analizë të këtij ligji konstatohet dukshëm se ky ligj, linte jashtë fushës së veprimit një numër të konsiderueshëm subjektësh të cilat nuk punonin në administratë dhe nuk ishin të angazhuar në ushtri. Me zhvillimin gradual të ekonomisë dhe shoqërisë, koha kërkonte ndërmarrjen e disa hapave të rëndësishëm në fushën legjislativë të sigurimeve shoqërore. Për këtë arsye, u hartua një tjetër ligj, ai i *"Pensioneve Nr. 129, datë 28.10.1927"*.

Risia e këtij ligji kishte të bënte me përfshirjen e 2 koncepteve të reja në fushën e pensioneve: Pensionin e detyrueshëm dhe pensionin fakultativ (me kërkesë). Asgjë e re nuk u pa në fushën e subjekteve, pra fusha e subjekteve as nuk u shtua dhe as u pakësua.

Një tjetër reformë ligjore në funksion dhe zbatim të ligjit të mësipërm u realizua në vitin 1934. Rregullore për zbatimin e Ligjit *"Mbi Pensionet Civile dhe Ushtarake datë 20.06.1934"*¹³. Kjo rregullore pasqyroi në mënyrë të detajuar funksionimin e skemës, periudhën e përfitimit, mënyrën e përlllogaritjes etj.

Ligjet e periudhës së *"Mbretit Zogu I"*, mbetën në fuqi deri në vitin 1946, vit ky që përkon me daljen e Ligjit Nr. 327, datë 04.09.1946, *"Për Sigurimet Shoqërore Shtetërore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*. Miratimi i këtij ligji solli ndryshime si në fushën e subjekteve, ashtu edhe në mënyrën e funksionimit dhe financimit të sistemit të sigurimeve nga pikëpamja financiare.

Përsa i përket subjekteve, Ligji Nr. 327, datë 04.09.1946, mbulonte me sigurime shoqërore të punësuarit në sektorin shtetëror dhe të punësuarit në sektorin e kooperativave bujqësore. Për kooperativat skema e pensioneve ka filluar në vitin 1972. Sot nuk njihen kontributet e kooperativës për efekt pensioni para vitit 1972. Definicionet e subjekteve të mësipërme tregojnë dukshëm ndryshimin e formës qeverisëse.

Përfshirja e kooperativistëve në skemën e sigurimeve shoqërore, tregon vëmendje të shtetit ndaj kësaj kategorie, për faktin se në fushën e marrëdhënieve të punës numri i këtyre subjekteve ishte i konsiderueshëm, në raport me popullsinë qytetare e cila ushtronte veprimtarinë e saj në sektorin shtetëror. Nga pikëpamja e financimit, skema e sigurimeve shoqërore, nuk ishte më një skemë e cila operonte me kontributet e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, por kjo skemë u bazua tërësisht në modelin Sovjetik.

Ky ligj u ndryshua më tej me ligjin nr. 4171, datë 13.09.1966, *"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"*, ndryshime këto që kishin për bazë Modelin Sovjetik të sistemit të Sigurimeve Shoqërore, me planifikim buxhetor. Ndryshimi që solli ky ligj ishte përjashtimi nga skema e sigurimeve shoqërore e anëtarëve të kooperativave bujqësore. Këto subjekte mbetën jashtë skeme deri në vitin 1972¹⁴.

Sot nuk njihen kontributet e kooperativistëve për efekt pensioni para vitit 1972.

13 Fletore Zyrtare Nr 20, Tiranë 1935.

14 Zhaklina Peto, Dizertacioni *"Aspektet juridike të sistemit të sigurimeve shoqërore"*, faqe 19

Të dyja këto ligje në thelb, ishin të ngjashëm me sistemet e sigurimeve shoqërore të përdorura në të gjitha vendet e ish-blokut socialist. Diferencat me ato skema ishin shumë të vogla dhe pasqyronin specifika të lidhura me zhvillimin ekonomik të vendit tonë, peshën e ndryshme të grupmoshave në përbërjen e popullsisë, përqindjen e popullsisë qytetare dhe të asaj fshatare, në totalin e popullsisë etj¹⁵.

Sistemi i sigurimeve shoqërore në këtë periudhë nuk e njihte fare konceptin e kontributit, kjo për faktin se pagesa e sigurimeve realizohej nga buxheti i shtetit. Llogaritja e fondeve të Sigurimeve Shoqërore ishte shumë e thjeshtë. Ajo niste me një drejtim "Invers"¹⁶. Tërësisht ndryshe funksiononte ligji nr 7703, datë 11.05.1993 i "Sigurimeve Shoqërore". Ky ligj solli ndryshime si në drejtim të shtimit të numrit të subjekteve përfituese, ashtu dhe në drejtim të mënyrës së financimit të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Si pasojë e ndryshimit të formës së marrëdhënieve të punës (përfshirja e pronës private), skemës iu shtua rrethi i subjekteve kontribues dhe përfitues. Llogaritja e fondeve të Sigurimeve Shoqërore, të cilat mbështesin skemën e sigurimit, nuk bëhet me anë të metodës "Invers", por sipas metodës "Pay as you go"¹⁷.

1.2 SOCIOLOGJIA E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

1.2.1 Aspekte Sociologjike të Sistemit të Sigurimeve Shoqërore

*Sociologjia është shkencë e cila merret me studimin e shoqërisë njerëzore dhe të dukurive të saj. Problemet, fenomenet dhe konfliktet shoqërore apo ndërnjerëzore janë pjesa qendrore e studimeve sociologjike*¹⁸.

Shkenca e sociologjisë e ka zanafillën në fund të shekullit të 19-të, për këtë arsye krahasuar me fusha të tjera, ajo konsiderohet një disiplinë relativisht e re. Përsa i përket sociologjisë së skemave të sigurimeve shoqërore, theksojmë se kjo disiplinë, krahasuar me disiplina të tjera, ka tërhequr vëmendjen e pak sociologëve, për faktin se sociologjia si një koncept i ri në vitet 1970-1980, fokusonte vëmendjen në problemet politike të cilat ishin më të dukshme.

Për herë të parë elemente të sociologjisë së sigurimeve shoqërore janë shfaqur në mënyrë më të dukshme në ato vende, ku zhvillimi i sistemeve sociale vlen për t'u lavdëruar. Të tilla mund të përmendim Suedinë dhe Gjermaninë, ku politikat sociale nuk janë disiplina rivale me sociologjinë por përbëjnë shqetësimin themelor të sociologëve.

Në Gjermani, u krijua grupimi i parë social-politik në vitin 1976, i cili u quajt "Deutsche Gesellschaft für Soziologie". Ky grupim ka ndikuar në rritjen e interesit në fushën e studimit të sociologjisë në sigurinë sociale.

Hulumtimi dhe analiza sociologjike mbi sigurimet shoqërore ka qenë e

15 Zhaklina Peto, Dizertacioni "Aspektet juridike të sistemit të sigurimeve shoqërore", faqe 19

16 Kjo, do të thotë se më parë bëheshin llogaritjet për plotësimin e të gjitha pagesave të përfituesëve, pastaj bëhej kërkesa në buxhetin e shtetit, për tërheqjen e fondit kur shfaqej nevoja për pagesa. Zhaklina Peto, Dizertacioni "Aspektet juridike të sistemit të sigurimeve shoqërore", faqe 20

17 Kjo metodë bazohet në sistemin e kontributeve që derdhin subjektet e skemës. Me këto kontribute mbulohej pagesat e sigurimeve shoqërore për përfituesit aktual.

18 Fjala Sociologji rrjedh nga bashkimi i fjalës Latine "Socius" që do të thotë "Shoqëri" dhe fjalës Greke "Logos" që do të thotë "Shkencë" <https://sq.wikipedia.org/wiki/Sociologjia>.

ndikuar nga zhvillimet ekonomike dhe sociale që nga viti 1970, të cilat prekën një pjesë të madhe të popullsisë botërore. Faktorë të tillë si; rritja e numërit të familjeve me një prind, ndikimi i ndryshimeve demografike, numri në rritje i subjekteve të pensionuara, nivelet e larta dhe rradhët e gjata të papunësisë dhe një tendencë në rritje drejt polarizimit të forcës së punës, ishin faktorë të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë nga disiplina dhe sociologët të cilët pas analizës dhe konkluzioneve, hartuan disa marrëveshje të rëndësishme në fushën e sigurimeve sociale në dobi të shoqërisë.

Veç faktorëve të mësipërm, në funksion të marrëveshjeve për sigurimet sociale, një rol të rëndësishëm ka luajtur ndërgjegjësimi në rritje i kritikave ndaj strukturave institucionale të cilat menaxhonin këtë sistem.

Fakti që këto struktura, merreshin në mënyrë të drejtpërdrejt me organizimin e këtij sistemi në drejtim të individëve, kërkonte një analizë të hollësishme. Qëllimi i kësaj analize kishte të bënte me nxjerrjen në pah të efikasitetit të këtyre organeve në drejtim të shoqërisë. Përmirësimi i shërbimeve nga ana e organit përkatës i cili menaxhon dhe organizon skemën e sigurimeve shoqërore u konsiderua një element shtesë i studimeve sociologjike, në sistemin e sigurimeve shoqërore.

Për këtë arsye, për herë të parë në Hollandë kanë funksionuar *"kurset e trajnimit profesional"* për satafin e sigurisë sociale. Krijimi i këtyre kurseve trajnimi kishte si qëllim rritjen e profesionalizmit për stafin e sigurimeve shoqërore, në drejtim të shërbimeve por edhe në drejtim të mirëmbajtjes së skemës. Ngritja e këtyre kurseve trajnimi, lindi si pasojë e hipotezës *"A ishte i mirë trajnuar stafi i administraes, për t'i bërë ballë situatave të ndryshme në fushën e sigurimeve shoqërore?"* Kjo hipotezë, ndihmoi në shtimin e interesit për të përfshirë kurse trajnimi, të cilat ishin aplikuar më parë në vende të tjera, ku kishin rezultuar të suksesshme.

Me gjithë rëndësinë e rolit të këtyre kurseve në sistemin e sigurimeve shoqërore, kurset e trajnimit edhe pse konsiderohen të suksesshme, përsëri kanë një koeficient rreziku. Koeficienti i rrezikut lidhet me faktin se trajnimi mund të reduktohet në një funksion shumë të kufizuar të shërbimit, duke u shkëputur kështu nga rrjedhat kryesore të sociologjisë, siç ka ndodhur në vitet e hershme në sociologjinë e edukimit¹⁹.

Për sa më sipër duke pasur parasysh forcën e sociologjisë sot, besoj se krijimi i kurseve të tilla mund të japë një stimul të jashtëm të rëndësishëm për zhvillimin e sociologjisë së sigurimeve shoqërore.

Nisur nga përkufizimi i sociologjisë theksojmë se: Krijimi i sistemit të sigurimeve shoqërore është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të shoqërisë kundrejt shtetit, për mbrojtjen e shtetasve nga rreziqet sociale. Objekti i studimeve dhe analizave sociologjike në lidhje me sistemin e sigurimeve shoqërore, janë mosmarrëveshjet historike, ekonomike që kanë ndikuar në krijimin dhe zhvillimin e tij, konfliktet ndërmjet grupeve të interesit, ndërmjet disiplinave të ndryshme, institucioneve shtetërore të sigurimeve shoqërore, normave juridike dhe ndikimin e tyre në jetën e gjithësecilit prej nesh.

Sociologjia bashkëkohore, në analizën e elementeve të disiplinave të ndryshme, karakterizohet nga analiza terrorike dhe metodologjike e

¹⁹ Bankat, 1971, Faqe. 1,

disa mosmarrëveshjeve mjaft themelore, me natyrë ndërdisiplinore. Nëpërmjet përdorimit të metodave teorike dhe metodologjike, sociologët analizojnë fenomenet që sollën këto mosmarrëveshje dhe rekomandojnë rrugët që do të ndiqen për zgjidhjen e tyre.

Në lidhje me evidentimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sociologë të ndryshëm shprehin mendime të ndryshme. Autori *C. Wright Mill*, në botimin e tij të vitit 1959²⁰, i ka kushtuar vëmendje sociologjisë së sigurimeve shoqërore, ai theksonte se në suksesin e një sistemi, duhet të veprojë teoria e *"Imaginatës sociologjike"*. Anthony Giddens, në botimin e vitit 1986²¹, ka theksuar se: *"Sociologjia e sistemeve të sigurimeve shoqërore, përfshin tri forma studimi, të bazuara ngushtësisht ndërmjet tyre studimin historik, studimin antropologjik dhe imaginatën kritike"*.

Referuar autorëve të mësipërm konkludojmë se studimet sociologjike të sistemeve të sigurimeve shoqërore, realizohen nëpërmjet një analize të hollësishme të fakteve historike, duke krahasuar në mënyrë progresive se sa ndryshe jeton shoqëria sot në krahasim me të kaluarën, sa ndryshe funksionojnë institucionet e shtetit etj. Ndërsa, analiza antropologjike, na lejon të vlerësojmë larminë e mënyrave të ekzistencës njerëzore, të cilat janë të përjetuara nga njerëzit e shoqërive të ndryshme.

Në përfundim të analizave të mësipërme historike dhe antropologjike vjen analiza kritike, e cila vlerëson suksesin e sistemeve në dobi të shoqërisë, duke ushtruar kritikë mbi normat dhe institucionet ekzistuese sociale të cilat bëhen pengesë ose nuk përmbushin si duhet qëllimin për të cilin ato janë krijuar. Elemente të rëndësishme në studimet sociologjike të sistemit të sigurimeve shoqërore, janë analizat e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në këtë sistem.

Në shumicën e rasteve analiza e faktorëve të brendshëm mbështetet në studimin e elementeve specifik ekonomiko-politik dhe demografik të sistemit. Kjo analizë ka si qëllim nxjerrjen e problematikave dhe dhënien e rekomandimeve në lidhje me efikasitetin e skemës. Gjithashtu, analiza e këtyre faktorëve ndihmon në përzgjedhjen e politikave efikase dhe afatgjata, në drejtim të mirëfunksionimit të skemës së sigurimeve shoqërore.

Ndërsa analizimi i faktorëve të jashtëm, mbështetet në eksperiencat të ndryshme ligjore apo administrative të marra nga vendet e huaja dhe të cilat kanë rezultuar të suksesshme, por të vlefshme janë edhe eksperiencat të cilat vijnë nga fusha e studimeve sociologjike të sociologëve të huaj mbi sistemin e sigurimeve shoqërore. Këto eksperiencat vlejnë si pikë referimi për të mundësuar përmirësimin e pikave të dobëta të sistemit, por edhe në ndërmarrjen e politikave të reja të suksesshme në dobi të skemës dhe shoqërisë.

Një tjetër element i rëndësishëm i studimeve sociologjike është dhe analiza krahasimore e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm ndërmjet tyre. Analiza krahasimore ndërmjet studimeve sociologjike të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, mundëson ballafaqimin e përvojave pozitive dhe negative. Në përfundim të kësaj analize sociologët shprehin mendimin e tyre se cilat nga këto përvoja janë më cilësore, me ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në efikasitetin e sistemit të sigurimeve shoqërore.

20 "The Sociological Imagination" New York Oxford University Press 1959

21 The Constitution of Society University of California Press, 1986

Në shumicën e rasteve kërkimet të cilat realizohen në fushën e sociologjisë, e vënë theksin mbi kërkimet e projektuara për të përmbushur nevojat afatshkurtra të politikbërësve, më shumë se të kërkimi i thelluar bazë. Kjo për faktin se shumica e studimeve sociologjike në sisteme të ndryshme marrin shkas nga prioritetet e programeve qeverise se sa nga njohuritë e shkencave sociale. Megjithatë, ky fakt nuk duhet të konsiderohet si një element negativ, përkundrazi, analizat sociologjike të programeve të politikbërësve nga njëra anë janë mjet për eliminimin e efekteve të padëshiruara të këtyre politikave në jetën ekonomiko-shoqërore dhe nga ana tjetër konstatojnë efikasitetin e politikave të veçanta në dobi të sistemit dhe shoqërisë.

Cilado të ketë qenë arsyeja e analizës sociologjike, sociologjia mbetet gjithmonë një shkencë në funksion të shoqërisë, nëpërmjet së cilës nga njëra anë shpjegohet se pse gjërat janë ashtu siç janë dhe nga ana tjetër, sociologjia ka detyrimin të shpjegojë rrethanat, se si ato mund të jenë ndryshe në funksion të përmirësimit.

1.2.2 Metodatat e Studimeve Sociologjike

Metodat që përdoren në studimet sociologjike klasifikohen në metoda kuantitative, kualitative dhe historiko-krahasuese. Në varësi të objektit të studimeve sociologjike, këto metoda mund të përdoren të ndara ose të trija së bashku. Kur bëhet fjalë për analizë sociologjike të sistemit të sigurimeve shoqërore, aplikohen të tri metodat e mësipërme.

Nga analiza e zhvillimit historik të sistemeve të sigurimeve shoqërore e trajtuar në kapitullin e parë, evidentohet qëllimi i krijimit të sigurimeve shoqërore si mjet mbrojtës i shoqërisë nga rreziqet sociale. Gjithashtu, fokusimi i analizës sociologjike historike, merr në konsideratë llojin e sistemit, subjektet përfituese dhe masën e shpërblimit ekonomik.

Për të kuptuar qartë efikasitetin e këij sistemi në dobi të shoqërisë si dhe për të pasqyruar konfliktet e interesit dhe pasojat në lidhje me këtë sistem metodat më të mira për të aplikuar në këtë rast të veçantë janë: *Funksionalizmi strukturor* dhe *teoritë e konfliktit*. Funksionalizmi strukturor pohon se shoqëria është e përbërë nga struktura të ndryshme të ndërvarura që kanë pasoja (funksionet). Gjithashtu, funksionalizmi strukturor, pohon se për aq kohë sa në tërësinë e një strukturë shoqërore pasojat pozitive peshojnë më shumë se sa pasojat negative, struktura do të vazhdojë.

Teoria e konfliktit pretendon se konflikti lind si pasojë e pabarazisë sociale dhe e aksesit të pabarabartë të grupeve të caktuara të shoqërisë, si pasojë e burimeve të pakta në pasuri, pushtet dhe prestigj. Teoria e konfliktit mbështet tezën se krijimi i strukturave sociale nuk e zgjidh konfliktin social. Sipas kësaj teorie krijimi i strukturave sociale përbën detyrim për pushtetin për të përmbushur detyrimet ndaj shoqërisë. Në thelb të kësaj teorie qëndron fakti se ndryshimi i vërtetë social është përgjigja e vetme për zgjidhjen e konfliktit.

Teoria e funksionalizmit strukturor, merr në shqyrtim të gjitha format strukturore të sistemit të sigurimeve shoqërore të cilat kanë funksionuar dhe funksionojnë apo do të propozohen në të ardhmen, duke marrë parasysh funksionet ose pasojat e sistemit të Sigurimeve Shoqërore si një strukturë.

Funksioni i sistemit të Sigurimeve Shoqërore ka qenë sigurimi me të ardhura të mjaftueshme për të shmangur rënien nën kufirin e varfërisë për të moshuarit, gratë e veja, jetimët dhe personat me aftësi të kufizuara, të papunët etj. Sistemi financohet nëpërmjet një takse nga paga e punës (kontributi). Referuar mënyrës së financimit të skemave të sigurimeve shoqërore dallojmë 2 tipe: *Skema të cilat financohen dhe skema të cilat nuk financohen.*

Analiza sociologjike e financimit të fondit të skemave të mësipërme, ka për qëllim të evidentojë funksionin strukturor të sistemit aktual të sigurimeve shoqërore dhe gjithashtu, të fokusohet në qëndrueshmërinë financiare të tij, duke u mbështetur në analizimin e balancës financiare të hyrjeve të kontributeve dhe pagesave në dobi të shtetasve. Nëpërmjet analizës sociologjike me fokus fondin e skemave që financohen vetëm nga kontributet dhe nuk njohin mënyra të tjera investimi, mund të arrihen në konkluzione shumë të rëndësishme për jetëgjatësinë e skemave.

Këto skema janë të lidhura ngushtësisht me nivelin e ekonomisë dhe punësimit. Nëse nga analiza sociologjike e faktorëve që ndikojnë në këto skema konkludohet se të ardhurat nga kontributet arrijnë që gjatë gjithë ekzistencës së skemës të mbulojnë shpenzimet që realizohen për mbrojtjen e shoqërisë, atëherë këto skema do të jenë një garanci suksesi.

Kur bëhet fjalë për fondin e skemave të cilat financohen, analiza sociologjike merr në konsideratë analizën e planeve të investimit. Kjo për faktin se këto skema funksionojnë në bazë të investimit të një pjese të madhe të fondit të kontributeve, ky fond në shumicën e rasteve investohet në bono qeveritare, në aksione dhe obligacione private. Investimi në aksione dhe obligacione private e ekspozojnë fondin ndaj rrezikut të tregut. Në lidhje me sa më sipër analiza sociologjike në lidhje me financimin e fondit është një domosdoshmëri, për të parë efikasitetin dhe jetëgjatësinë e këtyre skemave për faktin se kjo skemë është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut si pasojë e investimit.

Teoria e Konfliktit shqyrton çështjen e reformës së sigurimit shoqëror me qëllimin e vetëm që nga këto reforma shoqëria të përfitojë sa më shumë të mundet. Kjo për faktin se ky sistem është krijuar për të mbrojtur shoqërinë nga rreziku social i paaftësisë së të moshuarve për punë, ndihmë për jetimët dhe personat me aftësi të kufizuara etj, me qëllim për të gjeneruar të ardhura të nevojshme për të plotësuar nevojat themelore të jetës.

Sigurimet shoqërore kanë qenë dhe janë një mjet i nevojshëm për të zgjidhur pabarazinë e natyrshme që ndodh ndërmjet shoqërisë së aftë për punë dhe të asaj pjese e cila mbetet e pafavorizuar për të nxjerrë të ardhura nga puna. Teoricienë të ndryshëm të cilët analizojnë elementet e konfliktit ndërmjet subjekteve të skemës së sigurimeve shoqërore dhe jashtë saj, i kushtojnë vëmendje maksimale konkluzioni se për cilat kategori subjektësh sistemi aktual është funksional dhe për të cilët nuk është.

Gjithashtu, ata do të identifikojnë konfliktin midis grupeve që kundërshtojnë reformat e propozuara të sigurimeve shoqërore dhe ato në favor të tyre. Në ditët e sotme vihet re një mendim i përgjithshëm se sistemi duhet të reformohet në mënyrë që të sjellë më shumë mbrojtje

ekonomike për subjektet në nevojë.

Përveç përfitimeve ekonomike, një tjetër mendim lidhet me garancinë e këtij sistemi për gjeneratat e ardhshme që do të jenë pjesë e tij. Fakti nëse ky sistem do të mund të mbulojë me pagesa brezin e sotëm kontribues, mbetet një pikpyetje e madhe. Kjo vlen për të dyja llojet e skemave të financimit. Ngushtësisht funksionimi i këtyre skemave lidhet me zhvillimet ekonomike të vendit. Skemat të cilat nuk financohen, funksionojnë në bazë të solidaritetit të brezave dhe analiza sociologjike lidhet me dy faktorë të rëndësishëm: punësimin dhe solidaritetin.

Nëse këto skema nuk plotësojnë nevojat minimale të shoqërisë në diapazonin e rritjes së nivelit të jetesës, atëherë rreziku për t'u larguar prej tyre do të jetë më i madh dhe për këtë arsye do të kemi dhe prishje të solidaritetit të brezave. Në këtë rast brezi i përfituesve aktualë do të mund të rriskohej nga tendenca e brezit të ri drejt skemave me financim, për një nivel më të madh përfitimesh.

Nga ana tjetër, rreziku i mosmbulimit me sigurime shoqërore për subjektet pjesëmarrëse në skemat me financim, lidhet me faktin se ky sistem është kryesisht i varur nga luhatjet e aksioneve dhe tregjet e bonove, pra të gjithë pjesëmarrësit në këtë treg në lidhje me përfitimin e sigurimeve shoqërore të daljes në pension, do të jenë totalisht të varur mbi gjendjen e tregut në kohën e daljes në pension. Ky fakt përbën një rrezik të ekzistencës së sigurimeve shoqërore të ngjashëm me lojrat e fatit. Në këndvështrimin e garancisë së skemave të financimit të sigurimeve shoqërore, sociologjia konstaton problematika të mëdha në lidhje me ekzistencën e tyre. Nga ky fakt politikat shtetërore duhet të merren seriozisht me parimin e garancisë së skemës.

1.2.3 Teoritë e Shtetit Social

Në temën vijuese do të trajtohet gama e disa teorive të cilat kanë avancuar për të shpjeguar zhvillimin e shtetit social. Në këtë pjesë, do të kuptojmë analizën sociologjike dhe rolin e saj në përcaktimin e tezave bazë të krijimit të shtetit social, duke u përqëndruar në zhvillimin e teorive të strukturës së shtetit social. Në pjesën e dytë trajtohen metodikat teorike të cilat janë duke u përdorur për të analizuar zhvillimin (ose reduktimin) e mirëqenies së shteteve evropiane.

Tezat në lidhje me mirëqenien e shtetit

Në këtë seksion, do të përqëndrohemi në një numër të konsiderueshëm të tezave kryesore të mirëqenies së shtetit. Këto teza janë konsideruar si përfaqësuese të qasjeve kryesore për teorizimin e mirëqenies së shtetit që janë zhvilluar gjatë dekadave të fundit. Këto janë:

Shteti social shfaqet si pjesë e "logjikës së industrializimit".

Shteti social zhvillohet në përgjigje të nevojave të një kapitalizmi të avancuar.

Shteti social është një produkt i modernizimit të shoqërive.

Shteti social është formuar nga betejat rreth politikës dhe klasave sociale.

Shteti social është formuar nga organizata shoqërore të prodhimit.

Shteti social është përcaktuar nga struktura dhe interesat e shtetit dhe qeverisë.

1.2.3 /1 Shteti social si pjesë e “logjikës së industrializimit”

Gjatë periudhës së zhvillimit të shtetit, shoqërisë, ekonomisë, dolën si domosdoshmëri një numër i konsiderueshëm tezash, me qëllim për të miratuar një qasje strukturore ose funksionaliste në zhvillimin e mirëqenies së shtetit. Studiues të shumtë, për të arritur në konkluzione të sakta për mënyrën e zhvillimit të shtetit dhe lëvizjeve shoqërore, në studimet e tyre tentuan ta shikonin shtetin social si një makineri në zhvillim, për të plotësuar nevojat e shoqërisë, në një fazë të caktuar të industrializimit, modernizimit apo kapitalizmit të avancuar. Një shembull i mirë në lidhje me funksionin e shtetit social është ilustruar më mirë në Kerr et al. (1960), në studimin e tij *“Industrializimi dhe Njeriu Industrial”*. Në këtë studim autorët shprehen se: *“bota po hyn në një epokë të re”, epoka e industrializimit nëpërgjithësi.*²²

Me industrializim autorët kanë pasur parasysh *“rrjedhën aktuale të tranzicionit nga shoqëria paraardhëse bujqësore apo tregtare drejt shoqërisë industriale”*.²³

Në këtë kontekst, Kerr dhe kolegët e tij, duke parë zhvillimin e sigurisë sociale dhe shtetit social si një hap kyç në ndërtimin e fuqisë punëtore industriale, argumentojnë se: *“Në faza shumë të hershme të industrializimit, shteti dhe menaxherët në mënyrë tipike kanë bërë pak ose aspak kujdes për mirëmbajtjen e forcave të punës. Punëtorët janë dërguar përsëri te familjet e tyre, nëse personi është plagosur, sëmurë, është i papunë, ose shumë i vjetër për të punuar. Në fakt, për këtë arsye, familja është Sistemi i tij i vetëm në dispozicion të sigurimit shoqëror”*.²⁴

Megjithatë, duke qenë se industrializimi përparon, lidhjet më të gjera familjare janë të prirura të prishen. Prandaj punëtorët, kërkojnë që shteti dhe biznesi të ndajnë disa përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre.²⁵ Për rrjedhojë të kësaj trysnie: Shoqëritë e industrializuara të avancuara në mënyrë karakteristike kanë programe formale të kompensimit të aksidentit, përfitime nga sëmundjet, sigurime për papunësinë, pensionet e pleqërisë për punonjësit industrial. *“Ekziston një marrëveshje e përgjithshme që as individit dhe as familja e tij nuk duhet të marrin përgjegjësinë kryesore për rreziqet e përfshira duke qenë një anëtar i përhershëm i fuqisë punëtore industriale. Shoqërisë i është bërë thirrje për të ruajtur personat të cilët nuk mund të punojnë për arsye jashtë kontrollit të tyre, si dhe atyre që ishin të angazhuar në aktivitete produktive. Përgjegjësia për garantimin e mirëqenies minimale dhe sigurinë e njeriut industrial qëndron në një masë të madhe te menaxherët e tij dhe të qeverisë së tij. Kjo kompletion ndarjen e varësisë së tij, si materialisht dhe emocionalisht, në lidhje farefisnore dhe lidhje familjare”*.²⁶

Kerr et al. pranojnë se vendet e ndryshme mund të miratojnë *“taktika të ndryshme që do të ndikojnë në zhvillimin e fuqisë punëtore”* dhe se kjo do të ketë implikime për qasjen e shtetit në zhvillimin e sigurimeve shoqërore²⁷. Ata gjithashtu njohin rolin e protestave të punëtorëve dhe përgjigjen e elitës si një rol kryesor në zhvillimin e sigurisë më të madhe sociale.²⁸ Megjithatë, theksi në këtë qasje shumë funksionale ishte fakti se

22 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial” (1960:3)

23 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial” (1960 :14)

24 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial” (1960 :152)

25 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial” (1960 :153)

26 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial” (1960 :22-153)

27 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial”(1960 :160)

28 “Kerr et al.-Së(1960), studim “Industrializimi dhe Njeriu Industrial”(1960 :Ch.6)

shteti social u shfaq në një fazë të caktuar të industrializimit në përgjigje të nevojave të ndryshme të shoqërive industriale në krahasim me shoqëritë "tradicionale" para-industriale.

Gjatë kësaj kohe, një numër studimesh të veçanta të shteteve sociale tërhoqi në këtë qasje teorike. Vlen të përmendet këtu punimi *The Welfare State and Equality*²⁹. Një tjetër studim interesant në lidhje me politikën e mirëqenies dhe industrializimit në Evropë, Amerikë dhe Rusi i autorit Gaston V. Rimlinger arriti në përfundimin se: "Nevoja për një formë të qartë të organizuar për mbrojtjen e të ardhurave rritet duke qenë se një shoqëri bëhet e industrializuar dhe e urbanizuar dhe se kjo nevojë është e pavarur nga natyra e rendit sociale-ekonomike"³⁰.

Duke theksuar se siguria sociale është një element thelbësor në socializëm ashtu edhe në kapitalizëm, studimi i Rimlinger njih disa qasje krejt të ndryshme të cilat i ka marrë në regjime të ndryshme dhe ka theksuar rëndësinë e një sërë faktorësh të tjerë në zhvillimin e mirëqenies së shteteve. Këto qasje përfshinin: "Një theks mbi marrëdhëniet e klasës si një faktor përcaktues në zhvillimin e mbrojtjes sociale, natyrës së sistemit politik dhe rolin e ideve"³¹.

Myles dhe Quadagno në veprën e tyre "Political Theories of the Welfare State" kanë dalluar ndërmjet versioneve më të dobëta dhe të forta të teorisë së industrializimit³². Ata argumentojnë se versioni i dobët i teorisë së industrializimit, është: "Se industrializimi dhe mardhëniet e tij (rritja ekonomike, plakja e popullsisë) të cilat janë të nevojshme për një linjë të përbashkët të trendit në zgjerimin e shtetit social, rrallë herë është në pikpyetje"³³.

1.2.3 /2 Shteti social zhvillohet në përgjigje të nevojave të kapitalizmit të avancuar

Nëse funksionalizmi theksoi rolin pozitiv që shpenzimet e mirëqenies duhej të luajnë në sigurimin funksionimit normal të shoqërisë industriale, kjonjë qasje Marksiste.

Ndërsa adaptohej një kuptim shumë funksional i shtetit social, dukshëm shpenzimet e mirëqenies ishte njëproceskontradiktor që krijoitendencatekrizës ekonomike, sociale dhe politike.

Ky kuptim i shtetit social mund të shihet në studimin e O'Connor në botimin e tij "Krizë Fiskale dhe Shteti" në vitin (1973)³⁴. Në këtë botim O'Connor argumenton se: "Shteti kapitalist duhet të përpiqet të përmbushë dy funksione bazë dhe shpesh reciprokisht kontradiktore - akumulimin dhe legjitimimin"³⁵.

Me fjalë të tjera, shteti i mirëqenies në një shoqëri të përparuar kapitaliste ndihmon si në sigurimin e vazhdimësisë, stabilitetit dhe punës efikase të sistemit të ekonomisë dhe në sigurimin e integritetit të klasave shoqërore dhe grupeve dhe ruajtjes së rendit shoqëror. Gjithashtu, O'Connor ka argumentuar se për shkak të "Karakterit të dyfishtë dhe kontradiktor të shtetit

29 *The Welfare State and Equality* Harold L. Wilensky (California, 1975).

30 *Welfare policy and industrialization in Europe, America and Russia* * Gaston V. Rimlinger (1971:334).

31 *The Welfare State and Equality* Harold L. Wilensky (California, 1975:8-10).

32 "Political Theories of the Welfare State" John Myles and Jill Quadagno.

33 "Political Theories of the Welfare State" John Myles and Jill Quadagno.

34 "The Fiscal Crisis of State" James O'Connor, (1973).

35 "The Fiscal Crisis of State" James O'Connor, (1973:6).

*kapitalist gati i gjithë shpenzimi i mirëqenies së shtetit është i përfshirë në të dy funksionet si akumuluese dhe legjitime dhe ka shërbyer për të dy qëllimet në të njëjtën kohë*³⁶. Më hollësisht ai argumentoi se, disa shpenzime edukimi të tilla si: nevojat për të riprodhuar dhe të zgjeruar nivelet e aftësive teknike të forcave të punës, kanë shërbyer si një mjet në funksionin e akumulimit. Përsa i përket shpenzimeve të tjera mund të thuhet se ato shërbyen në funksion të legjitimit.

Në mënyrë të ngjashme, ai argumenton se: *“Qëllimi kryesor i transferimit të disa pagesave, të tilla si sigurimet shoqërore, ishte për të riprodhuar fuqinë punëtore ndërsa qëllimi i të tjerëve, siç janë pagesat e të ardhurave për të varfërit, ishte që ta qetësojë dhe të kontrollojë tepricën e popullsisë”*³⁷.

Ashtu si qasja funksionaliste, por në një mënyrë krejt tjetër, O’Connor pa edhe zhvillimin e shtetit social si të lidhur me fazën aktuale të kapitalizmit. Ai argumentoi se kapitalizmi modern monopol ndryshon nga kapitalizmi i mëparshëm konkurrues në dy aspekte themelore:

Së pari: Një ekonomi e dominuar nga korporatat e mëdha që operojnë në industritë monopoliste ka gjeneruar më shumë pabarazi.

Së dyti: Ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën në të cilën ekonomia dhe pabarazitë sociale ishin perceptuar dhe vepronin mbi bazë të kapitalizmit monopol. O’Connor argumenton se: *“Nën kapitalizmin konkurrues, çështje si papunësia dhe nivelet e pagave duket të jenë pasojë e forcave të papërcaktuara jashtë kontrollit të njeriut”*³⁸.

Në kontrast me kapitalizmin konkurrues, në kapitalizmin monopol, pabarazitë e krijuara nga zhvillimi fillojnë t’u atribuohen politikave të ndërëgjegjshme të korporatave të mëdha, sindikatave të mëdha, dhe agjencive qeveritare, në vend të forcave të papërcaktuara të tregut³⁹.

Kështu O’Connor shprehet se: *“Rritja e sektorit shtetëror dhe shpenzimeve shtetërore është duke funksionuar gjithnjë si bazë për rritjen e sektorit të monopolit dhe të prodhimit të përgjithshëm”* dhe anasjelltas. *“Rritja e shpenzimeve dhe programeve shtetërore është rezultat i rritjes së industrive monopol”*⁴⁰.

Me fjalë të tjera, ai argumenton se: *“Rritja e shtetit ishte edhe shkak edhe pasojë e zgjerimit të kapitalit monopol”*⁴¹. Ai parashtron një element interesant në lidhje me rritjen ekonomike: *“Akumulimi i kapitalit social dhe shpenzimeve sociale është një proces kontradiktor i cili krijon tendenca drejt krizës ekonomike, sociale, dhe krizës politike”*⁴².

1.2.3 / 3 Shteti social është produkt i modernizimit të shoqërive

Të dy teoritë si *“Logjika e industrializimi”* ashtu dhe *“qasja funksionaliste marksiste”* kanë operuar në një nivel të lartë të përgjithshëm. Në formën e tyre reale këto teori nuk kanë shpjeguar shumë për mënyrat e ndryshme në të cilat është zhvilluar mirëqenia e shteteve. Botimin *The Development of Welfare States in Europe and America* viti 1998 autorët Peter Flora,

36 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:7).

37 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:7).

38 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:7).

39 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:7).

40 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:7-8).

41 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:8).

42 “The Fiscal Crisis of State” James O’Connor, (1973:9).

Arnold Joseph Heidenheimer theksuan se: “Mireqënia e shtetit është një fenomen i përgjithshëm i modernizimit, si një produkt të diferencimit dhe të madhësisë në rritje të shoqërive, në njërin anë dhe të proceseve të mobilizimit social dhe politik, nga ana tjetër.”

Gjithashtu ata pohuan se koncepti i modernizimit kishte zëvendësuar në masë të madhe konceptin tradicional të zhvillimit, si dhe konceptet më të veçanta të tilla si *industrializimi* dhe *demokratizimi*. Këta autorë kanë pranuar se kuptimi i industrializimit ishte disi i paqartë dhe konfuz, ata argumentuan se koncepti i modernizimit ishte i dobishëm në analizën e mirëqenies së shteteve për shkak të theksit shumëdimensional të zhvillimit shoqëror që është teoria e ndërlidhjeve rastësore midis ekonomisë dhe rritjes së popullsisë, mobilizimit social dhe psikik, zhvillimit politik, ndryshimit kulturor dhe transformimit të ekonomisë ndërkombëtare dhe të rendit politik⁴³.

Në vijim, autorët kanë argumentuar se zhvillimi i mirëqenies së shtetit mund të analizohet së paku në bazë të tri aspekteve⁴⁴.

- *Proceset e diferencimit të të ardhurave individuale dhe familjare, të vendit të punës të jetuarit të cilat krijuan probleme të veçanta në tregun e punës, probleme të cilat duhet të zgjidhen nga shteti;*
- *evolucioni i të drejtave sociale si pasojë e (ose kompensimi për) institucionalizimit të të drejtave politike; dhe*
- *kontrolli në rritje, zëvendësimi dhe plotësimi i tregjeve (dhe në njëfarë mase e shoqatave) nga burokracitë shtetërore;*

Në analizën e procesit të përfshirjes së aspekteve të mësipërme në legjislacionin e Sigurimeve shoqërore në Evropë, autorët shfrytëzuan pikat kryesore kyçe variable duke u bazuar në qasjen e modernizimit: Këto pika kyçe, përqendrohen në:

*Zhvillimin social ekonomik*⁴⁵

*Mobilizimi politik i klasës punëtore*⁴⁶.

*Strukturat kushtetuese*⁴⁷

Në kundërshtim me çfarë mund të pritej, studimi i tyre ka gjetur terren për ato shtete të cilat e kanë mbështetur atë, në kontrast me vendet pioniere që krijuan fillimisht legjislacionin e sigurimeve shoqërore në fusha të ndryshme, vendet ndjekëse krijuan sistemet e tyre “*zakonisht në një nivel pak më të lartë të zhvillimit social-ekonomik dhe në përgjithësi në një nivel shumë i lartë të mobilizimit politik*”⁴⁸.

Megjithatë, në përputhje me qasjen e modernizimit, ata vënë re se: “vendet me nivel relativisht të ulët të zhvillimit social-ekonomik, të cilat përfshihen në skemat e sigurimeve shoqërore, janë karakterizuar nga nivele

43 The Development of WelfareStates in Europe and American autorë Peter Flora, Arnold Joseph Heidenheimer (1981:38).

44 The Development of WelfareStates in Europe and American autorë Peter Flora, Arnold Joseph Heidenheimer (1981:41).

45 Sqarim autori : “që do të thotë, niveli i industrializimit dhe urbanizimit”.

46 Sqarim autori : “përqindja e votave në zgjedhjet kombëtare për tëpunuar për palet e klasës punëtore”.

47 Sqarim autori: “që është, zgjerimi i votes dhe kontrasti ndërmjet monarkive kushtetuese-dualiste dhe demokracive parlamentare”.

48 The Development of WelfareStates in Europe and American autorë Peter Flora, Arnold Joseph Heidenheimer (1981:61).

relativisht të larta të mobilizimit politik të klasës punëtore dhe anasjelltas, vendet me nivel relativisht të lartë të zhvillimit socialo-ekonomik, të cilat përfshihen në skemat e sigurimeve shoqërore, karakterizohen nga nivele relativisht të ulëta të mobilizimit politik, duke çuar në probleme sociale që kanë "të nevojshme" futjen e institucioneve të tilla.

Peter Flora në veprën e tij *"Mbi historinë dhe problemet aktuale të shtetit të mirëqenies sociale"* argumenton se: *"në Europën Perëndimore shteti modern social lindi si një përgjigje për problemet specifike të klasës së re industriale punëtore dhe fakti që shteti social modern, i krijuar në fund të shek. të 19-të në Evropë, mund të shpjegohet thjesht me nivelet relativisht të larta të industrializimit dhe demokratizimit të arritur në këtë rajon të botës"*⁴⁹.

Megjithatë, ndërsa autori e sheh evoluimin e shtetit social si një aspekt universal të modernizimit, ai prezanton gjithashtu njohjen e diversitetit të shtetit social që ekziston në Evropë. Në kërkim të diversitetit të shteteve sociale, argumenton si të rëndësishme, të paktën dy dimensione themelore të infrastrukturës institucionale⁵⁰:

- *shkalla në të cilën shteti kishte "depërtuar" në institucionet sociale është deklarata e shtetit social dhe*
- *shkalla në të cilën institucionet sociale reflektojnë diferencimet sociale.*

Ndër të tjera, autori ka pohuar se: *"struktura të ndryshme të klasës rreken të çojnë në lloje të ndryshme të shtetit social dhe sa më homogjene të jetë klasa punëtore industriale, aq më të mëdha do të ishin shanset për zhvillimin e një sistemi uniform të mirëmbajtjes të të ardhurave"*⁵¹. Kjo çështje e fundit na çon në tezat e mëvonshme, të cilat përqendrohen në më shumë hollësi mbi rolin e politikës dhe klasës sociale në zhvillimin e shteteve sociale.

1. 2.3 / 4 Shteti social është krijuar nga betejat mbi politikën dhe klasat sociale.

Një gamë e mëvonshme e studimeve⁵² kritikuan theksin në qasjen strukturale në nevojat funksionale, në aspektin e kërkesave të industrializimit dhe përbërjen e popullsisë dhe në vend të saj në fokusimin e rolit të politikës dhe klasës sociale në përcaktimin e strukturës së shteteve sociale. Në veçanti, studimet theksuan rëndësinë e mobilizimit të punonjësve (ose përfituesëve të pagave) dhe të partive social-demokrate apo të krahut të majtë.

Burimet e pushtetit

Parimet kryesore të qasjes së burimeve të pushtetit, mund të përcaktohen si vijon⁵³:

- *Kontrolli mbi burimet e pushtetit është një faktor kryesor, që ndikon në funksionimin e proceseve distributive brenda shoqërisë, në atë se çfarë janë rezultatet e këtyre proceseve dhe se si konflikti i shpërndarjes ka si model. Prandaj kontrolli mbi burimet e pushtetit ka luajtur një rol të madh në përcaktimin e strukturës së shtetit social.*

49 "On the history and Current Problems of the Welfare State", Peter Flora, 1986.

50 "On the history and Current Problems of the Welfare State", Peter Flora, 1986.

51 "On the history and Current Problems of the Welfare State", Peter Flora, 1986.

52 "Social policy and distributional conflict in the capitalist democracies. A preliminary comparative framework" Walter Korpi, 1980.

53 "Power, politics, and state autonomy in the development of social citizenship" Walter Korpi, 1989.

- *Shpërndarja e burimeve të pushtetit në demokracitë kapitaliste mund ndryshojnë në mes të kombeve dhe gjithashtu mund të ndryshojë me kalimin e kohës.*
- *Burimet kryesore të pushtetit në demokracitë kapitaliste, supozohen të jenë të lidhura me strukturat e klasës. Në treg, kapitali dhe burimet ekonomike formojnë bazën e pushtetit. Në të kundërt, në fushën e politikës burimet kryesore të pushtetit kanë të drejtën e votës dhe të drejtën për të organizuar veprime kolektive.*
- *Demokracia politike luan një rol të rëndësishëm në përpunimin e konflikteve të interesit.*

1.2.3 / 5 Demokracia sociale

Qasja e burimeve të pushtetit nuk është e kufizuar vetëm me një analizë që argumenton se demokracia sociale është çelësi për zhvillimin e shtetit social. Ajo gjithashtu mund të bazohet në analizën e saj, në ndikimin e klasave të tjera të rëndësishme sociale dhe aktorët politikë. Në të vërtetë Korpi është shprehur kundër çdo interpretimi të qasjes së burimeve pushtetit, duke e cilësuar si “një teori një-faktoreshe” duke pretenduar të shpjegojë zhvillimin e shtetit social pak a shumë vetëm në drejtim të klasës së punës apo forcës së të majtës⁵⁴. Kështu ai argumentoi se “qasja burimeve të pushtetit nuk do të thotë se zhvillimi i politikave sociale është i bazuar vetëm në fuqinë organizative dhe politike të klasës punëtore dhe të partive të majta”⁵⁵.

Megjithatë, Korpi dhe kolegët e tij, shumica nga një sfond skandinav, përqendrohen kryesisht në rolin e demokracisë sociale dhe mobilizimin e rrogëtarëve në zhvillimin e shteteve sociale. Më tej, rezultatet e tyre kanë tendencë të mbështesin tezën e demokracisë sociale. Shembull është një studim i zhvillimit të përfitimeve të sëmundjes në 18 vendet e OECD që nga 1930. Në këtë studim Korpi ka evidentuar se pjesëmarrja e partisë së majtë, ishte një faktor i rëndësishëm gjatë dy periudhave të Pas-luftës dhe Para-Luftës dhe në zhvillimin e siguracioneve të sëmundjes⁵⁶.

Disa prej atyre që veprojnë në kuadër të qasjes së gjerë social-demokratike, kanë njohur kufizimet duke u mbështetur ekskluzivisht në një theks mbi rolin e klasës punëtore në zhvillimin e shtetit social. Esping-Andersen (1985), në studimin e tij “From poor relief to institutional Welfare states: the development of Scandinavian social policy”⁵⁷, studim në të cilin mori në analizë zhvillimin e shtetit social në Skandinavi, theksoi rëndësinë e koalicioneve të klasës.

Në këtë qasje, sipas tij Partia Social Demokrate ka mbetur aktor kyç në ndërtimin e koalicioneve ndër-klasore. Megjithatë, teza e tij i është nënshtruar kritikave gjithëpërfshirëse. Në veçanti, ajo është kritikuar për dështimin e saj, për të marrë parasysh rolin kyç të klasës së mesme⁵⁸ dhe rolin e punëdhënësit⁵⁹.

54 “Power, politics, and state autonomy in the development of social citizenship” Walter Korpi,(1989:312).

55 “Power, politics, and state autonomy in the development of social citizenship” Walter Korpi,(1989:313).

56 “Power, politics, and state autonomy in the development of social citizenship” Walter Korpi, 1989.

57 “From poor relief to instrumental Welfare states: the development of Scandinavian social policy”, Esping-Andersen, 1989.

58 “The Politics of Social Solidarity: Class Bases of European Welfare State, 1875-1975”, Peter Baldwin, 1990.

59 “Capitalists against Markets: The Making of Labor Markets and Welfare State in the United States and Sweden”, Peter Swenson, 2002.

Është e rëndësishme të theksohet se këto kritika nuk janë domosdoshmërisht të qasjes së burimeve pushtetit në vetvete, por as të zbatimit të saj të ngushtë në demokracinë sociale dhe klasën punëtore.

1.2.3 / 6 Roli i klasave të mesme

Baldwin, në studimin e tij të zhvillimit të sigurimeve shoqërore në Britani, Francë, Gjermani, Danimarkë dhe Suedi në periudhën nga 1875, ka theksuar rolin e rëndësishëm të klasave të mesme dhe ka argumentuar se: *“qasja social demokratike duhet të shihet si shembull i një logjike më të gjerë të interesave shoqërore prapa shtetit social dhe zhvillimit të saj”*.⁶⁰ Studimi i tij ndër të tjera është ndalur në rëndësinë e përfshirjes së klasave të tjera, në veçanti klasave të mesme, në analizën e zhvillimeve të shtetit social.

Baldwin ka argumentuar se: *“shqetësimet e grupeve të caktuara sociale përcaktuan politikën sociale në një kuptim të menjëhershëm dhe se klasat e mesme ishin një nga grupet kryesore sociale në këtë drejtim”*.⁶¹ Studimi i tij i hollësishëm historik kërkon interpretimin social demokratik, madje edhe në zemër të Skandinavisë ku sipas tij *“karakteristikat unike të shteteve sociale nordike ishin përcaktuar nga interesat emergjente politike të kalsave të mesme agrare, të cilat as nuk do të përjashtohen nga përfitimet e politikës sociale, as do të mbajnë më shumë nga kostot që mund të zhvendosen tek kundërshtarët e tyre urbanë”*.⁶²

Në mënyrë të ngjashme, ai argumenton se: *“zhvillimi i shtetit social në Britani dhe Skandinavi pas luftës ka reflektuar jo vetëm interesat e të varfërve, por në mënyrë të njëjlojtë dhe me klasat e mesme dëshiron të jetë i favorizuar nga bujaria staturore”*.⁶³

Në mënyrë të ngjashme, Van Kersbergen në librin e tij *“Social Capitalism: A study of Christian Democracy and the Welfare State”* ka theksuar rolin që demokracia e krishterë ka luajtur në zhvillimin e shtetit social në shumë vende europiane.⁶⁴

1.2.3 / 7 Kthimi i punonjësve

Një numër studimesh të kohëve të fundit, janë kritike ndaj qasjes së demokracisë sociale dhe theksojnë rolin e punëdhënësve në zhvillimin e shteteve sociale.⁶⁵ Swenson, për shembull, thekson se qasja e burimeve të pushtetit, (të paktën në variantin e saj social – demokratik) nuk mund të shpjegojë zhvillimin e New Deal- it në Shtetet e Bashkuara. Swenson thekson se: *“deri më sot është marrë thjesht teoria (në vend që të tregohet) që punëdhënësit ishin kundër zhvillimit të shteteve sociale dhe se niveli i opozitës ishte gjerësisht i njëjtë në të gjithë kohën dhe gjithë kombet”*.⁶⁶

Ai argumenton se: *“ky supozim është i paqëndrueshëm dhe pa shqyrtuar në detaje pozitën e punëdhënësve në të gjithë kohërat dhe te të gjithë kombet, një*

60 “The Politics of Social Solidarity: Class Bases of European Welfare State, 1875-1975”, Peter Baldwin, (1990:8-9).

61 “The Politics of Social Solidarity : Class Bases of European Welfare State, 1875-1975”, Peter Baldwin, (1990:289).

62 “The Politics of Social Solidarity: Class Bases of European Welfare State, 1875-1975”, Peter Baldwin, (1990:289).

63 “The Politics of Social Solidarity: Class Bases of European Welfare State, 1875-1975”, Peter Baldwin, (1990:289-90).

64 “Social Capitalism: A study of Christian Democracy and the Welfare State”, Kess van Kersbergen, 1995.

65 “Capitalists against Markets: The Making of Labor Markets and Welfare States in the United States and Sweden”, Peter Swenson, 2002; “The Politics of Social Risk: Business and Welfare States Development”, Isabela Mares 2003.

66 “Capitalists against Markets: The Making of Labor Markets and Welfare State in the United States and Sweden”, Peter Swenson, (2002:108).

*theks vetëm në demokracinë-sociale mund të jetë çorientues. Për shembull, ajo nuk mund të përcaktojë nëse forca e demokracisë sociale është e lidhur (negativisht ose pozitivisht) me forcën e kapitalit”.*⁶⁷

Në praktikë, Swenson, në studimin e tij historik të zhvillimit të shteteve sociale në Suedi dhe Shtetet e Bashkuara, përshkruan se si punëdhënësit kanë favorizuar shpesh zhvillimin e masave të politikës sociale. Ai argumenton se: *“ka zakonishtnjë logjikë rregullatore për interesat e punëdhënësve që shpesh ngjasojnë me rregullatore të qeverisë, kur ata shohin një përfitim neto dhe pak rrezik. Politikatat e mirëqenies mund të sigurojnë një rregullator të tillë. Megjithatë, ka shumë pengesa dhe të meta në rrugën e punëdhënësve që përpiqen të zbatojnë interesa të tilla dhe në praktikë reformatorët me distancë të konsiderueshme organizative nga bota kapitaliste (demokratët kryesisht liberale në SHBA dhe socialdemokratët në Suedi), ishin zakonisht përgjegjës për të marrë iniciativën e politikave”*.⁶⁸

Mares (2003), duke u bazuar në dëshmi nga zhvillimi i shteteve sociale në Francë dhe Gjermani, bën gjerësisht kritika të ngjashme të qasjeve ekzistuese. Mares argumenton se: *“politikatat sociale luajnë një rol të rëndësishëm ekonomik për strategjitë e tregut të punës të firmave.”*⁶⁹ Ajo sugjeron se: *“prania e punëtorëve të kualifikuar, madhësia e fortë dhe incidenca relative e rrezikut me të cilin përballen një firmë mund të ndikojë në preferencat e punëdhënësit për zhvillimet e politikave sociale”*.⁷⁰

Swank dhe Martin (2001) në veprën e tyre *“Employers and the Welfare State: The Political Economic Organization of Firms and Social Policy in Contemporary Capitalist Democracies”*, gjithashtu ofrojnë dëshmi në mbështetje të kësaj qasjeje, duke argumentuar se: *“organizimi i punëdhënësve jep formë në mbështetjen e politikave sociale ndërmjet firmave dhe ndikon në rezultatet e politikave sociale.”*⁷¹

Në veçanti, autorët argumentojnë se: *“centralizimi dhe kohezioni i grupeve të punëdhënësit dhe bashkëpunimi ekonomik ndërmjet ndërmarrjeve ndikon pozitivisht në rezultatet e shteteve sociale.”*⁷²

1.2.3 / 8 Studimet e fundit

Një numër i studimeve të fundit kanë ritheksuar rolin e klasës punëtore apo të demokracisë sociale në zhvillimin e sistemeve sociale - megjithëse me disa modifikime të teorive të mëparshme.⁷³

Hick (1999), në studimin mbi zhvillimin e shteteve sociale gjatë periudhës prej 1880, argumenton se: *“organizatat politike dhe politikatat organizative të të punësuarve janë forcat më të fuqishme konsatnte që veprojnë për të çuar përpara politikën e sigurisë së të ardhurave.”*⁷⁴

Huberant dhe Stephens (2001), përsëri duke kombinuar qasjet sasiore

67 “Capitalists against Markets: The Making of Labor Markets and WelfareState in the United States and Sweden”, Peter Swenson, (2002:108).

68 “Capitalists against Markets: The Making of Labor Markets and WelfareState in the United States and Sweden”, Peter Swenson, (2002:115-116)

69 “The Politics of Social Risk: Business and WelfareStates Development”, Isabela Mares (2003:9).

70 “The Politics of Social Risk: Business and WelfareStates Development”, Isabela Mares (2003:10).

71 “Employers and WelfareStates: The Political Economic Organization of Firms and Social Policy in Centemporary Capitalist Democracies”, Duane Swank dhe Cathie to Martin, 2001.

72 “Employers and WelfareStates: The Political Economic Organization of Firms and Social Policy in Centemporary Capitalist Democracies”, Duane Swank dhe Cathie to Martin, 2001.

73 “Social Democracy WelfareCapitalism: A Century of Income Security Politics”, Alexander M.Hicks, 1999. “Development and Crisis of Welfare State”, Evelynne Huberand John D. Stephe, 2001.

74 “Social Democracy WelfareCapitalism: A Century of Income Security Politics”, Alexander M.Hicks, (1999:10).

dhe historike (duke u fokusuar në periudhën nga 1945), përdorin një qasje "grumbullimit tëpushtetit" që përfshin (a) fuqinë e klasës, (b) strukturën e shtetit dhe të marrëdhënieve shtet-shoqëri, dhe (e) kompleksin e marrëdhënieve në ekonominë ndërkombëtare dhe sistemin e shteteve⁷⁵. Përfundimet e tyre bazë janë që: *"mbajtja social demokrate çon në ndërtimin e shteteve të mëdha sociale, me të drejtat bujare, në një fokus të bollshëm në ofrimin e shërbimeve sociale publike, në mobilizimin e punës dhe në rishpërndarjen nëpërmjet taksave dhe transferimit të Sistemit"*⁷⁶.

A. Shtetet sociale janë formuar nga organizimi social i prodhimit

Një teori tjetër e zhvillimit të shtetit social, duke u bazuar në një qasje strukturore neo-marksiste, por duke pasur parasysh rolin e klasave shoqërore dhe shtetit, është zhvilluar nga Quadagno (1988)⁷⁷. Ajo argumenton se: *"programet e mirëqenies nuk janë një tipar unik i vendeve të përparuara kapitaliste dhe që të paktën që prej shekullit të gjashtëmbëdhjetë, përfitimet e mirëqenies publike kanë kryer funksionet e sigurimit të mbështetjes në punën e prekshme dhe në alokimin e punës"*⁷⁸.

Kështu programet e mirëqenies janë zhvilluar në përgjigje të progresit të kapitalizmit industrial dhe natyra dhe forma e shteteve sociale përcaktohet nga organizimi shoqëror i prodhimit. Duke pranuar se koha dhe struktura e programeve të mirëqenies ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në mes vendeve, ajo argumenton se: *"Lidhja ndërmjet zhvillimit të shtetit social dhe format e prodhimit shoqëror mund të modifikohen në një shtet të avancuar kapitalist, nëse puna merr resurse politike me programet e lira të mirëqenies kiteret e tregut"*⁷⁹.

Ajo argumenton se *"shteti social mund të jetë, (por sigurisht nuk është pa ndryshim apo madje zakonisht), në kundërshtim me pronën dhe tregun e forcave dhe se aftësia e punëtorëve për të marrë përfitime sociale nga tregu varet nga pozita e tyre në hierarkinë shtetërore"*⁸⁰.

Në këtë organizim shoqëror të tezës së prodhimit, Quadagno paraqet dy njohuri kryesore nga të shkruarit neo-marksist. Së pari, se shteti është (vetëm) relativisht autonom në ndërmjetësimin midis klasave të ndryshme shoqërore dhe së dyti, se procesi politik operon në një numër të niveleve të ndryshme⁸¹.

Poulantzas (1975) nga ana tjetër, argumenton se: *"shteti kapitalist ka një rol të saktë si organizator politik dhe bashkues dhe si një faktor për themelimin e ekuilibrit të paqëndrueshëm të kompromiseve, rol i cili është i lidhur me autonominë e tij relative. Forma konkrete e marrë me këtë autonomi relative varet nga "konjuktura e saktë e luftës së klasave në çdo kohë". Termi "relativ" në shprehjen "autonomi relative e shtetit" i referohet marrëdhënies mes klasave shtetërore dhe dominuese, që do të thotë, ai i referohet luftës së klasave*

75 "Development and Crisis of Welfare State", Evelyne Huberand John D. Stephe, 2001.

76 "Development and Crisis of Welfare State", Evelyne Huberand John D. Stephe, 2001.

77 "The Transformation of Old AgeSecurity: Class and Political in American WelfareState", Jill Quadagno, 1988.

78 "The Transformation of Old AgeSecurity: Class and Political in American WelfareState", Jill Quadagno, (1988:6).

79 "The Transformation of Old AgeSecurity: Class and Political in American WelfareState", Jill Quadagno, (1988:7).

80 "The Transformation of Old AgeSecurity: Class and Political in American WelfareState", Jill Quadagno, (1988:7).

81 "The Transformation of Old AgeSecurity: Class and Political in American WelfareState", Jill Quadagno, (1988:13).

brenda secilit formim social dhe në formën e tij përkatëse shtetërore.⁸²

"Parimet e teorisë marksiste të shtetit përcaktojnë kufijtë negativë të përgjithshëm të kësaj autonomie, që është se shteti (në afat të gjatë) mund të korrespondojë vetëm me interesat politike të klasës dominues ose klasave. Por brenda këtyre kufjve, shkalla, shtrirja dhe forma e autonomisë mund të shqyrtohet vetëm në lidhje me një shtet të caktuar dhe të konjunkturës së saktë të luftës së klasave përkatëse (konfigurimin specifik i bllokut të pushtetit, shkalla e hegjemonisë brenda këtij blloku, marrëdhëniet ndërmjet klasave të ndryshme dhe fraksionet).⁸³ Poulantzas-i nuk merr parasysh faktorë të tillë si raca dhe gjinia, të cilat tani duhet gjithashtu të përfshihen në një analizë të tillë.

Offe (1984), në veprën e tij *"Contradictions of the Welfare State"* 159-60) ofron një analizë të natyrës së procesit politik, në të cilin rezultatet politike janë të vendosura⁸⁴. Kjo, argumenton ai, më së miri *"mund të konceptohet si e përbërë nga tri nivele (ose tri arena kumulative të konfliktit). E para dhe më e dukshme është arena e vendimit politik të zhvilluar brenda aparatit shtetëror. Këtu aktorët janë elitat politike që konkurrojnë me njëri-tjetrin për fitoret zgjedhore dhe burimet e pakta që vendosin në lidhje me programet e politikave sociale, legjislationit dhe buxheteve. Ky është niveli më sipërfaqësor e më i dukshëm i politikës dhe është niveli në të cilin analiza ka tendencë të fokusohet".⁸⁵*

Por, Offe argumenton se: *"hapësira e vendimeve të mundshme të elitave politike përcaktohet nga forcat shoqërore që, në një nivel shumë më pak të dukshëm, formojnë dhe ndryshojnë pikëpamjet e politikanëve dhe perceptimin e realitetit, që do të thotë, alternativa të hapura tek vendimmarrësit dhe pasojat që priten nga secila prej alternativave. Ky është niveli në të cilin përcaktohet axhenda e politikës dhe përparësitë relative të çështjeve dhe zgjidhjeve."⁸⁶*

"Në këtë nivel është më e vështirë për të identifikuar aktorët e veçantë dhe "forcat që veprojnë këtu janë më shpesh rezultat agragat i një shumice aktorësh dhe veprimeve anonime."⁸⁷

Pika e rëndësishme, e argumentit është se *"edhe pse fuqia për të strukturuar realitetin e politikanëve, axhenda dhe vëmendja nuk mund të gjurmohen aq lehtë tek aktorët personal, siç është rasti në nivelin e parë të konfliktit politik. Ka një matricë të pushtetit social sipas së cilës klasa sociale, aktorët kolektivë dhe kategoritë e tjera sociale kanë një shans më të madh të fenomenit dhe riformimit të realitetit politik, duke hapur ose mbyllur axhendën politike më shumë se të tjerët. Në themel ky është një nivel i tretë në të cilin ndryshimet brenda matricës vetë ndodhin, qëdo të thotë se, ndryshimet në peshë relative që aktorët kolektive gëzojnë në formësimin e axhendës së politikës."⁸⁸*

Duke kombinuar këto dy qasje, Quadagno përcakton zhvillimin e pensioneve të pleqërisë në Shtetet e Bashkuara në një set kompleks të ekonomisë, politikës dhe forcave sociale. Në veçanti, ajo argumenton se në Shtetet e Bashkuara anëtarësimi i vonshëm i punëtorëve në sindikatë, masa e prodhimit, ekzistenca e një sektori të fuqishëm privat dhe dualizmi

82 "Classes in Contemporary Capitalism", Nicos Poulantzas, (1975:71).

83 "Classes in Contemporary Capitalism", Nicos Poulantzas, (1975:71).

84 "Contradictions of the Welfare State", Claus Offe, 1984.

85 "Contradictions of the Welfare State", Claus Offe, (1984:159-60).

86 "Contradictions of the Welfare State", Claus Offe, (1984:159).

87 "Contradictions of the Welfare State", Claus Offe, (1984:159).

88 "Contradictions of the Welfare State", Claus Offe, (1984:160).

i ekonomisë amerikane (prodhimi kryesor në Jug, kundër industrializimit në veri), ndihmojnë për të shpjeguar formën e veçantë, të cilën merr politika e pensionit në atë vend.

1.2.3 / 9 Shteti social përcaktohet nga struktura dhe interesat e shtetit ose qeverisë

Shteti i përqendruar

Kjo qasje thekson rolin e shtetit (apo qeverisë) në zhvillimin e shtetit social. Ka dy aspekte të dallueshme në qasjen e shtetit të përqendruar që Skocpol (1985) në veprën e tij *"Bringing the State Back In"* parashtron⁸⁹.

Së pari, në kontrast me teorinë neo-marksiste, dhe duke u mbështetur në konceptin e Max Weber-it për shtetin, Skocpol argumenton se: *"shtetet nuk janë thjesht pasqyruar të kërkesave apo interesave të grupeve shoqërore, klasave ose shoqërive"*⁹⁰. Kjo, në vetvete, nuk është në kundërshtim me argumentin neo-marksist që shtetet janë në instancën e fundit reflektuese të këtyre interesave. Megjithatë, Skocpol shkon më tej duke iu referuar *"mundësisë se veprimeve plotësisht autonome shtetërore"*⁹¹.

Së dyti, Skocpol avancoi "një kuadër alternativ të references... ndoshta edhe më të rëndësishëm se pikëpamja e shtetit si aktor"⁹². Kjo pikëpamje e "Tocquevillian" sheh shtetet si "konfigurimin e organizimit dhe të veprimit që ndikon në kuptimin dhe metodat e politikës për të gjitha grupet e klasat në shoqëri"⁹³.

Weir dhe Skocpol në veprën e tyre "State Structures and the Possibilities for the 'Keynesian' Responses to the Great Depression in Sweden, Britain and the United States"⁹⁴, aplikojnë këtë metodë për të shpjeguar përgjigje të ndryshme për "Depresionin e Madh" (Great Depression) në Suedi, në Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Autorët përshkruajnë se si Suedia kishte për qëllim të bëhej një shoqëri me punësim të plotë dhe me nivele të larta të shpenzimeve publike për mirëqenien sociale.

Shtetet e Bashkuara gjithashtu miratuan një qasje të gjerë Keynesian-e por Britania e Madhe, pavarësisht nga të qenit një pioniere në krijimin e programeve publike të mirëqenies sociale, nuk përshtaten një qasje Keynesian-e dhe as shtrinë përfitimet sociale publike deri pas Luftës së Dytë Botërore⁹⁵. Duke refuzuar një numër të teorive të mundshme shpjeguese për këto ndryshime (të tilla si funksionalizmi dhe fuqia e klasës punëtore), autorët përshkruajnë një teori të shtetit të përqendruar. Ata sugjerojnë që *"dy faktorë kyç shpjegojnë dallimet e politikës: qasjet e përcaktuara të politikave për trajtimin e problemeve të papunësisë dhe mekanizmat institucionale që ato ofrojnë për të lejuar ekspertët e ekonomisë të marrin pjesë në hartimin e politikave publike"*⁹⁶.

89 "Bringing the State Back In" Peter B. Evans, Dietrich Rueschemeyer, Theda Skocpol, 1985.

90 "Bringing the State Back In" Peter B. Evans, Dietrich Rueschemeyer, Theda Skocpol, (1985:9).

91 "Bringing the State Back In" Peter B. Evans, Dietrich Rueschemeyer, Theda Skocpol, (1985:15).

92 "Bringing the State Back In" Peter B. Evans, Dietrich Rueschemeyer, Theda Skocpol, (1985:21).

93 "Bringing the State Back In" Peter B. Evans, Dietrich Rueschemeyer, Theda Skocpol, (1985:28).

94 "State Structures and the Possibilities for the 'Keynesian' Responses to the Great Depression in Sweden, Britain and the United States", Margaret Weir, Theda Skocpol, 1985.

95 "State Structures and the Possibilities for the 'Keynesian' Responses to the Great Depression in Sweden, Britain and the United States", Margaret Weir, Theda Skocpol, (1985:108-9).

96 "State Structures and the Possibilities for the 'Keynesian' Responses to the Great Depression in Sweden, Britain and the United States", Margaret Weir, Theda Skocpol, (1985:110).

Në Britaninë e Madhe, diskutimet e politikave janë të fokusuar, në mungesë të një tradite të punëve të gjera publike, në lidhje me përfitimet e papunësisë. Në kontrast, qeveria suedeze ishte në gjendje për të ndërtuar mbi punën ekzistuese në punët publike të kryera nga Komisioni Kombëtar i Papunësisë.

Gjithashtu, në Britaninë e Madhe në vitin 1930 autorët argumentojnë se *"thesari ishte në kontroll efektiv të zhvillimit të politikave dhe një paragjykim i thellë kundër risive të politikave që i kundërvihet ekonomisë së ortodoksisë të përhapur në të gjithë aparatit britanik"*⁹⁷. Në të kundërt, ekonomistët suedezë ishin të përfshirë më lehtë në procesin e krijimit të politikave.

1.2.3 / 10 Një qasje më e gjerë institucionale

Protagonistët kryesorë të qasjes së shtetit të përqëndruar të gjithë kanë zhvilluar më tej teorinë e tyre,⁹⁸ lidhur me zhvillimin e hershëm të shtetit social amerikan.

Skocpol përshkruan një qasje të *"një shteti të përqëndruar i cili i sheh segmentet politike si vend strategjik të veprimit, por një aktivitet politik, qoftë të kryera nga politikanët qoftë nga grupet shoqërore, siç kushtëzohet me konfigurimin institucional të qeverive dhe sistemeve të partive politike"*⁹⁹.

Ky kuadër, i cili përfshin jo vetëm shtetin, por edhe "organizatat e partisë" dhe "grupet politikisht aktive" si pjesë e shtetit, tërheq vëmendjen për katër lloje procesesh:

- a) shteti, formimi dhe shndërrimi i partive;
- b) efektet e institucioneve politike mbi identitetet, qëllimet dhe kapacitetet e grupeve shoqërore;
- c) përshtatja ndërmjet qëllimeve dhe kapaciteteve të grupeve dhe pikat e aksesit dhe sistemeve të lejuara nga institucionet politike; dhe
- d) efektet e reagimeve të politikave.

Skocpol argumenton se: *"arsyet pse Shtetet e Bashkuara zhvillojnë lloje të ndryshme politikash sociale, mund të kuptohen vetëm duke vendosur hartimin e politikave brenda një analize më të gjerë organizative bazuar në zhvillimin e politikave Amerikane"*¹⁰⁰.

Një variacion mbi këtë qasje, nga prespektiva Tocquevillian, ka theksuar mënyrën në të cilën struktura kushtetuese formale dhe joformale ndikon mbi rezultatet e shtetit social¹⁰¹. Shumë prej studiuesve të kohëve të fundit, po ashtu kanë tentuar të fokusohen në natyrën e institucioneve politike, duke u përqëndruar në rolin e shtetit si "aktor". Teoricienë institucionale kanë argumentuar se: *"difuzioni i autoritetit politik ka qenë një pengesë kryesore për zhvillimin e shtetit social në Shtetet e Bashkuara"*¹⁰² ndërsa Huber dhe Stephens, në studimin e tyre krahasues të zhvillimit

97 "State Structures and the Possibilities for the 'Keynesian' Responses to the Great Depression in Sweden, Britain and the United States", Margaret Weir, Theda Skocpol, (1985:127).

98 "Gender and the Social Rights of Citizenship: the comparative analysis of gender relations and Welfarestates", Ann Shola Orloff, 1993.

99 "State Formation and Social Policy in the United States", Theda Skocpol, (1992:41)

100 "State Formation and Social Policy in the United States", Theda Skocpol, (1992:41)

101 "Health Politics: Interests and Institutions in Western Europe", Ellen Immergut, 1992.

102 "It's the institutions, stupid! Why comprehensive national health insurance always fails in America", Sven Steinmo dhe Jon Watts. 1995.

të shteteve sociale të post-luftës, gjithashtu argumentojnë se: strukturat politike kanë luajtur një rol të rëndësishëm, si në zhvillimin e mirëqenies dhe në lehtësimin apo bllokimin e shkurtimeve të saj¹⁰³.

Teoritë e përshkruara më lart nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive dhe studimet krahasuese kanë argumentuar se: *"faktorë të theksuar nga një numër i qasjeve të ndryshme kanë ndikim në zhvillimin e shtetit social"*¹⁰⁴. Gjithashtu duhet të theksohet se qasjet e përvijuara më lart, me siguri nuk janë shteruese dhe janë thjesht tregues i disa prej prirjeve kryesore në teorizimin e shtetit social, në dekada e fundit.

Ka një numër të aspekteve të rëndësishme të teorisë së shtetit social, që nuk është e mundur të përfshihen në qasjet e përshkruara më lart. Këto përfshijnë ndikimin e fesë dhe të familjes.

Castles në veprën e tij *"The Australian Welfare State: Key Documents and Themes"* sugjeron se: *"dallimet në besimet fetare dhe/ose në shkallën e shekullarizimit ndërmjet kombeve të përparuara, mund të jenë relevante për të kuptuar variantet ndërkombëtare, në një gamë të gjerë të rezultateve të politikave publike si ndikimi i faktorëve socialo-ekonomikë dhe politike"*¹⁰⁵.

Duke përdorur katoliçizmin si një shembull, ai argumenton se: *"feja mund të ketë ndikim në fushat e politikave të ndryshme si shpenzimet sociale, të politikave të familjes dhe të politikave të rezultateve të tregut të punës, veçanërisht aty ku rezultatet e lidhur gjinore janë në diskutim"*¹⁰⁶.

Fahey (2002) është i mendimit se: *"ekziston një nevojë për vëmendje më të madhe në rolin e familjes dhe në lidhje me klasën agrare sociale, duke qenë se ajo ndikon në formimin e shteteve sociale"*¹⁰⁷. Ai kërkon të zgjerojë këto këndvështrime duke hulumtuar rolin e mbështetjes shtetërore për prodhimin bazë familjar ekonomik, sidomos bujqësinë familjare, në evoluimin e regjimeve të mirëqenies. Ai argumenton se punësimi në familje është një instrument alternativ për të zhvilluar punën dhe se punësimi i tillë familjar ka gjetur mbështetje të gjerë në shumë shtete sociale, gjatë shekullit të kaluar¹⁰⁸.

1.2.3 / 11 Perspektiva sociologjike mbi Sigurimet Shoqërore

Sociologjia si një disiplinë më vete mbështet funksionin e saj mbi një sërë urdhrash metodologjike. Në kuadër të studimit mbi institucionet sociale, analiza sociologjike ka të ngjarë të jetë historike dhe krahasuese si dhe të miratojë një qëndrim kritik edhe kur këto institucione janë bashkëkohore.

Në mënyrë të vazhdueshme vëmendja e shumë studiuesve sociologë është përqëndruar në studimet sociologjike mbi sistemet e sigurimeve shoqërore. Studimet kanë pasur si qëllim saktësimin e përkufizimit të sigurimeve shoqërore në legjislacionin social. Kjo për arsye se në vende të ndryshme, në periudha të ndryshme, kanë vepruar dhe veprojnë legjislacione të ndryshme, ku dalin në pah dallime thelbësore kombëtare.

Evidentimi i dallimeve dhe vlerësimi i tyre nga njëri sistem te tjetri, kanë përbërë qëllimin e studimeve të sociologjisë së sigurimeve shoqërore.

103 "Parties and Policies in Global Markets", Evelyne Huber and John D. Stephens, 2001.

104 "Parties and Policies in Global Markets", Evelyne Huber and John D. Stephens, 2001.

105 "The Australian Welfare State: Key Documents and Themes", Castle, (1994:19).

106 "The Australian Welfare State: Key Documents and Themes", Castle, (1994:38).

107 "Older People's Preferences for Employment and Retirement in Ireland". Tony Fahey, 2002

108 Ibid..

Analiza e këtyre studimeve është mbështetur në ekzaminimin e kuptimeve alternative të konceptit të sigurimeve shoqërore. Duke përdorur përkufizimin e konceptit të sigurimeve shoqërore, në drejtim të mbrojtjes sociale nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në vitin 1984 (ONP), sociologët kanë analizuar ndarjen shoqërore të mjeteve publike të sigurisë sociale dhe komponentëve fiskale dhe profesionale¹⁰⁹.

Njëqasje etillësiguron një sfidë për kategoritë konvencionale administrative dhe mundëson karakterizimin dhe krahasimin e dispozitave publike të sigurimeve shoqërore dhe alternativave të tyre funksionale, ndërmjet vendeve të ndryshme.

Gjithashtu një tjetër element i cili ka nevojë për një studim më të ngushtë nga një këndvështrim sociologjik janë kushtet e punës të të punësuarve dhe praktikës¹¹⁰. Kontributin e sociologjisë mbi sigurimet shoqërore do ta shpjegojmë duke analizuar çështjet e mëposhtme:

Karakterit sociologjik i sistemeve të sigurimeve shoqërore

Karakterit sociologjik i sigurimeve shoqërore mund të analizohet nëpërmjet elementeve bazë që përbëjnë këtë sistem në drejtim të administrimit të skemave të sigurimeve shoqërore, të ndihmave sociale, normat dhe fitimet e lidhura me fondin e kontributeve¹¹¹, skemat e sigurimeve me financim, skemat mbështetur në financimin e fondit dhe skema të cilat funksionojnë mbi përfitime të përcaktuara.

Një tjetër karakteristikë e cila përbën kusht thelbësor për studimet sociologjike, ka të bëjë me analizën e “kushteve” të cilat kanë ndikuar në shfaqjen e formave të ndryshme të zhvillimit të sigurimit shoqëror në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen e mundshme, të dispozitave të sigurimeve shoqërore.

Studimet krahasuese për origjinën dhe zhvillimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore

Këto studime janë një element i rëndësishëm i analizës sociologjike. Sociologët kanë dhënë një kontribut të veçantë në analizën historike të të gjithë faktorëve, të cilët çuan në krijimin e sistemit të sigurimeve shoqërore dhe zhvillimit të skemave të përfitimeve ekonomiko-sociale.

Në botimin e tij Jams Midgley (1984)¹¹², ka theksuar se “Pararendëset e sigurimeve shoqërore kanë qenë, asistencë sociale dhe forma të tjera jopublike të sigurimeve shoqërore, të praktikuar në vende të ndryshme në stadi të ndryshme të zhvillimit ekonomik shoqëror”.

Hulumtimi krahasues i historisë së krijimit dhe zhvillimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore në vende të ndryshme fillimisht është kryer në bazë të studimeve cilësore që përfshijnë një numër të vogël të vendeve dhe seksione të veçanta të sigurimeve shoqërore Hugo Hecló në vitin 1974¹¹³, në analizën e historisë së politikave të mirëmbajtjes të të ardhurave në Britani dhe Suedi, përdori analizën e mprehtë politike,

109 Shih, për shembull Sinfield 1989 Clinical social work with maltreated children and their families: An introduction to practice. New York: New York University Press.

110 Shih, përshembull, puna në ndërtimin social të varfërisë dhe mjaftueshmërinë e përfitimeve të cilat janë të pavarura nga formulimet administrative (Townsend, 1979 dhe Veit-Wilson, 1987).

111 Këtu bëhet fjalë për sistemet liberale, të cilat financojnë fondin e sigurimeve.

112 Social security, inequality and the third World. James Midgley Wiley, Chichester, 1984, 225.

113 Hug Hene Modern Social Politics in Britain and Sweden: From Relief to Income Maintenance (Yale studies in political science) 1974.

metoda krahasuese, kërkimore historike teorike dhe politike. Gjithashtu, ai konstatoi se përdorimi i metodave *sasiore* duke përfshirë një numër të madh vendesh dhe gamë të tërë të programeve të sigurimeve shoqërore nxjerr një konkluzion më të qartë të suksesit apo e thënë ndryshe të efikasitetit të sistemeve të sigurimeve shoqërore në drejtim të shoqërisë.

Studimet Makro-sociologjike dhe impakti i tyre në shtresëzimin social

Studimet makro-sociologjike, kanë një ndikim të dukshëm në sistemin e sigurimeve shoqërore përse i përket shtresëzimeve sociale. Dispozita e sigurimeve shoqërore pothuajse në të gjitha shtetet kanë qenë përgjigjet e ndërtimit të shtetit social të nevojës dhe të varësisë, por ndikimi i tyre në kushtet që ato janë të destinuara për t'u përmirësuar shpesh është një marrëveshje e madhe më e ndërlikuar.

Studimet sociologjike, kanë treguar se testimi i sistemeve të sigurimeve shoqërore në varësi të ndryshimeve ekonomike mund të rrisin mundësinë e vartësisë ndaj skemës për kategori të caktuara personash. Gjithashtu, mund të ndodhë që dispozitat e sigurimeve shoqërore mund të përsërisin dhe zgjerojnë varësitë gjinore brenda familjes, të rrisin numrin e të moshuarve dhe zgjerojnë pabarazinë në tregun e punës.

Studimet e këtij lloji mund të nxjerrin në pah problematikat, apo rrugët e eliminimit të tyre, nëse ato përfshijnë krahasime midis llojeve të ndryshme të dispozitave të sigurimeve shoqërore, apo në mes të sigurimeve shoqërore dhe të mekanizmave të tjerë të rishpërndarjes, si tatimi mbi të. Në këtë mënyrë, studimet sociologjike mund të shqyrtojnë efektet e sigurimeve shoqërore në natyrën e ndryshueshme të shtresëzimit social dhe në forma të ndryshme të cilat riprodhojnë pabarazi shoqërore. Kjo, nga ana tjetër, mund të hedhë dritë të re mbi debatet teorike mbi konceptet e ndërtuara sociologjikisht të klasës dhe gjinisë në lidhje me shtetin.

Në lidhje me ndikimin e shtresëzimit social në sistemin e sigurimeve shoqërore, studimet makro-sociologjike analizojnë sjelljen e njerëzve dhe mbi mënyrën se si ata e shohin veten në qëndrimet e tyre në raport me sistemin e sigurimeve. Përfitimet nga ky sistem mund ose nuk mund të sjellin efekt mbi qëndrimet dhe sjelljet e shoqërisë ndaj punës, për mbështetjen financiare dhe kujdesin brenda familjes, për përfitime të tjera të sigurimit shoqëror ndaj shoqërisë dhe shtetit. Studimet sociologjike kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në sqarimin e këtyre kuptimeve dhe në vlerësimin e rëndësinë e tyre. Këto studime duhet të jenë një element i rëndësishëm, kur bëhet fjalë për ndërhyrje radikale apo të pjesshme në politika sociale apo ekonomike, të cilat prekin mbarë shoqërinë.

KAPITULLI

II

- 2.1 KONCEPTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
- 2.2 OBJEKTI DHE SUBJEKTET E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
- 2.3 PARIMET E PËRGJITHSHME TË SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËROR
- 2.4 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME MBI BARAZINË GJINORE NË FUSHËN E SIGURIMIT SHOQËROR
- 2.5 PANORAMË E PËRGJITHSHME MBI TRAJTIMIN E PARIMIT TË BARAZISË GJINORE NGA LEGJISLACIONI I BASHKIMIT EUROPIAN
- 2.6 GJINIA DHE SHTETI SOCIAL
- 2.7 BURIMET NDËRKOMBËTARE NË SISTEMIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE
- 2.8 ROLI I SKEMAVE PROFESIONALE TË PENSIONEVE
- 2.9 ROLI I QEVERISË DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE
- 2.10 ROLI I PARTNERITETEVE NË RREGULLIMIN E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

KAPITULLI II

Hyrje

Në Kapitullin e dytë do të fokusohemi tek koncepti dhe objektivat e sistemit të sigurimeve shoqërore. Koncepti është analizuar në dy drejtime bazë:

- Në drejtimin e llojit të përmbajtjes së skemave
- Në drejtimin e rreziqeve sociale të konstatuara.

Analiza e disa objektivave në sistemin e sigurimeve shoqërore përfshihen në këtë kapitull si Kompesimi, Riaftësimi dhe Parandalimi.

Objekti i Sigurimeve Shoqërore është mbrojtja nga ngjarjet sociale të padëshiruara të shoqërisë ekonomikisht aktive apo të asaj pjese e cila nuk është aktive por për shkak të burimeve financiare bëhet pjesë e këtij sistemi.

Në këtë kapitull do të marrim në konsideratë dhe analizën e parimeve mbi të cilat mbështetet skema e sigurimeve shoqërore. Parimin e Universalitetit, Barazisë, Garancisë dhe Eksportimi i të drejtave të fituara do ti gjejmë të analizuar në këtë kapitull.

Fokusohet vëmendja në disa burime ligjore me karakter të përgjithshëm ndërkombëtarë dhe rolin e tyre në sistemin e sigurimeve shoqërore. Këtu evidentohen ato norma ligjore ndërkombëtare të cilat janë krijuar për të përmirësuar këtë sistem në dobitë shoqërisë por edhe norma të cilat nga pikëpamja ligjore janë konsideruar me interes të lartë dhe duhet të gjenin zbatim në pjesën më të madhe të shteteve krahas legjislacionit të brendshëm. Sigurisht që kemi marrë në konsideratë disa instrumenta të rëndësishëm ndërkombëtarë në fushën e sigurimeve.

- *Organizatën Ndërkombëtare të Punës si një instrument të rëndësishëm në përpilimin e normave ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve të punës së sigurimeve shoqërore dhe atë të mekanizmit të kontrollit dhe angazhimeve të shteteve palë.*
- *Aktet Normative të Këshillit të Europës si një instrument të rëndësishëm me karakter detyrues për implementimin e tyre në legjislacionet vendase.*
- *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Social Europiane e cila është trajtuar.*

Gjatë trajtimit të kapitullit dukshëm evidentohet fakti se në menaxhimin e skemave të pensionit, partner të ndryshëm si individë dhe institucione shtetërore luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e këtij sistemi. Por përveç aktorëve, në fushën e mbrojtjes sociale, një rol të veçantë zënë edhe metodat të cilat përdoren për të rritur efikasitetin e skemës me qëllim zgjerimin e mbrojtjes sociale si Rritjen e efikasitetit të Sigurimeve Shoqërore, Hartimin e Strategjisë për ofrimin e mbrojtjes sociale, kujdesin për mbulime me siguri të gjithë pjesëmarrësve në skemë.

2.1 KONCEPTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Sigurimet Shoqërore, konsiderohen element i rëndësishëm jo vetëm në jetën e një shteti, por dhe në jetën e individëve. Arsyeja bazë e kësaj rëndësie qëndron se sigurimet shoqërore përmbajnë në vetvete sisteme mbrojtëse për shoqërinë të cilat shfaqen në dy forma:

- *Sigurime shoqërore të detyrueshme;*
- *Sigurime shoqërore vullnetare.*

Këto sisteme mbrojtëse konsiderohen shtyllat bazë të financimit të këtij sistemi. Në lidhje me konceptin e sigurimeve shoqërore janë dhënë definicione të ndryshme në periudha të ndryshme të formimit të shtetit. Në kuptim të përgjithshëm, të konceptit të sigurimeve shoqërore theksojmë se:

Sigurimet shoqërore i referohen mbrojtjes së dhënë nga shoqëria për anëtarët e saj kundër ngjarjeve mbi të cilat nuk ka kontroll. Filozofia themelore e sigurimeve shoqërore është se shteti është organi përgjegjës për të siguruar një standard minimal të mirëqenies materiale për të gjithë qytetarët e tij në një bazë të gjerë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha risqet kryesore të jetës.

Në kuptimin tjetër, siguria sociale është kryesisht një instrument i drejtësisë sociale dhe ekonomike¹¹⁴. Sigurimet shoqërore përbëhen nga një "tërësi normash për mbrojtjen e shtetasve, kur ata goditen nga ngjarje sociale"¹¹⁵.

Shteti si organizatori kryesor i mbrojtjes së shtetasve realizon mbrojtjen e shoqërisë nëpërmjet disa sistemeve ligjore bazë, të cilat të gjitha së bashku i përkufizojmë sisteme të sigurisë sociale, si:

Sistemi i sigurimeve shoqërore;

Sistemi i sigurimeve shëndetësore;

Sistemi i mirëqenies shtetërore.

Të gjitha këto sisteme kanë për qëllim mbrojtjen e individëve, kur ata goditen nga ngjarje sociale si shkak i të cilave individit nuk mund të sigurojë të ardhura për të jetuar si pasojë e humbjes së aftësive të tij fizike të cilat e pengojnë të punojë. Ngjarjet mbi të cilat shoqëria nuk ka kontroll dhe që ne i konsiderojmë si rreziqe sociale shoqërohen me paaftësi për të punuar, si pasojë e të cilës individit humbet mundësinë për të krijuar të ardhura nga puna. Si të tilla mund të përmendim:

Sëmundja;Pleqëria; Papunësia;

Por, për efekte të këtij punimi ne do t'i referohemi vetëm sistemit të sigurimeve shoqërore. Pra, nga sa u shpjegua më lart kuptohet se, kur individit goditet nga ngjarjet sociale, mjeti ligjor i cili lehtëson në një farë mënyre jetesën, është "sistemi i sigurisë sociale"

2.1. 1 Objektivat e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore

Për të organizuar sa më mirë funksionimin e këtij sistemi në drejtim të

114 Social Security: Concept, Objective and Other Details Smriti Chand **Employee Management**

115 Ngjarjet sociale në literaturë i ndeshim dhe me termin rreziqe sociale.

mbrojtjes së shoqërisë në rastet e rrezikut social ky sistem karakterizohet nga disa objektiva bazë.

- *Kompensimi*: Nëpërmjet kompensimit nga skema garantohet siguria e të ardhurave në raste kur individ i është i prekur nga ngjarje sociale të paparashikuara dhe të pa evitueshme. Nëpërmjet kompensimit të rreziqeve, individ dhe familja kanë mundësinë të jetojnë pa stres.
- *Riaftësimi*: Ndryshe konsiderohet si zgjerim i kompensimit. Ka të bëjë me faktin e kurimit të plotë të sëmundjes dhe riaftësimin e plotë të tij për gjendje pune.
- *Parandalimi*: Parandalimi lidhet me marrjen e një sërë masash, me qëllim shmangien e humbjes së kapaciteteve prodhuese për shkak të sëmundjes, papunësisë apo invaliditetit. Me fjalë të tjera, këto masa janë të dizenuara me synimin për të rritur materiale, intelektuale dhe morale mirëqenien e komunitetit duke kthyer në burime të disponueshme ekonomike atë pjesë të shoqërisë të cilët janë prekur nga sëmundje të shmangshme dhe përtacisë.

Sigurimet shoqërore kanë një shtrirje të gjerë. Nëpërmjet tyre mbulohen aspekte në lidhje me drejtësinë sociale dhe ekonomike.

A. Nevoja për Sigurime Shoqërore

Nisur nga sa kemi përmendur më lart duhet të theksojmë, se filozofia themelore e ekzistencës së sistemit të sigurimeve shoqërore ka të bëjë me qëllimin e sigurimit të një niveli minimal jetese ndaj atyre individëve të shoqërisë në nevojë. Kjo është edhe arsyeja pse shteti e ndërton dhe e organizon këtë sistem.

Përvoja e akumuluar si kombëtare por edhe ajo botërore, tregon se në një ekonomi industriale, të punësuarit i janë nënshtruar papunësisë periodike për shkak të luhatjeve ciklike në biznes, sëmundje, aksidentet industriale dhe moshën e vjetër. Në fakt, nuk ka asgjë më shumë shqetësuese për punëtorin dhe familjen se papunësia. Ndërsa sëmundja në pjesën më të madhe të rasteve pezullon aftësinë për të punuar të të punësuarit përkohësisht, aksidentet industriale, moshën e vjetër, mund të çaktivizojnë atë në mënyrë të përkohëshme ose të përherëshme. Burimet kapitaliste kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar rreziqet sociale. Por, kur bëhet fjalë për të punësuarit situata ndryshon tërësisht.

Të punësuarit nuk kanë resurse të nevojshme për të përballuar rreziqet e shkaktuara nga sëmundjet, aksidentet, papunësia dhe moshën e vjetër. Shpesh herë ndodh që të punësuarit nuk kanë as burime alternative të jetesës ose pasurisë së akumuluar për të kapërcyer periudhën e ankthit. Një situatë e tillë thekson nevojën për sigurimet shoqërore të dhënë për këta të punësuar në nevojë.

Natyrisht, Qeveria ka detyrim për të ndihmuar punëtorët, nevojtarët dhe të pafuqishëm dhe t`u sigurojë atyre siguri për të kaluar periudhën e fatkeqësisë.

Nevoja për sigurimet shoqërore është realizuar jo vetëm të përballojë mbrojtjen e të punësuarve në nevojë kundër fatkeqësive të jetës, por edhe për zhvillimin e përgjithshëm të shtetit. Ato përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt qëllimit të një shteti të mirëqenies, duke përmirësuar

jetesën dhe kushtet e punës, mbrojtjen e njerëzve kundër pasigurive të së ardhmes.

Këto masa janë gjithashtu të rëndësishme për çdo program të industrializimit, jo vetëm për t'u mundësuar të punësuarve mbrojtje efikase, por ato gjithashtu zvogëlojnë harxhimin që rrjedhin nga mosmarrëveshjet industriale. Çdo ditë pune e humbur për shkak të sëmundjes dhe paaftësisë, gjithashtu përbëjnë një shterim të rëndë në burimet financiare jo vetëm të të punësuarve, por edhe në prodhimin industrial të vendit.

Mungesa e sigurimeve shoqërore pengon prodhimin dhe parandalon formimin e një force të qëndrueshme dhe efikase të punës. Siguria sociale nuk duhet konsideruar si një barrë, ajo është një investim i mençur në afat të gjatë. Kështu, nevoja për një program gjithëpërfshirës të sigurisë sociale në çdo vend dhe në çdo kohë mbetet një element me rëndësi për të siguruar një nivel minimal të jetesës për ata që janë të pafuqishëm në raste të ndryshme.

2.1.2 Klasifikimi i Rreziqeve Sociale

Elementet që zakonisht janë evidentuar si rreziqe sociale janë:

- *mungesa e të ardhurave nga puna e paguar, duke trajtuar ata individë të cilët përkohësisht nuk punojnë ose nuk do të punojnë më pas për shkak të moshës së vjetër, individët që nuk punojnë për shkak të paafësisë dhe të papunët;*
- *mënyra e largimit të të ardhurave nga humbja e partnerit;*
- *shpenzimet e veçanta që lidhen me lindjen dhe rritjen e një fëmije;*
- *nevoja për të përballuar shpenzimet që lidhen me kujdesin shëndetësor;*
- *mungesa e mjeteve të nevojshme për një jetë të ndershme.*

Referuar klasifikimit të rreziqeve sociale, ne mund të dalim në përfundimin se një marrëveshje e lidhur për një rrezik social të veçantë dhe shfaqja e një njësie të caktuar në rregullimin dhe në administrimin e këtij sistemi, është quajtur *degë* ose *skemë* sigurisë sociale.

Teoria moderne, por edhe më e kuptueshme në lidhje me sigurimin social, është përkrahur nga autorë si Berghman, i cili e konsideronte sigurinë sociale "*Situatë në mbrojtje të plotë kundër të gjitha dëmtimeve humane*".

Duke iu referuar këtij përcaktimi të bërë nga Berghman kuptojmë se siguria sociale është e lidhur ngushtë me këto elemente:

- *Punë e sigurt me masa për të stimuluar punëtorët dhe shkëmbimin e punëtorëve, kur rrezikohen për papunësi;*
- *me edukimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional, mbështetur në të gjitha burimet ekzistuese;*
- *me marrjen e masave parandaluese për dëmtimin e shëndetit të të punësuarit;*
- *me krijimin e mundësive dhe lehtësirave për të gjithë llojet e shërbimeve kolektive.*

Siguria sociale është e lidhur ngushtësisht edhe me marrëveshjen në termat e ligjit civil në lidhje me detyrimet ndaj palës së tretë, për shpërblimin e dëmit ose në lidhje me pasojat në rast vdekjeje. Pavarësisht nga të gjitha teoritë që qarkullojnë për sigurinë sociale, i rëndësishëm mbetet fakti se çdokush duhet të përpiqet me të gjitha mjetet që më parë ta parandalojë rrezikun social, e më pas të mendojë ta zgjidhë atë, duke u bazuar në procedura ligjore, administrative dhe në burime financiare.

Në këtë këndvështrim, ne duhet të mendojmë për rëndësinë që duhet t'u kushtohet masave për të parandaluar individët që të mbeten të papunë dhe të përpiqemi për të punësuar të papunët, duke aplikuar edhe metodat e shkëmbimit të të punësuarve, trajnimin dhe edukimin profesional, gjetjen e të gjitha burimeve për masa parandaluese për shëndetin, rritjen e shërbimit dhe përkujdesin shëndetësor, krijimin e shërbimeve kolektive në drejtim të krijimit të qendrave për kujdesin ndaj femijëve, individëve të sëmurë, për të moshuarit, por edhe për ata individë të cilët pretendojnë një jetë më të mirë.

Për të zbutur rrezikun social, përdoren edhe disa taktika të tjera solidariteti, të cilat janë shumë të domosdoshme në hapat e para të ballafaqimit me rrezikun social, por, edhe pse janë të domosdoshme, nuk mund të jenë gjithmonë të vazhdueshme. Teknika të tilla mund të jenë:

- *Ndihma e familjes dhe e të afërmeve;*
- *Kursimet;*

Teknikat më të njohura që përdoren gjerësisht nga sigurimet sociale janë:

- *Sigurimi shoqëror.*
- *Sigurimi shëndetësor.*
- *Mirqënia shtetërore.*

Në rastin e Sigurimeve shoqërore, aplikohen dy lloje teknikash të cilat lidhen me përqindjet e kontributit. *Kontribute të detyrueshme* dhe *kontribute vullnetare* për/ ose nga anëtarët e sistemit të solidaritetit, kështu që, kur një anëtar i rrjetit të solidaritetit rrezikohet nga rreziku social, ai/ajo mund të mbulohet me përfitim social nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

Shpesh herë, kjo skemë për të realizuar sa më mirë mbrojtjen shoqërore, përveç të ardhurave nga sistemi kontributiv mbështetet edhe nga subvencionet e shtetit.

Pak më lart theksuam se sistemi i sigurimeve shoqërore organizohet në dy drejtime, në atë të detyrueshëm dhe atë vullnetar. Shkurtimisht do të paqesim përkufizimet e këtyre dy kategorive.

Në kategorinë e sigurimeve shoqërore të detyrueshme sistemi i referohet një numri të madh skemash të cilat shërbejnë për të shtuar përfitimet nga sigurimet edetyrueshme shoqërore për pension, invalidët, sëmundje, papunësi, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, barrë lindje, sigurim shëndetësor.

Në kategorinë e sigurimeve shoqërore vullnetare (sigurime jo të detyrueshme) sistemi i referohet një numri të kufizuar skemash të cilat shërbejnë për pension, barrë lindje dhe sigurim shëndetësor.

Një tjetër kategori skemash e cila aplikohet në sigurimet shoqërore është edhe skema suplementare private, e cila realizohet në llogari individuale në rrugë private nëpër kompani private sigurimesh. Në këto shoqëri private, pjesëmarrja nuk është bërë e detyrueshme, por ajo rrjedh automatikisht si shkak i një marrëveshje kolektive.

Të gjithë ata individë, të cilët sigurohen në sistemin e sigurimeve shoqërore, kanë një të drejtë "subjektive" për të përfituar menjëherë sigurime shoqërore.

Një karakteristikë e skemave të sigurimeve shoqërore është mbështetja e funksionimit të tyre në parimin e solidaritetit social. Ky parim është i aplikueshëm në skemat e sigurimeve Pay-As You Go. Ku me kontributet e të punësuarëve aktual paguhen përfitimet për pensionistët aktual.

2.2 Objekti dhe Subjektet e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore

Si çdo degë e sistemit të së drejtës edhe e drejta e sigurimeve shoqërore ka objektin e saj.

Objekt i sigurimeve shoqërore është mbrojtja nga ngjarjet sociale të pa dëshiruara, e të gjithë shoqërisë ekonomikisht aktive apo të asaj pjese e cila nuk është aktive, por për shkak të burimeve financiare bëhen pjesë e këtij sistemi.

Në princip, sigurimet shoqërore përfshijnë në skemat e përfitimit, të gjithë ato individë që janë banorë të një shteti ku në këtë rast ata emërtohen Individë të siguruar.

Individë të siguruar, do të konsiderohen grupime të tilla si: punëtorë punëdhënës, apo grupe të tjera të cilët në mënyrë të dukshme paguhen mesatarisht, mirë dhe shumë mirë. Këtu mund të përfshihen të vetëpunësuarit, nëpunësit civilë ose nëngrupe të të gjithë këtyre grupeve. Me fjalë të tjera, me individë të siguruar do të kuptojmë të gjithë personat që kryejnë një punë të ligjshme.

Në bazë të ndarjes apo klasifikimit të mësipërm, të individëve të sistemit të sigurimeve shoqërore, kemi dhe një ndarje të objektit të sigurimit në lidhje me përfitimet që jep ky sistem. Më konkretisht, për sistemin e sigurimeve shoqërore do të kemi aplikime për përfitime për, sigurim të detyrueshëm, sigurim vullnetar, sigurim bazë profesional dhe sigurim në bazë të punës.

Por në këtë pikë për efekt të gjithëpërfshirjes së individëve në skemat e sigurimeve shoqërore, ne do të konsiderojmë individ të siguruar edhe një individ i cili nuk ka punë, por ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme, të cilat i mundësojnë atij sigurimin nëpërmjet skemës vullnetare. Duke iu referuar përkufizimit të objektit të sigurimeve shoqërore, mund të themi se Sigurimet Shoqërore konsiderohen si mbrojtje universale. Kjo për faktin se ky sistem është ndërtuar me qëllim mbrojtjen universale të gjithë banorëve të një shteti, të cilët janë ekonomikisht aktiv. Nisur nga kjo, mund të themi se mjafton që një individ, të jetojë dhe të punojë në një vend, me një kontratë të rregullt pune dhe ai nuk ka asnjë pengesë për t'u siguruar, e më vonë për të përfituar nga ky sistem.

Për sa më sipër, nuk duhet që të harrojmë se me lëvizjen e lirë të shtetasve mund të ndodhë që një shtetas të jetë emigrant në një vend tjetër dhe nuk e ka marrë ende rezidencën zyrtare, por gjithashtu është

ekonomikisht aktiv në këtë vend. Lind pyetja: *Kur do t'i lindë e drejta e aplikimit të sigurimeve shoqërore këtij individ?*

Kur flasim për vendbanim, duhet që të ndajmë atë nga rezidenca zyrtare. Ndërmjet vendbanimit dhe rezidencës zyrtare nuk ka barazi. Kjo për faktin se vendbanimi dhe rezidenca zyrtare janë dy gjëra të ndryshme. Një emigrant, mund të mos e marrë asnjëherë rezidencën zyrtare, por kjo nuk përbën arsye që ai të mos përfshihet në aktivitet ekonomik (puna). Nëse një emigrant përfshihet në aktivitet ekonomik të ligjshëm, ai patjetër që do të sigurohet.

Nga kjo kuptojmë se mjafton një individ-subjekt aplikues për sigurim shoqëror të detyrueshëm, për të përfutur të drejta që rrjedhin nga ky sistem, duhet të jetojë, të punojë dhe të paguajë taksat në një lokalitet të caktuar të një vendi.

Sigurimet shoqërore të detyrueshme, aplikohen në mënyrë të menjëhershme mbi të gjithë të punësuarit brenda vendit, mbi ata persona jo shtetas që janë rezidentë në një shtet dhe kryejnë aktivitet ekonomik në shtetin rezident. Këto lloj sigurimesh ofrojnë një mbulim të plotë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Sigurime shoqërore vullnetare, aplikohen si për ata persona që nuk janë të siguruar në skemën e detyrueshme si pasojë e mospasjes së aktivitetit ekonomik ashtu edhe për personat të cilët banojnë për disa kohë ose përherë në një shtet tjetër. Ky lloj sigurimi mund të përdoret për disa arsye:

- *Plotësimi i viteve të sigurimit të mbetura për pension.*
- *Përfitim i dy pensioneve.*

Nëpërmjet pagesës së sigurimit vullnetar, individëve-subjekteve, u krijohet një tjetër mundësi ose e thënë ndryshe, një tjetër e drejtë, për të qënë aplikues dhe njëkohësisht, përfitues të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Shtete të ndryshme nëpërmjet sigurimit vullnetar, sigurojnë mundësinë që shtetasit e tyre të cilët shkojnë për të punuar jashtë shtetit për një jetë më të mirë apo në projekte zhvillimi në shtetet e botës së tretë, etj, mund të aplikojnë në këtë skemë në vendin e tyre, me qëllim që të mbeten të lidhur me sistemin e sigurimeve shoqërore të origjinës.

Sigurime shoqërore profesionale janë një tjetër lloj sigurimi nëpërmjet të cilit individët sigurohen në bazë të aktivitetit të tyre profesional, dhe jo në bazë të të qënurit qenie humane apo qënies së tyre banorë të një shteti të caktuar. Sigurimet shoqërore profesionale mbulojnë të gjithë fuqinë punëtore të popullsisë. Por në të vërtetë brenda fuqisë punëtore të popullsisë ka më tepër grupe sigurime profesionale. Konkretisht për ato individë-subjekte të cilët kanë paga të mira, individ subjekt të vetëpunësuar, nëpunës civilë ose shpeshherë edhe për disa nëngrupe të kategorive të mësipërme. Por edhe kur aplikohen sigurimet shoqërore profesionale, në mënyrë ekuivalente, për të gjithë (ose për pjesën më të madhe të) fuqinë punëtore të popullsisë, përshkrimi i objektit personal të aplikimit të sigurimeve shoqërore nuk do të plotësohet vetëm nëpërmjet një formule të vetme, ai do t'i referohet burimeve të pagesës së kontributeve të derdhura gjatë gjithë jetës.

Megjithatë kur flitet për mardhënie pune ne vëmë re se ajo është e ndryshme. Ka shumë individë të cilët janë aktivë nga pikëpamja profesionale vetëm për disa orë në javë(part time) dhe për shkak të orarit të reduktuar kanë paga të limituara. Lind pyetja: *A do të konsiderohen subjekte për sigurimet shoqërore profesionale?* Në lidhje me këtë kategori të punësuarish ka qëndrime të ndryshme: Disa i konsiderojnë si subjekte të sigurimit profesional dhe në një numër shtetesh nuk i konsiderojnë të tillë.

Më lart ne theksuam se sigurimet shoqërore profesionale përdoren për të ofruar përfitime që lidhen me aktivitetin profesional të të siguruarve, por duhet sqaruar që një rol të rëndësishëm në përfitimin social ka edhe *lidhja e caktuar me territorin*. Si rregull, një individ-subjekt për sigurimet shoqërore profesionale, duhet të jetë profesionalisht aktiv në territorin e atij shteti në të cilin aplikohet skema e sigurimeve sociale, por jo vetëm kaq, ky individ subjekt duhet të punojë për një punëdhënës, kompania e të cilit është e vendosur ose është stabilizuar në territorin përkatës. Këto lloj sigurimesh profesionale, konsiderohen si *sigurime të detyrueshme*.

Emigrantët mund të rriskohen nga fakti i të trajtuarit ndryshe nga shtetet në të cilat ata lëvizin. Kjo mund të ndodh sepse ky shtet i ri nuk i jep përfitime të huajve(joshtetasve). Territorialiteti i sigurimeve shoqërore, tregon se ata që vendosin të bëjnë një zhvendosje afatgjatë në një vend tjetër, mund të humbasin disa nga të drejtat e sigurimeve shoqërore që ata kanë fituar në vendin e tyre. P.sh., ata mund të humbasin të gjithë kreditet(kontributet e derdhura) për periudhën e qëndrimit, punësimit ose aktivitetit ekonomik që ata kanë fituar në shtetin e tyre, ndërsa kjo periudhë mund të mos llogaritet nga ligji i sigurimeve shoqërore i shtetit të ri. Humbja e kësaj të drejte është shumë e rëndësishme, sidomos kur bëhet fjalë se së bashku me humbjen e këtyre krediteve, subjekti mbetet i zbuluar nga rreziqet sociale në lidhje me pensionet e vjetërsisë dhe invaliditetit.

Sigurime shoqërore profesionale, mbi baza vullnetare. Në këtë lloje sigurimesh, objekti i aplikimit do të përfshijë individë, të cilët nuk janë profesionalisht aktiv në një territor. Fakti që këta individë nuk janë aktiv në një territor, i ndalon ata të bëjnë kërkesa që lidhen me aplikimet për përfitime territoriale. Për rrjedhojë, këtyre individëve, nuk i takon të jetë objekt i aplikimit ngasistemi i Sigurimeve Shoqërore. Për këtë arsye, këta individë, mund të kthehen në përfitues në shtetin nga ku ata vijnë, nëpërmjet sistemit të sigurimeve profesionale vullnetare.

Sigurimi vullnetar profesional, krijon mundësi për mbulim social edhe për ata individë, të cilët punojnë në mënyrë të paligjshme nëpër shtete të ndryshme. Sigurimet Shoqërore profesionale, nuk ekzistojnë vetëm për kategoritë e të punësuarve, ka shtete të cilat i njohin këto lloj sigurimesh edhe për kategoritë e të vetëpunësuarve. Në vendin tonë nuk njihen skemat profesionale me baza vullnetare për të vetëpunësuarit. Kjo kategori nuk është e përfshirë as në skemat e detyrueshme profesionale. Këto skema janë ndërtuar vetëm për profesionin e minatorit. Gama e këtyre skemave funksionon mbi subjekte të kufizuara.

Organizimi i skemave vullnetare të të vetëpunësuarve shërben si një sistem për të treguar më shumë lloje të vetëpunësimit se sa një sistem unik. Kështu, mund të themi se ekzistojnë disa sisteme të ndryshme të

sigurimeve shoqërore, të ndara për disa lloje kategorish të vetëpunësuarish. Një tjetër fakt interesant janë shtetet me një sistem të ndarë të sigurimeve shoqërore për grupe të ndryshme të fuqisë punëtore.

Në këto sisteme individët, do të përzgjidhen në atë sistem i cili përfshin të gjithë ata individë të cilët nuk kanë një pagë të mirë, por që për shkak të punës që kryejnë mund të klasifikohen në nëpunës civilë. Gjithashtu mund të përfshihen edhe ata individë që nuk bëjnë pjesë në një prej sistemeve për kategori specifike të njerëzve të vetëpunësuar.

Nëpunësit civilë, mund të gëzojnë sistemin e tyre për sigurimet shoqërore. Shpeshherë, këto sisteme ngatërrohen me statusin e përgjithshëm të nëpunësit civil, ndaj që shpesh është e vështirë t'u tregosh atyre statusin aktual të profesionit dhe ku fillojnë aktualisht sigurimet shoqërore të nëpunësit civil. Jo të gjithë nëpunësit civilë, janë subjekte të të njëjtit sistem të sigurimeve shoqërore. Në një numër shtetesh, jo i gjithë personeli punonjës në shërbim të Qeverisë ose të një organi të ligjit publik, do të konsiderohet nëpunës civil. Për qëllime të sigurisë sociale ata mund të shihen si punonjës të Qeverisë (por jo si nëpunës civilë) dhe si të tillë këta mund të jenë subjekte të sistemit të punëdhënësve.

E njëjta gjë vlen edhe për ato shtete, ku njerëzit që punojnë për Qeverinë nuk janë titulluar si "nëpunës civilë", por punojnë në kushtet e një kontrate private pune, me një pagë të mirë. Në vendin tonë këto lloj nëpunësish konsiderohen Funkionarë Politikë, por këta funksionarë nuk sigurohen me një ligj privat. Marrëdhëniet e tyre të punës, për rrjedhojë edhe ato të sigurimit rregullohen me një ligj të veçantë.¹¹⁶

Organizimi i skemës profesionale të sigurimeve shoqërore, në lidhje me sistemet për punëdhënësit, për të vetëpunësuarit dhe për nëpunësin civil, mund të jetë edhe me nëndarje, por ajo nuk përfshin sigurimet e organizuara shoqërore profesionale në një bazë të ndryshme, të tilla si profesionet industriale ose degët e industrisë.

Profesione ose degë të tilla, mund të sigurohen në sisteme të veçanta: për shembull, në një numër shtetesh, minatorët dhe marinarët shijojnë një sistem të veçantë të sigurimeve shoqërore, e njëjta gjë vlen edhe për fermerët e peshkatarët, por brenda këtyre sistemeve, ndonjëherë ka dallime kur bëhet fjalë për kategori të tilla si menaxherë të vetëpunësuar dhe atyre që punojnë në shërbimet e vona, ndërsa në shembuj të tjerë të dyja kategoritë përfshihen në një sistem të njëjtë. Gjithashtu, janë edhe shumë shtete të tjerë, ku sportistët profesionistë dhe artistët, shijojnë një marrëveshje të veçantë për sigurimet shoqërore.

Ne kemi përmendur se në shumë shtete, pothuajse çdo profesion për vetëpunësim mund të ketë sistemin e tij të sigurisë sociale. Ndonjëherë, degë të industrisë ose grupe profesionale, nuk do të drejtohen nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore profesionale, por mund të sigurojnë një marrëveshje për një suplement special sigurimesh të aplikueshëm vetëm për ta.

Kjo strukturë profesionale e sistemit të sigurimeve shoqërore, përmban disavantazhin se individët mund të përjetojnë ndryshime në sistemin e tyre të sigurimeve shoqërore në rastet e transferimit. Për shembull:

116 LIGJ NR. 152/2013 PËR NËPUNËSIN CIVIL

Kthimi nga punëtorë në të vetëpunësuar, kur ndërrojnë profesionin ose në degën e insudtrisë. Transferimi është një element shumë i rëndësishëm i cili krijon probleme të veçanta në lidhje me periudhatë këruara për sigurime shoqërore për vetë punëtorin, por edhe me llogaritjen emarrjes së përfitimeve të caktuara apo me ruajtjen e të drejtave të arritura deri në atë moment.

Veçanërisht në këtë aspekt, problemi i mungesës së transferimit të plotë i të drejtës së pensionit është i njohur. Mungesa e transferimit të plotë, përfshin humbjen e mundshme të përfitimit si pasojë e mungesës së koordinimit ose pamjaftueshmërisë së sistemeve të njëpasnjëshme profesionale të sigurimeve shoqërore.

Sigurisht që një person mund të praktikojë aktivitete të ndryshme profesionale që e nxisin atë të mund të jetë pjesë e sistemeve të ndryshme profesionale të sigurimeve shoqërore. Kjo do të thotë se si pasojë e këtyre aktiviteteve, ai do të kontribuojë më shumë se një lloj kontributi sigurimesh shoqërore. Subjekte të tilla duhet të kenë një marrëveshje për kontribute të veçanta (më shumë të favorshme) për aktivitetin dytësor profesional. Si pjesë e përfitimeve: i titulluari mund të kërkojë përfitime në të dyja sistemet.

Si rregull, kombësia përkatëse e një individi-subjekt, nuk ka lidhje me sigurimet e tij shoqërore. Të gjithë personat që banojnë në mënyrë ligjore në një territor, do të përfitojnë të njëjtin trajtim ligjor, i cili i ka bazat në mosdiskriminimin e individëve-subjekte vendas dhe të huaj, apo të shtresave të ndryshme të popullsisë. Nënshtetësia e një shtetasi, parashikon sigurime shoqërore për atë shtetas por thamë se nënshtetësia i lejon individëve, të kalojë kushtet e zonës territoriale.

Marrëveshja për sigurimet shoqërore e disa shteteve, sigurisht që mbulon edhe subjektet e atij shteti që jetojnë dhe punojnë jashtë territorit edhe kur ata individë nuk kanë asnjë burim për të paguar taksa ose modele të ngjashme me këtë. Objekti i aplikimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, është i përcaktuar mbi bazën e kriterëve të përgjithshëm dhe kriterëve objektivë, kjo do të thotë se cilësia e të qenit i siguruar nuk është e lidhur me faktin se dikush duhet të paguajë të gjithë kontributin.

Mund të ndodhë që një individ-subjekt për arsye të cilat nuk varen prej tij, të ndërpresë derdhjen e kontributit. Ndërprerja e kontributit, nuk sjell përjashtimin e tij nga sistemi i sigurimeve shoqërore. Sigurimet shoqërore mund të na drejtojnë edhe deri në një farë kohe, por mund të ndodhë që dikush të vendosë me dëshirë që të ndërpresë vazhdimin e punës së tij .

Kjo gjë nuk nënkupton domosdoshmërisht që të gjithë elementet për të përfituar nga ky sistem do të vijnë drejt fundit. Si rregull, përfitimet do të vazhdojnë gjithmonë, por deri në masën e kontributit që subjekti ka derdhur në skemë subjekti. Gjithashtu, mund të ndodhë që sigurimet shoqërore, do të lidhen deri sa të ngjasë një rrezik social në një periudhë të caktuar, duke ndjekur më pas ndërprerjen e sigurimeve shoqërore. Lindja e të drejtës për përfitim social edhe pse personi nuk ka shumë kohë që është lidhur me sigurimet shoqërore e detyron skemën që të mbulojë me përfitime këtë individ pas pasojës. Kjo ka të bëjë, me mbulimin me sigurime në rast sëmundjeje apo në rast të aksidenteve në punë .

Pjesëmarrësit "e fjetur" të sigurimeve shoqërore ose të skemave të tjera

të pensionit, përbëjnë një grup të veçantë. Në këto skema marrin pjesë ata individë, të cilët për disa kohë janë pjesëmarrës në një skemë pensioni, paguajnë kontributet e tyre dhe më pas e braktisin skemën duke ndryshuar punë ose duke ndërprerë aktivitetin e tyre profesional. Pozicioni i tyre tregon qartë se ata nuk humbasin të drejtat që u vijnë nga skema e sigurimeve shoqërore. Ata do të jenë të aftë të shijojnë përfitimet (*pro rata*), si pasojë e pjesëmarrjes së tyre nëpër këto skema, deri në fund të kohës së tërheqjes së tyre.

Nga skema e sigurimeve shoqërore, mund të përfitojnë edhe individë të cilët nuk janë të siguruar në mënyrë direkte në skemë. Këta individë nuk janë titulluar për përfitime nga drejta e tyre, por ata mund ta derivojnë këtë të drejtë nga sigurimet shoqërore (dirkte) të dikujt tjetër.

Shembuj tipikë të këtij përfitimi edhe në rastet kur individi përfitues nuk është kontribues janë:

- *Marrja e pensionit të mbijetesës . Ky pension përfitohet nga personat e mbijetuar në shumicën e rasteve për rritjen e jetimëve.*
- *Përfitime për varrimin. Këto përfitime ofrohen nga fondi i sigurimeve shoqërore si pasojë e kontributit të personit që ka ndërruar jetë (vdekur).*

Në pjesën më të madhe, skemat që japin përfitime për ata individë që varen nga sigurimet shoqërore: sigurimi i bashkëshortes dhe fëmijëve, ndonjëherë edhe sigurimi i antarëve të familjes (vëllai, motra, ose prindët që jetojnë akoma). Dallimi ndërmjet të drejtës së dikujt dhe të drejtës së derivuar, kërkon një lidhje special. Për të marrë përfitimet e mësipërme të cilat konsiderohen indirekte, por që derivojnë nga lidhja direkte ndërmjet subjekteve, bën përjashtim rasti i divorcit. Në rast divorci lidhjet me personin e siguruar thyhen, për rrjedhojë nuk do të ketë as përfitime.¹¹⁷

2.3 Parimet e Përgjithshme të Sistemit të Sigurimeve Shoqërore

Parimet e sigurimeve shoqërore janë trajtuar nga autorë të ndryshëm me konotacione të ndryshme. Nëse do ti referohemi trajtimit të parimeve të sigurimeve sociale, sipas autorit Igor Tomesh në librin e tij *"E Drejta e sigurimeve sociale"*, do të vihet re se shpjegimi i këtyre parimeve mbështeten në analizën sociale të këtij sistemi. Ndërsa, në librin *"E Drejta e mbrojtjes shoqërore"* e autores Zhaklin Peto, analiza e parimeve është gërshetuar me analizën juridike dhe sociologjike të këtij sistemi.

Në këtë punim vëmëndja do të përqëndrohet në analizën e katër parimeve bazë, *universalitet, barazi, garanci dhe mjaftueshmëri*. Kjo për faktin se baza e këtij punimi do të jetë një analizë e hollësishme ekonomike, e funksionit të skemës në dobi të subjekteve përfituese, për këtë qëllim analiza e këtyre parimeve do të na ndihmojë të dallojmë ndikimin e tyre në skemë, tek individët dhe gjithashtu do të mund të shohim nëse këto parime funksionojnë si duhet në sistemin tonë.

Më konkretisht:

Universaliteti;

¹¹⁷ Problemet e divorcit në lidhje me sigurimet shoqërore trajtohen në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme. Në Amerikë legjislacioni parashikon se pas një divorci mbi 10 vjet martesë, bashkëshorti ose bashkëshortja pa punë, mund të përfitojë nga sigurimet shoqërore të bashkëshortit ose bashkëshortes të punësuar pas zgjidhjes së martesës, por kjo vetëm atëherë kur bashkëshorti/ bashkëshortja e papunë nuk ka bërë martesë tjetër.

Barazia;

Garancisë;

Eksportimittë të drejtave të fituara;

2.3.1 Parimi i Universalitetit

Nga vetë emri i këtij parimi, kuptohet qartë se kemi të bëjmë me një funksion universal të skemës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me pjesëmarrjen e shoqërisë aktive dhe joaktive për punë, në këtë sistem. Referuar qëllimit të krijimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, me *mbrojtjen e shoqërisë*, natyrshëm nënkuptojmë se për të përmbushur sa më mirë këtë qëllim, shtetit i del për detyrë që të organizojë këtë sistem deri në skajin më të largët të vendit, me qëllim dhënien e shërbimeve që rrjedhin prej tij, të tëgjithë shtetasve kontribues dhe përfitues.

Natyrshëm mund të pretendohet se përderisa sistemi i sigurimeve shoqërore është një sistem i detyrueshëm dhe zbatimi i këtij parimi shkon për rrjedhojë të detyrimit të ligjit. Por në fakt analiza jonë shkon përtej. Është e vërtetë se mënyra e funksionimit të skemës, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore kërkon funksionimin e tij në të gjithë vendin, por a funksionon në të gjithë popullsinë?

Nëse do t'i referohemi teorisë dhe frymës detyruese të ligjit mbi këtë sistem në pamje të parë themi se çdo gjë funksionon në rregull. Por në realitet veprimi universal i skemave mbi popullsinë nuk është ashtu siç duket. Kjo jo në kuadër të ekzistencës së institucioneve të sigurimeve shoqërore, këto institucione ndodhen në të gjithë territorin e vendit, por në drejtim të njohjes nga shoqëria të këtij sistemi. Jo çdokush e njeh këtë sistem dhe aq më pak rëndësinë dhe përfitimet që vijnë prej tij.

Në bazë të një pyetësori të përgatitur dhe për të shpërndarë prej nesh në Tiranë, grupeve të ndryshme shoqërore, nga përgjigjet e pyetësorit u konstatua se 1/3 e të anketuarve kishin informacion të cunguar, në lidhje me atë çka përfaqësonin sigurimet shoqërore, ndërsa pjesa tjetër nuk kishte dijeni se përse funksionon ky sistem. Mendoj se kjo përqindje e popullsisë së painformuar, vjen në ato shtresa të popullsisë me arsim 8-vjecar, të cilët u përkasin zonave rurale të vendit.

Nisur nga ky rezultat mendoj se duhet bërë një fushatë sensibilizuese jo për ekzistencën e këtij sistemi, por një fushatë për përfitimet që ofron dhe kushtet për të qënë përfitues prej tij. Ky sensibilizim nuk duhet të fokusohet vetëm në ekzistencën e administratës, por dhe në sqarimin e popullsisë se ky sistem është sistem mburojë për të gjithë shoqërinë, dhe ofron mbulime si gjatë marrëdhënies në punës ashtu edhe gjatë moshës së pensionit.

Nëpërmjet parimit të universalitetit dhe sensibilizimit ka të ngjarë të krijohet një mundësi më shumë për rritjen e numrit të kontribuesve në fondin e Sigurimeve Shoqërore, sidomos në zonat rurale ku numri i kontribuesve është shumë i ulët. Sipas një informacioni të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në territorin e Shqipërisë numri i kontribuesve ruralë në skemën e sigurimeve shoqërore është 367 mijë.

Për të pretenduar se ky parim është zbatuar sic duhet, vëmendja e shtetit duhet të shkojë përtej kontrollit, administrimit dhe organizimit të skemës

apo shpërndarjes së përfitimeve për shtetasit në çdo skaj të vendit. Zbatimi i këtij parimi konsiston edhe në njohjen universale të këtij sistemi nga të gjithë shtetasit, në mënyrë që të kemi mundësi të zbatojmë edhe një tjetër parim të rëndësishëm, atë të pjesëmarrjes. Por, nëse shoqëria nuk kupton çfarë të mirash përfiton, sa do të jetë masa e tyre, çfarë duhet bërë për ti përfituar ato, atëherë me bindje themi se parimi i pjesëmarrjes nuk mund të realizohet sic duhet.

Për sa më sipër duhet të sqarojmë se nëse shoqëria jonë nuk i drejtohet me kënaqësi skemës së sigurimeve, moszbatimi i parimit të universalitetit nuk është arsye. Arsyet janë të shumta dhe komplekse dhe lidhen me:

- *mungesën e vendeve të punës;*
- *masën e vogël të përfitimeve që ofron skema.*

Por, duke u nisur nga realiteti i prekur, mendojmë që një përpjekje sensibilizuese në mënyrë universale për të detajuar këtë sistem, mund të luajë një rol sado të vogël në rritjen e pjesëmarrjes së shtetësave në skemë.

2.3.2 Parimi i Barazisë

Në një shoqëri të zhvilluar, barazia e shtetësave para ligjit mbetet një element shumë i rëndësishëm. Po aq i rëndësishëm mbetet zbatimi i barazisë në skemat e sistemit të sigurimeve shoqërore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar këtij parimi dhe nga Konventa Sociale Europiane. Në lidhje me këtë parim Konventa Social Europiane pohon parimin e trajtimit të barabartë ndërmjet shtetësve të palëve kontraktuese¹¹⁸. Sipas kësaj konvente parimi i barazisë kërkon që palët kontraktuese të aplikojnë legjislacionin e tyre për shtetasit e vendeve të tjera, në të njëjtën mënyrë siç do aplikonin për shtetasit e tyre.

Përveç aplikimit të këtij parimit të skemës jokontribuese, Konventa ashtu si edhe Marrëveshja e Përkohshme parashikon që një palë kontraktuese duhet të pretendojnë që shtetasit e një pale tjetër kontraktuese të plotësojnë kushtet e veçanta të qëndrimit, veçanërisht kur shuma e kontributeve nuk është e lidhur me peridhën e qëndrimit¹¹⁹.

Në lidhje me çfarë është cituar më lartë duhet të theksojmë se *e drejta e trajtimit të barabartë të shtetësve* nuk është gjithmonë *absolute*. Palët kontraktuese të cilat rregullojnë marrëdhëniet e tyre në fushën e sigurimit shoqëror në bazë të Konventës Social Europiane, janë të lira të përjashtojnë parimin e trajtimit të barabartë në disa fusha, ose ta bëjnë atë të kushtëzuar disa të tjera. P.sh. Parimi i mosdiskriminimit mbibazat e nënshtetësisë, do të përfshihet në lidhje me ligjet kombëtare, të cilat janë të përqëndruara në pjesëmarrjen e personave të siguruar dhe në administrimin e skemës së sigurimit social¹²⁰.

Analiza e zbatimit të parimit të barazisë në skemat e sigurimeve shoqërore përqëndrohet në disa drejtime, kjo për faktin se nga vetë natyra se si funksionon ky sistem, apo dhe nga ajo çfarë cituam më sipër, nuk mund të pretendohet barazi tërësore në të gjithë elementët e tij. Analiza në lidhje me parimin e barazisë do të përqëndrohet në fushën e subjekteve dhe në atë të përfitimeve.

118 Artikulli 8 i Konventës

119 Sistemet e Mbrojtjes Shoqërore, Shtëpia botuese Adel Print viti 2011, Zhaklina Peto, faqe 63.

120 Artikulli 6 i të dy Marrëveshjeve të Përkohshme

Nga pikëpamja ligjore, zbatimi i këtij parimi ka në themel të tij aplikimin dhe zbatimin e ligjit dhe rregullave për të gjithë subjektet pjesëmarrëse në skemën e sigurimeve shoqërore pa dallim gjinie, race apo arsimimi. Për faktin se skema e sigurimeve shoqërore është një skemë shumë heterogjene si nga pikëpamja e pjesëmarrjes ashtu dhe nga ajo e përfitimit, diskutimet në lidhje me zbatimin e parimit të barazisë në skemën e sigurimeve shoqërore do t'i përqëndrojmë fillimisht në barazinë gjinore.

Barazia gjinore është një problem i dukshëm nëpërmjet mënyrës se si skema e sigurimeve shoqërore i trajton këto subjekte. Duke ju referuar prirjeve të sotme kombëtare dhe ndërkombëtare për trajtimin e barabartë, ndërmjet gjinive në fushën e sigurimeve shoqërore, dukshëm vihet re një lloj diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthorë për shkak të gjinisë.

Në dukje skema e sigurimeve shoqërore në lidhje me moshën e daljes në pension, parashikon një diferencë ndërmjet moshës së meshkujve dhe femrave. Ku femrat dalin në pension në moshën 60 vjeçe dhe meshkujt 65 vjeç. Po të vihet re, kjo diferencë moshe ka ekzistuar gjithmonë në çdo skemë sigurimesh shoqërore të vendit tonë, por jo vetëm tek ne edhe në vendet Europiane, vihet re një diferencë ndërmjet moshës së meshkujve dhe femrave. Në direktivën e 3-të "Për trajtimin e barabartë midis burrave dhe grave në fushën e sigurimeve shoqërore", 79/7 të KE-së, në nenin 7, janë parashikuar disa përjashtime në lidhje me diskriminimin gjinor, duke ekonsideruar këtë lloj diference si një diskriminim pozitiv. Gjithashtu, nuk mund të konsiderohet pabarazi dalja në pension në një moshë më të re të disa kategorive të tjera subjektsh siç janë, punonjësit e minierave, apo artistët. Këto kategori përfitojnë kushte ligjore të ndryshme për faktin se profesioni i tyre ka karakteristika të tilla, që e bën të pamundur vazhdimin e marrëdhënies së punës deri në nivelin maksimal të moshës.

Një tjetër diskriminim në fushën e subjekteve është i lidhur kryesisht me masën e kontributit dhe llojin e përfitimeve. Këtë analizë do ta përqëndrojmë te ato subjekte të cilat kanë paga maksimale, por ushtrojnë aktivitet punësimi në veprimtari private, ndërmjet subjekteve të cilat punojnë në administratën shtetërore. Kur flasim për kategoritë e subjekteve që ushtrojnë punësim në aktivitet privat, pavarësisht se ata marrin pagë mbi maksimalen, kur mbushin moshën e pensionit, ata do të përfitojnë vetëm pension maksimal i cili është i barabartë ma ata subjekte të cilat kanë përfituar pagë maksimale. Ndërsa kur bëhet fjalë për subjekte të cilat punojnë në administratë me një pagë mesatare, kur arrijnë moshën e pensionit këta subjekte trajtohen me pension pleqërie+suplementar. Në dukje kemi një pabarazi që vjen si shkak i formulës që zbatohet në sistemin tonë të sigurimeve.

Fakti që skema e sigurimeve shoqërore e vendit tonë funksionon si një skemë me përfitime të përcaktuara, ose siç njihet ndryshe DB ose NDC, ku kontributet e çdo individit depozitohen në llogari personale, me arritjen e moshës së pensionit, shpërndarja e të ardhurave bëhet sipas parimit, *i takojnë atë sa ka kontribuar në skemë*. Duke iu referuar ndryshimeve të 1 janarit 2015 që ka pësuar ligji "Për sigurimet shoqërore", shkurtimisht evidentojmë reformimet e mëposhtme:

Së pari, heqja e tavanit të pagës për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shëndetësore. Së dyti, përfshirja e Pensionit Social, si një formë e re përfitimi, me efekt të ndjeshëm social. Konkretisht neni 5/1 i Ligjit

104/2014 vendos si kritere për këtë lloj përfitimi:

- a) *Qënie e përfituesit shtetas shqiptar;*
- b) *Mbushja e moshës 70 vjeç;*
- c) *Qënia e personit me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, ose të paktën pesë vitet e fundit përpara përfitimit;*

Personi nuk përfiton kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e sigurimeve të detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social. Masa e pensionit social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë, me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur më datë 31.12.2014. Masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi. Së treti, në vijim të referimit të ndryshimeve të reja ligjore, përmendim nenin 5/2 të ligjit në të cilin është parashikuar krijimi dhe rregullimi me ligj të veçantë, i fondeve profesionale dhe fondeve të pesioneve vullnetare.

Së fundmi, heqja e pensionit të pjesshëm të pleqërisë, si një përfitim që u akordohej të gjitha femrave që kishin mbush 57 vjeçe dhe të gjithë meshkujve që kishin mbushur moshën 62 vjeç.

Duhet pasur parasysh që ndryshimet e reja ligjore, hoqën tavanin e pagës, vetëm për kontributet e sigurimeve shëndetësore (duke vendosur në këtë mënyrë një lidhje integrale të drejtpërdrejtë, mes vlerës së kontributit dhe asaj të përfitimit), kuptohet qartë se, në domenin e sigurimeve shoqërore, ku ende ekziston tavanin i kontributit, kontributi i punës së çdo individi gjatë gjithë jetës së tij, është më i madh se masa e përfitimit, nga dita që del në pension e deri në fund të jetës së tij.

Fakti që skema ofron përfitime të përcaktuara, që do të thotë një shumë minimale dhe maksimale fikse, dhe fakti që ndoshta në një muaj një i punësuar ka paguar kontribut një shumë të ardhurash me një diferencë pak më të vogël se masa e pensionit maksimal, përbën një element diskriminues në lidhje me masën e përfitimit.

Në lidhje me këtë analizë mendojmë se ky fakt përbën dhe sjelljen shpesh herë negative të subjekteve ndaj skemës së sigurimeve shoqërore. Fshehja e kontributeve dhe puna në të zezë janë sjellje e subjekteve pikërisht si kundrapeshë e kësaj mënyre funksionimi të skemës. Ndërsa, po t'u referohemi kushteve ligjore në lidhje me derdhjen e kontributeve, lindjes së përfitimit, do të themi se ligji i sigurimeve shoqërore, ka një frymë shumë pozitive në kuadër të zbatimit të barazisë në këtë drejtim.

2.3.3 Parimi i Garancisë

Garancia është një ndër parimet bazë dhe më kryesore të sistemit të sigurimeve shoqërore. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i këtij sistemi nuk mund të kuptohet kurrë pa zbatueshmërinë e këtij parimi. I gjithë sistemi i sigurimeve shoqërore krahas parimeve të mësipërme gjatë funksionimit të tij, ndjeshëm mbështetet dhe parimin e garancisë. Parimin e garancisë e shohim në dy drejtime: në *drejtimin ligjor* dhe në atë *financiar*.

Problemi më i madh që i paraqitet këtij sistemi është garancia financiare, sepse garancia ligjore është element i sanksionuar në Kushtetutë dhe ligj. Ligji ngarkon subjekte me të drejta dhe detyrime dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet subjekteve dhe sistemit. Garancia ligjore mbart në vetvete karakterin e një parimi politiko-ligjor, ku të drejtat e fituara nuk do të çenohen nga asnjë lloj reforme qoftë ajo e karakterit politik, ligjor apo ekonomik.

Ndërsa po t'i referohemi garancisë financiare problem bëhet më i ndërlikuar se kaq. Kjo për faktin se fondi i sistemit të sigurimeve shoqërore, financohet me të ardhurat e kontributeve që kontribuojnë në sistem personat ekonomikisht aktivë. Këto kontribute janë burimi bazë ifinancimit të sistemit të sigurimeve shoqërore. Të gjitha kontributet që mbliidhen në sistemin e sigurimeve shoqërore, shpërndahen sipas degëve përkatëse, duke mbuluar më pas të gjitha pagesat e përfituesëve aktualë (pensionistëve).

Fakti që kontributet depozitohen si të ardhura nga subjektet ekonomikisht aktive, lë të kuptohet se kontributi është një element i lidhur me punësimin, dhe fakti që punësimi është i lidhur me zhvillimin ekonomik, e bën këtë element të skemës shumë delikat.

Parimi i garancisë financiare është një karakteristikë e të gjitha skemave publike me përfitime të përcaktuara apo e atyre me kontribut kombëtar të përcaktuar. Kur flasim për skema sigurimesh me kontribute të financuara, duhet të theksojmë se parimi i garancisë financiare, zbatohet në mënyrë të pjesshme. Kjo për faktin se këto skema funksionojnë në bazë të investimit të kontributit, dhe nëse investimi dështon këto skema garantohen nga shteti vetëm në vlera minimale.

Në rastin e skemave me përfitime të përcaktuara dhe me kontribut nacional të përcaktuar, nëse kontributet e derdhura nuk arrijnë të mbulojnë me përfitime, përfituesit aktual, shteti mbetet garanti kryesor i shlyerjes së këtyre detyrimeve, nëpërmjet subvencionit. Pra ajo që kuptohet është se shteti merr përsipër të jetë garanti kryesor i përfituesve të skemës.

Në një tjetër këndvështrim, do të shohim se në frymën e këtij parimi është ndërtuar i gjithë sistemi i sigurimeve shoqërore në vendin tonë. Ky parim funksionon në mënyrë të vazhdueshme brez pas brezi. Ky sistem është ndërtuar i tillë ku sipas ligjeve dhe rregullave të vendosura për funksionimin, organizimin e këtij sistemi brezat e rinj krijojnë garanci financiare për brezat e vjetër.

Kështu ky parim mbështetet në solidaritetin e brezave, ku brezi i ri ndërjegjësohet se këto kontribute plotësojnë një nevojë aktuale. Garancia financiare është një parim, të cilit i kushtohet një vëmendje e veçantë nga të gjithë shtetet, sidomos shtetet, të cilat nuk renditen në vendet me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

2.3.4 Eksportimi i të Drejtave të Fituara

Eksportimi i të drejtave të fituara është një parim i cili funksionon në vendet e Komunitetit European dhe rrjedh si detyrim i Konventës Social Europiane. Qëllimi i përdorimit të këtij parimi lidhet me skemën e sigurimeve shoqërore për përfitimet afatgjata si: *pensionit i pleqërisë ose invaliditetit* i cili paguhet për pjesën tjetër të jetës së personit, ose për një periudhë të gjatë.

Sipas ligjit tonë të sigurimeve shoqërore nuk lejohet pagesa e dy pensioneve. Nëse një subjekt i cili kur arrin moshën e pensionit i lind e drejta për përfitimin edhe në Shqipëri edhe në një vend tjetër ku ka kryer aktivitet ekonomik, ai do të ketë të drejtën vetëm për përfitimin e një pensioni. Rastet përjashtimore lejohen vetëm për ato vende, ku vendi ynë ka nënshkruar marrëveshje në fushën e pensioneve. Nëse dikush ka përfituar një pension pleqërie, ligji kombëtar mund të theksojë se ky individ nuk mund të përfitojë këtë pension, nëse largohet nga vendi. Kjo mund të krijojë një padrejtësi të madhe për ata individë që për rrethana familjare janë të detyruar të lëvizin në një tjetër vend. Parimi i eksportimit të përfitimeve thekson që nëse dikush që ka të drejtën e përfitimit, ose po përfiton nga një nga kategoritë e caktuara të instrumenteve koordinuese, ndryshon vendqëndrimin, përfitimet duhet të vazhdojnë të paguhen nga vendi i tij i vjetër.

Shuma e përfitimit nuk duhet reduktuar ose duhet rregulluar në ndonjë mënyrë si rezultat i kësaj lëvizjeje. Parimi i eksportimit të përfitimeve mund të aplikohet edhe për përfitimet afatshkurtra si p.sh. përfitimi nga papunësia, me anë të të cilit njerëzit e sëmurë nga puna në një shtet tjetër, do të vazhdojnë të marrin gjithsesi përfitime nga vendi i tyre mëparshëm. Përfitimet individuale gjithashtu mund të eksportohen, për shëmbull trajtimi i shëndetit mund të sigurohet në një tjetër shtet, nën koston e shtetit të pacientit. Kjo duhet të jetë e lidhur me faktin që kur dikush sëmurët ndërsa është me pushime, por kjo mund të aplikohet nëse dikush kërkon një operacion special, i cili nuk është i mundur në shtetin e tij.

Në kushtet e vendit tonë të gjitha eksportimet realizohen vetëm me marrëveshje bilateral. Ky parim do të merrte një vlerë të veçantë, nëse vendi ynë do të ishte vend anëtar i Europës.

2.4 Çështje të Përgjithshme mbi Barazinë Gjinore në Fushën e Sigurimit Social

Barazia gjinore në skemat e sigurimeve shoqërore, është më shumë se një çështje e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në kuptimin formal. Qëllimi i analizës së barazisë gjinore në këtë punim ka në fokus aspektin e roleve gjinore në shoqëri, role të cilat ndryshojnë brenda shoqërive dhe që në vitet e fundit kanë pësuar ndryshime të mëdha në shumë e shumë vende.

Nisur nga sa më lart kuptojmë se krijimi dhe organizimi i skemave të sigurimeve shoqërore në drejtim të barazisë gjinore ka si qëllim:

- *Garantimin e barazisë në marrëdhëniet midis burrave dhe grave, duke marrë në konsideratë role të ndryshme gjinore të cilat do të shërbejnë si mjet për promovimin e barazisë gjinore.*

Barazia gjinore në sistemet e sigurimeve shoqërore është një çështje komplekse e cila përfshin dy lloje të diskriminimit: - *direkte dhe indirekte.*

Diskriminimi direkt mund të vërehet në:

- *Diferencat në trajtim midis grave të martuara, ekonomikisht aktive, dhe burrave, bazuar në idenë se gruaja është e varur nga burri i saj, në mënyrë që të drejtat e saj të sigurimeve shoqërore kanë derivuar nga të drejtat e*

sigurimit të tij, duke mos u bazuar vetë në kontributin e saj personal;

- *Diferencat në normat e përfitimeve ose të kontributeve të bazuar në llogaritjet aktuariale, bërë veçmas për burrat dhe gratë, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si jetëgjatësia, rreziqet e mobilitetit dhe paaftësisë, modelet e pritura të punës, etj.*

Diskriminimi indirekt është një fenomen i cili në pamje të parë është i fshehtë, ai mund të konstatohet duke analizuar masa të cilat, edhe pse shpesh herë përkufizohen pa dallim seksi, në praktikë ndodh ndryshe. Këto masa ndikojnë si te gratë ashtu edhe tek burrat në mënyra të ndryshme, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre profesionale, statusit martesor ose situatës familjare.

Shumë gra e kalojnë pjesën më të madhe të jetës së tyre, jashtë punësimit dhe në këtë mënyrë janë të varura ekonomikisht nga burrat e tyre. Në sistemin e sigurimeve shoqërore, bazuar në marrëdhëniet e punës, të drejtat që rrjedhin lejojnë një bashkëshort të varur për të përfituar nga kujdesi shëndetësor dhe përfitimet e të mbijetuarëve. Fusha e barazisë gjinore në kuadër të sigurimeve shoqërore është zhvilluar shumë dhe në saj të rolit të bashkësisë ndërkombëtare.

Një rol të madh në këtë fushë ka evidentuar edhe ONP-ja, standardet që lidheshin me gratë kishin për qëllim kryesisht mbrojtjen e punëtoreve femra në aspektin e shëndetit dhe sigurisë, kushtet e punës dhe kërkesave të veçanta që lidheshin me funksionin e tyre riprodhues. Me kalimin e kohës, ka pasur një ndryshim në llojet e standarteve mbrojtëse për grate - nga Konventat mbrojtëse të Konventat që kanë për qëllim dhënien e femrave dhe meshkujve të drejta të barabarta dhe mundësi të barabarta.

Miratimi i Konventës së barabartë mbi pagesën, 1951 (Nr. 100), diskriminimin (në punë dhe profesion), 1958 (Nr. 111), dhe Konventa, 1981 (Nr. 156) për punonjësit me përgjegjësi familjare, shënuan një ndryshim në qëndrimet tradicionale në lidhje me rolin e gruas dhe një njohje të faktit që përgjegjësitë familjare ndikojnë jo vetëm gruan punëtore, por familjen dhe shoqërinë në tërësi.

Mesi i viteve 1970 shënoi lindjen e një koncepti të ri dhe më ambicioz që synon shanse të barabarta midis burrave dhe grave në të gjitha fushat. Ky koncept ka gjetur shprehjen e tij në debatet dhe tekstet që kishin ardhur nga Sesioni i 60-të i Konferencës Ndërkombëtare të Punës të mbajtur në vitin 1975. Që atëherë mbrojtja e grave që punojnë është bazuar në parimin se gratë duhet të jenë të mbrojtura nga rreziqet e natyrshme në punë dhe në profesion, në të njëjtën bazë dhe në përputhje me të njëjtat norma si burrat. Masat e veçanta mbrojtëse të cilat mbeten të lejueshme janë ato që synojnë mbrojtjen e funksionit riprodhues të grave.

Shumica e instrumenteve të sigurimeve shoqërore të ONP-së fillimisht nuk përmbanin asnjë dispozitë që ndalonte diskriminimin në bazë të gjinisë. Ato ishin miratuar në një kohë kur opinion mbizotërues (shpesh në kundërshtim me realitetin edhe atëherë) ishte se meshkujt ishin mbajtës të familjes dhe se gratë normalisht do të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për familjen. Dy Konventa të sigurimeve shoqërore, megjithatë ndalojnë diskriminimin. Njëra është Konventa Materniteti Mbrojtjes (e rishikuar), 1952 (Nr. 103), e cila thotë se çdo kontribut paguhet pa dallim midis burrave dhe grave të punësuar në ndërmarrje. Konventa

tjetër është për Promovimin dhe Mbrojtjen e Punësimit ndaj Konventës së papunësisë, 1988 (Nr. 168), e cila kërkon barazi trajtimi për të gjithë personat e mbrojtur, pa diskriminim në bazë të seksit, duke lejuar që shtetet anëtare të miratojnë masa të veçanta për të përmbushur nevojat specifike të kategorive të personave që kanë probleme të veçanta në tregun e punës.

Konventat e tjera të ONP-së edhe pse nuk i referohen në mënyrë specifike sigurimeve shoqërore, natyrisht që shprehimisht e ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë, përkatësisht përmes Konventave Nr 100, 111 dhe 156 të përmendura më lart. Me qëllim që të vendoset barazia efektive e mundësive dhe trajtimit të burrave dhe grave punëtore, Konventa Nr. 156 parashikon që të gjitha masat e sanksionuara prej saj, të implementohen nga shtetet anëtare, në përputhje me kushtet dhe mundësitë kombëtare, duke marrë parasysh nevojat e punëtorëve me përgjegjësi familjare. Rekomandimi mbi diskriminimin (në punë dhe profesion), 1958 (Nr. 111) po ashtu rekomandon që të gjithë personat duhet, pa diskriminim, të gëzojnë barazinë e mundësive dhe trajtimit në lidhje me masat e sigurisë sociale.

Mbrojtja e funksionit riprodhues të gruas është e lidhur ngushtë me promovimin e barazisë gjinore. Gjate gjithë historisë së saj, ONP-ja ka qënë e shqetësuar që gratë punëtore ta gëzojnë këtë të drejtë, nga miratimi në 1919 i Konventës Mbrojtja e Amësisë (Nr. 3) në miratimin në vitin 2000 të Konventës së Maternitetit Mbrojtjes (Nr. 183) dhe Rekomandimit (Nr. 191).

2.5 Panoramë e Përgjithshme mbi Trajtimin e Parimit të Barazisë Gjinore në Fushën e Sigurimeve Shoqërore, nga Legjislacioni i Bashkimit Europian

Ligji i BE-së ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e barazisë më të madhe të sigurisë sociale për gratë. Traktati i BE-së kërkon pagë të barabartë për burrat dhe gratë. Megjithatë, kjo nuk shtrihet në skemat e pensioneve publike (edhe pse kjo ka të bëjë me pensionet profesionale, të cilat konsiderohen të jenë pagesa të shtyra). BE-ja ka rënë dakord për një direktivë në 1979, e cila kërkonte trajtim të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me shumicën e fushave të sigurisë sociale (për shembull papunësi, pleqëri, sëmundje dhe paaftësi).

Në atë kohë, shumë shtete anëtare të BE-së i diskriminonin gratë, për shembull, duke paguar nivele të ulëta të përfitimeve ose duke paguar përfitime për periudha të shkurtra kohore. Direktiva e BE-së hyri në fuqi në 1986.¹²¹

Direktiva e BE-së, e kombinuar me prirjet drejt barazisë dhe numrit në rritje të grave në fuqinë punëtore në Europë, solli ndryshime të rëndësishme në strukturën gjinore të skemave të sigurimeve shoqërore dhe futjen e barazisë gjinore formale në shumicën e fushave sociale.

Megjithatë, një numër i fushave, duke përfshirë familjen dhe përfitimet e të mbijetuarve, që bie jashtë fushëveprimit të direktivës dhe fushëveprimit personal të direktivës, është që të kufizojë punëtorët ose personat që kërkojnë punë. Kështu p.sh. gratë që heqin dorë nga puna për t'u kujdesur për fëmijët, lihen jashtë fushëveprimit të direktivës dhe nuk

¹²¹ Një numër i vendeve të BE-së (në veçanti Irlanda, Holanda dhe Britania e Madhe) nuk e kanë zbatuar plotësisht direktivën në legjislacionin e tyre kombëtar.

mund të pretendojnë barazinë e trajtimit. Megjithatë përpjekjet ligjore në këtë drejtim qenë të vazhdueshme dhe filluan të hartoheshin direktiva të detajuara në lidhje me trajtimin e barabartë në pensionet profesionale.

Parimi i trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në fushën e sigurimit social, nga kuadri legjislativ i Bashkimit European, ka një dimension të dyfishtë: Ai i referohet:

- *skemave ligjore, të sigurimeve shoqërore.*
- *skemave profesionale të sigurimeve shoqërore.*

Rregullat që zbatohen për këto dy lloje skemash janë shumë të ndryshme. Në skemat ligjore të sigurimeve shoqërore ndeshen shumë më tepër përjashtime nga parimi i trajtimit të barabartë. Më konkretisht:

A) Skemat ligjore të sigurimeve shoqërore

Për analizën e këtyre skemave do t'i referohemi Direktivës 79/7/KE të 19 dhjetorit 1978, si një akt që i shtrin efektet e veta normative brenda kuadrit kufitar të Bashkimit European. Në lidhje me zbatimin gradual të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në fushën e sigurimeve shoqërore. Direktiva i drejtohet vetëm skemave ligjore të detyrueshme, që mbulojnë me sigurim shëndetësor, të invaliditetit, të pleqërisë, të aksidenteve në punë, të sëmundjeve profesionale dhe të papunësisë (neni 3/1 a). Sipas nenit 4/1 të Direktivës, parimi i trajtimit të barabartë nënkupton ndalimin e çdo diskriminimi gjinor direkt ose indirekt, kryesisht për sa i përket fushës së zbatimit të skemave ligjore të sigurimeve shoqërore dhe kushteve që duhen plotësuar për të pasur të drejtën e mbulimit nga këto skema, detyrimit për derdhjen e kontributeve dhe llogaritjes së tyre, llogaritjes së përfitimit nga shërbimet, përfshirë edhe shtesat që derdhen për bashkëshortin ose personat në ngarkim, kushtet e kohës dhe të përfitimit të të drejtave për mbulime.

Neni 7/1 i Direktivës i njuh të drejtën shteteve anëtare të përjashtojnë disa çështje nga fusha e zbatimit të saj. Këtu kemi të bëjmë kryesisht me: përcaktimin e moshës së pensionit të pleqërisë, përfshirë këtu edhe pasojat që mund të kenë shërbimet e tjera, avantazhet në kuadrin e sigurimeve të pensioneve të pleqërisë për personat që kanë rritur fëmijë (fitimi i së drejtës për periudha shkëputjeje nga puna për rritjen/edukimin e fëmijëve), përcaktimin e të drejtave për përfitimin e pensionit të pleqërisë ose invaliditetit, në bazë të të drejtave që vijnë nga bashkëshortja, dhënien e ndihmave afatgjata për invalidët ose pleqëri, në favor të bashkëshortes në ngarkim.

Kontestimet kryesore që ka trajtuar Gjykata Europiane e Drejtësisë, nëpërmjet kërkesave paragjyqësore, kanë të bëjnë me përjashtimin e parë të mundshëm, pikërisht me rastin kur diferenca mes moshës së daljes në pension, sjell trajtime të ndryshme, sipas moshës, mes burrave dhe grave, për shërbime të tjera që nuk mbulojnë nga përjashtimi. Kjo çështje është ngritur konkretisht në lidhje me pensionin e parakohshëm, i cili i jepej jo në të njëjtën moshë për burrat dhe për gratë, në rastet e paafësisë për punë ose të papunësisë në mosha të mëdha. Këto dy çështje iu paraqitën Gjykatës Europiane të Drejtësisë nga Austria. Gjykata shfrytëzoi këtë rast për të saktësuar se këto shënime nuk kanë të bëjnë me pensionin e pleqërisë. Gjithashtu gjykata vendosi se këto dy raste nuk përfshihen në

fushën e përjashtimeve të nenit 7/1 të Direktivës, sepse kushti i moshave të ndryshme “mund të konsiderohet sipas kësaj direktive, si një pasojë që mund të shkaktohet nga parashikimi në legjislacionin kombëtar të një kufiri moshe të ndryshëm për burra dhe për gra për përfitimin e pensionit të pleqërisë”.

I tillë ishte rasti i vendimit Haackert i 4 majit 2004¹²², me kusht që moshën e përcaktuar për të përfituar pension të parakohshëm për shkak të papunësisë është e njëjtë si për burrat dhe për gratë: 60 vjeç për gratë (zgjidhje e vënë në zbatim për herë të parë në vendimin Burton të 16 shkurtit 1982¹²³, në lidhje me një skemë daljeje në pension me dëshirën e të interesuarve). Por në vendimin e çështjes Buchner të 23 majit 2000¹²⁴, aplikimi i një moshe të ndryshme për burrat dhe gratë për përfitimin e pensionit të parakohshëm për paaftësi nuk është konsideruar si diçka që përfshihet në fushën e përjashtimeve, për arsye se gratë mund ta kërkonin këtë pension 5 vjetpara moshës normale të pensionit (që nga moshën 55 vjeç) ndërsa burrat 8 vjet përpara (ose 57 vjeç).

Një hapësirë e tillë tolerance përkundrejt përjashtimit, që është mjaft e konsiderueshme, ilustron ambicien modeste të kësaj direktive, e cila synonte vënien “graduale” në zbatim të parimit të trajtimit të barabartë gjinor në skemat ligjore të sigurimeve shoqërore.

Ky qëndrim që në fillim ishte i kuptueshëm, mbështetej në faktin se skemat kombëtare të sigurimeve shoqërore praktikojnë gjerësisht trajtimin e ndryshëm për burrat dhe gratë. Por situata kishte premisa të ndryshonte dhe kërkesat komunitare të rëndoheshin përgjatë rishqyrtimeve periodike që këshilloheshin në paragrafin 2 të nenit 7.

Si pasojë e këtyre rishqyrtimeve, përjashtimet nuk do të ekzistonin gradualisht “për shkak të zhvillimeve sociale në këtë fushë”. Për shkak të mungesës së kësaj klauzole afatgjatë, dispozitivi nuk ka ndryshuar dhe shtetet anëtare kanë vazhduar t’i zbatojnë të gjitha përjashtimet. Kjo ka bërë që kontrasti të jetë edhe më i fortë në raport me rreptësinë e qëndrimeve që praktikohet ndaj skemave profesionale. Këtu dallohen fare qartë edhe se sa e rëndësishme është sfida e përkufizimit të skemave sociale.

B) Skemat profesionale të sigurimeve shoqërore

Neni 3 i direktivës 79/7/KE në lidhje me skemat profesionale të sigurimeve shoqërore, parashikonte se Këshilli do të miratonte më vonë dispozitat e nevojshme dhe me propozim të Komisionit. Pavarsisht kësaj, kjo gjë u realizua vetëm në vitin 1986, me anë të Direktivës 86/378/KE të 24 korrikut 1986¹²⁵. Direktivat e vitit 1986, krahasuar me Direktivën 79/7/KE, ishte ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, sepse parashikonte për skemat profesionale të njëjtin numër përjashtimesh, si edhe për skemat ligjore të parashikuara në Direktivën 79/7/KE.

Duke u nisur nga cilësimi i ngurtë i shpërblimit që Gjykata Europiane e Drejtësisë kishte bërë për shumicën e skemave profesionale të mbrojtjes sociale, këto përjashtime bëheshin të pavlefshme, sepse ishin

122 GJ/DKE 4 Maj 2004, Haackert, çështja C-303/02, Rec. fq. I-2195; Europe 2004, fq. 20.

123 GJ/DKE 16 Shkurt 1982, Burton, çështja 19/81, Rec. fq. 554; CMLR 1982, fq. 629.

124 GJ/DKE 23 Maj 2000, Buchner, çështja C-104/98, Rec. fq. I-3625.

125 Direktiva 86/378/KE e Këshillit e 24 Korrikut 1986 në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në skemat profesionale të sigurimeve shoqërore

të papajtueshme me parimin absolute të shpërblimit të barabartë të parahikuar nga Traktati. Për këtë arsye u miratua Direktiva 96/97/KE e 20 dhjetorit 1996¹²⁶, e cila ndryshoi tekstin fillestar për të ngushtuar efektin e përjashtimeve vetëm për punëmarrësit e pavarur, të cilët për nga natyra nuk kanë lidhje me nocionin e shpërblimit.¹²⁷

Pavarësisht të gjithave dhe duke u kujdesur që të jetë sa më e qartë Direktiva "përmbledhëse" ka preferuar të flasë në përgjithësi për këto skema profesionale. Neni 6 e bën Direktivën të zbatueshme "për popullatën aktive, përfshirë edhe punëmarrësit e pavarur, punëmarrësit që e kanë ndërprerë aktivitetin për shkak të një sëmundje, të barrë lindjes, të një aksidenti ose të papunësisë objektive, personat që kërkojnë punë, për punëmarrësit në pension dhe punëmarrësit invalid, si dhe të gjithë ata që kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat e këtyre punëmarrësve, në bazë të legjislacioneve dhe (ose) praktikave kombëtare".

Për sa i përket fushës së zbatimit të këtyre masave, neni 7/1 i Direktivës parashikon se kjo direktivë zbatohet si për skemat profesionale të sigurimeve shoqërore që garantojnë sigurimin për risqet tradicionale (sëmundje, invaliditet, pleqëri, aksidente në punë, sëmundje profesionale dhe papunësi) ashtu edhe për "skemat profesionale të sigurimeve shoqërore që parashikojnë mbulime të tjera sociale, në natyrë ose në vlerë monetare, kryesisht sigurimin e personave në ngarkim të lënë pas vdekjes së mbajtësit të familjes dhe sigurimet familjare, nëse ata përmbajnë avantazhe që janë paguar nga punëdhënësit për arsye të marrëdhënieve të tyre të punës.

Paragrafi i 2 i nenit 7 të Direktivës gjen zbatim dhe mbi skemat e posaçme të funksionarëve, për të cilat Gjykata Europiane e Drejtësisë ka një jurisprudence të pasur, nëse "mbulimet e pagueshme në kuadër të skemës jepen për arsye të marrëdhënieve të punës me punëdhënësin publik". Aty saktësohet gjithashtu se "fakti që një skemë e tillë është pjesë e një skeme ligjore të përgjithshme, nuk e çënon zbatimin e dispozitës pararendëse."

Kjo jurisprudence buron nga vendimi Beune i 28 shtatorit 1994¹²⁸ i cili zbaton për rastet e skemave të posaçme të funksionarëve, përkufizimin e shpërblimit të bërë nga Gjykata (GJDK 17 Maj 1990 Barber) duke bërë që ato të përfshihen në nocionin e shpërblimit për sa kohë rrjedhin direkt nga marrëdhënia e punës së funksionarit me punëdhënësin publik.

Për sa i përket parimit të parahikuar në nenin 5 të Direktivës, ai është formuluar plotësisht në të njëjtën mënyrë me atë të nenit 4 të Direktivës 79/7/KE. Por gjithsesi, është interesant fakti që ai është pasuruar me raste, që në nenin 9 quhen "shembuj diskriminimi" të përbërë nga 11 shembuj të dispozitave, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë (neni 9/1), shumica të dala nga jurisprudencea.

Aty përmenden rreullat e ndryshme në lidhje me moshën e hyrjes në skemë ose kohën e periudhave të trajnimit të nevojshëm për përfitimin

¹²⁶ Direktiva 96/97/KE e Këshillit e 20 Dhjetorit 1996 që ndryshon Direktivën 86/378/KE në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në skemat profesionale të sigurimeve shoqërore.

¹²⁷ Neni 11 i Direktivës "përmbledhëse" e rimerr këtë masë, e cila nuk paraqitet më nën këndështrimin e përjashtimit, por si "mundësi zbatimi i diferencuar për sa u përket punëmarrësve të pavarur", deri në realizimin e barazisë në skemat ligjore, gjë që nuk ka gjasa të ndodhë në të ardhmen e afërt.

¹²⁸ GJDK 28 Shtator 1994, Buene, çështja C-7/93, Rec. fq. I-4471; RJS 1994, fq. 803, shënime PH. Laigre; JDI 1995, fq. 435 shënime D. Simone.

e sigurimit, rregullat e ndryshme të rimbursimit të kontributeve kur punëmarrësi largohet nga skema pa fituar të drejtën e diferencuar për sigurim afatgjatë, ose diferencimin e nivelit të sigurimit. Në rastin e fundit, Direktiva mban një qëndrim që lidhet drejtpërdrejtë me jurisprudencën e Gjykatës (vendimet Neath i 22 Dhjetorit 1993¹²⁹ dhe Coloroll i 28 Shtatorit 1994¹³⁰).

Ky qëndrim konsiston në legjitimitimin e trajtimeve të ndryshme që vijnë si rezultat i përdorimit të elementëve të ndryshme të llogaritjes së sigurimit në skemat me kontribute fikse, ose të niveleve të ndryshme të kontributeve në skemat me mbulime fikse të financuara nga kapitali i krijuar.

Në përfundim, mund të nënvizojmë veçoritë që paraqesin skemat profesionale të sigurimeve shoqërore, veçori të cilat lidhen drejtpërdrejtë me jurisprudencën e GJED, sidomos me trajtën që kjo jurisprudencë mori në çështjen Barber¹³¹. Gjykata e cila ishte e ndërgjegjshme për pasojat e rënda financiare që mund të sillte vendimi i saj për skemat profesionale që kishin praktikuar në mirëbesim diferencimin gjinor, vendosi t'i kufizonte në kohë efektet e vendimit të saj paragjyqësor, gjë që e lejon edhe Traktati.

Cilësimi i "shpërblimit" është pra i vlefshëm vetëm për mbulimet që lidhen me periudhat e punësimit pas 17 majit 1990, pa efekte prapavepruese, me përjashtim të punëmarrësve ose personave në ngarkim, të cilët i janë drejtuar gjykatës para kësaj date.

Lidhur me rastin e fundit, neni 12 na kujton se periudhat e siguruara nuk mund të shkojnë në asnjë mënyrë përtej datës së vendimit Defrenne¹³², 8 prill 1976, i cili konfirmoi efektin direkt të nenit 119 të TKE (ndryshuar në nenin 157 TFBE).

Edhe pse efektiviteti i zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave lidhet në të drejtën e Bashkimit Europian, pjesërisht me përshkrimin e hollësishëm të situatave specifike në të cilat zbatohet, ky parim është përforcuar veçanërisht nga botimi i një numri dispozitash horizontale, më të rëndësishmet e të cilave janë rregullat procedurale.

C) Krijimi i kuadrit të përgjithshëm në favor të trajtimit të barabartë në fushën e punësimit dhe të marrëdhënieve të punës.

Fuqizimii luftës kundër të gjitha formave të diskriminimit ka filluar qysh me Traktatin e Amsterdimit, i cili shtoi në nenin 13 të TKE një klauzolë për dhënie kompetencash, duke u njohur institucioneve të Bashkimit Europian të drejtën të plotësojnë kuadrin ligjor kundër diskriminimit. Neni 19/1 i TFBE, vazhdues i nenit 13 TKE, parashikon se në vijim të Këshillit, nëpërmjet një procedure vendimarrëse të posaçme (miratim) "mund të marrë masat e nevojshme për të luftuar çdo lloj diskriminimi për shkak të gjinisë, racës ose origjinës etnike, besimit fetar ose bindjeve, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual."

Kjo qasje globale është konsoliduar me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, i cili shtoi në nenin 10 të TFBE një klauzolë koherence, e cila e

129 GJDE 22 Dhjetor 1993, Neath, çështja C-152/91, Rec. fq. I-6935; JDI 1994, fq. 480, shënime D. Simon; CMRL 1994, fq. 1387, shënime T.K. Herver, DR. soc. 1995, fq. 156 shënime M. De Vos.

130 GJDE 28 Shtator 1994, Coloroll, çështja C-200/91, Rec. fq. I-4389; RJS 1994, fq. 803, shënime PH.Laigre; DR. soc. 1995, fq. 424, shënime Ph. Langlois.

131 GJDE 17 Maj 1990, Barber, latpërmendur.

132 GJDE 8 Prill 1976, Defrenne, latpërmendur.

detyron Bashkimin Europian të përpiqet të luftojë kundër diskriminimeve që rrjedhin prej të gjitha arsyeve të mësipërme gjatë miratimit dhe zbatimit të politikave dhe të punës së tij.

Neni 21 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, i cili është bërë i kundërtueshëm ndaj institucioneve të Bashkimit, parashikon një ndalim edhe më të gjerë të diskriminimeve, përfshirë edhe të atyre që bazohen tek ngjyra, origjina Shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, përkatësia ndaj një pakice kombëtare, por edhe pasuria apo lindja.

Kjo fushë mund të krahasohet edhe me atë të përkufizuar që në vitin 1985 nga Konventa nr.111 e ONP-së¹³³ e cila parashikon diskriminimin për shkak të *“racës, ngjyrës, gjinisë, besimit fetar, opinionit publik, origjinës kombëtare ose prejardhjes sociale.”* Mund të nënvizojmë pra se në të Drejtën e Bashkimit Europian nuk ekziston një parim absolut i barazisë, i cili të përfshijë të gjitha kriteret e mundshme të diskriminimit.

Por, kjo gjë ekziston në nivelin e Këshillit të Europës, në kuadrin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të paktën për shtetet që kanë ratifikuar Protokollin nr.12 të vitit 2000.

Në ndryshim nga e drejta primare, e cila përmbledh të gjitha kriteret e diskriminimit të ndaluara nga e drejta e Bashkimit, dispozita “ligjore” të miratuara për vënien në zbatim të këtij parimi të përgjithshëm të mosdiskriminimit janë mjaft të shpërndara. Fakti që lufta kundër diskriminimit gjinor ka filluar më parë, shpjegon faktin e dedikimit të ligjeve specifike në lidhje me të. Krijohet ideja se është miratuar një tekst i vetëm për kriteret e tjera, përveç gjinisë, i cili të përfshinte të gjitha kriteret e ndalimit të diskriminimit edhe se ky tekst zbatohet në rrethana të ndryshme. Por kjo nuk ka ndodhur, përkundrazi, institucionet kanë miratuar tekste në lidhje me disa shkaqe të caktuar diskriminimi, që nuk mbulojnë të njëjtën fushë veprimi. Kështu u miratuan njëra pas tjetrës, më 29 qershor dhe më 27 nëntor 2000, dy Direktiva mbi një çështje të njëjtë, por që mbështeteshin mbi dy qasje të ndryshme.

E para Direktiva 200/43/KE¹³⁴, *“në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes personave pa dallime race ose origjine etnike”* i kushtohet vetëm luftës kundër diskriminimit racor, por pa u kufizuar vetëm në botën e punës. Kjo direktivë ka një fushë zbatimi shumë të gjerë, në të cilën e drejta sociale është vetëm një ndër aspektet e shumtë të saj. Kjo direktivë mbulon gjithashtu mbrojtjen sociale në kuptimin e gjerë të fjalës (sigurime shoqërore dhe kujdes shëndetësor), avantazhet sociale, formimin si dhe aksesin në të mirat material dhe në shërbime.

Për sa i përket Direktivës së dytë 200/78/KE¹³⁵, e cila pretendon se krijon *“një kuadër të përgjithshëm në favor të trajtimit të barabartë në fushën e punësimit dhe të marrdhënieve të punës”*, në realitet ajo mbulon vetëm disa kritere të ndaluara diskriminimi, duke lënë mënjanë gjininë dhe prejardhjen etnike (objekt i Direktivës së parë). Por, sidoqoftë këto dy Direktiva të vitit 2000 plotësojnë gjerësisht kuadrin ligjor, i cili deri në atë kohë kufizohej te diskriminimet. gjinore dhe mbulojnë shkaqet kryesore të trajtimit të pabarabartë në punë.

¹³³ Konventa nr.111 e 1958, në lidhje me diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesioneve.

¹³⁴ Direktiva 2000/43/CE e Këshillit e 29 qershorit 2000, në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes personave pa dallim race ose origjine etnike, FZ L 180 e 19 korrikut 2000, fq. 22.

¹³⁵ Direktiva 2000/78/CE e Këshillit e 27 nëntorit 2000, mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm në favor të trajtimit të barabartë në fushën e punësimit dhe të punës, FZ L 303 e 2 dhjetorit 2000, fq. 16.

D) Cilat janë kriteret e diskriminimit të ndaluar:

Nëse Direktiva 2000/43/KE, ka të bëjë me trajtimin e barabartë pa dallim race ose prejardhje etnike, Direktiva 2000/78/KE, synon ndryshimet në trajtim për shkak të besimit ose bindjeve, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Dy nga këto kriteret kanë qënë edhe më parë objekt saktësimesh jurisprudenciale, të cilat nga njëra anë paralajmërojnë pranimet e nocionit të paaftësisë, e nga ana tjetër kundrejtueshmërinë në fushën e diskriminimit për shkak të orientimit seksual.

Për sa i përket nocionit të paaftësisë(handikapit) Gjykata Europiane e Drejtësisë u shpreh në kuandrin e një çështje të ngritur nga një e punësuar kundër punëdhënësit të saj për pushim nga puna për shkak të një sëmundje që e pengonte të rifillonte aktivitetin profesional brenda një kohe të shkurtër(GJDKE 11 Korrik 2006, Chacon Navas¹³⁶). Ndërsa pala paditëse dhe juridiksioni kompetent përpqeshin të parandalonin çdo rrezik diskriminimi për shkak të paaftësisë së krijuar për arsye të një sëmundje shkaktare të paaftësisë fizike. Gjykata e hodhi poshtë një qasje të tillë, e cila barazon në një farë mënyre nocionin e sëmundjes me atë të paaftësisë, nocione që sipas Gjykatës duhej të ishin plotësisht të ndara.

Gjykata përfitoi nga ky rast për të dhënë përkufizimin e vetë të "paaftësisë", për të cilin Direktivat nuk parashikonin asnjë përkufizim, duke e konsideruar si "një kufizim që vjen nga cënimet fizike, mendore ose psikike dhe që pengon pjesmarrjen e një personi të caktuar në jetën e tij profesionale". Duke u nisur nga konstatimi se vetëm ky motiv përmendet shprehimisht në Direktivë, Gjykata hedh poshtë çdo interpretim tjetër, i cili mbart rrezikun të shtoj edhe një motiv tjetër diskriminimi.

Për sa përket orjenimit seksual, rasti i parë i zbatimit të Direktivës 2000/78/KE, ishte çështja Maruko(GJDKE, 1 Prill 2008¹³⁷). Pas vdekjes së partnerit të tij, zotit Maruko iu refuzua dhënia e pensionit me arsyen se ky lloj mbulimi i përkiste vetë, të veut ose të vesë. Pasi bëri një test klasik të krahasimit mes situatave, Gjykata vërejti se Kodi Gjerman i Sigurimeve Shoqërore vendos shenjën e barazisë së plotë mes partnerit bashkëjetues dhe bashkëshortit, kur bëhet fjalë për përfitimin e pensionit pas vdekjes së mbajtësit të familjes.

Meqë partnerët e regjistruar gjendeshin në Gjermani dhe meqë nga pikëpamja e sigurimeve shoqërore ata ishin në një situatë të përafërt me atë të bashkëshortëve, dukej qartë se kërkuesi ishte viktimë e një mangësie të papranueshme të trajtimit, në një fushë me ndjeshmëri të madhe. Duhet të nënvizojmë se diskriminimi direkt për shkak të orientimit seksual nuk ishte flagrant, sepse diferenca në trajtim lidhej shumë më pak me orientimin seksual se sa me statusin e marrdhënies "martesore".

Mbulimi në fjalë i rezervohej vetëm të veve dhe në këtë rast i ishte refuzuar partnerit bashkëjetues të regjistruar. Megjithatë vetëm në rastet kur një shtet anëtar vendos me vullnet të lirë që të barazojë trajtimin e partnerëve bashkëjetues të regjistruar me atë të bashkëshortëve, Gjykata mund të detyrojë këtë shtet të respektojë parimin e mosdiskriminimit për arsye të orientimit seksual.

¹³⁶ GJDKE 11 Korrikut 2006, Chacon Navas, çështje C-13/05, Rec. fq. I-6467; Europe 2006, fq. 17, shënime L.Idot; Dr. Soc 2006, fq. 1117, shënime J. Savatier; RJS 2006, fq. 757, shënime F. Kessler; CMLR 2007, fq. 487, shënime L.Waddington.

¹³⁷ GJDKE 1 prill 2008, Maruko, çështja C-267/06, Rec. fq. I-1757; Europe 2008, fq. 13, shënime L. Driguez; Dr. Soc. 2008, fq. 712, shënime J-Ph. Lhernould; JCP S 2008, 1416, shënime J. Cavallini; RJS 2008, fq.688, shënime M. Le Barbier-Le Bris .

D.1) Cilat janë aspektet e diskriminimit?

Dy direktivat e vitit 2000(neni 3/1) parashikojnë se janë të ndaluara të gjitha format e diskriminimit në punë, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat. Pra ato zbatohen në fushën e aksesit në punësim, me pagë ose me vetëpunësim(përfshirë këtu kriteret e përzgjedhjes, kushtet e marrjes në punë dhe të rritjes në detyrë), si dhe aksesin në të gjitha format e orientimit, trajtimit, perfeksionimit dhe rikonvertimit profesional).

Janë gjithashtu të përfshira në fushën e zbatimit të parimit të mosdiskriminimit të gjitha kushtet e punësimit dhe të punës, kushtet e shpërblimit dhe të largimit nga puna si dhe aderimi ose angazhimi në një organizatë punëdhënësish ose punëmarrësish, apo çdo organizatë tjetër profesionale. Pra në këtë kuadër, janë të ndaluara diskriminimet në fushën sindikale për shkak të racës, prejardhjes etnike, besimit ose bindjeve, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Këto raste nuk duhet të ngatërrohen me rastet e diskriminimeve për shkak të aktivitetit sindikal, të cilat nuk parashikohen shprehimisht nga Direktiva 2000/78/KE, edhe pse mund të mendojnë se gjenden të përfshira në kategorinë e diskriminimeve për shkak të bindjeve.

Për të përkufizuar "konceptin e diskriminimit", Direktiva 2000/43/KE dhe 2000/78/KE frymëzohen nga masat shumë të gjera të vëna në zbatim në fushën e luftës kundër diskriminimeve gjinore. Pra janë të ndaluara si diskriminimet direkte ashtu edhe ato indirekte(neni2/1), ngacmimet(neni2/1) dhe diskriminimet në "nxitje", i cili përkufizohet në nenin 2/1 si "çdo qëndrim që konsiston në nxitjen e një personi për të praktikuar një diskriminim të caktuar."

Diskriminimet e renditura në nenin 2 janë pasuruar më tej nga Gjykata me rastin e vendimit Coleman (GJDKE 17 Korrik 2008 ¹³⁸) i cili konfirmoi një zgjerim të mundshëm dhe të konsiderueshëm të fushëveprimit të masave kundër diskriminimit të hartuara nga institucionet e BE-së duke përfshirë dhe nocionin e diskriminimit "me asocacion". Çështja kishte të bënte me rastet e diskriminimit dhe ngacmimit të pësuar nga një e punësuar për arsye të handikapit të fëmijës së saj, çka e detyroi atë që të jepte dorëheqjen.

Pra çështja që shtrohej ishte të përcaktohej nëse ajo mbrohej nga Direktiva, por edhe viktima "indirekte" e cila nuk përfshihej personalisht në një nga shkaqet e diskriminimeve të ndaluara, por lidhej me të tretë që kishin karakteristikat e diskriminimeve të mundshme. Gjëja që në fund të fundit kishte interes për Gjykatën ishte fakti se handikapi kishte qenë arsyeja, motivi i diskriminimit. Pak rëndësi kishte që ky handikap ishte i vetë punëtores apo i të afërmeve të saj. Realisht, Direktiva nuk ka si qëllim mbrojtjen e kategorive të caktuara të personave, por të ndalojë përdorimin e një numri të caktuar diskriminimesh.

Kemi të bëjmë me diskriminim direkt kur një person pëson trajtim të pabarabartë për shkak të një handikapi, por jo domosdoshmërisht të handikapit të tij. Kështu vendimi Coleman përfaqëson padyshim një kontribut mjaft të rëndësishëm në kuadrin e masave komunitare të luftës

138 GJDKE 17 korrik 2008, Coleman, çështja C-303/06, Rec. fq. I-5603; RDSS 2008, fq. 865, shënime A. Boujeka; RJS 2008, fq. 883, shënime M. Le Barbier -Le Bris; Europe 2008, fq.27 , shënime L. Driguez; JCP S 2008, 1549, shënime J. Cavallini .

kundër diskriminimeve direkte dhe indirekte, si dhe kundër ngacmimeve, për sa kohë ato ushtrohen për shkak të diskriminimeve të ndaluara.

Duhet të nënvizojmë se në praktikë mund të jetë e vështirë të sillen prova, të cilat janë më të vështira të administrohen në rastet e diskriminimeve ose ngacmimit "me asociacion", pavarësisht rregullave të barrës së provës, të parashikuara nga e drejta komunitare e trajtimit të barabartë. Edhe pse Direktivat e vitit 2000 parashikojnë një numër tepër të madh dhe të gjerë diskriminimesh të ndaluara, ato lejojnë dhe një numër të caktuar përjashtimesh.

2.6 Trajtimet e Diferencuara të Lejuara:

A. Kërkesat profesionale

Ashtu si edhe Direktiva "përmbledhëse" në rastin e diskriminimit gjinor, edhe këtu pranohen disa trajtime të diferencuara, që lidhen me "natyrën e një aktiviteti profesional ose me kushtet e ushtrimit të tij". Karakteristikat e aktivitetit duhet të trajtohen si "kërkesë profesionale thelbësore ose vendimtare" (neni 4). Kjo masë që u zbatua për herë të parë në vendimin Wolf (GJDK 12 janar 2010¹³⁹) e shtyu gjykatën të miratonte përcaktimin e një kufiri moshe për marrjen në punë të disa zjarrfikësve, në Landin Gjerman të Hesit, të cilët mernin pjesë direkt në operacionet e shuarjes së zjarreve, çka justifikonte plotësimin e disa kërkesave "jashtëzakonisht të larta" përsa i përket aftësive fizike.

Sipas Gjykatës këto kërkesa lidhen me moshën, prandaj u përcaktua moshë minimale prej 30 vjetësh si e përshtatshme për të siguruar mirëfunksionimin demografik të personelit të zjarrfikësve dhe një ndarje më të mirë të detyrave mes atyre që ishin më të aftë për ndërhyrje më fizike dhe atyre që pas moshës 45 ose 50 vjeç, do të kryenin detyra me më pak kërkesa fizike.

Këto përjashtime të cilat duhet të jenë të ligjshme dhe proporcionale ndaj zbatimit të plotë të parimit të trajtimit të barabartë, janë plotësisht të kuptueshme, megjithëse mund të ishte më e udhës që Direktivat të zbatoheshin sipas kriterëve diferencues të parapërcaktueshme. Një qasje më e hollësishme ndoshta do të kishte bërë të mundur të shmangeshin nga kjo kategori përjashtimesh diferencimet që bëhen duke u mbështetur tek orientimi seksual, për të cilat nuk kuptohet se përse duhet të përbëjnë një kërkesë profesionale të justifikueshme. Gjithashtu, për sa i përket racës dhe prejardhjes etnike, ndoshta përjashtimi do të duhej të përqëndrohej tek aktivitetet artistike, ku pamja e jashtme fizike mund të jetë vendimtare për të zgjedhur një model, një manekin ose një aktor. Sidoqoftë Direktiva 2000/78/KE identifikon dy rrethana të veçanta në të cilat mund të përdoret ky përjashtim: Nga njëra anë janë aktivitetet profesionale të ushtruara në kuadrin e "kishave dhe organizatave të tjera publike ose private, etika e të cilave bazohet te feja ose te bindjet". Nga ana tjetër neni 3 paragrafi 4, u jep shtetasve anëtarë mundësinë të përjashtojnë forcat e armatosura nga fusha e veprimit të Direktivës, për sa i përket diskriminimit për shkak të moshës apo të paaftësisë.

B. Diskriminimi pozitiv

Nenet 5 dhe 7 të Direktivave, respektivisht të qeshorit dhe të nëntorit të

¹³⁹ GJDK 12 janar 2010, Wolf, çështja C-229/08

vitit 2000, u njohin shteteve anëtare të drejten "të mbajnë në fuqi dhe të miratojnë masa specifike për të parandaluar ose kompensuar pabarazi" që mund të shkaktojnë këto masa. Kjo kompetencë përjashtuese, e formuluar në tema shumë të përgjithshme, është përforcuar nga Direktiva 2000/78/KE në favor të punëmarrësve handikapë.

Paragrafi 2 i nenit 7 thekson mundësinë e marrjes së çdo mase "në lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë (së tyre) në vendin e punës" dhe i autorizon shtetet anëtare "të krijojnë ose mbajnë në fuqi dispozita ose lehtësira që synojnë mbrojtjen ose nxitjen e përshtatjes së tyre me botën e punës. Ky kujdes i veçantë mund të krahasohet me atë që parashikohet në nenin 5, i cili i kushtohet "marrjes së masave të asyeshme për personat handikapë" dhe që i detyron punëdhënësit të marrin masat e nevojshme për t'u lehtësuar atyre ushtrimin e një aktiviteti profesional, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë do të ishte një barrë e pa përballueshme për ta, dhe nuk do të mund të kompensohej në mënyrë të kënaqshme nga ndihmat shtetërore në favor të pesonave handikapë.

C. Trajtimi i diferencuar për shkak të moshës

Direktiva 2000/78/KE i kushton një dispozitë shumë të gjatë dhe të posaçme legjitimit të diferencuar në bazë të moshës. Faktikisht, edhe pse në nenin 6 paragrafi 2 pranohet se skemat aktuale profesionale të sigurimeve shoqërore mund të praktikojnë disa forma të caktuara diferencimi për arsye të moshës, paragrafi 1 i këtij neni parashikon se kjo gjë lejohet vetëm kur është "e justifikueshme dhe e nevojshme për realizimin e objektivave të ligjshme në tregun e punës."

Nënvizojmë se ky përjashtim pranohet "pavarësisht" nenit 2 paragrafi 2 për sa kohë ai legjitimon një diskriminim të bazuar tek mosha, për të cilin zbatohen nivelet e vlerësimit që përdoren zakonisht për të identifikuar një diskriminim indirekt. Pra shtetet anëtare kanë të drejtë të mbajnë në fuqi dhe të miratojnë masa, me anë të të cilave merret parasysh kriteri i moshës kur duhet ndërhyrë për të siguruar mbrojtjen ose përshtatjen profesionale të të rinjve ose të punëmarrësve në moshë të madhe (neni 6 pg 1, "a").

Këtu mund të kemi të bëjmë me kushte speciale të aksesit në punësim dhe në formim profesional, ose me kushte të posaçme, përfshirë edhe shpërblimin dhe largimin nga puna. Mund të parashikohen gjithashtu rregulla që e kushtëzojnë dhënien e disa avantazheve me respektimin e disa kushteve minimale, që lidhen me moshën dhe me eksperiencën profesionale ose vjetërsinë, çka në shumë raste është e njëjta gjë (neni 6, paragrafi 1, "b").

Ndër këto trajtime të diferencuara, të pranuar "gjerësisht", figurojnë edhe ato që vendosin kufij të detyrueshëm moshe për pranim në punë (neni 6, paragrafi 1, "c"), me qëllim që të merren parasysh kërkesat në lidhje me formimin profesional para moshës së pensionit. Këtu ndeshemi në kontradiktën që ekziston potencialisht mes respektimit të parimit të trajtimit të barabartë dhe realizimit të objektivave të Strategjisë së Lisbonës, si dhe orientimeve udhëheqëse të punësimit, të cilat miratohen rregullisht nga Këshilli.

Në një kontekst të tillë, nuk duhet të habitemi nëse konstatojmë se zbatimi i këtij përjashtimi ka qënë arsyeja e një numri të madh procedimesh

gjyqësore, ku vetë Gjykata duket se është në kërkim të një ekuilibri delikat mes nxitjes së trajtimit të barabartë dhe detyrimeve ekonomike që lidhen me presionin e përgjithshëm që ekziston në tregun e punës së shteteve anëtare, duke justifikuar faktin se legjislacioni europian tregohet më shumë se “tolerant” në këtë pikë.

Vendimet e para janë një tregues i kujdesit me të cilin ka vepruar Gjykata në shqyrtimin e kuadrit të masave kombëtare që i janë paraqitur. Sa herë që i paraqitet rasti, Gjykata nuk harron të nënvizojë se gjyqtarët kombëtar kanë ekskluzivitetin në marrjen e vendimit përfundimtar. Çështja e legjitimitetit të masave, që merren paraprakisht në shqyrtim në kuadrin e testit të famshëm “të dyfishtë”, duket se është mjaft delikate në një fushë ku shteteve anëtare u njihet një farë lirie vlerësimit dhe ku gjyqtarët e Luksemburgut zbatojnë detyrimisht manifestin e vetëkufizimit. Për t’u bindur për sa më sipër, mjafton të konstatojmë se në rastet kur Gjykata ka zbuluar një përdorim abuziv të përjashtimit të parshikuar nga neni 6 paragrafi 1, ajo e ka mbështetur gjithmonë vlerësimin e saj të mungesa e proporcionalitetit të masave kombëtare në shqyrtim.

I tillë që rasti në vendimin e parë të dhënë, vendimi *Mongold* i 22 nëntorit 2005¹⁴⁰, në të cilin bëhej fjalë për një ligj gjerman që lejonte pa rezerva, lidhjen e kontratave me kohë të caktuar, kur punëmarrësi mbush moshën 52 vjeç. Qëllimi ishte që të favorizoheshin në punësim të papunët më në moshë, gjë që shërbente për të justifikuar kalimin me sukses të testit të objektivitetit. Por, karakteri automatik nuk dukej se respektonte kushtin e proporcionalitetit, sepse nuk dallonte rastin e një të interesuari të papunë dhe një të interesuari që e kishte tashmë një vend pune para lidhjes së kontratës. Kjo bënte që masa të ishte jo produktive, sepse rrezikonte që të gjithë punëmarrësit e moshuar të kishin një trajtim më pak të favorshëm. Këtu duhej të merrej parasysh edhe dënimi i një dispozite të Kodit Civil gjerman që përjashtonte llogaritjen e periudhave të punës para moshës 25 vjeç për përcaktimin e afatit të njoftimit të largimit nga puna.

Ky dënim u dha në rastin e vendimit *Kucukdeveci* të 19 janarit 2010¹⁴¹. Edhe pse mund të justifikohet duke u nisur nga konsiderata politike që lidhen me punësimin dhe me kontrollin e tregut të punës, ligji gjerman nuk ishte me vend, sepse nga njëra anë synonte t’i jepte punëdhënësit fleksibilitet më të madh, për sa i përket largimit nga puna të punëmarrësve më të rinj, të cilëve mund t’u kërkohet më lehtë një mobilitet personal dhe profesional më i madh, nga ana tjetër kodi zbatohet për të gjithë punëmarrësit të hyrë në ndërmarrje para moshës 25 vjeç, pavarësisht moshës që kanë në momentin e largimit nga puna.

Kujdesi i Gjykatës për të mos hyrë në terrenin e legjitimitetit del në pah shumë qartë në vendimin *Hutter* të 18 qershorit 2009¹⁴², në lidhje me një ligj austriak mbi organizimin e universiteteve. Ky ligj përjashtonte periudhat e shërbimit të bëra para moshës 18 vjeç, në llogaritjen për avancimin në karrierë. Ligji justifikohet me faktin se synonte të favorizonte punësimin profesional të të rinjve duke lehtësuar kostot e lidhura me këtë punësim, por nuk e kalonte provën e proporcionalitetit.

140 GJ/DKE, 22 nëntor 2005, *Mngold*, çështja C-144/04, Rec. Fq. I-9981; RAE 2005, fq. 723, shënime E. Dubout; JCP 2005, 1414, shënime J. Cavallini, Europe 2006, fq. 19, shënime L. Idot; RJS 2006, fq. 257, shënime H. Tissandier; RDUÉ 2006, fq. 466, shënime E. Muir; RDT 2006, fq. 31, shënime M. Schmitt.

141 GJ/DKE 19 janar 2010, *Kucukdeveci*, çështja C-555/07, nuk është botuar ende.

142 GJ/DKE 18 qershor 2009, *Hutter*, çështja C-88/08, nuk është botuar ende. Europe 2009, fq. 26, shënime L. Driguez.

Gjykata nënvizoi mungesën e koherencës të një mase që praktikisht e penalizonte eksperiencën profesionale dhe nuk arrinte të shmangte trajtimin më pak të favorshëm të atyre që kishin një formim arsimor të përgjithshëm, në raport me personat e diplomuar në shkollat profesionale. Pra edhe pse pengesa konstatohet vetëm në momentin e shqyrtimit të proporcionalitetit, nuk mund të mos nënvizojmë se akuza e bërë, pra mungesa e koherencës, lidhet si me legjitimitetin ashtu edhe me proporcionalitetin.

Në çdo rast, kryerja e këtij testi të dyfishtë nuk çon automatikisht drejt vënies në diskutim të legjislacionit kombëtar. Për këtë arsye Gjykata e ka konsideruar të vlefshëm mekanizmin spanjoll të daljes automatike në pension të punëmarrësve që kanë arritur moshën 65 vjeç (GJDK 16 tetor 2007, *Palacios de la Villa*¹⁴³). Qëllimi për të siguruar një shpërndarje të vendeve të punës mes brezave të ndryshme, qëllim objektivisht i justifikuar, shoqërohej edhe me masa proporcionale, meqë moshë nuk luante gjithmonë një rol vendimtar.

Legjislacioni spanjoll merrte gjithashtu parasysh rrethanën kur i interesuari mund të përfitonte pension të plotë (zgjidhje e konfirmuar në një çështje britanike të ngjashme, GJDK 5 Mars 2009, *Age Concern England*¹⁴⁴). Sipas së njëjtës logjikë, Gjykata vendosi se ishte i pranueshëm përcaktimi i moshës 68 vjeç për daljen në pension të stomatologëve. Kërkesa e proporcionalitetit duhej të konsiderohej si e përmbushur, kur kufiri i moshës i përgjigjet në mënyrë koherente dhe të përshtatshme synimit të ligjshëm për mbrojtjen e shëndetit dhe të politikës së punësimit, duke bërë të mundur "të ndahen mes brezave mundësitë e punësimit në gjirin e një profesioni" (GJDK 12 janar 2010, *Petersen*¹⁴⁵, pika 78).

Edhe pse Gjykata është treguar e kujdesshme, ajo nuk është treguar më pak e interesuar që t`i japë fushëveprimin më të madh parimit të trajtimit të barabartë, çka e shtyu atë të vendosë parimin e mosdiskriminimit për shkak të moshës, në nivelin e parimit të përgjithshëm të së drejtës së Bashkimit, në kuadrin e një jurisprudence të guximshme, por gjithashtu mjaft të kundërshtuar.

Tonaliteti ishte dhënë qysh me vendimin *Mangold* të 22 Nëntorit 2005¹⁴⁶, që kishte të bënte me liberalizimin e kontratave me kohë të caktuar dhe për më të moshuarit. Gjykata e cila ishte e vendosur të respektonte parimin, shqetësohej nga fakti se afati për implementimin e Direktivës 2000/78/KE nuk kishte përfunduar ende. Duke sjellë si argument faktin se mosmarrëveshja mbulohej nga e drejta komunitare (kontratat me kohë të caktuar rregulloheshin nga Direktiva 1999/70/KE¹⁴⁷), gjyqtarët e Luksemburgut vendosën të inagurojnë zbatimin e parimit të mosdiskriminimit për shkak të moshës, i cili rridhte nga shumë tradita kombëtare, dhe nga disa instrumente ndërkombëtare.

Ky qëndrim i guximshëm dhe jo shumë i kritikuar kishte lënë të mendohej

¹⁴³ GJDK 16 Tetor 2007, *Palacios de la Villa*, çështja C-411/05, Rec. fq. I-8531; Europe 2007, fq. 25, shënime L. Idot; RJS 2008, fq.97, shënime H.Tissandier; JPC 2008, 1152, shënime J.Cavallini; CMLR 2008, fq. 859, shënime L. Waddington.

¹⁴⁴ GJDK 5 Mars 2009, *Age Concern England*, çështja C- 388/07, i pabotuar ende. Europe 2009, nr.190, shënime L. Driguez; RJS 2009, fq. 443, shënime M. Le Barbier- Le Bris.

¹⁴⁵ GJDK 12 Janar 2010, *Petersen*, çështja C-341/08, i pa botuar ende.

¹⁴⁶ I lartpërmendur.

¹⁴⁷ Direktiva 1999/70/KE e Këshillit e 28 qershorit 1999, në lidhje me Marrëveshjen Kuadër CES, UNI CE et CÉP mbi punën me kohë të caktuar, FZ L 175 e 10 Korrikut 1999, fq.43.

se neni 13 i TKE (bërë 19 TFBE) luante në një farë mënyre një efekt direkt, për më tepër horizontal, gjë që ka nxitur disa palë paditëse të mbështesnin padinë e tyre direkt mbi këtë dispozitë. Vendimi Bartsch i 23 shtatorit 2008¹⁴⁸, i dha Gjykatës mundësinë të bënte një sqarim mjaft të nevojshëm, në një rast që lidhej me rregullat e zbatuara nga një skemë pensioni profesional.

Kjo skemë nuk parashikonte dhënien pension paditëses, me arsyen se ajo ishte shumë më e re se bashkëshorti i saj i vdekur (më shumë se 15 vjet diferencë). Gjykata i dha fund këtij konflikti, në të cilin vetë Avokati i Përgjithshëm shërbeu si zëdhënësi i Gjykatës. Ajo kishte nënvizuar që më përpara se neni 13 TKE (bërë 19 TFBE) nuk kishte efekte direkte, për sa kohë ishte vetëm një dispozitë ligjore plotësuese dhe se në vetvete nuk shprehte asnjë të drejtë, së cilës mund t'i referoheshin drejtpërdrejt. Për sa kohë afati për implementimin e Direktivës nuk ka përfunduar, ose kur rasti në shqyrtim nuk lidhet me asnjë tekst tjetër komunitar, është pra e panevojshme t'i referohesh çfarëdolloj parimi të përgjithshëm të së drejtës.

Ky është një arsyetim që Gjykata nuk e ka parë të nevojshëm ta parashikojë shprehimisht. Në fund të konfrontimit mes këtij vendimi dhe vendimit Mangold rezultoi se përfundimi i afatit të implementimit të Direktivës 2000/78/KE do ta shuante këtë polemikë. "Devijimi" i bërë nëpërmjet një parimi të përgjithshëm të së drejtës, kishte bërë të mundur që parimi i mosdiskriminimit të kishte efekt të plotë, në mënyrë tranzitore dhe vetëm për rastet që hynin në fushën e së drejtës së Bashkimit Europian.

Gjykata bëri të triumfante trajtimi i barabartë në vendimin Kucukdeveci¹⁴⁹, ndikimi i të cilit tejkaloi gjerësisht sferën e të drejtave sociale të Bashkimit Europian, sepse përbën një zhvillim të konsiderueshëm të qëndrimit të Gjykatës, për sa i përket efektit direkt të Direktivave. Pas studimit të një dispozite të Kodit Civil Gjerman, e cila përjashtonte marrjen parasysht të periudhave të punësimit para moshës 25 vjeç për llogaritjen e afatit të paralajmërimit për largim nga puna.

Gjykata vendosi se kjo dispozitë përputhej me Direktivën 2000/78/KE. Kjo bënte që pala paditëse të mos mund t'i referohej dispozitës në një mosmarrëveshje horizontale mes punëmarrësit dhe punëdhënësit të tij.

Gjykata e nxitur fort nga Avokati i Përgjithshëm i saj dhe pavarësisht faktit se afati për implementimin e Direktivës kishte përfunduar, risolli në sipërfaqe parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit për arsye moshe, e cila ishte tronditur pas çështjes së bujshme Mangold. Kjo gjë i bëri asaj të mundur të shmangte jurisprudencën e rreptë të këtij vendimi, në lidhje me mungesën e efektit horizontal të Direktivave.

Nga njëra anë, shqetësimi i brendshëm i Gjykatës është lehtësisht i kuptueshëm në lidhje me një direktivë, që nuk bën veçse shtjellon një nga të drejtat themelore, të konfirmuara tashmë si e detyrueshme nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian. Nga ana tjetër, ky fakt juridik e shtyu Gjykatën t'i jap vlerën e një parimi të përgjithshëm të së drejtës pikërisht parimit, i cili sipas Direktivës 2000/78/KE, mund të mos zbatohet lehtësisht për shkak të diskriminimeve direkte. Lind pyetja, a nuk është

148 GIDKE 23 Shtator 2008, Bartsch, çështja C-427/06, Rec. fq. I-7245; JCP S 2008, 1595, fq. 19, shënime J. Cavallini; Europe 2008, fq. 25, Shënime V. Michel; RDUE 2009, fq. 119, shënime S. Thomas.

149 I lartpërmendur

nënvizuar nga vetë Gjykata në vendimin *Age Concern England*¹⁵⁰, veçantia që i është njohur moshës në raport me diskriminimet e tjera (pika 60) të ndaluara nga Direktiva.

Pavarësisht nga përjashtimet pak a shumë të rëndësishme që e drejta e Bashkimit lejon, kjo e drejtë ofron tashmë një arsenal të vërtetë të së drejtës substanciale, e cila u garanton punëmarrësve respektimin e parimit të trajtimit të barabartë, në të gjitha aspektet e aktivitetit të tyre profesional. Duhet të nënvizojmë gjithashtu se ajo përmban rregulla specifike, me natyrë procedurale që synojnë përmirësimin e mbrojtjes së punëmarrësve.

2.7 Garancitë procedurale që u njihen viktimave tëprezumuara të diskriminimeve të ndaluara.

Kjo çështje është e përbashkët për të gjitha aspektet e shqyrtuara, të parimit të trajtimit të barabartë. Si Kapitulli 1 i Titullit III të Direktivës "pëmbledhëse" ashtu edhe Kapitulli II i dy Direktivave 2000/43/KE dhe 2000/78/KE, parashikojnë nën të njëjtin emërtim "E drejta e rekursit dhe zbatimi i të drejtës", dy lloj garancish. Ato kanë të bëjnë, nga njëra anë me ekzistencën e rrugëve të rekursit (A) dhe nga ana tjetër me përcaktimin e rregullave të provueshmërisë (B).

KAPITULLI



3.1 GJINIA DHE SHTETI SOCIAL

3.2 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME MBI BARAZINË GJINORE NË FUSHËN E SIGURIMIT SHOQËROR

3.3 PANORAMË E PËRGJITHSHME MBI TRAJTIMIN E PARIMIT TË BARAZISË GJINORE NGA LEGJISTLACIONI I BASHKIMIT EUROPIAN

KAPITULLI III

3.1 Gjinia dhe Shteti Social

Pse është gjinia relevante në shtetin social ?

Shumica e studimeve të shtetit social diskutuar në kapitujt e mëparshëm, nuk kishin përvijuar asnjë referencë të veçantë për gjininë dhe duket se ishte supozuar se çështjet gjinore nuk ishin të rëndësishme për mënyrën në të cilën shteti social është zhvilluar. Ndoshta ka shumë të ngjarë që ndarja gjinore sociale është marrë e mirëqënë nga këta autorë. Shumë prej skemave kryesore të mbuluara nga këto studime, të tilla si sigurimet e sëmundjes apo sigurimi i papunësisë, kanë qenë të zbatueshme kryesisht për punëtorët meshkuj. Por, në praktikë, gratë kanë përbërë një pjesë të konsiderueshme në marrjen e përfitimeve sociale, përfitime veçanërisht të testuara, gjatë shekujve.

Kështu është e qartë se për një periudhë shumë të gjatë, gratë kanë përbërë shumicën në marrjen e përfitimeve të caktuara sociale. Jo vetëm kaq, por gratë që kanë marrë përfitime sociale ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme në varësi të llojit të skemës. Për shembull, gratë ka shumë të ngjarë të kenë marrë përfitime të testuara mesatare se sa përfitime të sigurimeve shoqërore, për shkak të pjesëmarrjes së tyre më të paktë në fuqinë punëtore të siguruar. Kështu Skema si ato të sigurimeve të sëmundjeve dhe papunësisë, prirën të jenë me një relevancë më të madhe për burrat. Në anën tjetër, skema të tilla si përfitimet e lindjes ishin të rëndësishme vetëm për gratë. Sa i përket kësaj, është e nevojshme të merren në konsideratë çështjet e përkatësisë gjinore në zhvillimin e shteteve sociale.

Në Strasburg 1523, 69 % e të rriturve që merrnin ndihma për të vobektët ishin gra. Në Toledo 1573, 63 % e atyre që merrnin ndihmat për të vobektët ishin gra. Në 1760 gratë përbënin rreth 70 % të të gjithë përfituesve të ndihmës sociale në Angli.

Në Irlandë në vitin 1960, 72 % e të rriturve qëpërfitonin nga skema e asistencës në shtëpi, ishin gra. Në fillim të shekullit XX, në Mbretërinë e Bashkuar, 61 % e të rriturve që përfitonin nga të gjitha format e ndihmave për të varfërit ishin gra dhe në vitin 1980, 60% e të rriturve të cilët merrnin përfitime suplementare ishin gra.

Siç është analizuar në mënyrë të detajuar në vijim, agjencia është një arsye më shumë për të pasur parasysh çështjet gjinore. Një numër autorësh kanë argumentuar se agjencia e grave ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aspekteve të shtetit social, përmes kontributit të organizatave të grave apo grave administrative dhe politikëbërëse.

Së fundi, është e rëndësishme që të merret në konsideratë roli i gjinisë për shkak të ndikimit që ka pasur në strukturën e sistemeve sociale. Për të marrë vetëm një shembull të rëndësishëm, shumë sisteme sociale, që kanë reflektuar strukturën e supozuar të familjeve, kanë ndërtuar një model të shtyllës së familjes mashkullore.¹⁵¹ Në përcaktimin e sistemeve sociale, ishte supozuar se shtylla kryesore në familje ishte burri dhe se gruaja nuk punonte jashtë shtëpisë, ose punonte vetëm në një masë të kufizuar. Për këtë arsye, sistemet e përfitimit janë projektuar për të

151 Shih Kutinë 4, 2 për një diskutim të këtij lloji të supozimit në raport Beveridge.

përforcuar këtë strukturë me pagesat që bëhen për shtyllën e familjes patriarkale me shtesa "varësie" për gruan dhe fëmijët e saj. Vetëm gjatë kohëve të fundit diskriminimi ndaj një gjinie, në aspektin e qasjes në ndihmën sociale është bërë i paligjshëm dhe kjo ende nuk zbatohet për të gjitha fushat e politikave të mirëqenies.

Kur "shteti social" ishte ende duke u konceptuar dhe duke u krijuar, qëllimi i tij ishte "të mbronte shtetasit nga varfëria përmes strehës që ofronte familja", përmes garantimit të të drejtave dhe zotërimeve që buronin nga puna e paguar. Gratë e angazhuara në punë të papaguara si detyra familjare, ishin përfshirë në një tjetër "tip" punësimi. Puna e tyre edhe pse konsiderohej e rëndësishme për realizimin e "idealeve britanike", mbetej megjithatë e parregulluar dhe e papaguar. Individët gra të përfshira në këtë lloj "punësimi" mbeteshin të varfra dhe të padukshme.

Supozimi i Beveridge-it se të punësuarit me kohë të plotë ishin vetëm meshkuj, bënte të qartë faktin se parakushti për t'u konsideruar qytetar me të drejta të plota, ishte të qenit burrë. Ideja kryesore e Raportit Beveridge ishte të garantohej sigurimi i plotë shoqëror i burrave dhe kërkonte përqëndrimin e politikave sociale rreth burrit. Me martesën, gruaja përfshihej në një kategori të re personash, për qëllime të sigurimit social. Pateman lidhur me këtë, është shprehur se "kriteri kryesor për qytetari lidhet me fitimin e elementeve përbërëse të saj, që janë aftësitë dhe karakteristikat mashkullore."¹⁵² Për më tepër në mendësinë e asaj periudhe "qytetarë" ishin vetëm ata që kishin përgjegjësi të caktuara, siç janë familja, bashkëshorti dhe fëmijët për të cilët kujdesen.

Për më tepër qytetari klasik, ishte ai që ishte martuar me një grua, të cilën nuk e kishte përfshirë në punë të paguar jashtë shtëpisë. Në këtë mënyrë "mbajtësi i familjes" mund të kërkonte një punë me kohë të plotë, pa u shqetësuar për mirërritjen e fëmijëve apo mbajtjen e shtëpisë. Po ashtu nëse burri prekej nga sëmundja, papunësia apo rreziqe të ngjashme sociale, atëhere ai ishte i garantuar nga kontributet e derdhura gjatë qenies në punë. Të gjitha këto i dhanë shtysë të fortë mendësisë sipas të cilit punëmarrësi është gjithmonë një burrë, i përfshirë në një ekonomi të gjallë e në veprim, i punësuar në një punë me orar të plotë e për pasojë i aftë për të paguar kontribute të plota. Mendësi të tilla si më sipër, legjitimuan seksizmin në limitet e veta.

Shteti i mirëqenies sociale ishte ndërtuar mbi bazën e premisë së qëndrueshmërisë së martesës mes gruas dhe burrit. Për më tepër, ishte supozuar se lindja e një fëmije nga martesë, sillte shkëputjen përfundimtare të gruas nga tregu i punës, duke e angazhuar me rritjen e fëmijëve. Brenda kupolës familjare gratë duhet të garantonin gjithë kujdesin e nevojshëm. Ideja se puna e gruas ishte një punë e papaguar, ishte e nënkuptar.

Nevojat sociale dhe financiare të gruas së martuar ishte supozuar të mbulohehin nga kontributet e bashkëshortit. Sigurimi i tyre shoqëror do të vinte përmes martesës dhe varej tërësisht nga shuma e kontributeve të bashkëshortit, pra edhe nga shuma e pagës së tij. Gratë edhe pse madhore, me kapacitete të plota fizike dhe të afta për të rritur e mirërritur gjeneratat e reja, ishin në të njëjtën kohë të paafta për të siguruar në mënyrë të pavarur të ardhurat e tyre. Pra Beveridge sigurimin shoqëror

¹⁵² "The sexual contract" Pateman, Carole (1988:22).

të femrave e lidhte drejtëpërdrejtë me statusin e tyre martesor.

Gratë shtëpiake nuk mund të trajtoheshin si “të pavarura”, por si partnere në ndarjen e përfitimeve nga kontributi shoqëror. Për më tepër, për sa kohë nuk kishte asnjë ndërhyrje shtetërore për të garantuar aksesin dhe pavarësinë e femrave në këto lloj përfitimesh, pabarazia e grave brenda shtëpisë ishte pasqyrë e statusit të saj social. Beveridge i shihte gratë si një akt vital për mirëfunksionimin e shtetit, vetëm në sajë të rolit të tyre si bashkëshorte dhe nëna, por jo si qytetare ekonomikisht të pavarura. Roli i tyre pra përqëndrohej vetëm në lindjen e fëmijëve, në shërbim të zhvillimit të kapitalizmit. Martesa po ashtu ishte burimi primar i sigurisë dhe shteti luante një rol mbështetës në këtë drejtim.

Ndryshimet sociale në vitet që pasuan Raportin Beveridge ushtruan presion në shtetin e mirëqenies sociale. Rritja e numrit të divorceve, një popullsi drejt plakjes e cila kërkonte rritjen e shpenzimeve shtetërore për pensione, rritja e numrit të grave me fëmijë por pa bashkëshort, të gjitha të mësipërmet ishin në funksion të reflektimit tashmë, të idesë se gratë duhet të përbëjnë mazhorancën e përfituesve të garancive të shtetit social. Familjet të cilat pas divorcit kryesoheshin nga gratë, ishin diçka që Beveridge nuk e kishte parashikuar në raportin e tij. Pateman për këtë, është shprehur se “femrat janë më të prirura se meshkujt për t’u varfëruar pas divorcit....standardi i jetesës së femrave pas divorcit mund të ulet rreth 75 %, ndërsa i meshkujve rreth 50 %.”¹⁵³

Ky efekt mund të shihet si pasojë e drejtpërdrejt e politikave sociale të ndjekura deri në këtë kohë. Esping Anderson vlerëson se: “nevoja për ndryshime radikale të politikave familjare jo vetëm që ndihmon për të reduktuar varësinë ekonomike të femrës, por po ashtu bën të mundur realizimin e kombinimit mes fertilitetit të lartë dhe karrierës femërore.”¹⁵⁴

Duke pasur parasysh rëndësinë e Raportit Beveridge në bërjen e politikës në Britaninë e Madhe, shumë sociologë dhe analizues të politikave sociale, kryesisht nga një background socialist/feminist, kanë zhvilluar një numër kritikash ndaj raportit. Këto opinione janë kritikuar nga ana tjetër nga Blackburn.¹⁵⁵ Autorët feministë, sipas Blackburn, kanë argumentuar se Beveridge e ka reduktuar raportin e tij, duke marrë në konsideratë vetëm gratë e martuara me qytetarë të klasit të dytë, për sa i përket sigurimeve shoqërore. Kjo është bërë në tri mënyra.

Së pari, Beveridge propozoi se gratë e martuara me punësim të siguruar do të paguanin kontributet kombëtare të sigurimit të reduktuara dhe do të kualifikoheshin për përfitime më të ulëta. Beveridge ka argumentuar për këtë qasje se një burrë, ndryshe nga një grua e martuar, ka derdhur kontribute në emër të tij dhe gruas së tij. Kjo sipas tij, pa dyshim plotëson pabarazinë gjinore.

Së dyti, Beveridge propozoi që femrat e martuara duhet të kenë të drejtë të zgjedhin nga pagesa e kontributeve të sigurimit kombëtar, nëse ato e zgjedhin atë. Kjo rezultoi në vetëm një pakicë të grave të martuara, duke u bërë plotësisht të siguruara dhe është argumentuar që kjo ndihmon për të përforcuar varësinë e tyre financiare brenda martesës.

¹⁵³ “The sexual contract” Pateman, Carole (1988 :33).

¹⁵⁴ “The three worlds of Welfarecapitalism”, Esping- Anderson, (1990:237).

¹⁵⁵ “Think: A Compelling Introduction to Philosophy”, Simon Blackburn, 1999.

Së treti, autorët feministë e kanë kritikuar Beveridge-in për supozimin e tij se shumica e grave të martuara do të lënë punën e paguar dhe do të mbështeten nga shtylla e familjes patriarkale. Beveridge-i propozoi që me lënien e punësimit të siguar, gra të tilla të kishin të drejtën për një grant martesë, në këmbim të të cilit ato do të humbisnin të drejtat e tyre për përfitime, bazuar mbi kontributet e tyre të mëparshme të Sigurimeve. Beveridge-i kishte marrë parasysh, duke u mbështetur në të dhënat e para-luftës, që 88 % e grave të martuara do të ishin ekonomikisht të varura nga burri i tyre.

Blackburn thekson se kjo linjë e kritikës ka qenë pa dyshim me vlera të mëdha, por argumenton se ajo është vetë e hapur për disa kritika.

Së pari, ajo thekson se: *"kritika nuk merr seriozisht fitimet reale që shteti social i jepte grave duke përmendur, për shembull, përmirësimin e kujdesit shëndetësor, shtesat e qumështit dhe ushqimeve, ndihmat familjare që i paguheshin nënës dhe një minimum i garantuar i jetesës. Shërbimet e zgjeruara sociale gjithashtu kanë ofruar rritjen e mundësive të punës për gratë."*

Së dyti, Blackburn thekson se raporti Beveridge u pranua gjerësisht, sepse ai ishte i njohur si për burrat dhe për gratë. Ajo vuri në dukje se raporti ishte gjerësisht i pranueshëm për sindikatat e u miratua fuqimisht dhe nga intelektualët kryesorë të krahut të majtë dhe grupet zgjedhore të partisë Liberale dhe të Punës. Mbështetja për familjen me shtyllë familjare burrin nuk ishte e veçantë për Britaninë e asaj kohe, por ishte edhe ideologji mbizotëruese në një numër të vendeve të tjera duke përfshirë Norvegjinë, Gjermaninë dhe Holandën. Në të vërtetë, siç pohon Harris (1977), *"pikëpamjet e Beveridge-it ishin në përputhje me ato të shumicës së lëvizjes së grave, në Britani në vitet 1930 dhe 40."*¹⁵⁶ Në fakt, shumica e grave votuese në 1945 votuan për Punën. Harris argumenton se ajo është sipërfaqësore dhe disi patronizuese për të qortuar Beveridge-n për dështimin, për të miratuar pikëpamjet e një gjysmë shekulli më vonë.

Së treti, Blackburn argumenton se disa nga kritikët e Beveridge-it duhet të përshkruhen më drejtësisht në Treasury, opozita e të cilit do të thotë për shembull, se niveli i propozuar i fondeve familjare është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme. Blackburn argumenton se: *"parimi i Sigurimeve të Beveridge-it ishte i mbushur me probleme si për burrat dhe për gratë dhe se për këtë arsye një analizë e ndjeshmëgjimore nuk mund të përqendrohet ekskluzivisht te gratë."*¹⁵⁷

Ajo vë në dukje se jo vetëm gratë e varura, por një gamë e gjerë e grupeve të tjera, përfshirë të papunët afatgjatë, të sëmurët kronikë dhe të rinjtë, ishin të detyruar të mbështeteshin te përfitimet e testuara mesatare.

Së katërti, Blackburn argumenton se kritikët socialiste/ feministe nuk arrijnë të vlerësojnë kompleksitetin e procesit të politikave sociale. Ajo vë në dukje se zhvillimi i politikës sociale është shpesh rezultat i grupeve konkurruese të interesit, duke çuar në mënyrë të pashmangshme në kompromise të mundimshme. Kështu ajo argumenton se *"nuk është e mundur të interpretohet shteti social thjesht si një rezultat i dëshirës së Beveridge-it për të kontrolluar gratë."*¹⁵⁸

¹⁵⁶ "Human Nature and the Evolution of Society" Jeffrey Harris, 1977.

¹⁵⁷ "Think: A Compelling Introduction to Philosophy", Simon Blackburn, (1999:387).

¹⁵⁸ "Think: A Compelling Introduction to Philosophy", Simon Blackburn, (1999:379).

Në përfundim, Blackburn argumenton se socialistët/ feministet janë të saktë kur argumentojnë se gratë janë trajtuar në mënyrë të padrejtë nga shteti social. Megjithatë, ajo argumenton se është gjithashtu thelbësor për t'u marrë parasysh, fakti se ka pasur disa përfitime reale për gratë dhe se *"gratë ishin gjithashtu aktive në formimin e shtetit social, dhe kanë mbështetur angazhimin e qeverisë për të zbatuar raportin Beveridge."*¹⁵⁹

3.1 / 1 Tezat mbi Gjininë Dhe Shtetin Social

Shteti social ruan kushtet sociale të riprodhimit

Kjo qasje miraton një perspektivë strukturaliste ose funksionaliste. Megjithatë, edhe pse ato vijnë përgjithësisht nga një background feminist socialist, autorët duke përshtatur këtë perspektivë, e shohin shtetin social si të formësuar nga të dy palët: kapitalizmi dhe patriarkati. McIntosh, për shembull, argumenton se: *"shteti luan një rol në shtypjen e grave përmes mbështetjes së tij për një formë të veçantë të familjes: familje e varur kryesisht mbi një pagë të mashkullit dhe nga shërbimet e brendshme të femrës."*¹⁶⁰ McIntosh e sheh këtë sistem të familjes si të lidhur me prodhimin kapitalist i cili, megjithëse jo siç duhet, shërben për riprodhimin e klasës punëtore dhe për mirëmbajtjen e grave si një ushtri rezervë e punës. McIntosh krijon një pikë të rëndësishme në vlerësimin e lidhjes ndërmjet shtetit social dhe çështjeve gjinore, kur shprehet se: *"në strukturën e përfitimeve, duhet të shohim rolin që femrat luajnë në ekonominë si një e tërë, dhe në modelet e marrëdhënieve shoqërore që ato kanë vendosur dhe mbështesin"*¹⁶¹. (1978: 257). McIntosh kërkon të analizojë rolin që luan shteti në krijimin dhe mbështetjen e sistemeve, në të cilat gratë janë të shtypura dhe në varësi të burrave.

Ajo identifikon dy sistemet kyçe, ato të familjes së ngushtë dhe pagave të punës. Duke ilustruar veçanërisht përvojën britanike, McIntosh përshkruan një ndër mënyrat përmes të cilave shteti luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e familjes. Këto përfshijnë supozimin se gratë e martuara do të jenë financiarisht të varura nga burrat e tyre dhe (atëherë) pamundësinë e grave për shumë përfitime të sigurimeve shoqërore. Në anën tjetër, përfitimet mbështetëse si pensioni i gruas së ve, e bën më pak të nevojshme për gratë që të angazhohen në fuqinë punëtore të paguar. Kështu McIntosh argumenton se: *"familja nuk është thjesht shprehje sociale e një instinkti por është e strukturuar dhe e kufizuar nga politikat shtetërore sociale"*¹⁶².

Në një formë më të nuancuar të kësaj teze, Siim argumenton se ka pasur dy aspekte kontradiktore të zhvillimit të shtetit social, shtypës dhe mbështetës: *"Nga njëra anë shteti social është në mbështetje të grave dhe ka ndihmuar për të ulur varësinë personale të grave në lidhje me burra si nëna dhe punëtore. Nga ana tjetër shteti social ka qenë edhe shtypës ndaj grave, i ka trajtuar gratë sipas një lloji të ri të hierarkisë së centralizuar të fuqisë dhe ka shpërfllur interesat kolektive të grave ose interesat e grave të realizuara, nën racionalitetin dominues të shtetit"*¹⁶³. Në veçanti, ajo thekson shkallën në të cilën sistemet sociale janë të strukturuar, duke ndryshuar në bazë të ndarjes gjinore.

159 "Think: A Compelling Introduction to Philosophy", Simon Blackburn, (1999:382).

160 "The Handbook of Political Sociology: States, Civil Societies, and Globalization", Mary McIntosh, (1978: 255).

161 "The Handbook of Political Sociology: States, Civil Societies, and Globalization" Mary McIntosh, (1978: 257).

162 "The Handbook of Political Sociology: States, Civil Societies, and Globalization", Mary McIntosh, (1978: 259).

163 "How WelfareStates Care: Culture, Gender and Parenting in Europe", Siim Sellis, (1987: 265).

Duhet të mbahet mend se deri në vitet 1970 dhe 1980 shumë sisteme sociale europiane përmbanin dispozita që ishin drejtpërdrejt diskriminuese kundër grave (në veçanti femrave të martuara), dhe se në disa raste këto ishin hequr vetëm për shkak të legjislacionit të BE-së dhe si rezultat i një numri sfidash ligjore. Megjithatë, kjo lloj analize vepron në një nivel të lartë përgjithësimi dhe nuk përqipet të llogarisë dallimet ndërmjet vendeve. Ajo gjithashtu abstragon nga pyetja nëse është e mundur për organizatat e grave apo sindikatat të përmirësojnë dispozitat në favor të grave.

A. Agjensia e grave ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e Shtetit Social

Lloji i dytë i madh i analizës së zhvillimit të shteteve sociale, ka theksuar rolin historik të agjencisë së grave në formësimin e aspekteve të shteteve sociale europiane. Bock dhe Thane¹⁶⁴ kanë analizuar ndikimin e lëvizjeve të grave në shfaqjen e shteteve sociale të Europës nga vitet 1880 deri në vitin 1950. Ata studiovan veçanërisht tri grupe të mëdha të femrave *"historia e të cilave është formësuar nga shfaqja e veprimeve sociale shtetërore"*¹⁶⁵ gratë dhe në veçanti nënat, që jetojnë në varfëri; Lëvizjet e grave; dhe gratë që administrovan dispozitat sociale dhe politikat.

Bock dhe Thane (1991) kritikojnë qasjet e zakonshme, të cilat nuk vënë në dukje lidhjen "negative" direkte apo të tërthortë, që ekziston mes skemave sociale dhe grave. Ato argumentojnë se ndikimi i tërthortë ishte *"për të përforcuar varësinë e grave mbi burrat që kanë përfituar nga masat sociale, dhe kështu edhe për të përforcuar hendekun gjinor në aspektin e të ardhurave dhe varfërisë (relative)"*¹⁶⁶ Megjithatë, këto studiuese theksojnë se *"disa dispozita sociale, synonin drejtpërdrejt gratë dhe kontribuonin në lehtësimin e disa aspekteve të mjerimit të femrave dhe varfërisë, veçanërisht ato të lidhura me amësinë."* Ato theksojnë faktin se lëvizjet e grave, të cilat ishin aktive në të gjithë Evropën në mesin e shekullit XIX. *"ndihmuan ose ndikuan për të sjellë futjen e përfitimeve të lindjes, shtesat e familjes dhe amësisë dhe zhvillimin e politikave familjare."*¹⁶⁷

Në mënyrë të ngjashme, Koven dhe Michel¹⁶⁸ nxorren në pah faktin se *"hartimi i programeve shtetërore dhe politikave me natyrë sociale, në shkallë të gjerë, përkonin me rritjen e lëvizjeve sociale të grave në Francë, Gjermani, Britaninë e Madhe, dhe Shtetet e Bashkuara në fund të viteve të shekullit XIX dhe në fillim të XX."*¹⁶⁹

Në studimin e tyre mbi politikat maternaliste dhe origjinën e shteteve sociale në Francë, Gjermani, Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara në periudhën 1880- 1920, Koven dhe Michel pohojnë se *"përpyekjet e grave për reforma dhe shtete sociale jo vetëm kanë përkuar në kohë, vend dhe nganjëherë në personel, por edhe kanë përforcuar dhe transformuar njëri-tjetrin në mënyra të rëndësishme dhe të qëndrueshme"*¹⁷⁰ Ato argumentojnë

164 "Maternity and Gender Policies: Women and the Rise of the European Welfare." Gisela Bock dhe Pat Thane, 1991.

165 "Maternity and Gender Policies: Women and the Rise of the European Welfare. Gisela Bock dhe Pat Thane, (1991: 1).

166 "Maternity and Gender Policies: Women and the Rise of the European Welfare." Gisela Bock dhe Pat Thane, (1991:4).

167 "Maternity and Gender Policies: Women and the Rise of the European Welfare." Gisela Bock dhe Pat Thane, (1991:6).

168 "Mothers of a New World: Maternalist Politics and the Origins of WelfareStates", Seth Koven dhe Sonya Michel, 1993.

169 Ibid, fq.1076.

170 Ibid, fq. 1076.

se gratë në secilin nga katër vendet e mësipërme kanë pasur sukses, në shkallë të ndryshme, në formësimin e të paktën një seksioni të politikës shtetërore, që është, ajo në lidhje me mirëqenien e nënës dhe fëmijës.

Studiueset në fjalë theksojnë tre faktorë të rëndësishëm që ndihmuan për t'i dhënë formë politikës në këto fusha:

Së pari: zgjerimi konsekuent i punësimit të grave në fusha të tilla si punë sociale, vizitat shëndetësore dhe infermierinë e qarkut;

Së dyti: ligjëratat e mëmësisë të cilat, argumentojnë ato, *"lartësuan virtytet e jetës familjare, ndërsa në të njëjtën kohë legjitimuan përfshirjen e grave në politikë dhe në shtet, në komunitet, në vendet e punës dhe tregut"*¹⁷¹;

Së treti: zhvillimi i politikave për të përmbushur nevojat e nënave dhe fëmijëve nëpërmjet një game të gjerë të organizatave bamirëse.

Ironikisht, megjithatë, ata argumentojnë se *"fuqia e lëvizjeve të grave në kuadër të veprimit social, ishte e lidhur anasjelltas me një seri përfitimesh të mirëqenies sociale për gratë dhe fëmijët"*¹⁷². Ata e argumentojnë këtë me faktin se *"shtetet e forta, që janë ato me një burokraci të zhvilluar mirë dhe një traditë të gjatë të ndërhyrjes së qeverisë, u lejuan grave më pak hapësirë politike, për të zhvilluar programe të mirëqenies sociale siç bënin shtetet e dobëta, ku shoqatat e grave vullnetare lulëzuan"*¹⁷³.

Ata argumentojnë se Gjermania, e cila kishte një shtet të fortë, kishte një lëvizjetë grave e cila ishte politikisht e paefektshme, por zhvilloi programe më gjithëpërfshirëse për gratë dhe fëmijët. Në kontrast, Shtetet e Bashkuara, me lëvizje të fortë të reformave të femrave dhe shtet më të dobët, prodhoi përfitime më pak bujare për gratë. Boek dhe Thane nxjerrin në pah faktin se rënia e numrit të lindjeve ishte një shqetësim i madh në të gjithë Evropën në këtë periudhë dhe se kjo çoi në politika pronataliste. Në lidhje me futjen e fondeve familjare, ata theksojnë se *"gratë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përfshirjen e fondeve familjare në axhendën politike, por i mungonte fuqia për të sjellë realizimin e tyre edhe pse, ata argumentojnë se në demokracitë liberale gratë ishin në gjendje të fitonin ndikim mbi trajtën përfundimtare që do të merrte legjislacioni mbi fondet familjare"*¹⁷⁴.

Koven dhe Michel në mënyrë të ngjashme theksuan që organizatat e grave "me shumë gjasa e rritën ndikueshmërinë e tyre në periudhën kur formësimi i legjislacionit ndikohej nga aktorët meshkuj të politikës, që ndjekin qëllime të tjera."¹⁷⁵ Ata theksojnë se: *"Çështjet lidhur me popullsinë dhe efikasitetin ishin shumë të rëndësishme në dekadat e para Luftës së Parë Botërore dhe se këto, dhe pastaj vetë Lufta, nxiti ligjvënësit për të krijuar shumë programe që mund të mos merrnin mbështetjen e Shtetit në kushte të tjera."*¹⁷⁶

Megjithatë, ata kanë zbuluar se programet ia dedikojnë ekzistencën e tyre modeleve, organizatës dhe energjive të prodhuara nga aktivistet femra. Në bilanc, Koven dhe Michel argumentojnë se *"gratë në të gjitha këto katër*

171 Ibid, fq. 1078.

172 Ibid, fq. 1079.

173 Ibid, fq. 1079-1080.

174 Ibid, fq. 13.

175 "Mothers of a New World: Maternalist Politics and the Origins of Welfare States", Seth Koven dhe Sonya Michel, (1993:1080).

176 Ibid, fq. 1080.

vende kanë kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e programeve të mirëqenies private, vullnetare, të nënës dhe fëmijës, disa prej të cilave kanë shërbyer si modele për programet shtetërore.¹⁷⁷” Megjithatë, ata gjejnë se “në të katër vendet, gratë shpesh kanë humbur kontrollin në diskutet maternaliste, kur ato kanë debatuar në legjislatura të dominuara nga meshkujt.¹⁷⁸”

B. Demokracia sociale ka zhvilluar më shumë politikat sociale gjinore.

Si pjesë e zbatimit të përgjithshëm të argumentit social demokratik, për zhvillimin e shtetit social, autorët kanë argumentuar se shtetet e demokracisë sociale kanë qenë të prirura për të zhvilluar politika të cilat ishin më miqësore rreth elementit gjinor. Angazhimi në nivele të larta, veçanërisht në vendet nordike, i punësimit dhe i shërbimeve publike, ka tentuar të rrisë punësimin e femrave (veçanërisht në shërbimet publike sociale) dhe ka ndikuar në hartimin e politikave të cilat mbështesin punësimin e femrave. Të dy faktorët, politikat e punësimit dhe politikat pro - gjinore, kanë qenë të prirura për të përforcuar njëra-tjetrën.¹⁷⁹

Në të kundërt, shtetet sociale demokratike të krishtera (ose të krishtera-centriste) kanë qenë të prirura për të miratuar politikat e punës dhe të mirëqenies, që janë të fokusuar në një model mashkullor - shtyllë të familjes dhe të cilat shkurajojnë (ose të paktën nuk e nxisin) punësimin e femrës (apo të nënës). Shtetet sociale të krishtera-centriste të tilla si Gjermania, kanë tendencë për të siguruar nivele shumë më të ulëta të mbështetjes publike për politika të tilla, si ato për kujdesin ndaj fëmijëve dhe kujdesi ndaj të moshuarve. Në përgjithësi, tendenca në shtete të tilla sociale, është më tepër për përfitime në të holla, me shpenzimet për shërbimet sociale të cilat janë shumë më të ulëta sesa në shumicën e vendeve nordike.

Shumica e shteteve të krishtera-centriste gjithashtu kanë nivele të ulëta të punësimit të femrave dhe të nënës. Shtetet sociale jugore gjithashtu kanë prirje të kenë nivele të ulëta të shërbimeve të punësimit, dhe nivele të ulëta të shërbimeve të kujdesit publik. Në përgjithësi, një studim i detajuar i shteteve sociale e mbështet këtë tezë, edhe pse ka disa anomali të tilla si Franca, e cila duke qenë se demokracia sociale ka luajtur historikisht një rol shumë të kufizuar në zhvillimin e shtetit social - ka zhvilluar nivele të larta të mbështetjes së arsimit dhe ka arritur nivele relativisht të larta të punësimit të femrave.

C. Shekullarizimi i jetës politike çon në politikat shoqërore gjinore

Duke u ndalur në veçanti në rastin e Francës, Morgan(2003) ka argumentuar se *“laicizmi i jetës politike në Francë, dobësia e demokracisë së krishtere si forcë politike dhe varësia e sektorit vullnetar ndaj shtetit, janë ato që e kanë diferencuar politikën franceze nga ajo e shteteve të tjera centriste-sociale¹⁸⁰”*. Megjithatë, në vend që të kontribuojë drejtpërdrejt në politikat pro-gjinore, Morgan pohon se *“krijimi i një sistemi të mirëorganizuar kujdesi për fëmijët dhe sistemi i arsimit që ka ndihmuar punësimin e grave, kanë qenë pasoja indirekte të cilat ka ardhur nga përmbushja e objektivave të tjera qeveritare¹⁸¹”*.

177 Ibid, fq.1100.

178 Ibid, fq.1106.

179 “Development and crisis of the Welfare state: Parties and policies in global markets” Evelyne Huber, John. D. Stephens, 2001.

180 “European WelfareStates: Comparative Perspectives”, Kimberly J. Morgan, 2003.

181 Ibid, fq. 261.

Kjo ka çuar në një situatë ku *"politikat për të mbështetur punësimin e nënave ka qenë e prekshme nga makinacionet e elitave politike, prioriteti i të cilave ka qenë zhvillimi ekonomik dhe fiskal, duke anashkaluar realizimin e politikave feministe"*.¹⁸² Argumenti i Morgan është një shpjegim bindës për anomali të dukshme të politikës franceze. Shkalla e madhe e shekullarizimit dhe mungesa afatgjatë e ndonjë partie kristian-demokrate në qeveri, mund të shpjegojnë dallimin ndërmjet strukturës së sistemit francez dhe atij gjerman.

Megjithatë, Morgan sugjeron se teza e shekullarizimit ka implikime më të gjera, me një dobësi të demokracisë së krishterë dhe rol relativisht të vogël të sektorit vullnetar, elemente këto që diferencojnë rastet e Skandinavisë dhe Francës. Kështu ajo argumenton se laicizmi ka qenë gjithashtu i rëndësishëm në Skandinavi dhe se zhvillimi i politikave të favorshme gjinore nuk mund t'i atribuohet vetëm demokracisë sociale.

Në këtë drejtim, ajo tregon shembullin e Norvegjisë, *"e cila është më pak e shekullarizuar se fqinjët e saj, duke patur partinë më të madhe dhe më të suksesshme kristian-demokrate në rajon. Norvegjia ka një sektor më të zhvilluar vullnetar dhe është parë gjithashtu si implementuese e politikave disi më pak gjinore, në krahasim me Suedinë më të shekullarizuar"*.¹⁸³

3.1 / 2 Tezat aktuale lidhur me gjininë dhe shtetin social

Ka ndoshta tri zgjatime kryesore të teorisë së shtetit social, në të cilat ndikimi i gjinisë ka qenë i konsiderueshëm. I pari, kërkon që të përfshijë çështjet gjinore në mendësinë e përditshme.

I dyti kërkon të zhvillojë tipologjinë gjinore të regjimeve sociale. I treti dhe ndoshta më i rëndësishmi, kërkon të zhvillojë kritere me anë të të cilave ne mund të analizojmë shtete sociale nga një perspektivë gjinore.

3.1 / 3 Teoritë gjinore dhe ato të zakonshme

Edhe pse teoritë kryesore të shtetit social janë kritikuar rëndë për shpërfillje gjinore dhe pavarësisht nga fakti se këto kritika janë të vlefshme, përpjekja për të përfshirë çështjet gjinore në ndërtimin e teorisë të reja të shtetit social, ka qenë shumë e kufizuar.

Walter Korpi¹⁸⁴ ofron një përjashtim të rëndësishëm për këtë dhe kërkon të kombinojë gjininë dhe klasën shoqërore, në një analizë të modeleve të pabarazisë, në llojet e ndryshme të shteteve sociale, në 18 vende.

Huber dhe Stephens (2001) kanë kërkuar po ashtu të integrojnë aspektet e gjinisë në analizat e tyre të shteteve sociale. Ata analizojnë ndikimin që ka pasur punësimi i femrave, duke argumentuar se ai ka qenë *"një përcaktues i rëndësishëm i zgjerimit të shërbimeve publike, të mirëqenies sociale neto dhe të faktorëve të tjerë socialë, politikë dhe historikë"*.¹⁸⁵ Ata argumentojnë se pjesëmarrja në rritje e fuqisë punëtore të grave, krijon një dinamikë në të cilën ushqehen kërkesat për shërbime sociale, të cilat u mundësuan grave të hyjnë në tregun e punës dhe të sigurojnë punësim. Nga ana tjetër, kjo mund të çojë në rritjen e mbështetjes ndërmjet grave për mirëmbajtjen

182 Ibid, 289.

183 "Gender and the Social Democratic Welfare Regime", Kerstin Sorensen, Christina Bergqvist, 2002.

184 "Class and gender inequalities in different types of Welfare states: the Social Citizenship Indicator Program (SCIP)", Walter Korpi, 2000.

185 "Development and crisis of the Welfare state: Parties and policies in global markets.", Evelyn Huber, John D. Stephens, 2001.

dhe zgjerimin e shërbimeve të shtetit social . Këto shembuj janë, për fat të keq, përjashtime më shumë se sa rregulla.

Një element tjetër i dytë (në terma të paktën sasiore) në teorinë e shtetit social, është ai që kërkon të zhvillojë tipologjitë gjinore të shtetit social. Siç është cituar edhe më lart, zona e tipologjive të shtetit social ka qenë një industri në rritje. Megjithatë, një përqindje shumë e konsiderueshme e numrit mjaft të kufizuar të studimeve mbi gjininë dhe shtetin social janë, për arsye disi të paqarta, të përqëndruara në këtë fushë. Një konkluzion shumë i rëndësishëm, i cili është diskutuar më poshtë, ka dalë nga këto studime.

Shumë prej këtyre studimeve, nxjerrin në pah ose kritikojnë "*Tri botët e kapitalizmit Social*" të Esping-Anderson-it. Por duhet të mbahet mend se studimi i Esping-Anderson-it nuk ishte i fokusuar në analizën e politikave shtetërore të mirëqenies. Përkundrazi, shpjegimi i Esping Anderson-it është bazuar në një informacion teorik, dhe politik që çon te të kuptuarit e faktorëve, që kanë ndikuar në zhvillimin e tri regjimeve krejt të ndryshme të mirëqenies.

Për të realizuar studimin e tyre, Esping e Anderson përdorën instrumenta të tilla si "*decomodification*" apo e thënë shqip "*analiza e forcës së të drejtave sociale dhe varësinë e tyre ndaj tregut.*" Ky instrument dhe të tjerë, i ndihmuan ata në identifikimin e ndryshimeve empirike ndërmjet regjimeve të shtetit social. Studimi i tyre megjithatë iu nënshtrua një sërë kritikave, kryesisht të fokusuar në faktin se instrumenti i *decomodification-it* është i papërshtatshëm për analiza që kanë në fokus gjininë.

3.1 / 4 Analiza e mirëqenies nga një perspektivë gjinore

Një nga qëllimet themelore të studimeve mbi regjimet e shtetit social ka qenë kuptimi i asaj se si mund të analizohen shtetet sociale nga një perspektivë gjinore. Siç e kemi parë, "*strukturalizmi ka të bëjë thjesht me supozimet se shteti social vepron për të ruajtur kushtet sociale të riprodhimit.*"¹⁸⁶ Është supozuar se shteti social ka vepruar në dëm të grave dhe nuk është kërkuar të analizohet se si një shtet social mund të jetë më i favorshëm ndaj çështjeve gjinore (edhe pse, në praktikë, shumë feministe socialiste qenë të përfshira në fushata të mirëqenies).

Pjesa më e madhe e studimeve të kohëve të fundit në lidhje me gjininë dhe shtetin social është fokusuar në çështjet se si dikush mund të masë impaktin gjinor të shtetit social, në veçanti te kërkimi për atë që mund të përshkruhet si një model 'gjinor i favorshëm'. Duhet të theksohet se ekziston në mënyrë eksplicite, një aspekt normativ në pjesën më të madhe të këtij hulumtimi. Qëllimi nuk është thjesht të analizohet shteti social, por më tepër të kryhet një lloj analize që do të mundësojë zhvillimin e një shtetit social favorizues ndaj çështjeve të gjinisë. Duke qenë se një qasje e tillë normative është nënkuptuar nga shumë teori të zakonshme, ajo është dukshëm më shumë në fasadë të shpjegimeve feministe.

A. Roli i punës brenda familjes

Një numër autorësh janë përqëndruar te rëndësitë e punës brenda familjes, për analizën e shteteve sociale, si nga pikëpamja se si shtetet sociale janë të strukturuar për të mbështetur/ nxitur kryerjen nga gratë

¹⁸⁶ "The Handbook of Political Sociology: States, Civil Societies, and Globalization", Mary McIntosh, 1978.

të punëve brenda familjes, e po ashtu edhe nga perspektiva që rritja e mbështetjes për punët brenda familjes është jetike për zhvillimin e shtetit social favorizues ndaj gjinisë. Më parë, Lewis ka argumentuar se *"një nga çështjet qendrore në strukturimin e regjimeve sociale ishte vlerësimi i punës së papaguar të kryer nga gratë brenda familjes, me qëllim sigurimin e mirëqenies."*¹⁸⁷

Lewis ka zhvilluar një analizë të regjimeve të mirëqenies të bazuara në modele të ndryshme të "shtyllës së familjes". Ajo argumenton se vende të tilla si Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda kanë miratuar një model të fortë të "shtyllës së familjes", ku supozohet që burri shkon për të punuar dhe gruaja është kryesisht përgjegjëse për kujdesin në punë. Në të kundërt, Suedia ka miratuar një model të dyfishtë ku të dy bashkëshortët kanë qasje në tregun e punës (modeli i dobët i shtyllës së familjes).

Lewis vuri në dukje se si Suedia, ndërsa aplikonte një model të dyfishtë, për një periudhë të gjatë kohe, nuk e kishte trajtuar çështjen e punës së papaguar të gruas. Së fundi, ajo identifikoi Francën si shembull i një modeli të modifikuar të shtyllës së familjes, ku ishte nxitur pjesëmarrja e grave në tregun e punës dhe ku sistemi francez i mirëqenies i kishte njohur pretendimet e grave si bashkeshorte, nëna dhe punëtore.

Jenson kritikoi fokusin origjinal të Lewis-it në lidhje me punën e papaguar duke argumentuar se *"puna e papaguar nuk mund të shërbejë si sinonim i kujdesit dhe se është kujdesi në punë ai i cili përbën një çështje qendrore në strukturimin e shteteve sociale."*¹⁸⁸ Në të vërtetë, në veprat e mëvonshme, Lewis është përqëndruar në mënyrë të konsiderueshme, në përkujdesjen brenda familjes. Në veprën e fundit Lewis ka argumentuar se *"një model shteti social i përqëndruar - gjinor, duhet t'i mëshojë nevojës për të zhvilluar politika që vlerësojnë dhe rishpërndajnë punën e kryer brenda familjes."*¹⁸⁹

Megjithatë, Daly, duke njohur rëndësinë e politikave të përkujdesjes për familjen, argumenton se *"ajo mund të jetë çorientuese, veçanërisht në një kontekst krahasues, që përshkruan politikat e kujdesit të plotë të shteteve sociale. Për më tepër, ka relativisht pak harmoni mes politikave në lidhje me përkujdesjen për fëmijët dhe ato për të moshuarit dhe të tjerë të rritur të cilët mund të kenë nevojë për kujdes. (2000: 58). Ndërsa kujdesi është një komponent thelbësor i çdo kornize gjinore, ajo vetë është e pamjaftueshme, si një tregues i dimensionit gjinor të përmbajtjes së shteteve sociale"*¹⁹⁰.

B. Aksesi në punën e paguar

Një linjë e dytë e argumentit, e cila gjithashtu pranon rëndësinë e punës së përkujdesjes (punët brenda familjes), fokusohet në rëndësinë e masave që duhet të marrë shteti social për të nxitur përfshirjen e barabartë të të dyja gjinive tek fuqia e paguar punëtore. Sorensen dhe Bergqvist argumentojnë se *"politikat e favorshme ndaj barazisë gjinore nuk e mbështesin ndarjen tradicionale të punës midis grave dhe burrave. Përkundrazi, ato mbështesin gratë dhe burrat që të braktisin rolet e tyre tradicionale, duke nxitur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe përfshirjen e meshkujve në punët brenda familjes."*¹⁹¹

187 "Gender and Welfare Regimes: Further Thoughts", Jane Lewis, (1992:160-170).

188 "Who Cares? Women's Work, Childcare, and WelfareState Redesign", Jane Jenson, 1997.

189 "Economic Citizenship. A comment", Jane Lewis, 2002.

190 "The Political Economy of the Service Transition", Tim Daly, (2000:58).

191 "Gender and the Social Democratic WelfareRegime", Kerstin Sorensen, Christina Bergqvist, 2002.

Orloff në analizën e saj të gjinisë dhe të të drejtave sociale të shtetësisë, e ka cilësuar përfshirjen e punës së paguar si *"një prej efekteve të shteteve sociale në marrëdhëniet gjinore (përveç trajtimit të punës së paguar dhe të papaguar)."*¹⁹²

Orloff argumentoi se *"për shumë gra aksesit në fuqinë e paguar punëtore mbart mundësinë e emancipimit."*¹⁹³ Sipas studimit të saj shumë gra duan punë të paguar për shkak se ajo u siguron pavarësinë brenda martesës dhe familjes patriarkale.

C. Autonomia personale

Një analizë më e detajuar e tematikës së mësipërme ka theksuar rëndësinë e autonomisë personale dhe familiarizimit (autonomi nga marrëdhëniet familjare). Orloff, përveç përfshirjes në punën e paguar, gjithashtu ka propozuar që kapaciteti për të formuar dhe mbajtur një familje autonome duhet të shërbej si kriter për të analizuar efektin e shtetit social mbi marrëdhëniet gjinore.

Duke hequr një paralele me konceptin e *"decomodification"*¹⁹⁴, koncept që në rastin konkret i referohet situatës kur një person mund të përballojë koston e jetesës pa mbështetjen e të tjerëve¹⁹⁵. Orloff argumenton se është e nevojshme të përcaktohet një kriter matës i mundësisë që ka një grua, e cila përballon në të njëjtën kohë një punë të paguar si dhe punët e mirëmbajtjes brenda shtëpisë, për të formuar dhe mbajtur një familje autonome, pa pasur nevojë të martohen për të pasur mbështetjen financiare të mashkullit, si *"shtylla e familjes."*

Orloff argumenton se *"kapaciteti që kanë gratë për të formuar dhe për të mbajtur një familje autonome, i çliron ato nga detyrimi për të hyrë apo për të qëndruar në një martesë vetëm për shkak të cënueshmërisë ekonomike, dhe kështu që shteti është favorizues ndaj gruas duke rritur ndikimin e grave brenda martesës ...apo duke rritur standardet absolute dhe relative të jetesës së grave, mbajtëse të familjes."*¹⁹⁶

Një koncept i lidhur është ai i shfamiliarizimit që mund të shihet si autonomi nga marrëdhëniet familjare. Këtu, megjithatë, ka mosmarrëveshje të konsiderueshme midis autorëve feministe në se kjo është një masë pozitive apo nëse është një zhvillim drejt individualizimit pa mbështetjen e duhur sociale, i cili mund të jetë i rrezikshëm për gratë dhe fëmijët. Për më tepër, është argumentuar se *"çështja kryesore është nëse gratë janë në gjendje të zgjedhin lirisht në mes të marrëdhënieve martesore dhe të tjerave apo nëse janë të detyruara nga nevoja financiare."*¹⁹⁷

D. Ndarja gjinore e mirëqenies

Daly ka zhvilluar një konceptualizim shumë të dobishëm të shteteve

192 "Gender and the social rights of citizenship: The comparative analysis of gender relations and Welfarestate", Shola Orloff, 1993.

193 Ibid, fq.318.

194 Apo e thënë ndryshe me konceptin e forcës së të drejtave sociale dhe shkallës së varësisë së tyre ndaj trysnive të tregut.

195 Sipas përkufizimit të dhënë në tekstin "The three worlds of Welfare capitalism", Esping- Anderson, (1990:22).

196 "Gender and the social rights of citizenship: The comparative analysis of gender relations and Welfarestate", Shola Orloff, (1993:321).

197 "Gender and Well-Being: The Role of Institutions", Ginn et al, (2001:7).

sociale, nga një perspektivë e ndjeshme gjinore¹⁹⁸. Ajo argumenton se në nivel mikro ofrimi i shërbimeve, që lidhin shtetit social, ekonominë dhe familjen përfshin *“natyrën e lidhjeve të individit ndaj shtetit, familjes dhe tregut, dhe në veçanti terma dhe kushte nën të cilat mund të ngrihen pretendimet në lidhje me burimet publike.”*¹⁹⁹

Ajo thekson se një analizë të favorshme ndaj çështjeve gjinore të shtetit social duhet *“të kapë burimet materiale të ofruara nga shteti për gratë dhe burrat, si individë dhe si anëtarë të familjeve, kushtet nën të cilat rishpërndarja është e realizuar ndërmjet tyre, dhe përfitimet e realizuara, porë nga aspekti i ndarjes gjinore.”*²⁰⁰

Ajo përqendrohet, në veçanti, në strukturat e ofrimit të shërbimeve të shtetit social, në proceset e shtetit social dhe rezultatet që pasojnë:

- *Në aspektin e strukturave, Daly shqyrton parimet e shpërndarjes, domethënë, llojin e rreziqeve të mbuluara nga sistemi i përfitimeve, bazën e të drejtave për përfitime, trajtimin e llojeve të ndryshme të familjes, dhe natyrën e shkallën e shërbimeve sociale.*
- *Sa i përket proceseve të shtetit social, Daly fokusohet te shfamiliarizimi në lidhje me mënyrën në të cilën mirëmbajtja është ndërtuar si detyrim - publik, ose privat dhe në të cilin puna e kujdesit është konsideruar si e papaguar.*
- *Në aspektin e rezultateve, Daly shqyrton shtresëzimin që rrjedh nga shteti social duke përfshirë pabarazinë e të ardhurave, varfërinë dhe kapacitetin për të marrë pjesë në tregun e punës dhe/ ose familje.*

Duke u mbështetur në këtë kuadër, Daly ofron një analizë të ndikimit gjinor në shtetet sociale të Britanisë dhe Gjermanisë. Gjetjet e saj ilustronë vështirësitë e kryerjes së një analize të tillë, me bazë gjinore.

Në kushtet e reduktimit të pabarazisë në të ardhura, analizat e saj tregojnë se modeli britanik ka përparësi, por kur vjen puna te familjet, sistemi social gjerman çon jo vetëm në një rishpërndarje më të madhe të të ardhurave të përgjithshme, por për më tepër sjell barazi të ardhurash mes burrave dhe grave në familje.

Në kushtet e varfërisë së të ardhurave, analiza e saj tregon se Gjermania është modeli më i mirë me nivele të varfërisë më pak se gjysma e atyre të Britanisë dhe me gratë gjermane që kanë një normë të varfërisë më pak se gjysma, krahasuar me normën e varfërisë së grave në Mbretërinë e Bashkuar. Në kushtet e strukturave nxitëse, ajo fokusohet në ndikimin që ka martesë në pjesëmarrjen në tregun e punës.

Këtu ajo tregon se për gratë në Gjermani martesë, teorikisht ofron një standard të arsyeshëm jetese. Megjithatë, modeli gjerman i “nxit” gratë të heqin dorë nga të ardhurat personale, për të përfituar nga siguria e martesës, duke i bërë në këtë mënyrë gratë të varura nga burrat e tyre apo partnerët, duke patur parasysh që përfitimet familjare i kalojnë burrit, si kryefamiljar e përfaqësues i familjes.

Nga ana tjetër, në Mbretërinë e Bashkuar gratë janë më pak të varura nga të ardhurat familjare dhe me shumë gjasa mund të jenë të përfshira

¹⁹⁸ “The Political Economy of the Service Transition”, Tim Daly, 2000.

¹⁹⁹ Ibid.

²⁰⁰ Ibid.

më aktivisht në tregun e punës apo të jenë subjekt i përfitimeve sociale. Megjithatë, sipas Daly-t "është e diskutueshme nëse të punosh për të ardhura relativisht të ulëta pa patur mundësi për të përfituar nga shërbimet sociale, që janë kaq të rëndësishme për nënat, mund të cilësohet si një instrument i cili zgjeron mbrojtjen për gratë dhe forcon barazinë gjinore në fushën sociale."²⁰¹

Në përfundim, Daly thekson se "gjykuar nga aspekti i niveleve të përgjithëshme të varfërisë dhe nivelit të të ardhurave të arritshëm nga nënat e vetme, Gjermania është vendi më i mirë për të jetuar, sipër gratë edhe për burrat, edhe pse në shumicën e rasteve pjesa më e madhe e grave nuk e përballojnë të vetme koston e jetesës së tyre, por mbështeten te të ardhurat e meshkujve.

3.2 Disa aspekte në lidhje me aplikimin e parimit të barazisë gjinore në skemat e sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit shqiptar.

3.2/1 Sanksionimi ligjor i parimit të barazisë

Garantimi i trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha sferat e jetës është një nga prioritetet dhe qëllimet e të gjitha shoqërive (përfshirë edhe atë shqiptare) në kuadër të progresit dhe ndërtimit të shtetit të mirëqënies sociale. Sic theksohet edhe nga Gjykata Kushtetuese "e drejta për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore është një e drejtë që përfshihet në grupin e të drejtave ekonomike-sociale, që për nga natyra janë të drejta pozitive. Prandaj, përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar. Këto mangësi shteti duhet t'i garantojë pa lejuar diskriminim të paarsyeshëm e jo objektiv."^{(Shih vendim Nr. 9, datë 26.02.2009 GJK).}

Për sa më sipër zbatimi i duhur i parimit të barazisë gjinore në fushën e mbrojtjes sociale shtrihet në dy drejtime kryesore. Ai shtron fillimisht detyrën e shtetit në marrjen e masave për garantimin de jure të barazisë midis burrave dhe grave në sferën e sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale. Kjo do të thotë që ligjvënësi shqiptar duhet të garantojë një kuadër juridik në përputhje me standartet ndërkombëtare i cili të mos ketë asnjë ndikim më pak të favorshëm në ndonjërin prej gjinive në lidhje me të gjitha të drejtat që duhet të përfitohen nga skemat e mbrojtjes sociale. Së dyti, garantimi i parimit të barazisë gjinore nënkupton marrjen e masave për garantimin e barazisë thelbësore, barazisë së rezultateve. Kjo do të thotë, që në hartimin e kuadrit normativ të nevojshëm për vënien në zbatim të ligjit "Për sigurimet shoqërore" duhet të merren parasysh pozita e ndryshme e burrave dhe grave në shoqëri si dhe nevojat e vecanta të tyre. Sic e theksuam edhe më lart, garantimi i parimit të barazisë gjinore në lidhje me të mirat e përfituara nga skemat e sigurimeve sociale është pjesë e pandarë e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Për këtë arsye shteti shqiptar duhet të ndjekë praktikën më të mira ndërkombëtare dhe evropiane me qëllim krijimin e një kuadri juridik në fushën e mbrojtjes sociale në përputhje me këto standarte.²⁰²

Si në të gjitha sferat e jetës ekonomike, politike, kulturore po ashtu edhe sociale, Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri",

²⁰¹ Ibid, fq.216.

²⁰² Mund të përmendim për shembull Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Neni 9 i tij), Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 22 dhe 25), Karta Sociale Evropiane, Korventa Nr. 102 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) etj.

shërben si një mekanizëm ligjor i nevojshëm për sanksionimin e parimit të barazisë gjinore. Duke pasur si qëllim të sigurojë një mbrojtje efektive nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë tjetër që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, ky ligj përpara detyrimit autoritetet shqiptare për të marrë të gjitha masat e nevojshme legislative dhe politike për të garantuar mundësi të barabarta të burrave dhe grave në përfundimin (në përfundim të tjerave) të të drejtave me karakter social. Neni 21 i ligjit sanksionon se punëmarrësit femra dhe meshkuj kanë të drejtë që pa asnjë diskriminim për shkak të gjinisë *“të kenë sigurime shoqërore, vecanërisht në rastet e daljes në pension, të papunësisë apo të humbjes së aftësisë të përkohshme për punë”; “të kenë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë” apo “të kenë të drejtë të përfitojnë kompensime për fëmijët që kanë në ngarkim”.*

Po kështu Neni 23 i ligjit është më rëndësi për t'u trajtuar në terma të kontributeve të llogaritura në lidhje me punën e papaguar (që në pjesën më të madhe të rasteve afekton gjininë femërore). Në mënyrë të shprehur Neni 23 përcakton se puna e papaguar e femrave dhe meshkujve vlerësohet si kontribut për zhvillimin e familjes dhe shoqërisë, në rast kur ai/ajo *“kujdeset për mirëqënien e familjes; kujdeset për fëmijët; kujdeset për anëtarët e tjerë të familjes apo punon në bujqësi dhe ekonomi familjare”.* Për më tepër Neni 9 i ligjit, në paragrafin e parë të tij sanksionon si një nga rastet kur nuk përbën diskriminim për shkak të gjinisë *“marrjen e masave të vecanta nga ana e shtetit, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë [mbrojtjen e posaçme të grave gjatë shtatzanisë dhe lindjes, të nënave të reja si dhe të prindërve të rinj, për shkak të lindjes natyrore ose të adoptimit të fëmijëve, duke krijuar kushte për mbrojtjen dhe lehtësimin e tyre në sigurimet shoqërore e ndihmat sociale...]”.*

Gjithashtu, ligji nr 10.221 datë 4.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* e trajton në mënyrë të posaçme barazinë gjinore midis burrave dhe grave në fushën e sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale në Nenin 20 të tij. Paragrafi i dytë i këtij neni shërben si një garanci për të trajtuar në mënyrë të barabartë femrat dhe meshkujt në lidhje me *“kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.*

Në përputhje me paragrafin e parë të Nenit 20 të ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, personat fizikë ose juridikë që ofrojnë të mira apo shërbime me pagesë ose jo do të jenë në shkelje të parimit të trajtimit të barabartë gjinor (përveç të tjerave) në fushën e mbrojtjes sociale në rast se ata *refuzojnë t'i ofrojnë një personi të mirat e përfituara nga skemat e sigurimeve sociale dhe mbrojtjes shoqërore për shkak të gjinisë ose në rast se zbatojnë kushte dhe vendosin kritere të ndryshme për burrat dhe gratë për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore.* Pra, zbatimi i këtij neni nënkupton ndalimin e të gjitha atyre rasteve kur edhe pse subjekti (burrë ose grua) plotëson të gjitha kriteret për të përfituar nga një degë e sigurimeve shoqërore, autoritetet publike refuzojnë t'ia ofrojnë atë nisur nga gjinia e tij.

Në fakt, zbatimi i parimit të barazisë midis burrave dhe grave në sferën e sigurimeve shoqërore, nuk do të thotë apriori garantimi i përfitimeve të

barabarta për të gjya gjinitë. Ky parim duhet kuptuar në terma të trajtimit të njëjtë të të gjithë subjekteve përpara ligjit specifik, që do të thotë që burrat dhe gratë duhet njëjloj të kenë mundësi dhe akses për të përfituar nga skemat e mbrojtjes sociale, në rast se ato plotësojnë kushtet dhe kriteret e vendosura me ligj.

Vlen të përmendim këtu edhe jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese e cila ka arritur në konkluzionin se *"Barazia në ligj dhe para ligjit nuk parakupton zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme, por ajo parakupton kryesisht barazinë e individëve që ndodhen në kushte të njëjlojta."*(shih vendimin nr.11, datë 27.08.1993).

Për më tepër sipas po kësaj Gjykate "zbatimi i parimit të barazisë në çështjet që lidhen me të drejtat ekonomike dhe sociale (sigurimet shoqërore dhe mbrojtja sociale) merr rëndësi të veçantë në dritën e parimeve të tilla, si shteti social dhe shteti i së drejtës. Këto parime kërkojnë që shteti, si rregullator, të vendosë kufijtë midis të mirës së përgjithshme të shoqërisë dhe të drejtave të grupeve të veçanta. Shteti duhet të niset nga trajtimi i barabartë për të gjithë dhe pastaj të kujdeset përkatësisht për kriteret e secilit grup. Ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave, duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese."(vendim nr 9, datë 26.02.2007).

Për sa më sipër trajtimi i barabartë gjinor në fushën e mbrojtjes sociale kërkon së pari: garantimin e mundësive të barabarta për secilën prej gjinive për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale dhe së dyti marrjen parasysh të ndryshimeve biologjike të burrave dhe grave për të mundësuar krijimin e një skeme të përshtatshme përfitime për secilën prej kategorive të përmendura.

Në kuadër të ligjeve të posacme, si ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 *"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar ashtu edhe ligji nr.9355 datë 10.03.2005 *"Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"* nuk përmban ndonjë dispozitë me natyrë diskriminuese për sa i përket trajtimit të diferencuar të burrave dhe grave. Edhe pse jo i sanksionuar në mënyrë të shprehur garantimi i parimit të barazisë gjinore, në terma të përgjithshme, ligji *"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"* përcakton në Nenin 6 të tij kategorinë e subjekteve që përfitojnë nga ky ligj, pa vendosur ndonjë kriter ndarjeje. Sipas këtij neni *"Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme të gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrë lindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes. Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrojtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar, në rastin e pakësimit të të ardhurave, si pasojë e paaftësisë së përkohëshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia."*

Ndërkohë që, ligji *"Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"* duke të jetë më i plotë në terma të përcaktimit të parimeve bazë mbi të cilat duhet të funksionojë skema e ndihmës dhe sigurimeve shoqërore. Neni 3 i tij rendit ndër të tjerash si pjesë të parimeve të aplikueshme *" parimin e universalitetit, mosdiskriminimit, barazinë e mundësive si dhe parimin e të drejtës së të gjithëve për të përfituar"*.

Megjithatë pavarësisht këtyre parimeve, një nga përcatimet, që janë cilësuar si problematike në lidhje me aplikimin e parimit të barazisë gjinore e që kanë sjellë vështirësi në fuqizimin ekonomik të grave është përkufizimi që Ligji "për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i bën nocionin të "kryetarit të familjes". Sipas Nenit 4, pika 10 e këtij ligji "*Kryetar të familjes*", *kuptohet personi sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.*" Ky përcaktim i shprehur në ligj, duket sikur rithekson stereotipet gjinore në shoqëri në lidhje me rolin dominant të burrit në marrëdhënie familjare. Për këtë arsye ai ka qënë në vëmendje të politikbërësit shqiptar, me rregullimin përmes akteve të vecanta nënligjore. (shih më poshtë)

Llojet e diskriminimit gjinor në terma të sigurimeve shoqërore.

Sic edhe e theksuam më sipër, garantimi i parimit të barazisë gjinore në lidhje me sigurimet shoqërore dhe mbrojtjen sociale, është më shumë se vetëm trajtimi i barabartë i burrave dhe grave në sensin e ngushtë formal. Sigurimi i këtij parimi kërkon, në të njëjtën kohë marrjen parasysh të rolve gjinore në shoqëri, të cilat jo vetëm që mund të ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën, por gjithashtu janë shoqëruar me ndryshime të mëdha në vitet e fundit. Në këtë kontekst, duke marrë parasysh për sa më sipër, shteti duhet të angazhohet në disenjimin e një skeme të sigurimeve shoqërore që duhet të marrë parasysh si trajtimin e barabartë midis burrave dhe grave po ashtu edhe rolet e ndryshme gjinore duke shërbyer si një mjet për promovimin e barazisë gjinore. (ILO, Social Security: a New Consensus, 2001, kap 6.). Mosmarrja parasysh e këtyre dy parimeve mund të na çojë në një skemë që trajton në mënyrë të diferencuar burrat apo gratë për qëllim të përfitimeve nga sigurimet shoqërore. Si edhe në sferat e tjera, llojet e diskriminimit gjinor në këtë fushë mund të vërehen në formën e diskriminimit direkt dhe indirekt. Organizata Ndërkombëtare e Punës i trajton të dyja këto forma të diskriminimit gjinor si rrjedhim i moszbatimit të parimit të barazisë gjinore në sigurimet shoqërore.

Sipas saj : *diskriminimi direkt* mund të gjendet tek (I) ndryshimet në trajtim midis burrave dhe grave të martuar , ekonomikisht aktivë, bazuar në idenë që gruaja është e varur nga burri, kështu që e drejta e saj për sigurim është një e drejtë që rrjedh nga sigurimi i burrit dhe jo një e drejtë që i përket vetë asaj; (II) ndryshimet në përqinjen e përfitimeve ose normën e kontributeve në bazë të faktorëve aktuarialë të llogaritur në mënyrë të ndarë për burrat dhe gratë, duke marrë gjithashtu në konsideratë faktorë të tillë si : jetëgjatësia e ndryshme e burrave dhe grave, rreziqet e sëmundshmërisë dhe invaliditetit, modelet e punës, etj.²⁰³

Ndërkohë që diskriminimi indirekt i burrave dhe grave në fushën e sigurimeve shoqërore është rezultat i masave, të cilat, edhe pse në dukje janë neutrale, pa ndonjë dallim të shprehur të lidhur me seksin, ndikojnë në mënyrë të ndryshme mbi burrat dhe gratë për shkak të natyrës ndryshme të veprimtarisë së tyre profesionale, statusit martesor ose situatave familjare. Femrat punëmarrëse mbizotërojnë në sektorët që nuk mbulohen nga sigurimet shoqërore, të tilla si puna në familje, puna me kohë të pjesshme ose punë të rastit ose në ekonominë informale ose mund të marrin periudha të gjata kualifikuese, të cilat edhe pse në

²⁰³ International Labour Conference, Report VI, Social security: Issues, challenges and prospects, ISBN 92-2-111961-0, f. 37.

terma neutrale penalizojë gratë.²⁰⁴ Në rastin e dytë, marrja e masave nga ana e shtetit që afektojnë ndryshme mbi burrat dhe gratë, mund të mos konsiderohet si diskriminim vetëm nëse shteti, për marrjen e tyre, ka pasur një justifikim objektiv të bazuar në një qëllim të ligjshëm dhe nëse masat e marra kanë qënë proporcionale dhe të nevojshme me qëllimin që kërkohej të arrihej.

3.2/3 Barazia gjinore në sferën e sigurimeve shoqërore dhe varësia e saj nga marrëdhënia e punësimit.

Që në fillim duhet të theksojmë se ka një lidhje të ngushtë midis nocionit të sigurimeve shoqërore dhe punësimit. Kjo pasi sigurimi shoqëror i detyrueshëm mbron me të ardhura vetëm personat e punësuar si dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë, ku përfshihen punëdhënësit si dhe personat e vetëpunësuar.²⁰⁵

Kështu, për të përfituar nga njëra prej degëve e sigurimeve shoqërore do të duhet të jesh subjekt i një pune të ligjshme, të përfunduar me një kontratë punë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nga ana tjetër periudha e punësimit është e lidhur ngushtë me periudhën gjatë të cilës punëmarrësi paguan kontribute, për efekt të kriterëve që duhet të plotësohen për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore e që lidhen me periudhën e sigurimeve.

Gjithashtu, nëse marrim për bazë pozicionin që kanë gratë në raport me tregun e punës, mund të themi se gratë përbëjnë grupin më të disavantazuar. Kjo pasi, situata e tyre përcaktohet nga ndarja e punës, në të cilën ato ndajnë pjesën më të madhe të punës së papaguar.²⁰⁶ Në raportin e Zhvillimit Njerëzor, për vitin 2015, nënvizohet se pjesëmarrja globale e forcës së punës ishte 50 % për gratë dhe 77 % për burrat. Gjithashtu të dhënat sipas këtij raporti tregojnë se në vitin 2015, në rang botëror, 72% e burrave të aftë për punë kanë qënë të punësuar, krahasur me 47% të grave.²⁰⁷ Gjithashtu, angazhimet që kanë gratë në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve apo anëtarëve të tjerë të familjes, mund të ndikojë negativisht në lidhje me punësimin e tyre me kohë të plotë, duke i detyruar ato që në një pjesë të rasteve të nënshkruajnë kontrata punë me kohë të pjesshme. Sipas raportit të Zhvillimit Njerëzor (2015) burrat dominojnë botën e punës së paguar, ndërsa gratë botën e punës së pa paguar. Në Shqipëri burrat bëjnë mesatarisht vetëm 53 minuta punë të papaguar në ditë, krahasuar me 314 minuta në ditë që bëjnë gratë shqiptare. ²⁰⁸ Kjo mund të ndikojë në si në pagën e përfituar prej tyre në varësi të llojit të punës të ofruar (në ndryshim me meshkujt), ashtu edhe për sa i përket viteve të punës për efekt të skemave të sigurimeve shoqërore.

Duke u bazuar pikërisht në këtë kriter, pra, të qëniet i punësuar në sektorin formal (apo të ligjshëm) mund të arrijmë në një konkluzion të parë mbi lidhjen midis diskriminimit e grave në sferën e sigurimeve shoqërore dhe politikave të punësimit. Kjo edhe nëse marrim parasysh faktin se, në raport me burrat, gratë e kalojnë një pjesë të madhe të jetës jashtë sferës së punësimit, duke u varur ekonomikisht nga burrat e tyre të punësuar. Si rezultat ato ngelen jashtë skemave të detyrueshme të sigurimeve

204 Ibid

205 Shih nenin 2 të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

206 International Labor Office " Social Security: A new consensus", 2001, fq71.

207 Shih Human Development Report 2015, kap.3 tek <http://report.hdr.undp.org/>

208 Ibid.

shoqërore, duke mos përfituar ta ardhura në rast të verifikimit të gjendjes së paaftësisë së tyre.

Nga ana tjetër, edhe nëse krahasojmë sektorët e punësimit midis burrave dhe grave, mund të vihet re se një pjesë relativisht më e madhe e grave janë punësuar në sektorin informal, me më pak të ardhura e më pak mbrojtje në terma të sigurimeve shoqërore.

Në raste të tjera, gratë për shkak të faktorëve riprodhues të tyre, detyrohen të ndërpresin marrëdhënien e punësimit për një kohë të caktuar, duke u kujdesur për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, gjë që mund të ketë pasoja negative në lidhje me ngjitjen e tyre në karrierë apo në lidhje me fuqizimin ekonomik. Si rrjedhim, edhe sasia e kontributeve të paguara prej tyre në një rast të tillë do të ishte më e ulët, duke ndikuar në të njëjtën kohë në uljen e mundësive për të përfituar nga kategori të caktuara të skemave të sigurimeve shoqërore në rast të gjendjes së paaftësisë.

Për më tepër, gratë për shkak të ndërprerjeve më të shpeshta të punës ose për shkak të punësimit me kohë të pjesshme, mund të mos plotësojnë kritere të tjera të nevojshme për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore si psh: periudha e sigurimit, të ardhurat e mëparshme etj. Për sa më sipër, kapaciteti i tyre kontributiv në skemat e sigurimeve është më i ulët nga ai që ato mund të kishin vërtet mundësi të derdhnin nëse do të ishin të punësuar në pozicione apo kategori të tjera punë, e për rrjedhim edhe mundësitë e tyre për të përfituar nga këto skema do të jetë më i ulët. Nga ana tjetër, punëtorët në sektorin informal (ku gratë zënë një pjesë të madhe) mbeten të përjashtuar nga skemat e sigurimit.

Të gjitha argumentet e analizuar më sipër, në bëjnë të kuptojmë se, ndërprerja e karrierës profesionale, trajtimi i diferencuar në pagë (paga më të ulëta), punësimi me kohë të pjesshme, punësimi në sektorin informal, puna e papaguar apo kategoria/lloji i punës së kryer sjell në mënyrë më disproporcionale efekte negative më të shumta tek gratë se sa tek burrat. Kjo sjell pasoja jo vetëm në lidhje me skemat e pensioneve (mosha/ periudha e sigurimit), por gjithashtu edhe në lidhje me kategori të tjera të mbrojtura ku mund të përmendim edhe skemën e papunësisë e të ardhurat e përfituara në rast të verifikimit të këtij rreziku.²⁰⁹ Për këtë arsye, për të promovuar trajtimin e barabartë gjinor në fushën e sigurimeve shoqërore, është me interes ndërmarrja e politikave në kuadër të zgjerimit të skemave me karakter universal në fushën e mbrojtjes së shëndetit, kujdësit ndaj fëmijëve, pensioneve universale etj.

Ndërkohë që, në ndryshim nga sistemi i sigurimeve shoqërore, politikat shtetërore të mbrojtjes sociale kanë si qëllim ofrimin e ndihmës për kategoritë në nevojë, me më pak të ardhura apo për grupet më të marginalizuara në shoqëri. Në këtë kontekst, në parim, sistemet e mbrojtjes sociale, duken më pak të prekshme nga faktorët diskriminues, nisur nga ideja se në kuadër të parimit të shpërndarjes së të ardhurave dhe drejtësisë sociale ato ndihmë të gjitha kategoritë e grave me të ardhura në rast nevojë në formën e ndihmës sociale. Megjithatë, edhe pse në trajtë formale, duket politikat e asistencës dhe mbrojtjes sociale, bazohen në trajtimin e barabartë të burrave dhe grave, në aspektin praktik jo gjithmonë ndodh kështu. Për shumë kohë, këto skema mundësonin përfitimin e ndihmës ekonomike e sociale për kryetarin e familjes, që

²⁰⁹ Ibid, fq 72.

de facto njihej burri. Kjo con në një situatë të tillë, ku edhe në rast të përfitimit të ndihmës ekonomike në familje, gratë do të vazhdojnë varen ekonomikisht nga burrat e tyre përfitues realë të kësaj ndihme. Për sa më sipër, mund të arrijmë në përfundimin se ka një lidhje të ngushtë midis diskriminimit gjinor në tregun e punës dhe politikave të sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale dhe anasjelltas.

3.2/4 Cështje të trajtimit të diferencuar të përligjur në fushën e sigurimeve shoqërore

Sic e kemi theksuar më lart, ligji "Për sigurimin shoqëror në Republikën e Shqipërisë", përmban dispozita parimisht neutral për sa i përket cështjeve gjinore. Megjithatë nëse shohim kriteret/kushtet që duhet të plotësojë një subjekt për të përfituar nga skema e pensionit të pleqërisë mund të vemë re një dispozitë e cila duket sikur trajton në mënyrë të diferencuar meshkujt kundrejt femrave. Kështu, Neni 31 i ligjit përcakton në pikën e parë të tij se *"personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji"*. Ndërkohë që Neni 92 i ligjit sanksionon zgjatjen graduale të të moshës dhe periudhës së sigurimit për pension, duke i ndarë tabelat e moshës së nevojshme për të përfituar nga pension i pleqërisë në dy pjesë: zgjatja graduale e moshës për burrat dhe për gratë. Nëse e analizojmë tabelën me vëmendje mund të vemë re një diferencë në moshë për një periudhë prej 5 vitesh në favor të grave. Për shembull për të njëjtën periudhë kohe nga 01.01.2015 - 31.12.2015 mosha e daljes në pension për burrat është përcaktuar 61 vjeç dhe për gratë 56 vjeç; për periudhën 01.01.2016-31.12.2016 kjo moshë për burrat zgjatet në 61 vjeç e 6 muaj ndërkohë për gratë 56 vjeç e 6 muaj.

Sic e shohim, edhe pas zgjtjes graduale të moshës së daljes në pension, ligjvënësi shqiptar vazhdon të rruajë të njëjtën diferencë prej 5 vitesh midis burrave dhe grave. Pyetja që mund të shtrojmë në këtë rast është nëse kjo diferencë në moshë në favor të gjinisë femërore ka ndonjë ndikim negativ/diskriminues kundrejt meshkujve? Praktika ndërkombëtare e shteteve të ndryshme ndahet në lidhje me këtë masë. Ka shtete si Gjermania apo Franca që kanë vendosur të njëjtën moshë të daljes në pension si për burrat ashtu edhe për gratë. Por, ndërkohë ka një pjesë të madhe të shteteve (Itali, Austri, Belgjikë etj) që ndjekin të njëjtën politikë si Shqipëria, në lidhje me vendosjen e daljes në pension të grave në një moshë më të re se sa burrat.

Në fakt, edhe pse praktikat e shteteve ndahen në lidhje me këtë cështje, në mendojmë se kjo diferencë në moshë midis burrave dhe grave nuk mund ta shndërrojë dispozitën në fjalë si diskriminuese. Edhe pse ligji kërkon përcaktimin e kriterëve të ngjashme për burrat dhe gratë për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore, në disa raste, vendosja e kushteve të ndryshme për gratë në raport me burrat (si në këtë rast mosha e ndryshme) nuk përbën diskriminim. Kjo pasi Neni 20, pika 7 e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" sanksionon se *" Ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet për caktimin e një moshe të vecantë për mundësi të përfitimeve sociale, të të mirave, lehtësive dhe shërbimeve, kur ekzistojnë kriterë të arsyeshme e objektive për caktimin, pa cënuar thelbin e të drejtës për përfitime dhe kur caktimi synon të arrijë një qëllim të ligjshëm për një interes publik, ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, gjithmonë në përpjestim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar caktimin."*

Në të njëjtin konkluzion ka arritur edhe Gjykata Kushtuese me vendimin nr.9 datë 26.02.2007 ndërsa shprehet se *"...respektimi i parimit të barazisë kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve në kushte të njëjta të shtetasve pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet."* Edhe nëse i referohemi praktikës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë mund të arrijmë në të njëjtin konkluzion. Në një nga çështjet e marra në shqyrtim GJED²¹⁰ ka nënvizuar se *"dallimet në moshë referuar daljes në pension të burrave dhe grave nuk cojnë në diskriminim nëse ndiqen nga një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm, që në rastin e marrë në shqyrtim ishte korigjimi i pabarazive de facto midis burrave dhe grave në tregun e punës, të ardhurat e fituara, kushtet sociale të ndryshme që lidhnin gratë më tepër me punën e papaguar se sa me atë të paguar, duke i krijuar vështirësi atyre për të përfutuar nga skema e sigurimeve shoqërore."*

Për këto arsye, caktimi i moshës së ndryshme të daljes në pension mendojmë se mund të cilësohet si masë pozitive që merr shteti në favor të grave, nisur nga ndryshimet biologjike midis të dyja gjinive. Nëse do të ishim përpara diskriminimit (direkt apo indirekt), theksi do të duhet të vihej jo me në diferencat biologjike midis meshkujve dhe femrave por në ndryshimet sociale, stereotipat shoqërore në lidhje me rolin e ndryshëm të secilës prej gjinive. E vetmja pyetja që kanë shtruar ekspertët të fushës në këtë rast ka qënë nëse mbajtja e një moshe të ndryshme të daljes në pension midis grave dhe burrave mund të shoqërohet me një rritje të shpenzimeve të skemës së sigurimeve. Megjithatë, nisur nga analiza e bërë më lart, ne mendojmë se, më tepër se sa diskriminim, përpara një dispozite të tillë, do të ishim përpara një detyrimi (edhe moral) të ligjvënësit shqiptar për të korigjuar pabarazitë shoqërore me të cilat hasen femrat në raport me burrat, të cilat për rrjedhojë prodhojnë edhe pabarazi të gjendjes ekonomike të tyre .

Gjithashtu, si pjesë e masave pozitive në lidhje me trajtimin më të favorshëm të grave që ndodhen në situata të vecanta mund të përmendim edhe dispozitat ligjore që vendosin kriteret më të zbutura për gratë në lidhje me përfitimin nga skemat e sigurimeve shoqërore. Të tilla kategori përfshijnë gratë shtatzana, nënat e reja apo nënat me shumë fëmijë. Kështu neni 31 i ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në pikën 2 të tij sanksionon se *"Nënat, që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim."*

Po kështu ligji parashikon edhe dispozita të vecanta vetëm për kompensimin e grave për shtatëzani në rast të ndryshimit të vendit të punës. Konkretisht Neni 28 i ligjit të sipërcituar, parashikon në pikën 1 të tij se *"Gruaja e siguruar, që me vendim të komisionit mjekësor kompetent ndryshon vendin e punës për arsye shtatëzanie, ka të drejtë të përfitojë kompensim të ardhurash për pakësimin që pëson nga ndryshimi i vendit të punës. Ky kompensim jepet në rast se është derdhur kontribut për një kohë jo më pak se 12 muaj"*. Në këtë rast shuma e kompensimit që ligjvënasi parashikon në favour të grave nuk mund të cojë në trajtim të diferencuar

210. Shih vendimi i GJED "Stec and others Vs United Kingdom", datë 23.05.2000.

të tyre ndaj burrave. Kjo pasi në rastin e mësipërm, kemi një qëllim objektiv dhe të përligjur, që justifikon marrjen e masave të vecanta e që lidhet me lehtësimin apo fuqizimin e gjendjes ekonomike të grave gjatë periudhës së tyre të shtatzanisë, ku për arsye objektive (me karakter biologjik) mund të detyrohen ose të shkëputen nga vend i mëparshëm i punës për shkak të mbrojtjes së shëndetit të tyre ose fëmijës, ose të transferohen në pozicione të tjera më pak të rrezikshme, por në mjaft raste edhe më pak të pagueshme.

Nuk ka ndonjë dallim edhe në rastin e sanksionimit të të ardhurave për barrë lindje, që ligji shqiptar ua njeh vetëm grave të siguruara. Në kreun II të ligjit ku përcaktohet kjo kategori të ardhurash, shumica e dispozitave janë sanksionuar në favour të grave. Por kurrsesi nuk mund të themi se këto janë dispozita me karakter diskriminues. Kjo pasi funksionet riprodhuese janë të lidhura biologjikisht me gruan, e në këtë rast, gratë dhe burrat nuk ndodhen në kushte të ngjashme që të pretendojnë të trajtohej njëllor nga ligji. Në favor të këtij argument vlen edhe shembulli i shprehur në ligj në lidhje me përfitimin e shpërblimit për lindje fëmijë. Duke qënë se në këtë rast, kalojmë nga funksione të lidhura ngushtësisht me gratë, në funksione prindërore që mund të ushtrohen njëllor nga të dy prindërit, dispozita në ligj ka karakter më neutral.

Neni 29, pika 1 e ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë sanksionon se *"Shpërblim për lindje fëmijë i paguhet një personi të siguar, i cili është nëna ose babai i një fëmijë që lind, me kusht që njëri prej tyre të ketë kontribuar për një vit para lindjes së fëmijës"*.

Për sa më sipër mund të konkludojmë se marrja e masave me karakter pozitiv nga ana e ligjvënësit shqiptar nuk mund të cilësohet apriori me natyrë diskriminuese, nëse ato justifikohen nga një qëllim i ligjshëm, objektiv dhe nëse masat e marra në cdo rast janë proporcionale me qëllimin që kërkohet të arrihet. Këto masa jo vetëm që nuk mund të cilësohet si diskriminuese, por në të kundërt, mendojmë se ato i shërbejnë promovimit të parimit të barazisë gjinore në shoqëri, duke zbutur apo korrigjuar pabarazitë me natyrë biologjike midis burrave dhe grave në lidhje me situata të vecanta.

3.2/5 Çështje të zbatimit të barazisë gjinore në terma të ndihmës ekonomike

Përveç, sistemit të sigurimeve shoqërore, pjesë e politikave sociale të shtetit në kuadër të krijimit të shtetit social është edhe sanksionimi i përfitimit të ndihmës ekonomike për të gjitha kategoritë e subjekteve që në një moment të caktuar të jetës së tyre përfshihen në kategorinë e subjekteve në nevojë. Nga pikëpamja juridike, ligji i posacëm që rregullon mënyrën e ndarjes së ndihmës ekonomike për kategoritë që nuk mund të plotësojnë dot nevojat bazë jetike për shkak të aftësive të kufizuara ekonomike e sociale është ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore". Edhe pse ne kemi theksuar në fillim të pikës 2.9 që ky ligj sanksionon si një nga parimet bazë , parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, nëse analizojmë dispozita të vecanta të këtij ligji, mund të gjejmë raste kur të dyja këto parime nuk gjejnë zbatim. Ne e kemi cilësuar edhe më lart, problematike, përkufizimin që ky ligj i bën nocionit të kryetarit të familjes, duke e lidhur këtë të fundit fillimisht me burrin në familje e vetëm në mungesë të tij me gruan.

Arsyet lidhen, së pari, jo vetëm që ofrimi i një përkufizimi të tillë, në kushtet kur shteti shqiptar kërkon të afirmojë parimet demokratike të barazisë gjinore, na con në një terren ku jo vetëm që nuk promovohet trajtimi i barabartë gjinor, por vihet në dukje roli dominant i burrit në familje. Në këtë kontekst, është vetë ligjvënësi ai që nuk del jashtë kornizave të stereotipeve në lidhje me rolin dhe pozitën e ndryshme të burrit dhe gruas në familje. Së dyti, duke dalë nga konteksti social, e duke kaluar në atë ekonomik, parashikimi i një dispozite të tillë, sjell problem në lidhje me fuqizimin ekonomik të grave Brenda familjes. Kjo pasi ligji e lidh nocionin e "kryetarit të familjes" me subjektin që do të bëhet përfitues i ndihmës ekonomike. Prandaj, nëse shohim vendimin Nr. 787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike", në nenin 1, pika 2 e tij, kryefamiljari përcaktohet si subjekti që duhet të plotësojë dokumentacionin për të përfituar nga ndihma ekonomike dhe si personi që e tërheq atë. Për pasojë mund të ishim sërish përpara një situatë të tillë, të varësisë së pashmangshme ekonomike të gruas ndaj burrit.

Pikërisht, për shkak të trajtimit të diferencuar gjinor që përlij kjo dispozitë si dhe në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që ka marrë shteti shqiptar në nivel evropian për promovimin e parimit të barazisë gjinore në shoqëri, për rritjen dhe fuqizimin e pozitës së gruas në shoqëri, Këshilli i Ministrave, ndër morri një masë të rëndësishme përmes miratimit të vendimit Nr. 375, datë 11.6.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 904, datë 12.12.2012, të këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të Përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot".

Ky vendim ka rëndësi së pari pasi përcakton në pikën 3 të tij se kërkesën për të përfituar ndihmë ekonomike nuk e bën më vetëm kryefamiljari, por ky i fundit së bashku me bashkëshorten, duke e cilësuar përfitimin e ndihmës ekonomike si një e mirë e përbashkët dhe në interes të të dy bashkëshortëve. Nga ana tjetër, ajo që ka më shumë rëndësi është shtimi i shkronjës "c" në pikën 5 të këtij vendimi sipas të cilit "Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike e ka bashkëshortja". Gjithashtu, vendimi përcakton masa të veçanta të përfitimit të ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit apo viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, që në shumicën e rasteve janë gra.

Siç mund ta shohim, ndryshimi që vjen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, është me interes në kuadër të rritjes së fuqizimit të grave në familje duke i dhënë atyre mundësinë të tërheqin ndihmën ekonomike. Kjo, edhe pasi gratë janë subjektet që brenda familjes, kujdesen për rritjen e fëmijëve dhe kujdesin ndaj shtëpisë. Kështu, tërheqja e ndihmës ekonomike prej tyre, mund të sjellë përmirësim, jo vetëm të gjendjes së tyre ekonomike, por më gjerë, edhe të situatës familjare në tërësi.

Në analizë të fundit, mund të themi se me gjithë përmirësimin që sjell në praktikë vënia në zbatim e këtij vendimi, shtrirja e tij e kufizuar vetëm në zonat pilot Tirane, Elbasan dhe Durrës mund të mos sjellë rezultate të përgjithshme në kuadër të përmirësimit të gjendjes ekonomike të grave në qarqet e tjera, që nuk mbulohen brenda zonave pilot, ku diferencat gjinore në çështje të karakterit ekonomik e social mund të jenë madje edhe më të ndjeshme se ato në zonat e pilotuara. Për sa më sipër,

rekomandojmë që ndryshimet që ka sjellë ky vendim, të bëhen evidente në të gjithë territorin e vendit, përmes miratimit të vendimeve të reja për të njëjtin qëllim, ose rishikimit të vendimit të sipërcituar, në favor të promovimit të zbatimit të parimit të barazisë gjinore në një shkallë relativisht të gjerë.

3.3 Burimet Ndërkombëtare në sistemin e Sigurimeve Shoqërore

Sistemimi i sigurimeve shoqërore ndër vite ka pësuar ndryshime të mëdha në kuadrin e përmirësimit të tij në dobi të shoqërisë. Një ndër pikënisjet e ndryshimeve në këtë sistem ka ardhur si pasojë e përballjes me influencën e normave "të huaja". Si pasojë e kësaj përballjeje dhe në zbatim të rekomandimeve të vendosura nga Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare, ligjet vendase duhet të përshtasin norma të reja.

Në këtë mënyrë krahas burimeve të brendshme u zhvilluan disa burime pak a shumë të detyrueshëm si në nivel ndërkombëtar. Bashkësitë ndërkombëtare kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes sociale, ato kanë qenë gjithnjë të vetëdijshme duke pranuar përgjegjësitë e tyre se komuniteti ndërkombëtar duhet të zhvillojë përgjegjësinë e vet për çështjet sociale në përgjithësi, por veçanërisht në lidhje me fushën e sigurimeve shoqërore.

Përveç dokumenteve të përgjithshme me përfshirje universale dhe dokumenteve të shumta ndërkombëtare dypalëshe, siç janë traktatet e imigrimit apo të sigurimeve shoqërore, normat ndërkombëtare në fushën sociale u hartuan kryesisht në kuadrin e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP)²¹¹. Në nivel rajonal dhe veçanërisht në Evropë, dy janë organizatat ndërkombëtare që janë përpjekur të rregullojnë realitetet profesionale edhe pse duke u nisur nga qasje mjaft të ndryshme.

Së pari Këshilli i Europës, për të cilin, e drejta e sigurimeve shoqërore nuk përbën qendër ekskluzive interesi. Megjithatë duhet të theksoj se në drejtim të kësaj fushe ky institucion promovoi disa të drejta sociale themelore në kuadrin e instrumenteve ndërkombëtare të tipit klasik, të cilat konsiderohen novatore nga pikëpamja e modaliteteve të kontrollit të respektimit të angazhimeve nga vetë shtetet anëtare.

Së dyti, Bashkimi Europian, Mund të themi se Bashkimi Europian është hartuesi kryesor i normave mbikombëtare në fushën e së drejtës sociale në përgjithësi dhe atë të sigurimeve në veçanti, si në aspektin e efektivitetit ashtu edhe të diversitetit të së drejtës së krijuar.

"E drejta sociale e Bashkimit Europian" përfshin norma që njëherësh janë më të shumta në numër dhe më të mirëpërpiluara dhe mund të influencojnë thellësisht të drejtat kombëtare të shteteve anëtare, për shkak të efektit juridik që u është njohur. Shtetet europiane, shumica e të cilave nuk kanë marrë shumë angazhime të formave të përmendura, rrezikojnë të shpërndahen midis detyrimeve të parashikuara në aktet ndërkombëtare, që mund të mos përputhen me njëri-tjetrin dhe që për pasojë do të duhet të bashkërendohen në mënyrën më të harmonizuar të mundshme.

Shkurtimisht do të trajtojmë se cilat janë organizmat ndërkombëtare të

211 Kemi parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të 1948 ose Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 1966.

cilët kanë luajtur një rol të madh në fushën e sigurimeve shoqërore.

3.3/1 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)

ONP është një organizatë ndërkombëtare unike në llojin e saj, si në aspektin e kuadrit institucional ku janë përpiluar normat ndërkombëtare të punës, ashtu edhe në atë të mekanizmit të kontrollit të respektimit të angazhimeve nga ana e shteteve palë. Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e normave që ajo krijon, realizohet në përputhje me rregullat klasike të së drejtës ndërkombëtare.

Ndër veprimtaritë legislative më të spikatura të kësaj organizate në fushën e sigurimeve shoqërore mund të përmendim:

1. *Mbrojtja e punëmarrësve nga sëmundjet e përgjithshme dhe profesionale dhe nga aksidentet në punë.*
2. *Mbrojtja e të miturve dhe grave në punë*
3. *Pensionet e pleqërisë dhe të invaliditetit*

Në përputhje me objektivat e politikave të ndërmarra dhe parimeve bazë, veprimtaria e ONP-së është e përqëndruar më konkretisht në punësimin me kohë të plotë, vlerësimin e nivelit të jetesës, zhvillimin e sigurimeve shoqërore, mbrojtjen e shëndetit, shanseve të barabarta në punë.

A. Aktet normative të Këshillit të Europës

Normat europiane në fushën e sigurimeve shoqërore, të hartuara nën kujdesin e Këshillit të Europës gjenden në konventat ndërkombëtare të hartuara nga instancat e Këshillit të Europës. Këto konventa nuk u kushtohen gjithmonë ekskluzivisht çështjeve sociale, kjo për faktin se kjo organizatë ndërkombëtareme dimension europian ka si mision qendror që në të gjithë hapësirën e përbërë nga 47 anëtarë të përforcojë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës.

Këshilli i Europës u ka kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me të drejtën e punës dhe mbrojtjen sociale, ku ato janë trajtuar si çështje kryesore dhe dytësore. Disa prej këtyre konventave frymëzohen nga parime që janë sanksionuar në kuadrin e ONP-së. Në fakt që në fillimet e Këshillit të Europës synimi ka qenë që të dallohen qartë dy kategori të drejtash: nga njëra anë të drejtat civile dhe politike për të cilat konsensusi ishte lehtësisht i parashikueshëm dhe nga ana tjetër të drejtat ekonomike dhe sociale që janë me ndjeshmëri shumë të madhe për shtetet palë. Ky dallim që bazohet në arsye politike ashtu edhe ekonomike perceptohet kur vëzhgohen instrumentat e miratuara në kuadrin e Këshillit të Europës.

Për të ilustruar këtë ndarje, dy janë instrumentet që tërheqin më shumë vëmendjen:

- *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, ku vetëm disa dispozita lidhen shprehimisht me të drejtën sociale, por që përfundimisht ka shfaqur prirje ndaj të drejtave sociale.*
- *Karta Sociale Europiane që i kushtohet ekskluzivisht të drejtave sociale të individit.*

B. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Kjo konventë synon të mbrojë të drejtat themelore të individit kryesisht ato civile dhe politike. Disa prej këtyre të drejtave kanë dimension pak a shumë social, gjë që lejon që ky instrument të përmendet si burim i të drejtës sociale europiane dhe ndërkombëtare. Duke qënë se objekti kryesor i konventës është mbrojtja e të drejtave civile dhe politike, vetëm disa dispozita të izoluar mund të lidhen drejtpërdrejt me të drejtën sociale. Në këtë drejtim përmendim:

“Ndalimi i skllavërisë ose i punës së detyruar”²¹²

“Liria sindikale”²¹³

C. Karta Sociale Europine ²¹⁴

Kjo kartë përmban një tekst i cili i dedikohet ekskluzivisht mbrojtjes së të drejtave sociale, me të cilën ajo synon të përcaktojë një standart të përbashkët për të gjitha shtetet kontraktuese. Qëllimi kryesor i Kartës është promovimi i unitetit europian në fushën sociale. Kjo kartë përmbante si të drejta ekonomike ashtu dhe sociale. Si e tillë të drejtat e paraqitura në këtë kartë kanë shërbyer si objekt për krijimin e disa konventave të veçanta të miratuara nga ONP.

3.3/2 Roli i Skemave Profesionale të Pensioneve në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore

Në Kapitullin e dytë theksuam se një element i rëndësishëm i objektit të sistemit të sigurimeve shoqërore janë skemat profesionale të pensioneve, janë një ndër format e sigurimit të të ardhurave nga sektori privat. Skemat profesionale mund të menaxhohen në rastin e ndërmarrjeve të vogla nga ofruesit tregtar, ose të vetadministruar në rastin e kompanive të mëdha. Kostot e transaksionit të këtyre skemave janë shumë më të ulta se sa për marrëveshjet individuale.

Në mënyrë tipike, skema nuk është e hapur për njerëz që nuk punojnë në ndërmarrjen në fjalë, mbledhja e primeve ose kontributeve në këto skema është e drejtpërdrejtë. Skemat profesionale janë themeluar tradicionalisht me iniciativën e punëdhënësit, shumë prej këtyre skemave tani janë subjekt i marrëveshjeve kolektive dhe në disa vende janë bërë të detyrueshme me ligj ose me dekret.

Organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e skemave të pensioneve profesionale. Disa skema të industrisë së gjerë, në vende të tilla si Shtetet e Bashkuara, janë të drejtuara tërësisht nga sindikatat. Sot ka një kërkesë në rritje nga palët e interesuara, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për investimet e fondit të pensionit. Për miliarda dollar të kapitalit që qarkullon në tregjet globale, shumë organizata kombëtare e punës kanë ndërmarrë hapa dhe përpiqen për të kontrolluar dhe për t'i përcjellë këto fonde për të avancuar interesa e punëtorëve.

²¹² Neni 4 i KEDNJ

²¹³ Neni 11 i KEDNJ

²¹⁴ Karta Sociale Europiane që u nënshkrua në Torino në 18 Tetor 1961 dhe hyri në fuqi në 1965, në 1 Maj 2010 numëronte 27 palë kontraktuese.

3.3/3 Roli i Qeverisë dhe Insitucioneve në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore.

Në shumicën e vendeve organizimi dhe ofrimi i përfitimeve sociale janë kryesisht përgjegjësi e autoriteteve publike. Referuar aspektit historik, zhvillimi i sistemeve kombëtare të mbrojtjes sociale shpesh reflekton dëshirën e ligjvënësve për të harmonizuar dhe për të bërë skema të detyrueshme, të varieteteve të ndryshme, të cilat të mund të përmbushnin standardet e shoqërisë pjesëmarrëse.

Struktura e skemës së sigurimeve shoqërore shpesh do të përcaktojë masat për administrimin e saj. Kështu, skemat që ofrojnë përfitime universale kanë më shumë gjasa që të administrohen direkt nga shteti. Por ka një spektër të gjerë të marrëveshjeve institucionale, duke filluar nga administrata e drejtpërdrejtë e deri tek një department i qeverisë, për mbështetje të menaxhimit të sektorit privat.

Mirëpo ka edhe shtete ku tradita e sigurimit social (ose parimi kontributiv) është më e fortë.²¹⁵ Në shtetet ku mbizotëron parimi kontributiv, skemat janë të administruara në përgjithësi nga një institucion publik, i cili është mbikqyrësi kryesor i skemës së sigurimeve shoqërore²¹⁶.

Veçanërisht, në disa vende në zhvillim, segmentimi administrativ ka qënë shkaku kryesor i mungesës së fokusit në politikat e mbrojtjes sociale. Qeveria, politikëbërja është përqëndruar shpesh në Ministrinë e Financave, e cila ka prirje që të ketë një interes të veçantë në menaxhimin e fondit kontributiv në përgjithësi, por për pensionet në veçanti.

Ministritë e ndryshme, si Mirëqënia Sociale, Ministria e Shëndetësisë mund të jenë gjithashtu përgjegjëse për administrimin e skemave të ndryshme të sigurimeve shoqërore, edhe pse ato janë të menaxhuara në mënyrë direkte nga institute ose nga agjenci të veçanta për sigurime shoqërore. Në varësi të shkallës së decentralizimit fiskal, në vende të ndryshme edhe qeveritë në nivel lokal mund të kenë një rol të pavarur dhe funksionojnë në fushën e mbrojtjes sociale, por kryesishtjo në sistemin e sigurimeve shoqërore, por veçanërisht në lidhje me ndihmën sociale.

3.3/4 Roli i Partneriteteve në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore

Përveç forcimit të rolit të aktorëve të ndryshëm në mbrojtjen sociale, të listuara më sipër, ekziston një numër i madh i mënyrave në të cilat partneritetet mund të formësohen mes tyre, në mënyrë që të rrisin efektivitetin e sigurimeve shoqërore dhe të zgjerojnë mbrojtjen sociale. Në këtë punim ne do të përmendim vetëm disa prej tyre.

- *Rritja e efektivitetit të sigurimeve shoqërore.*

Rritja e efikasitetit të sigurimeve sociale nuk mund të kuptohet pa u mbështetur në partnerin kryesor që është Shteti. Shteti nëpërmjet mekanizmave të tij është aktori kryesor i ndërtimit të sistemeve të sigurisë sociale dhe i ndikimit në efektivitetin e tyre, në mënyra të ndryshme si:

²¹⁵ Shtete të tilla mund të përmendim Francën dhe Gjermaninë dhe në pjesën më të madhe të Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine dhe Karaibet.

²¹⁶ Skema jonë e sigurimeve shoqërore është një skemë që udhëhiqet nga parimi kontributiv. Sigurimet shoqërore organizohen nga një institucion publik. Ky institucion publik përbëhet nga bordi i drejtorëve përfaqësues të ministrive të linjës i cili pa ndryshim është ligjërisht autonom në vendimmarrje, por gjithmonë brenda kuadrit të politikave sociale, ekonomike, dhe frymës qeverisëse të pushtetit. Menaxhimi i skemës kontributive realizohet nga një drejtor ekzekutiv, i cili mund të emërohet nga bordi ose ministri.

- *Organizimi dhe ofrimi i përfitimeve sociale;*
- *Hartimi i Rregulloreve për vendosjen e detyrimeve për punëdhënësit për të siguruar përfitime apo për të detyruar shoqëritë tregtare të sigurimit apo fondet private të pensioneve për të ruajtur standardet e përshkruara;*
- *Hartimin e politikave fiskale, duke përfshirë koncesionet e taksave për përfitime të sigurimeve shoqërore ose të kontributeve;*
- *Ratifikimi i Konventave të ONP-së për sigurimet shoqërore dhe pjesmarrja në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të sigurimeve shoqërore.*

Një arsye tjetër e rëndësishme në lidhje me pjesëmarrjen e partnerëve socialë është fakti se skemat e sigurimeve shoqërore janë të financuara tërësisht apo kryesisht nga kontributet të cilat punëdhënësit dhe punëtorët paguajnë në bazë të të ardhurave të punës. Megjithatë, edhe në rastin e skemave të cilat financohen nga të ardhurat e taksave të përgjithshme dhe të administruara nga një department i qeverisë, partnerët social mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e politikave dhe në bërjen e sistemeve më të përgjegjshme ndaj nevojave të punëtorëve. Forma të tjera të pjesmarrjes popullore në këto skema mund të shërbejnë për t'i rritur ato.

Në shumë vende përgjegjësinë për ofrimin e mbrojtjes sociale, sidomos për pensionet dhe kujdesin shëndetësor, në mënyrë jo të qartë nga legjislacioni, i është atribuar ndërmarrjeve si përgjegjësi të punëdhënësit. Zakonisht qëllimet e shtetit janë treguar në mënyrë të qartë nga fakti se ndërmarrjet (dhe në një masë më të vogël të punësuarit) marrin koncesione të konsiderueshme tatimore nëse i plotësojnë këto përgjegjësi.

Punëtorët e paguar në punë më pak të sigurta, veçanërisht gratë, kanë prirje për të përfituar më pak nga skemat vullnetare të punëdhënësve. Sigurimi i mbrojtjes sociale në këtë mënyrë dhe jo përmes sigurimeve shoqërore mund të shprehet në pabarazi më të madhe në shpërndarjen e përfitimeve.

Legjislacioni ose vetë qeveritë nëpërmjet vendimeve të tyre, në disa vende zgjeruan skemat private ose profesionale të pensioneve për të mbuluar të gjitha ndërmarrjet dhe punëtorët në një industri apo edhe të gjithë sektorët e ekonomisë. Sistemi i krijuar ishte një formë e ndërmjetme midis skemave të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe skemave private vullnetare.

Kysistem kombinon avantazhet e mbulimit të gjerë për grupime të ndryshme nga rreziku social, me autonomi nga çdo përfaqësues i drejtpërdrejtë i shtetit. Baza e shëndoshë financiare e skemave të tilla dhe kërkesa absolute për ata që do të menaxhohen bashkërisht nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëtorëve, krijojnë kushte të favorshme për funksionimin e tyre.²¹⁷ Në të kundërt, në vende të cilat mbështeten gjerësisht në skemat individuale të kompanisë, sistemet e mëdha rregullatore janë shoqëruar në disa raste me krijimin e mekanizmave të garantimit të pensioneve.

Në nivel stukturor, ka pasur argumentime kundër parimeve të sigurimeve shoqërore me menaxhim publik. Qëndrime të ndryshme kanë hedhur idenë se nga njëra anë kjo skemë luan rol mbrojtës mbi individët, por nga ana tjetër detyrimi për të qënë pjesmarrës vetëm në këtë skemë të

217 Përvoja në vende të tilla si Finlanda, Franca dhe Holanda sugjeron se këto masa themelore në shkallë të madhe lehtësojnë funksionin rregullator të shtetit.

detyrueshme, heq lirinë e tyre të zgjedhjes për alternativa të tjera skemash sigurimesh shoqërore. Një shembull i tillë është skema jonë e sigurimeve shoqërore. Kjo skemë me menaxhim shtetëror, nuk lejon alternativa të tjera për mbulimin me sigurime shoqërore bazë.²¹⁸

Nëse subjektet duan sigurime të tjera shtesë ata mund të sigurohen në sisteme të tjera alternative, por pa hequr dorë nga kontributi në skemën shtetërore.

Pra, sheti ofron një nivel minimal të mrojtjes sociale dhe pastaj krijon dhe nxit një mjedis në të cilin mund të bëhen marrëveshje private në fushën e sigurimit shoqërorë.

Një tjetër argument në lidhje me sigurimet shoqërore të cilat administrohen nga shteti, lidhet me faktin se ato nuk janë subjekt i konkurrencës në treg(ata janë në mënyrë efektive monopol shtetëror) dhe fondi i sigurimeve nuk investohet për të sjellë fitim për kontributet.

Ndryshe ndodh me skemat me financim, fondi i të cilave është pjesë e investimit dhe konkurrencës në treg. Ka pasur një prirje ku shumë teoricienë që merren me shkencën e sigurimeve shoqërore, theksojnë faktin se nëse fondi i sigurimeve do të jetë konkurrues në treg, kjo do të ketë një efekt në përgjithësi të dobishëm për përfituesit e këtyre skemave.

Megjithatë, përvoja ka treguar se financimi i fondit të sigurimeve shoqërore nga kompanitë private të cilat operojnë në këtë fushë, është shumë më i kushtueshëm në disa drejtime:

- *Për të administruar llogaritë e kursimeve individuale;*
- *Për menaxhimin e fondeve të pensioneve;*
- *Për përballimin e kostove të larta për marketing;*
- *Shkakton nivelet e lartë të përqëndrimit të fondeve të pensioneve.*

3.3/5 Sigurimi i mbrojtjes sociale për të gjithë shtetasit.

Sigurimi i mbrojtjes sociale për të gjithë shtetasit mbetet një element shumë i rëndësishëm. Shtigjet e përshtatshme për zgjerimin e mbulimit me sigurime shoqërore varen ndjeshëm nga sfidat e përmendura më lart, siç janë niveli i zhvillimit ekonomik të vendit, gjendja e sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shkalla e informalizimit të punësimit. Disa nga vendet e industrializuara kanë arritur mbulim të plotë personal për disa rreziqe sociale të papritura, por jo për të tjerët. Si rezultat, në këto vende zgjerimi i mbulimit me sigurime shoqërore mund të arrihet brenda kontekstit të sistemeve ekzistuese.

Për vendet me një zhvillim me të ardhura mesatare, mund të jetë e mundur që për disa rreziqe sociale të papritura të mund të arrijnë mbulim universal me anë të sistemeve ekzistuese. Në raste të tjera, mund të jetë e nevojshme për të zhvilluar dhe skemat mbështetëse të krijuara në mënyrë specifike, për të përmbushur nevojat e punëtorëve në ekonominë informale. Duke pasur parasysh përmasat e vogla të sektorit formal në vendet me të ardhura në zhvillim, është e domosdoshme t'u jepet prioritet projektimit të skemave për të përmbushur nevojat e punëtorëve të ekonomisë informale.

²¹⁸ Çdo alternativë tjetër i referohet sigurimit suplementar privat.

- Strategjitë për ofrimin e mbrojtjes sociale

Fakti që mbrojtja sociale mbetet një element shumë i rëndësishëm i shoqërisë, përpjekjet për të realizuar një mbulim të plotë kur individët goditen nga rreziqet sociale janë shumë të mëdha, por nuk janë gjithmonë të garantuara. Mënyra se si organizohet mbulimi i subjekteve nga skemat e sigurimeve shoqërore është një element shumë i rëndësishëm. Kjo për faktin se edhe në vendet e industrializuara ku niveli i ekonomisë është i lartë, ndeshen fenomene të mbulimit të paplotë me sigurime shoqërore.

Në raste të tilla sfida e skemës së sigurimeve shoqërore orientohet me realizimin e mbulimit të plotë me sigurime shoqërore, ose me zgjerimin e sigurimit të detyrueshëm për të gjithë ose shumicën e popullsisë, duke përdorur skemat ekzistuese të sigurimeve shoqërore, ose modifikimin e tyre në përshtatje me nevojat e kategorive të reja të popullsisë që do të mbulohen. Ndërsa po t'i referohemi vendeve me të ardhura të ulta, duhet të theksojmë se çdo rritje e vërtetë në mbulimin me sigurime duhet që të arrihet nëpërmjet:

- *Zgjerimit të skemave të sigurimeve shoqërore;*
- *Politikave inkurajuese të mikro-sigurimit;*
- *Futjen e përfitimeve universal ose shërbimeve të financuara nga të ardhurat e përgjithshme të shtetit.*

Më konkretisht:

- Zgjerimi i skemave të sigurimeve shoqërore

Skema e sigurimeve shoqërore është e detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë. Por jo gjithmonë shoqëria është e ndjeshme ndaj këtyre skemave dhe kjo në shumicën e rasteve vjen si pasojë e disa kufizimeve që janë vendosur në skemë, në lidhje me llojin e mbulimit dhe masën e përfitimit. Megjithatë pavarësisht kufizimeve të vendosura, tendenca e shtetit është të realizojë mbulim për të gjithë shtetasit. Sot fshehja nga pagesa e sigurimeve mbetet një element i dukshëm, natyrshëm lind pyetja: Pse? Ne do të rendisim disa arsye në lidhje me këtë pyetje:

- *Mungesë e presionit në drejtim të atyre shtetasve të cilët nuk janë kontribues*
- *Mungesë e ndërgjegjesimit të shtetasve për përfitimet që do të kenë nëse ata do të sigurohen*
- *Mungesa e partneritetit social efektiv dhe efikas brenda vendeve të caktuara dhe në nivel ndërkombëtar*
- *Mosgadishmëri apo paaftësia e qeverive për të marrë përsipër angazhime të reja dhe potencialisht të kushtueshme.*

Mungesa e presionit në drejtim të atyre shtetasve, të cilët nuk janë kontribues dhe mungesa e ndërgjegjesimit të shtetasve për përfitimet që do të kenë, nëse ata do të sigurohen, pasqyrojnë nivelin relativisht të ulët të organizimit mes njerëzve të cilët janë të pambrojtur.

Mungesa e partneritetit social efektiv ndërmjet shtetit dhe individëve, ka të bëjë me faktin se subvencionet, të cilat ofrohen nga qeveria për ato kategori

subjekteshtë përcaktuara në ligj, për pakicën e popullsisë, që është pjesë e sistemit të sigurimeve shoqërore, do ta bënte shumë të shtrenjtë zgjerimin e mbrojtjes në mënyrë të konsiderueshme për këto kategori.

Për sa më sipër duhet të theksojmë faktin se, institucionet të cilat përgatisin propozimet për të zgjeruar mbulimin me sigurime shoqërore, janë ata që janë përgjegjës për administrimin e sistemit ekzistues dhe shpesh administrim i cili në jo pak raste realizohet në kushte të vështira. Për këtë arsye, këto institucione, mund të kenë pak nxitje për të propozuar shtrirjen e mbulimit me sigurime, vecanerisht për kategoritë të cilat subvencionohen nga shteti.

Heqja e kufizimeve për lirinë e përfshirjes në këto skema nga njëra anë dhe forcimi i institucioneve demokratike nga ana tjetër, janë mekanizma të cilat do të ndihmojnë për të nxitur bisedimet kolektive. Implikimet negative për buxhetin e shtetit, me qëllim zgjerimin e mbulimit me sigurim shoqëror, mund të reduktohen apo riorientohen, kur konstatohet se numri i subjekteve që do të përfitojnë është vetëm një pakicë dhe nuk mund të mendohet të shtrihet në shumicën e fuqisë punëtore.

Përpjekje të spikatura vihen re në mënyrë të vazhdueshme për të zgjeruar skemat ekzistuese të sigurimeve shoqërore për të mbuluar të vetëpunësuarit. Numri i kontribuesve në këto skema realisht është më i vogël sesa pritshmëritë. Kjo për arsye se shumë pak subjekte kanë ndjeshmërinë të bashkohen në këto skema për faktin se ato nuk janë të gatshëm - dhe në të vërtetë shpesh të paafte - për të paguar punonjësit me kontributin e punëdhënësit.

Vetëm në disa raste njerëzit nuk kanë nevojë për mbulimin e detyrueshëm që të ketë një nxitje të fortë për të kontribuar vullnetarisht, për shembull për të ruajtur të drejtat e tyre pensionale apo për të përfunduar periudhën minimale e kërkuar për t'u kualifikuar për një pension. Sa për mbulimin e detyrueshëm të të vetëpunësuarve, kjo është e vështirë për t'u arritur, duke pasur parasysh problemet në identifikimin e faktit se cilët janë të vetëpunësuar dhe cilët janë ata që fitojnë nga ky vetëpunësim.

Disa skema të veçanta për punëtorët e vetëpunësuar janë të prirura të kenë më shumë sukses, sidomos në qoftë se qeveria është e gatshme për të subvencionuar në to. Megjithatë, nëse kjo kategori do të ketë nivel të ulët kontributesh dhe përqendrimi në përfitime të cilat janë me interes më të madh të vetëpunësuarve, si përfitime për të mbijetuarit dhe të sigurimit të invaliditetit, janë elementë të rëndësishëm dhe e bëjnë më të lehtë arritjen e përputhshmërisë.²¹⁹

Inkurajimi i mikrosigurimit dhe specifikat për punëtorët e ekonomisë informale

Në vitet e fundit grupe të ndryshme punëtorësh në ekonominë informale kanë ngritur skemat e tyre të mikrosigurimit. Përvoja mbarëbotërore eidenton se këto skema të sigurimit janë menaxhuar në mënyrë të pavarur në nivel lokal dhe ndonjëherë në njësi vendore.

Termi *mikrosigurim*, i referohet aftësisë për të trajtuar flukset monetare të vogla në raport me të ardhurat dhe shpenzimet, jo me madhësinë e skemës edhe pse shpesh skema të tilla janë në fakt lokale dhe të përbëra nga një numër shumë i vogël anëtarësh. Qëllimi kryesor i shumë prej këtyre skemave është të ndihmojë anëtarët pjesëmarrës në rastin e shfaqes së

219 Shëmbujt e fundit të zgjerimeve të suksesshme të mbulimit të detyrueshëm janë Namibia, ku përafërsisht 80 për qind e punëtorëve të sektorit formal ishin të mbuluar dhe skema gëzonte popullaritet të gjerë. Suksesi i skemës i atribuohet administrimit efikas të kontributeve të ulëta.

rrezikut social të sëmundjes. Ata zakonisht nuk parapëlqejnë që të ofrojnë sigurim të plotë shëndetësor.

Skema të tilla zakonisht kanë avantazhet e kohezionit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë. Ato gjithashtu, mund të arrijnë kosto në ulëta administrative, por pikëpamjet ndryshojnë shumë në lidhje me kosto-efektivitetin e tyre. Këto skema, mund të veprojnë në kuadrin e një skeme të kredisë²²⁰.

Është vlerësuar se këto skema zakonisht tërheqin rreth 25 për qind, ose më pak të popullsisë në lokalitetet ku ata ndodhen. Të vetmet skema të cilat arrijnë të kenë norma të larta të depërtimit (në mes 50 dhe 100 për qind) janë ato në komunitete veçanërisht të lidhura ngushtë, ose ato ku të gjithë anëtarët e grupit aderojnë në një sindikatë apo shoqatë profesionale. Kjo përqindje edhe pse larg nga ajo që duhet të jetë realisht, është shumë më e lartë se ajo e arritur nga skemat e sigurimit shoqëror të hapura në baza vullnetare për të vetëpunësuarit.

Këto skema mund të kenë potencial për të rritur në mënyrë të konsiderueshme mbulimin e mbrojtjes sociale, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe duke punuar së bashku me skemat e sigurimeve shoqërore, të pushtetit lokal dhe kombëtar dhe organizata të tjera në shkallë të gjerë. Ka mënyra të ndryshme në të cilat shteti mund të promovojë skema mikro-sigurimi. Si të tilla mund të përmëndim:

- *Mbështetje financiare, nëpërmjet pagesës së subvencioneve në formën e kontributeve.*
- *Krijimi i një kuadri ligjor dhe rregullator për të mundësuar sigurimin e menaxhimit demokratik dhe ekonomikisht të shëndoshë të skemës.*

Mbetet për të vërtetuar potencialin e skemave të mikro-sigurimeve në praktikë. Ndoshta nuk ka justifikim për këto skema. Për të marrë më shumë mbështetje dhe siguri ata duhet të jenë subjekti i hulumtimit të mëtejshëm. Përfshirja e përfitimeve universale ose shërbime të financuara nga të ardhurat e përgjithshme të shtetit.

Përfitimet universale të mjeteve monetare gjenden në një numër të vendeve të industrializuara, por shumë rrallë në vendet në zhvillim. Shërbimet universale, shërbimet e shëndetit publik në veçanti, janë më të zakonshme. Megjithatë në vitet e fundit, karakteri universal i këtyre shërbimeve shëndetësore ka qenë dëmtuar në masë të madhe nga imponimi i tarifave të përdoruesve, nga të cilat vetëm të braktisurit prirën të jenë të përjashtuar.

Nga përkufizimi, kuptojmë se skema universal e shtrin mbulimin në 100 për qind të popullsisë të synuar, për shembull, ata subjekte mbi një moshë të caktuar, pa ndonjë kusht për kontribut apo test të të ardhurave. Këto skema shmangin shumë nga problemet të cilat shfaqen në sistemet kontributive.

Megjithatë, duhet patur parasysh se kushte të tilla si mosha e pensionit, mund të jetë mjaft kufizuese për sa i përket nivelit të përfitimit, që do të thotë se ky nivel do të jetë shumë i ulët. Një karakteristikë e këtyre skemave është masa e përfitimit, një shumë fikse për të gjithë ata që

²²⁰ Të tilla si Banka Gramën, e cila ka përvojë në mbledhjen e Kontributeve dhe të administrimit të pagesave. Nga ana tjetër, si në Argentinë, organizatat e përfitimit të ndërsjellë mund të krijojnë skemën e kreditit në mënyrë për subvencionimin e aktivitetin e tyre në fushën e kujdesit shëndetësor.

kualifikohen si pjesëmarrës në këtë skemë. Shuma fikse e përfitimit është një element shumë i rëndësishëm që ndihmon për të mbajtur poshtë koston e skemave universale.

Skemat universale rrisin në masë të madhe barazinë gjinore. Ato mbulojnë njerëzit pa marrë parasysh statusin e tyre të punësimit dhe historinë e punës dhe gratë marrin të njëjtën vlerë e dobi ashtu si burrat. Problemi i vërtetë me skemat ekzistuese universale të cilat gjenden kryesisht në botën e industrializuar, nuk është aq shumë kostoja e tyre totale e cila është zakonisht më pak se ajo e skemave kontribuese, por fakti se - ndryshe nga skemat kontributive- ata do të financohen nga të ardhurat e përgjithshme të qeverisë dhe për këtë arsye duhet të konkurojnë çdo vit me të gjitha prioritetet e tjera të shpenzimeve të qeverisë.

Ato që mund të perceptohen si të përballueshme një vit mund të jenë më pak të përballueshme në të ardhmen nëse politikat apo kushtet ekonomike kanë ndryshuar. Forma më të gjera të mundshme të përfitimit universal përveç pensionit social²²¹, apo kujdesit për të miturit (që gjen aplikim në shumë vende ku funksionojnë këto skema),tentohet të zgjerojnë këto skema edhe me ato subjekte të cilët nuk janë në kushte për të fituar jetesën e tyre, por edhe për të paaftët për punë edhe pse në moshë pune.

²²¹ Pensioni Social është propozuar të përfshihet edhe në skemën tonë të sigurimeve, si kolona e tretë. Kjo kolonë do të financohet totalisht nga të ardhurat e buxhetit të shtetit.

KAPITULLI

IV

4.1 SFIDAT E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

4.2 SFIDA EKONOMIKE

4.3 SFIDA DEMOGRAFIKE

4.4 SFIDA POLITIKE

4.5 SFIDA SOCIALE

KAPITULI IV

Hyrje

Në këtë kapitull do të trajtohen sfidat kryesore me të cilat përballet sistemi i sigurimeve shoqërore. Për të pasur një sistem garantues për të gjithë popullsinë, skemat e sigurimeve jo vetëm në vendin tonë por në të gjithë botën ballafaqohen me shumë sfida të rëndësishme të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në efikasitetin e sistemit të sigurimeve shoqërore. Në këtë kapitull do shikojmë trajtimin e katër sfidave të cilat janë konsideruar si më të rëndësishme si pasojë e rolit të tyre të drejtëpërdrejtë në skemë. Sfidat janë:

- *Ekonomike*
- *Demografike*
- *Politike*
- *Sociale*

Në analizën e sfidës Ekonomike do të analizohen dy probleme makro-ekonomike, me rrënjë shumë të thella

- *Rritja e dobët ekonomike*
- *Niveli i lartë i papunësisë*

Kjo analizë do të shoqërohet me grafika të ndryshme të cilat tregojnë ndikimin e ekonomisë në gjendjen aktuale të skemës së sigurimeve shoqërore.

Analiza e sfidës Demografike është trajtuar hollësisht në këtë kapitull me të gjithë elementët e saj përbërës si:

- *Strukturën e moshës*
- *Raporti ndërmjet rritjes së moshës së popullsisë mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë.*
- *Lëvizjet migratore dhe emigrimi*
- *Lindjet dhe vdekjet.*

Nëpërmjet analizës të këtyre elementëve krijohet një panoramë e saktë e gjendjes së kontribuesve aktualë, por nga ana tjetër nëpërmjet evidentimit të trendeve, mundëson marrjen e masave për parandalimin e fenomeneve negative në skemë dhe ndërhyrjen e menjëhershme në konstatimin e faktit negative. Në këtë kapitull do të paraqiten edhe rrugët për eliminimin e këtyre efekteve.

Sfida Politike, analizohet për vetë faktin se politika është një element i pandashëm i skemës së sigurimeve shoqërore. Sot në botë ka një numër të madh diskutimesh në lidhje me skemat që aplikohen në sistemet e sigurimeve shoqërore, konkretisht diskutimi fokusohet në skemat DB skema me përfitime të përcaktuara dhe skemat NDC skemat me kontributet nacionale të përcaktuara. Sot në botë ekspertët kanë ulur ndjeshëm besimin në sistemet e pensioneve Pay As You Go ose ndryshe PAYG. Ky fakt përbën një sfidë të jashtëzakonshme politike, duke qenë

se çdo reformë e re që do të ndërmerret duhet të provojë se më në fund gjërat do të bëhen më mirë se përpara reformës. Reformat në fushën e pensioneve shoqërohen me strategji të qëndrueshme politikash ku si kontribuesit ashtu edhe përfituesit të dinë që më parë se çdo të bëhet me ta në të ardhmen.

Sfida Sociale, konsiderohet si një element shumë i rëndësishëm për sistemin e sigurimeve shoqërore të çdo shteti. Rëndësia e kësaj sfide lidhet me vetë qëllimin e krijimit të sistemit të sigurimeve shoqërore. Forcimi dhe zgjerimi i dialogut social ka qënë dhe vazhdon të jetë prioritet i shtetit. Njerëzit dhe shoqëritë i kanë zhvilluar në kohë të ndryshme dhe forma të ndryshme mbrojtjen e shoqërisë nga rreziqet sociale, kjo sipas nevojave të shoqërisë dhe modelit të zhvillimit social dhe ekonomik. Analiza sociale është mbështetur në rëndësinë e disa elementëve bazë përbërës të partneritetit social si Sindikatat dhe Institucionet e Shoqërisë

4.1 SFIDAT E SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Zhvillimi i shoqërisë, civilizimi i individëve të saj, raporti midis të rinjve dhe të moshuarve, raporti i lindjeve dhe i vdekjeve, raporti midis grave dhe burrave, ndryshimi i ekuilibrave ekonomikë, reformat politike, ndikojnë drejtpërdrejt në çdo element të sistemit të sigurimeve shoqërore, duke luajtur një rol të rëndësishëm në funksionimin e tij.

Ky sistem është detajuar që të mbulojë me sigurime shoqërore ose e thënë ndryshe me të ardhura, të gjithë subjektet që janë pjesë e tij, kur ata goditen nga ngjarje sociale si moshë e thyer, sëmundje, papunësia, humbja e mbajtësit të familjes etj.

Ky sistem në themel të tij ka zbatimin e drejtësisë sociale për të gjithë subjektet pjesëmarrëse në to. Përpjekjet për zbatimin e drejtësisë sociale do të ishin perfekte, sikur të mos kishte pengesa të karakterit:

Ekonomik;

Demografik;

Politik;

Social;

Këto pengesa konsiderohen të rëndësishme për sistemin e sigurimeve shoqërore, sepse pasojnë prishjen e ekuilibrave të skemave përbërëse të tij. Gjithashtu, prishja e ekuilibrave demografikë, ekonomikë, politikë dhe socialë, luan rol të rëndësishëm në disa momente kyçe të funksionimit të skemave të sigurimeve shoqërore. Si të tilla mund të përmendim: procesin e mbledhjes së kontributeve, shpërndarjen e të ardhurave (pagesave) në drejtim të përfituesve të skemës, momentin e llogaritjes së shpenzimeve, bazuar në analizën e hollësishme të ekuilibrave financiare të skemave të mësipërme të sigurimit dhe degëve të tij.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se një popullsi e plakur nuk mund të ofrojë garanci në skemat e pensioneve, sepse do të rrisë nivelin e shpenzimeve të skemës së detyrueshme për pensione. Një ekonomi e dobët nuk mund të jetë garant për zbatimin e planeve makroekonomike, e

për rrjedhojë do të sjellë pengesa të dukshme në hapjen e vendeve të reja të punës dhe uljen e numrit të kontribuesve.

Vendimet politike, në lidhje me reformat në sistemin e sigurimeve shoqërore, janë një element tjetër i rëndësishëm në lidhje me suksesin ose jo të skemës së sigurimeve shoqërore. Nëse këto vendime do të jenë të drejta, atëherë dhe kërkesat e grupeve të interesit do të plotësohen brenda standarteve të pritshmërisë. Efektet pozitive të menaxhimit të mirë të demografisë, ekonomisë dhe politikës, në fund mund të kuptohen si një sukses i skemës në dobi të subjekteve pjesëmarrës në të. Kjo lidhet me faktin se, çdo përpjekje pozitive në lidhje me elementet e mësipërme, konvertohet në garanci përfitimesh për subjektet pjesëmarrës në skemë.

Nëse këto elemente nuk funksionojnë siç duhet atëherë rreziku në lidhje me realizimin e qëllimit për të cilin janë krijuar këto skema mbetet shumë i madh. Sa më i madh paraqitet ky rrezik, aq më të vogla do të jenë përfitimet që ofrohen nga këto skema, për rrjedhojë, reagimet e grupeve të interesit do të jenë një presion i madh për çdo qeverisje. Objekt i këtij kapitulli do të jetë analizimi i hollësishëm i këtyre sfidave dhe ndikimi i tyre në sistemin e sigurimeve shoqërore.

4.2 Sfida Ekonomike

Funksionimi ekonomik i skemës së sigurimeve shoqërore jo vetëm në vendin tonë por pothuajse në të gjithë botën, ballafaqohet me dy probleme makroekonomike, me rrënjë shumë të thella: *rritja e dobët ekonomike dhe niveli i lartë i papunësisë*. Të dy problemet e mësipërme, shkojnë paralelisht me njëri tjetrin. Duke krijuar kështu vështirësi në rritjen e fondit të kontributeve. Kontributet përbëjnë burimin kryesor të financimit të sigurimeve shoqërore, si të tilla përpjekjet e politikave ekonomike në lidhje me përmirësimin e sistemit të sigurimeve shoqërore lidhen ngushtësisht me rritjen e tyre.

Shtimi i kontributeve në skemë ballafaqohet me një sërë problemesh por ato që konsiderohen më kryesore janë problemet ekonomike të vendit. Rritja e ekonomisë sjell për rrjedhojë dhe rritje të vendeve të punës. Ndikimi i këtyre probleme herë shfaqet pozitivisht dhe herë negativisht. Nëse do të kemi nivel të lartë ekonomik do të kemi vende pune dhe për rrjedhojë do të kemi më shumë kontribues në skemë. Rritja e numrit të kontribuesve në skemë do të sjellë një fuqizim ekonomik të skemës dhe rritjen e garancisë për mbulimin e pagesave nga skema.

Në këtë aspekt, duhet theksuar se qëllimi më urgjent i politikës ekonomike është rritja e vendeve të punës. Sado i vogël të jetë zhvillimi i vendit, ndikimi i tij duhet të ndihet edhe te vendet e punës. Rritja e numrit të vendeve të punës, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në skemën e sigurimeve shoqërore, në pjesën e kontributeve. Rritja e vendeve të punës shkon paralelisht me rritjen e kontributeve. Rritje e kontributeve do të thotë, qëndrueshmëri e skemës, garanci në pagesa dhe rritje përfitimesh në dobi të grupeve të interesit.

Nëse ekonomia e një vendi ecën me hapa të konsiderueshëm, atëherë problemi i papunësisë vjen duke u zvogëluar. Në një ekonomi të zhvilluar, rritja e vendeve të punës është një ndër elementet kryesore më të rëndësishme, për të siguruar bazën ekonomike që duhet të mbështesë sistemet e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe sistemet e pensioneve, në veçanti.

Më konkretisht në vendin tonë niveli i papunësisë është parashikuar si më poshtë: Nëse do t'i referohemi situatës së punësimit të shkuar, aktuale dhe të supozuar në të ardhmen në vendin tonë, konstatojmë se në vendin tonë niveli i papunësisë është parashikuar si më poshtë:


Shkalla e papunësisë për meshkujt, nga 12.1 në vitin 2005, shkon në 6% në vitin 2020, 5% në vitin 2050 dhe më pas mbetet konstante deri në vitin 2075.²²²

Shkalla e papunësisë për femrat, nga 17.2 në vitin 2005, shkon në 8.5% në vitin 2020, 5% në vitin 2050 (në këtë vit barazohet me shkallën e papunësisë për meshkuj) dhe më pas mbetet konstante ashtu si për meshkujt, deri në vitin 2075.²²³

Duke iu referuar këtyre të dhënave konstatojmë se kjo shkallë papunësie, shoqërohet dhe me mungesë kontributesh në skemën e sigurimeve shoqërore. Mungesa e kontributeve do të thotë mos mbulim me sigurim shoqëror. Për të parë shkallën e mbulimit me kontribute të personave të punësuar në vite, do t'i referohemi studimit mbi Politikën e pensioneve, përgatitur nga Ministria e Mirëqenies dhe Çështjeve Sociale. Në këtë dokument parashikohet se: Shkalla e mbulimit me sigurime shoqërore, që shpreh raportin e numrit të kontribuesve ndaj forcave të punës, ka rënë gradualisht nga 33.76% në 32.41% në periudhën 1994-1999. Më pas ky tregues vjen në rritje, duke arritur në 58.4% në vitin 2012.

Ky tregues dëshmon për zvogëlimin e dukurisë së evazionit të kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore. Nëse krahasojmë numrin e të siguruarve me popullsinë në moshë pune situata bëhet akoma më alarmante. Grafiku i mëposhtëm tregon se vetëm 1/3 e popullsisë në moshë pune është e mbuluar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, çka do të thotë se aftërsisht 2/3 e shqiptarve që sot janë në moshë pune rrezikojnë të mbeten pa pension në të ardhmen

TAB. 1/5²²⁴ - Numri i kontribuesve krahasuar me popullsinë në moshë pune në vitet 2005-2013



²²² Këto supozime përputhen me propozimin e ardhur për këtë tregues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta deri në vitin 2050.

²²³ Këto supozime përputhen me propozimin e ardhur për këtë tregues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta deri në vitin 2050.

²²⁴ Tabela është shkëputur nga dokumenti i politikave të pensioneve hartuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Një tjetër problem i cili duhet theksuar kur bëhet fjalë për nivelin e punësimit është fenomeni i *informalitetit* në drejtim të sistemit të sigurimeve shoqërore. Informaliteti në drejtim të skemës së sigurimeve shoqërore, shfaqet në formën e fshehjes së pagesës së kontributeve për sigurime shoqërore. Informaliteti është një fenomen i përhapur në vendin tonë, por edhe në vende të tjera të Europës. Vlerësimet lidhur me përmasën e sektorit informal në Shqipëri, tregojnë se ekonomia informale luhetet mes 30 deri në 60 % të GDP-së. Ndërsa sipas raportit të fakteve të CIA-s, ekonomia informale zë rreth 50 % të GDP-së. Ndonëse kemi një sektor të madh informal, thellësia e informalitetit është e ndryshme në aktivitete të ndryshme ekonomike. (sqarohen më poshtë)

Informaliteti në drejtim të skemës së sigurimeve, shfaqet në dy forma:

- *Puna e zezë*
- *Eminenca gri.*

Puna e zezë, konsiderohet një plagë e madhe e shoqërisë shqiptare. Puna e zezë është një dukuri shumë e përhapur në vendin tonë. Ekzistenca e këtij fenomeni, ka të bëjë kryesisht me 2 arsye kryesore:

- *Nivelin e ulët ekonomik*
- *Mungesën e traditës në pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore.*

Në lidhje me arsyen e parë, duam të theksojmë se në një ekonomi me normë fitimi të ulët, ajo pjesë e shoqërisë që jeton në kushte jo të mira ekonomike, ka tendencë që të gjitha të ardhurat që fiton nga puna (paga), t'i vërë në shërbim të standardit të jetesës, më shumë se t'i ndajë ato me skemën e sigurimeve shoqërore, pavarësisht se pjesëmarrja në skemë është një detyrim sa kushtetues, ligjor por aq edhe personal i çdo të punësuarit, me qëllimin e vetëm për t'i siguruar mbrojtje nga ngjarjet sociale të padëshiruara.

Kur bëhet fjalë për të siguruar standardin minimal të jetesës, fenomeni ligjor anashkalohet dhe të punësuarit kanë tendencën t'u fshihen sigurimeve shoqërore, duke i konsideruar kontributet një taksë negative pa analizuar qëllimin e tyre afatgjatë.

Përsa i përket mungesës së traditës, duam të shpjegojmë se që nga viti 1944-1992, shoqëria jonë nuk e ka njohur fare konceptin e sigurimeve shoqërore, pavarësisht se përfitonin pagesa nga ky sistem si për sëmundje, barrëlindje, pension, invaliditet, përsëri qëndronin indiferent për mënyrën se nga dilnin këto të ardhura. Në fakt të gjitha pagesat e kontributeve të skemës së sigurimeve shoqërore në këtë periudhë mbuloheshin nga buxheti i shtetit dhe planifikoheshin në planet ekonomike 5-vjeçare. Të punësuarve në këtë periudhë nuk u merrej asnjë lek nga paga e punës.

Në pamje të parë kjo mënyrë e financimit të sistemit të sigurimeve shoqërore të krijonte idenë se shteti kishte marrë një barrë shumë të madhe në dobi të punëtorëve, por nga ana tjetër, duhet theksuar se e gjitha kjo pagesë rëndonte në koston e krahut të punës dhe pagat e vogla që ofroheshin. Referuar këtij argumenti nëse do t'i referohemi me shifra konstatojmë se:

Numri mesatar vjetor i kontribuesve në vitet e para të zbatimit të skemës ka rënë në mënyrë drastike, duke shënuar kulmin në vitin 1997. Pas këtij viti vërehet një rritje graduale e numrit të kontribuesve, duke arritur maksimumin në vitin 2011, me 692 mijë; ndërsa aktualisht numri i kontribuesve të drejtpërdrejtë është rreth 643 mijë.²²⁵

Një tjetër problem i cili është konsideruar plagë ekonomike në lidhje me pakësimin e kontributeve për skemën e sigurimeve shoqërore janë të vetëpunësuarit në bujqësi. Skema e pensioneve për ish-kooperativat u modelua në vitin 1972 dhe hyri në fuqi në vitin 1974.

Për të përfituar pensionin e pleqërisë një ish-anëtar i kooperativës bujqësore duhet të kishte 20 vjet antarësi në kooperativ. Pas shpërbërjes së kooperativave bujqësore (1992) dhe fermave shtetërore (1993), popullsia rurale në moshë pune përbëhet nga fermerë të vetëpunësuar dhe familjet e tyre.

Në vitin 1994, rreth 166 mijë fermerë të moshuar dhe invalidë, ish-antarë të kooperativave bujqësore përfitonin të ardhura sipas skemës së pensioneve të modeluar në vitin 1972 e cila siguronte pensione sa rreth 50% e pensioneve të qytetit, ndërsa rreth 82 mijë persona përfitonin të ardhura sipas rregullave për Ndhmën Ekonomike²²⁶.

Nisur nga sa më sipër kuptohet qartë se kjo kategori subjektsh nuk kanë asnjë tendencë të shkojnë drejt skemës së sigurimeve shoqërore, kjo për disa arsye:

- *Niveli i ulët i përfitimeve*
- *Zhvillimi i ulët i bujqësisë*
- *Mungesa e informimit*
- *Mungesa e ushtrimit të kontrollit shtetëror.*

Pjesa më e madhe e kësaj kategorie subjektsh jetojnë në informalitet. Nëse do t'u referohemi shifrave statistikore do të vëmë re se janë rreth 166 mijë të cilët nuk paguajnë kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore, duke u bërë kështu një barrë e madhe në të ardhmen.


Megjithatë ndër vite është mundur që të arrihet një rritje e numrit të kontribuesve në këtë kategori. Ndërsa aktualisht numri i kontribuesve të drejtpërdrejtë në skemën e sigurimeve shoqërore është rreth 643 mijë. Rritja e kontribuesve në skemë ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të kontribuesve në fshat, si pasojë e kushteve favorizuese të pagesave kontributive të miratuara me ligj, edhe pse ky numër mbetet ende mjaft i ulët në raport me numrin total të të vetëpunësuarve në zonat rurale.

I krahasuar me numrin total të përfituesve, raporti kontribues-përfitues rezulton të jetë në nivele mjaft kritike.²²⁷ Kjo kategori subjektsh rrezikon të përfitojë pensione shumë të vogla, por edhe të mbetet pa pensione. Jemi të mendimit se niveli i ulët ekonomik dhe nevoja për mbijetesë janë edhe arsyet për të cilat një pjesë e shoqërisë tenton t' i fshihet skemës së sigurimeve shoqërore.

225 Dokumenti i politikave të pensionit, Hartuar nga Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë. Fq. 11.

226 Dokumenti i politikave të pensionit, Hartuar nga Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë. Fq. 10.

227 Dokumenti i politikave të pensionit, Hartuar nga Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë. Fq. 11.

TAB. 2/5 228- Numri i kontribuesve për vite të përzgjedhura.

Informaliteti i emincës gri, lidhet me fshehjen e pjeshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ajo pjesë e shoqërisë së punësuar e cila paguhet me të ardhura mesatare, ose mbi mesataren, por deklaron si pagë pune të ardhura minimale, duke fshehur kështu një sasi të konsiderueshme të ardhurash për kontribute.

Kjo kategori e cila tenton të fshehë pagën reale të punës dhe të derdhë kontribute në nivel minimal, operon kryesisht në sektorin privat. Nëse informaliteti nuk do të ekzistonte, do të kishim një efekt shumë pozitiv, në gjendjen ekonomike të skemës së sigurimeve shoqërore. Fakti që niveli i punësimit luan një rol të rëndësishëm në skemë, i detyron administratorët e sigurimeve shoqërore që të ndërmarrin planifikime dhe strategji afatgjata në lidhje me ecurinë ekonomike, me qëllim dhënien e garancive të rëndësishme të skemës së sigurimeve shoqërore.

Sfida ekonomike, konsiston në një tjetër element të rëndësishëm në hartimin e planeve *makroekonomike*. Referuar disa të dhënave të marra nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore do të paraqesim një tablo të planeve mikro dhe makro në vendin tonë.

TAB. 3/5

	2005	2006	2007	2010	2020	2050	2075
<i>Rritja GDP reale</i>	5.5 %	5.8 %	6.0 %	5.0 %	4.8 %	3.8 %	3.0 %
<i>Rritja pagës reale</i>	3.5 %	11.5 %	15.2 %	3.7 %	3.2 %	2.3 %	2.0 %
<i>Inflacioni</i>	2.4 %	2.4 %	2.3 %	2.3 %	2.0 %	2.0 %	2.0 %

Rritja e GDP reale deri në vitin 2013, përputhet me mendimin e Ministrisë së Financave për këtë tregues dhe më pas ISSH ka supozuar që ritmi i rritjes së GDP- së reale do të ulet linearisht nga 5% që është në vitin 2013, deri në 3% në vitin e fundit të parashikimit 2075.

Rritja e pagës për shkak të rritjes së produktivitetit. Rritja e pagave është një ndër masat me karakter ndihmës jo vetëm për individët përfitues, por

edhe për skemën e sigurimeve shoqërore. Kjo rritje fillimisht u bë duke u bazuar në manualin e modelit aktuarialë afatgjatë PROST "Përgatitja e Inputeve", ku theksohet se "Kur nuk ka të dhëna të tilla, ky tregues merret 2% më pak se rritja reale e GDP, për ato vende ku forcat e punës janë në moshë të re dhe duke u zgjeruar dhe 1% më pak se rritja reale e GDP, për ato vende të cilët kanë një sistem pensionesh të konsoliduar, e forca pune të qëndrueshme."

Supozimi i ISSH në lidhje me pagën reale është që në vitin bazë ky tregues të fillojë me 2% më pak se rritja e GDP dhe në vitin e fundit të parashikimit të jetë 1% më pak. Nga kjo tendencë do të përjashtoheshin vetëm vitet 2006 - 2010, ku rritja e pagës për shkak të rritjes së produktivitetit do të ndryshojë. (shih tabelën e mësipërme).

Produktiviteti do të ndryshojë duke reflektuar rritjen e pagës kontributive si rezultat i uljes së informalitetit dhe në mënyrë që të ardhurat e parashikuara deri në vitin 2010 të përputhen me Projekt-buxhetin afatmesëm. *Shkalla e inflacionit* nga 2.4% që ishte në vitin 2005 do të pësojë ulje deri në 2% në vitin 2020 dhe më pas do të mbetet konstante deri në vitin e fundit të parashikimit 2075.

Ky supozim është brenda intervalit 2 - 4% të rekomanduar nga Ministria e Financave dhe është në përputhje me supozimet që janë hartuar në bashkëpunim me ekspertë të Degës së Shërbimeve Statistike, Aktuariale dhe Financiare të ONP-s.

Një tjetër problem i skemës siç e theksuam edhe më lart është numri i kontribuesve në skemë. Ulja e shkallës së papunësisë dhe si pasojë rritja e numrit të të punësuarve sjell gjithashtu rritjen e numrit të kontribuesve. Kontribuesit i ndajmë në:

Kontribues në skemën urbane²²⁹

Studime dhe ide të ndryshme në lidhje me analizën ekonomike në perspektivë të rritjes së të ardhurave të skemës së sigurimeve shoqërore, kanë parashikuar që këto të ardhura do të rriten majft deri në vitin 2010, kjo si rezultati reformave të ndërmarra nga qeveria për uljen e informalitetit, duke përbërë në vitin 2010, rreth 89% të të punësuarve duhet të sigurohen.

Për vitet që pasojnë, ritmi i rritjes së numrit të kontribuesve do të bjerë duke përbërë kështu në vitin 2020 - 93% të të punësuarve dhe në vitin 2040 - 95%. Më poshtë paraqitet ritmi i rritjes së numrit të kontribuesve nga një vit në tjetrin:

229 Të gjitha të dhënat numerike dhe analiza e tyre është marrë nga një dokument studimi i Insitutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Financave.

TAB. 4/5²³⁰

	2005	2010	2020	2040
<i>numri i kontribuesve (në mijë)</i>	361.9	530.7	713.6	847.8
<i>ritmi i rritjes së numrit të kontribuesve</i>		46.6% (krahasuar 2005)	34.4% (krahasuar 2010)	18.8% (krahasuar 2020)

Më pas, numri i kontribuesve do të rritet vetëm si pasojë e rritjes së numrit të të punësuarve, pasi kjo përqindje mbahet pak a shumë konstante në vitin 2075.

Kontribuesit e skemave rurale

Në analizën e prespektivës që është realizuar për *numrin e kontribuesve në skemën rurale*, është marrë parasysh koeficienti i urbanizimit; në pjesën e parë të periudhës së parashikimit deri në vitin 2020 është supozuar që 1 % e kontribuesve lëvizin nga zonat rurale drejt zonave urbane dhe më pas përqindja e numrit të kontribuesve ndaj popullsisë sipas moshave mbetet konstante deri në vitin e fundit të parashikimit.

Një tjetër element i rëndësishëm i skemës i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e saj janë *përqindjet e kontributit*.

Në skemën urbane, përqindja e kontributit për pensione në skemën e sigurimeve shoqërore ka pasur këto ndryshme: Periudha më e ulët e përqindjeve të kontributit në skemën e sigurimeve shoqërore është evidentuar në Shtator të vitit 2006, nga 29.9% ajo shkoi në 23.9% dhe më pas ajo mbetet e pandryshuar deri në vitin e fundit të parashikimit.

Në skemën rurale, të vetëpunësuarit në bujqësi derdhen kontribut në masa të përckatuara me VKM çdo vit (e ndryshme për zona fushore e malore), masa të cilat janë shumë më të vogla se kontributi që derdh një i vetëpunësuar në qytet.

Pjesa tjetër ekëtij kontributi deri tek kontributi minimal, derdhet nga Buxheti i Shtetit në formë subvencioni.

Kështu, kontributi për pensione i të vetëpunësuarve në bujqësi në vitin 2005 përbën rreth 4.4% të pagëe minimale. Sipas strategjisë së barazimit të kontributit minimal të qytetit dhe fshatit, mendohet që kjo përqindje e kontributit që derdhen të vetëpunësuarit në bujqësi, do të rritet gradualisht (me të njëjtën masë). Kjo do të sillte një reduktim të shumës së të ardhurave që do të kontribuonte Buxheti i Shtetit për llogari të të vetëpunësuarve në bujqësi.

Mendohet se në vitin 2020 masa e kontributit që paguan një i vetëpunësuar në bujqësi të barazohet me kontributin minimal. Në këtë periudhë buxheti i shtetit nuk do të subvencionojë më për kontribuesit e zonave rurale. Në këtë vit, përqindja, e kontributit për pensione që derdh i vetëpunësuarit në bujqësi do të jetë 23.9%, dhe kjo përqindje do të mbetet konstante deri në vitin e fundit të periudhës së parashikimit.

Strategjia e barazimit të kontributit minimal të qytetit dhe fshatit është supozuar të jetë si më poshtë:

²³⁰ Materiali marrë nga një dokument studimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Financave

TAB. 5/5²³¹

	2005	2008	2010	2012	2014	2016	2020
% e vetp në bujqësi	4.4 %	6.6 %	11.4 %	13.9%	16.4%	18.9%	23.9%
% Buxhetit i Shtetit	25.5%	17.3%	12.5%	10.0%	7.5%	5.0%	0.0%

Në rast se përqindjet e kontributeve të pensionit preceptohen si taksa shtrembëruese, sfidat demografike dhe makroekonomike do të ndërveprojnë me njëra-tjetrën përmes shtesës tatimore që fusin kontributet e pensioneve midis shpenzimeve të përgjithshme të punës, të paguara nga punëdhënësit, dhe të ardhurave neto të marra nga punëmarrësit.

Megjithatë, stabilizimi apo ulja e shkallës së kontributeve kërkon uljen e shpenzimeve. Kjo mund të bëhet duke shtyrë moshën e daljes në pension, apo duke ulur përfitimet e pensionit. Shtyrja e moshës së pensionit e realizuar si në mënyrë të menjëhershme ashtu dhe në mënyrë graduale, mbetet gjithmonë një kundërshtim nga ana e grupeve të interesit, por referuar parashikimeve mbi jetëgjatësinë, të cilat do të trajtohen më poshtë, kjo masë mbetet më e pranueshme se sa ulja e masës së pensionit.

Që të dyja strategjitë e mësipërme të reformave, i kanë shkurtuar shumë kërkesat ekzistuese. Do të ishte iluzion që hapat e nevojshme strukturore të reformës të shiheshin si një situatë *"ku fitojnë të dy palët"*. As ulja e normës së zëvendësimit, as rritja e moshës së pensionit nuk janë masa popullore. Për të minimizuar koalicionet negative kundër reformës, punëmarrësit duhet si pasojë të jenë në gjendje të zgjidhin në mënyrë sa më elastike midis dy opsioneve jo popullore.

Shumë njerëz, sidomos në Evropë, i shohin sistemet e pensionit si arritje shoqërore që duhen mbrojtur, pavarësisht se sa ka ndryshuar mjedisi demografik dhe ai makroekonomik. Si rrjedhojë, duke bërë një ndryshim në paradigme për të kaluar nga ajo që njeriu dëshiron të kërkojë, në atë që realisht skemat e sigurimeve shoqërore mund të financojë.

Kjo, kërkon një ndryshim në retorikën e sistemeve tona të pensioneve; ajo kërkon gjithashtu një deklaratë transparente të shpenzimeve të sistemeve aktuale që mbështesin këtë retorikë. Siç është përmendur më parë vlerësimet lidhur me përmasën e sektorit informal në Shqipëri, tregojnë se ekonomia informale luhatet mes 30 deri në 60% të GDP-së²³². Ndërsa sipas raportit të fakteve të CIA-së, ekonomia informale zë rreth 50% të GDP-së. Ndonëse kemi një sektor të madh informal, thellësia e informalitetit është e ndryshme në aktivitete të ndryshme ekonomike

Megjithatë duhet të theksojmë se sistemi i kontribuesve mbi sigurimet shoqërore në Shqipëri nuk është i qëndrueshëm. Numri i kontribuesve ndaj forcave të punës është në nivele 65-67%. Ky tregues është shumë më i përkeqësuar është në fshat, ku numri i kontribuesve ndaj personave të punësuar nuk i kalon 50%, megjithëse qeveria ka vendosur norma të ulëta të kontributit.²³³

231 Materiali marrë nga studimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Financave.

232 OECD, 2007

233 I.S.SH, 2009

Sektori publik punëson pothuajse 20% të të ardhurave që kontribuojnë kompanitë private. Ndërsa sektori privat supozohet të ofrojë pagat më të larta se sektori publik, mbi 50% të të punësuarve në sektorin privat, deklarojnë pagën minimale, ndërsa në sektorin publik vetëm 1% e të punësuarve deklarojnë pagën minimale.

4.3 SFIDA DEMOGRAFIKE

Demografika, një sfidë e rëndësishme e sistemit të sigurimeve shoqërore jo vetëm në vendin tonë, por edhe në Evropë.

Në mënyrë të përmbledhur do të analizojmë një parashikim të situatës demografike në vendin tonë. Plakja e popullsisë është një fenomen i rëndësishëm në skemën e sigurimeve shoqërore jo vetëm në vendin tonë po në mbarë Europën. Plakja e popullsisë si një faktor i pashmangshëm detyron institucionet shtetërore të ndërmarin strategji afatgjata në lidhje me funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore. Referuar parashikimeve që janë bërë nga INSTAT për lëvizjet demografike dhe referuar lëvizjeve reale të ndodhura na krijohet një problem i madh në lidhje me parashikimet e bëra.

Popullsia kalon në procesin e plakjes si pasojë e Rritjes së raportit të grupmoshave të vjetra, i cilivaret shumë nga disa fenomene si:

- 1- *Lindjet, vdekjet;*
- 2- *Lëvizjet emigratore, migratore;*
- 3- *Fertiliteti;*

Përbërja e sotme e moshave të popullatës, kushtëzohet nga niveli dhe tendenca e lindjeve dhe vdekjeve në të kaluarën. Në qoftë se numri i popullsisë së moshuar, në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë aktive rritet, rrjedhimisht do të rriten edhe shpenzimet e fondit të Sigurimeve Shoqërore, për pagesat e pensioneve dhe të shërbimeve të tjera në dobi të tyre.

Në Shqipëri vetëm 8.3% e popullsisë është mbi 65-vjeç, pothuajse një e treta. Kjo shifër e rendit vendin tonë në vende me një popullsi relativisht të re, krahasuar me vendet e tjera të Evropës, si Bullgaria, Lituania dhe Kroacia të cilat kanë afërsisht 17% të popullsisë së tyre mbi moshën 65 vjeçare.²³⁴

Njohja e mirë e faktorëve të mësipërm, na ndihmon për të pasur një panoramë më të qartë në lidhje me funksionimin e skemës së sigurimeve në të ardhmen. Në këtë mënyrë do të mund të parandalohen element negative, por dhe do të mund të realizohet një fushat informuese për rrezikun që vjen si pasojë e plakjes së popullsisë.

Një tjetër element i rëndësishëm i studimit statistikortë plakjes së popullsisë, është eliminimi i fenomeneve negative që mund të prekin skemën në të ardhmen. Nëpërmjet këtyre studimeve mund të krijohet parashikimi i shpenzimeve të përafërta, që do të bëjë skema e Sigurimeve Shoqërore dhe marrjen e masave për të ardhmen.

Përveç parashikimit të shpenzimeve, njohja e këtyre faktorëve do të na ndihmojë që të parashikojmë zbatimin e politikave financiare, politikave

²³⁴ Raporti Nr. 37594-AI i Bankës Botërore, faqja nr.2.

sociale e mbi të gjitha, parashikimin afatgjatë të pagesave të individëve nga çdo kolonë e skemës së sigurimeve në përgjithësi dhe fondit të pensioneve në veçanti.

Dihet se mosha në raport me individët paraqitet me struktura të ndryshme, ky fakt e bën të vështirë dhënien e definicioneve të sakta demografike. Evidentimi i pikave të dobëta është një nga mënyrat delikate të trajtimit të problemit.

Lëvizjet migratore

Duke pasur parasysh numrin e madh të lëvizjeve migratore brenda vendit, i cili shtohet me shpejtësi në përmasa të gjera, jo rrallë herë kaotike dhe të paeventuara zyrtarisht, nga zonat rurale në drejtim të zonave urbane, lind si detyrim primar evidentimi i saktë dhe me korrektësi i këtij procesi demografik. Proçesi demografik është detyrë shumë e mprehtë e shtetit. Ky proces, përbën një element bazë dhe të domosdoshëm për realizimin e strategjive afatgjata, që do të përfshijnë të gjithë sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Gjithashtu, ky proces pasohet nga një shkallë e lartë ndërlikimi.

Kjo shkallë e lartë ndërlikimi, i përket përpjekjeve të vazhdueshme për evitimin e fenomeneve negative aktuale dhe ato që mund të pasohen në të ardhmen veçanërisht në skemën e pensioneve. Kjo për faktin se, sot politikata qeverisëse po tentojnë që të çojnë drejt një lehtësimit të kontribuesve ruralë me qëllim që të zbusë diferencën paguese ndërmjet tyre dhe atyre urbanë.

Edhe skemat e sistemit të sigurimeve shoqërore, funksionojnë të ndara, si për sektorin rural edhe për atë urban. Por nga ana e përfituesve ka një pabarazi. Kjo pabarazi vjen si shkak i së kaluarës. Përfituesit ruralë nuk kanë qenë përfitues apo të mbuluar nga skema e sigurimeve shoqërore deri në vitin 1972. Për të përfituar pension të plotë kërkohej 35 vite kontribute. Me aplikimin e ligjit të ri të sigurimeve shoqërore, subjekteve rurale, të cilët kishin plotësuar moshën por nuk kishin kufirin e viteve të sigurimit, u lindte e drejta të përfitonin pension të pjesshëm.

Numri i subjekteve të cilët përfitonin pension të plotë pleqërie, ishte relativisht i vogël krahasuar me numrin e atyre që zgjodhën të përfitonin pension të pjesshëm. Kjo ishte edhe arsyeja që shumë kontribues, ubënë përfitues të degës së pensioneve të pjesshme, duke rritur jo vetëm shpenzimet në këtë degë, por duke krijuar një disnivel në raportin ndërmjet masës së pensioneve që përfitohen në zonat rurale dhe masës së pensioneve që përfitohen në zonat urbane. Shih tabelën. 6/5²³⁵

TABELA 6/5

	2006	2008	2009	2010	2011	2012	2015
<i>pensione urbane</i>	5%	9%	9%	9%	7.5%	6.2%	2.1%
<i>pensione rurale</i>	20%	15%	13%	13%	12%	11.5%	2.1%

Prandaj, për të evituar fenomenet negative të sistemit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe për të evidentuar qartë raportet ndërmjet popullsisë rurale dhe asaj urbane, apo edhe raportin ndërmjet femrave dhe meshkujve, është domosdoshmëri regjistrimi i popullsisë. Proçesi

235 Kjo tabelë është marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nga drejtoria e statistikës.

demografik përbën një element bazë dhe të domosdoshëm, për të realizuar strategjinë afatgjatë të Sigurimeve Shoqërore. Lëvizjet migratore të popullsisë, i sjellin sistemit të Sigurimeve Shoqërore, pasoja negative në drejtim të:

- *Pakësimi të numrit të kontribuesve;*
- *Rritjes së shpenzimeve;*

Le të shohim më konkretisht, ndikimin e këtyre pasojave negative.

- *Pakësimi i numrit të kontribuesve*

Pakësimi i numrit të kontribuesve është një fenomen, i cili mund të shfaqet për një periudhë afatshkurtër, por mund të ekzistojë dhe për një periudhë afatgjatë, kjo për disa arsye:

- *Mungesa e vendeve të punës*

Mungesa e vendeve të punës mund të ketë shkak faktorë të ndryshëm. Një nga këta faktorë, i cili sjell papunësi është edhe migrimi. Shpeshherë migrimi kushtëzon gjetjen e vendit të punës. Kjo për disa arsye, të cilat lidhen me:

- *Nivelin profesional;*
- *Nivelin e zhvillimit ekonomik të zonës ku migrohet.*

- *Tregu informal i punës*

Fenomeni i tregut informal i punës (puna e zezë) është shumë i përhapur në ditët e sotme. Fshehja nga pagesa e kontributit, sjell pasoja negative si në drejtim të ekzistencës së sistemit, ashtu edhe në drejtim të individëve që shmangin ato.²³⁶ Si pasojë e tregut informal të punës, sistemit të Sigurimeve Shoqërore do t'i ulet numri i kontribuesve. Por pasojat negative të tregut informal, nuk ndihen vetëm në Skemën e Sigurimeve Shoqërore edhe individët që shmangen nga pagesa e kontributit do të jenë të pasigurtë për të ardhmen e tyre, kur të goditen nga ngjarje sociale²³⁷. Pra, çdo individ që bëhet pjesë e tregut informal, nuk do të ketë asnjë përfitim nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore.

- *Rritja e shpenzimeve*

Kur një individ emigron nga një zonë rurale në një zonë urbane, jo gjithmonë është me fat për të gjetur punë. Mund të ndodhë që një individ, të humbë punën si pasojë e falimentimit të aktivitetit ekonomik. Ky moment, e drejton atë në degën e asistencës. Dega e asistencës, konsiderohet një degë deficietare. Shpenzimet e kësaj dege, janë më të larta se sa niveli i arkëtimeve të kontributit. Kjo për faktin se në këtë degë, kontribuon vetëm punëdhënësi me një përqindje të ulët. Për këtë arsye kjo degë financohet nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, mund të ndodhë, që si shkak i papunësisë, individit t'i drejtohet për përfitime edhe degës së pensionit²³⁸, duke rritur para kohe shpenzimet për këtë degë.

²³⁶ Duke fshehur punën individët nuk derdhiin kontribute në skemën e sigurimeve. Ndërsa pasojat në kolonën e shpenzimeve, mbetet e njëjtë Individët që kryejnë punë të zezë, përfitojnë nga kolona e asistencës. Prandaj themi se, puna e zezë është një fenomen shumë i rrezikshëm për skemën e sigurimeve.

²³⁷ Me ngjarje sociale do të përfshihen: Sëmundja, pleqëria, papunësia.

²³⁸ Dega e pensioneve që rëndohet më shumë është ajo e pensionit të pjesshëm dhe atij të reduktuar.

Pra, sa më sipër, mund të themi:

Sa më shumë të zvogëlohen shpenzimet e skemës së sigurimeve, aq më shumë siguri do të ketë skema për realizimin e pagesave në drejtim të individëve dhe në zbatimin e politikave sociale. Për të parë më konkretisht rolin që luan lëvizja migratore, duhet që të kemi të dhëna të sakta në lidhje me numrin e popullsisë, përqindjen e popullsisë qytetare dhe asaj fshatare, përqindjen e popullsisë së arsimuar dhe asaj të pa arsimuar.

Këto të dhëna sigurohen nëpërmjet regjistrimit të popullsisë. Gjithashtu nëpërmjet regjistrimit të popullsisë, mund të evidentohen edhe probleme të tilla, si:

Raporti ndërmjet popullsisë qytetare dhe fshatare

Dihet që para viteve '90, në vendin tonë numrin më të madh të popullsisë, e zinte popullsia që jetonte në fshat. Me zhvillimin e ekonomisë, shoqërisë, rritjen e kërkesave për një jetë më të mirë për vete dhe familjarëve të tyre, u shtuan ndjeshëm lëvizjet e migracionit. Lëvizjet e migracionit ishin më të mëdha në drejtimin fshat-qytet, nga zonat rurale në ato urbane, nga qyteti në drejtim të kryeqytetit.

Si pasojë e këtyre lëvizjeve, filloi të krijohej një mbipopullim i qyteteve në zhvillim. Mbiipopullimi i qyteteve u shoqërua me çrregullim në skemën e Sigurimeve Shoqërore. Ky çrregullim, solli pasoja negative si në: kolonën e kontribueve ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Kështu në kategorinë e personave të migruar, numri i individëve të cilët humbasin vendin e punës ishte i madh. Me humbjen e vendit të punës këta individë, kalonin nga kontribues të skemës në përfitues.

Raport ndërmjet burimeve të vendeve të reja të punës dhe punëkërkuessve

Një ekonomi e zhvilluar dhe një shtet i fuqishëm, krijojnë mundësi për zënie në punë të shtetasve. Punësimi i rregullt i shtetasve, shoqërohet me derdhjen e rregullt të kontributeve në favor të sistemit të Sigurimeve Shoqërore duke e forcuar atë. Në kushtet aktuale të vendit tonë, personat që kërkojnë punë, zënë një numër të madh në krahasim me vendet e lira të punës. Numri i punë kërkuessve rritet ndjeshëm, si rezultat i disa fenomeneve:

Privatizimi i procesit të ekonomisë;

Shkurtimi i aktiviteteve të biznesit të vogël;

Falimentimi i aktiviteteve të biznesit të vogël;

Shtimi i popullsisë;

Lëvizjet migratore;

Duke u nisur nga fenomenet e mësipërme, organet, si: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Insituti i Sigurimeve Shoqërore, kanë për detyrë hartimin e strategjive afatgjata për rritjen e ekonomisë, punësimit duke i harmonizuar ato, me zhvillimet demografike dhe me projekte për reduktimin e varfërisë.

Lëvizjet emigratore

Emigrimi është një fenomen, i cili ndikon drejtpërdrejt në sistemin e Sigurimeve Shoqërore, duke sjellë pakësimin e fondit të kontributeve

por dhe të shpenzimeve. Kjo do të thotë si pasojë e emigrimit, skemës së Sigurimeve Shoqërore i pakësohen jo vetëm subjektet që derdhin kontribute, por edhe subjektet që përfitonin pagesa. Pra skemës së Sigurimeve Shoqërore, i pakësohen në të njejtën kohë shpenzimet edhe hyrjet e të ardhurave (përqindjet e kontributit).

Fenomeni i gjerë i emigrimit, përfshiu si kategorinë e personave të papunë, ashtu dhe të punësuarit. Të dyja këto kategori, ndikonin si negativisht ashtu edhe pozitivisht mbi skemën e Sigurimeve Shoqërore. Më konkretisht, emigrimi i personave të papunë, luajti një rol "pozitiv" si për buxhetin e shteti ashtu edhe për skemën e Sigurimeve Shoqërore. Në lidhje me buxhetin e shtetit, emigrimi i të papunëve, ul shpenzimet e shtetit për përqindjen e kontributit në favor të të papunëve, për pagesën e asistencës.

Për sa i përket sistemit të Sigurimeve Shoqërore, emigrimi i të punësuarve apo thënë ndryshe i kontribuesve të skemës prish ekuilibrin e skemës së kontributeve, në lidhje me pagesat që ofron skema e Sigurimeve Shoqërore (pagesa për pensione, pagesa familjare, pagesa për barrëlindje, etj). Pra, konstatojmë se lëvizja emigratore e shpeshtë dhe e pakontrolluar, i shkakton skemës pasoja negative, të cilat reflektohen në përfitimin e pagesave që ofrojnë skemat në favor të subjekteve. Si të tilla mund të përmendim;

riskun për të mos kryer në kohën e duhur, pagesat në dobi të përfituesve;

riskun e destabilizimit financiar të sistemit²³⁹;

riskun për të penguar aplikimin e politikave në drejtim të përmirësimit të këtij sistemi;

Në vitet '90-'93 dhe në 1997, vendi ynë u përfshi në një "bum" shtetasish të emigruar jashtë vendit. Çoroditja e pastatistikuar e hyrjeve dhe daljeve të individëve në ato vite, reflektoi problem të rëndësishëm në skemën e Sigurimeve Shoqërore, ndër të cilat mund të përmendim:

- *Penguan funksionimin normal të skemës së Sigurimeve Shoqërore, si në kolonën e kontributeve, ashtu dhe në kolonën e pagesave;*
- *Penguan realizimin, shpërndarjen dhe llogaritjen e pensioneve (pleqërie, invaliditet, të plotë apo të pjesshëm);*
- *Penguan procedurën e mbledhjes së përqindjes së kontributeve;*
- *Skema e kontributeve, i njuh si periudha të errëta, vitet '90-'93 dhe në vitin 1997-1998. Kjo sepse derdhja kontributeve në këto periudha, ishte shumë e vogël, aq sa:*
- *Rrezikoi përfitimin e pagesave nga skema e Sigurimeve Shoqërore;*
- *U përdor Fondi Rezervë;*
- *U bë domosdoshmëri financimi i vazhdueshëm nga buxheti i shtetit²⁴⁰;*

Për të minimizuar efektet negative të emigrimit në ligjin e ri të Sigurimeve Shoqërore, Ligji parashikoi një kolonë të re të mbulimit me sigurime:

²³⁹ Si pasojë e lëvizjeve emigratore të pakontrolluara, sistemi është shumë i zbuluar nga rreziku i pakësimit të fondit.

²⁴⁰ Financim, i cili vazhdoi deri në vitin 2000. Nga ky vit e në vazhdim buxheti i shtetit vetëm subvencionon.

Kolona Vullnetare²⁴¹.

Kolona vullnetare u vlerësua si zgjidhje praktike për të realizuar mbledhjen e përqindjeve të kontributit për:

- *Emigrantët;*
- *Ato subjekte, të cilët nuk dëshirojnë të sigurohen në mënyrë të vazhdueshme;*
- *Ato subjekte, që duan të bëjnë pagesat e kontributit për vitet e prapambetura;*

A- STRUKTURA E MOSHËS DHE RITJIA NEGATIVE

Shkalla e përgjithshme e lindjeve në vit përcakohet si nga numri pritshëm i fëmijëve që një bebe vajzë pritet të ketë në bazë të regjimeve të pjellorisë dhe vdekshmërisë në vitin *t*. Për çdo 100 vajza, lindin rreth 105 djem, kështu që nëse të gjitha gratë do të mbijetonin në fund të moshës së pjellorisë, do të mjaftonte një shkallë pjellorie totale prej 2.05 për rinovimin e të gjithë popullsisë. Duke marrë parasysh vdekshmërinë, një vlerë disi më e lartë prej rreth 2.07 përqind do të ishte e mjaftueshme në Europë²⁴¹.

Popullsia e qëndrueshme në rënie ka një shpërndarje moshore shumë më të vjetër se sa ajo në gjendje të pandryshueshme (stacionare) për të mos folur për popullsinë në rritje nga e cila ne krijojmë idenë tonë rreth botës. Kjo formë e plakjes së popullsisë vjen vetëm nga pjelloria, meqenëse vdekshmërinë e kemi mbajtur të palëvizshme.

Si përfundim mund të themi se; *Duke i ndaluar ndryshimet e mëdha në pjellori apo migracion, popullsia shumë shpejt do t'i ngjajë ekuivalentit të saj.* Pavarësisht se një masë e madhe e diskutimit aktual për plakjen kërkon parashikime të ardhshme të vdekshmërisë, përcaktuesi i madh i plakjes është pjelloria, si përmes nivelit aktual të ulët që shpie në rritje negative, ashtu edhe përmes grupmoshave me bume të lindjeve, të cilat do të fillojnë të dalin në pension së shpejti.

Ulja e vdekshmërisë në fakt ka një ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e sistemeve të pensioneve. Vaupel dhe Oeppen (2002), kanë paraqitur dëshmi të zhvillimit të "praktikës më të mirë të jetëgjatësisë". Kjo është jetëgjatësia e vendit që në çdo kohë ka jetëgjatësinë më të madhe. Vaupel dhe Oeppen tregojnë se për gratë, kurba shkon pothuaj në mënyrë lineare nga vlera 45 vjet, e konstatuar në Suedi në 1840, në 85 vjet, e konstatuar në Japoni në 2000.

Si rrjedhojë, praktika më e mirë e jetëgjatësisë është përmirësuar me afërsisht 0.25 vjet çdo vit për 160 vjet. Duke analizuar të dhënat e popullsisë në vendin tonë sipas moshave për të gjithë periudhën e parashikimit deri në vitin 2075, vihet re një plakje e popullsisë shqiptare në të ardhmen atafgatë, e cila reflektohet në:


B- RITJIE TË PJESËS SË POPULLSISË MBI MOSHËN E PENSIONIT NDAJ TOTALIT TË POPULLSISË

Kytregues fillon të ulet nga 11.7% në vitin 2005 deri në 10.1% në vitin 2011 për shkak të rritjes së moshës së pensionit dhe kur rritja e moshës së pensionit në

²⁴¹ Sot kjo kolonë është zhvilluar ndjeshëm, duke e shtuar numrin e subjekteve që mbuloohen me sigurime.

65 vjeç për burra dhe 60 vjeç për gratë të ketë përfunduar, pjesa e popullsisë mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë rritet gradualisht duke marrë vlerën 24.8% në vitin 2075 si në grafikun e mëposhtëm:

TABELA 7/5²⁷³₂₄₂



Siç duket edhe nga grafiku, rritja e pjesës që zë popullsia mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë, shoqërohet me uljen e pjesës që zë popullsia nga mosha 15 vjeç deri në moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë dhe gjithashtu me uljen e pjesës që zë popullsia nën moshën 15 vjeç ndaj totalit të popullsisë.

Rritje të koeficientit të varësisë së të moshuarve

Rritja e koeficientit të varësisë së të moshuarve merr vlerat 19.3% në vitin bazë, më pas ulet deri në vitin 2011, ku merr vlerën 15.5% si rezultat i rritjes së moshës së pensionit dhe më pas rritet duke pasur ritmin më të madh të rritjes deri në vitin 2060. Ky tregues merr vlerën 43.7% në vitin e fundit të parashikimit 2075, si në grafikun e mëposhtëm:

TABELA 8/5



Këto fenomene demografike të cilat dëshmojnë për një plakje të popullsisë shqiptare në prespektivën afatgjatë, shoqërohen edhe me ndryshime në treguesit e skemës së sigurimeve shoqërore. Një rritje e tillë e koeficientit të varësisë së të moshuarve e bën sistemin aktual të

²⁴² Treguesit e tabelave dhe analiza e tyre i referohen Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

pensioneve financiarisht dhe demografikisht të papërbalueshëm në rast se do të vazhdojë të japë përfitime në një raport të ngjashëm me pagën mesatare si sot dhe në rast se do t'u japë përfitime të gjithë të moshurave.

Referuar grafikut të mësipërm dhe argumenteve të dhëna më lart theksojmë së: Lidhja mes kontributeve edhe përfitimeve, ndonëse shumë e dobët aktualisht, do të vazhdojë të dobësohet edhe më shumë në të ardhmen për shkak të rritjes së numrit të pensionistëve dhe rënies së numrit të popullsisë në moshë pune, treguesit financiare të skemës së pensioneve do të vazhdojnë të përkeqësohen deri në vitin 2030.

Në këtë vit defiçiti i skemës nis e reduktohet duke arritur afër zeros në fund të periudhës së parashikimit, duke qenë se numri i përfituesve ulet dhe masa e përfitimit kufizohet gjithnjë e më shumë nga pensioni tavan. Si pasojë e këtyre ndryshimeve demografike dhe efekteve negative që sjellin ato në skemën e sigurimeve shoqërore, është ndërmarrë reforma si organizative ashtu dhe financiare.

4.4 SFIDA POLITIKE

Një tjetër sfidë me të cilën përballen skemat e sigurimeve shoqërore është edhe *sfida politike*. Sot në botë ka një numër të madh diskutimesh në lidhje me sistemin *Pay As You Go*. Shumica e ekspertëve gjatë dy dekadave të fundit, kanë ulur ndjeshëm besimin në sistemet e pensioneve *Pay AS You Go* ose ndryshe *PAYG*²⁴³.

Ky fakt përbën një sfidë të jashtëzakonshme politike, duke qenë se çdo reformë e re që do të ndërmerret duhet të provojë se më në fund, gjërat do të bëhen më mirë se përpara reformës.

Ajo që nevojitet, jo vetëm për të ndryshuar skemën, por edhe për të rikthyer besimin- është transparenca dhe një proces i besueshëm reformash. Proçeset e përshtatjes me reformat e reja duhet të jenë graduale dhe të sqaruara në detaje. Kjo do të bëjë që shoqëria palë në këto reforma, të pranojë lehtësisht risitë. Sensibilizimi se çdo ndryshim që ndërmerret në skemë do të ketë efekt pozitiv në shoqëri duhet të jetë kryefjala e këtyre reformave. Çdo lloj operacioni emergjent do ta minonte besueshmërinë e shoqërisë pjesëmarrëse në skemë.

Nëse politika do të merrte masa emergjente dhe të menjëherëshme në skemat e pensioneve këto masa do të krijojnë shembuj negative në ndryshimin e papritur të rregullit të indeksimit të matur dhe rritjen pa vend të shkallës së kontributeve. Gjermania është vendi ku për shkak se një pjesë e madhe e rezervave të likuiditetit ishin harxhuar gjatë ngjithjes së fundit të ciklit të biznesit, duke ekspozuar sistemin e pensioneve ndaj ndryshimeve të papritura dhe duke minuar kështu edhe më shumë besimin në sistemin *PAYG*.

Pasiguria e skemave të sigurimeve shoqërore si pasojë e paqëndrueshmërisë së politikave fiskale

Një përkufizim i mirënjohur i qëndrueshmërisë së politikave është ai i shprehur nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD):

“Qëndrueshmëria ka të bëjë kryesisht me një administrim të mirë të punëve

²⁴³ Börsch-Supan dhe Miegel (2001) në botimin e tyre „Pension Reform in Six Countries: Éhat Can Ée Learn from Each Other ?

të brendshme. Ajo ka të bëjë kryesisht me faktin nëse, bazuar në politikën aktuale të kontabilitetit, një qeveripo shkon në drejtim të akumulimit të borxhit.”²⁴⁴

Më konkretisht: “Politika fiskale mund të shihet si një bashkësi rregullash, si edhe si një nivel i trashëguar borxhi. Ndërsa një politikë e qëndrueshme fiskale mund të përcaktohet si një politikë e tillë ku raporti i borxhit me PBB-në eventualisht kthehet përsëri në nivelin e tij fillestar.”²⁴⁵

Parashikimet për shpenzimet dhe transfertat merren si të dhëna. Kjo realizohet sipas frymës së kontabilitetit brezor.

Në rastin e sistemeve të pensioneve, OECD-ja është e mendimit se shkalla aktuale e kontributeve duhet të jetë e mjaftueshme për të financuar përfitimet dhe se fondi i mundshëm që krijohet duhet të qëndrojë në një nivel të arsyeshëm krahasuar me madhësinë e sistemit. Megjithatë, ka edhe aspekte të tjera që meritojnë vëmendje. Në veçanti, një kontribues mund ta konsiderojë një sistem të qëndrueshëm edhe kur rregullat ndryshohen, ose edhe kur pensionistët e pësojnë, por kur shkalla e kontributeve nuk ndryshon shumë.

Një pensionist mund ta konsiderojë sistemin e qëndrueshëm për aq kohë sa merr pensionin që ka pritur, edhe kur një gjë e tillë kërkon ndryshimin e rregullave dhe kur ata që e pësojnë janë kontributet.

Në secilin prej këtyre dy rasteve, ka rrezik që për shkak të zhvillimeve të ardhshme, sistemi papritur mund të dëmtojë njërin apo tjetrën palë. Në rast se njihen gjasat e risqeve të ndryshme, administrata e sigurimeve mund të përgatitet për to në mënyrë racionale. Zvogëlimi i gamës së ngjarjeve të papritura duket se është një aspekt i natyrshëm i qëndrueshmërisë.

Në teorinë e lojës (*game theory*), një *strategji* është një bashkësi rregullash të përcaktuara, për të tashmen dhe të ardhmen, që tregojnë se çfarë veprimi do të ndërmerret nga të gjitha shtetet e botës.²⁴⁶ Në rastin e pensioneve, një *strategji e qëndrueshme politikash* është një bashkësi rregullash të tilla ku si kontribuesit ashtu edhe pensionistët e dinë që më parë se çfarë do të bëhet në çdo rrethanë të arsyeshme në të ardhmen dhe ku ata i pranojnë veprimet e ardhshme, apo të paktën nuk mund ta ndryshojnë sistemin me forcë.

Ndryshimi midis një politike dhe një strategjie politike është një ndryshim mjaft praktik. Konsideratat në lidhje me politikat e qëndrueshme të pensioneve zakonisht bazohen në një tërësi supozimesh bazë për faktorët kyç të tillë si demografia e ardhme, prodhimtaria, dhe normat e interesit. Në ndryshim nga kjo, vlerësimet në strategjitë e qëndrueshme të pensioneve duhet të bazohen në një numër të madh shtetesh të mundshme të botës, duke mbuluar një gamë realiste zhvillimesh ekonomike dhe demografike.

Edhe horizonti kohor mundet po ashtu të jetë i rëndësishëm. Valde-Prieto (2000) sugjerojnë se stabiliteti financiar afatgjatë s’ka rëndësi, nëse rregullat lejojnë që zbalancimet të vazhdojnë për aq kohë sa procesi politik do të ketë gjasa të ndërhyjë. Në praktikë, nuk mund të dihet me siguri se si punëtorët dhe pensionistët e ardhshëm do të reagojnë ndaj

244 Shih Blanchard e të tjerë, viti 1998, faqe 8

245 Shih Rasmusen 1989, faqe 17

246 Shih Setergren 2001 faqe 1

sistemit. Kur argumentojnë në favor të reformës, hartuesit e politikavetë reja prirjen të theksojnë zhvillimet e ardhshme që kanë më shumë gjasa të ndodhin. Kundërshtarët përpiqen të imagjinojnë rrethanat kur një aspekt i sistemit apo një tjetër do ta bëjnë atë të dështojë.

Në pjesën më të madhe të studimeve, propozimet ofrohen në bazë të parashikimeve në të ardhmen, në bazë të probabiliteteve. Megjithatë ashtu sikundër i kemi përdorur këto supozime më lart në këtë punim, përsëri nuk jemi të sigurtë nëse këto skenarë konvencionalë do të kenë pak apo aspak efekt në rekomandimet e politikave. Për shkak se alternativave nuk u është bashkëngjitur asnjë probabilitet, rëndësia e tyre është e dyshimtë dhe rezultatet janë të vështira për t'u interpretuar.

Për një kontribues apo pensionist të veçantë, qëndrueshmëria është e lidhur si me besueshmërinë ashtu edhe me parashikueshmërinë. A mund të dihet me saktësi të mjaftueshme shkalla e kontributeve dhe pensioneve të ardhshme, me qëllim që të bëhet zgjedhja e duhur midis kursimeve suplementare dhe konsumit (ose kohës së lirë)? Besimi është një tjetër element i rëndësishëm i skemave të sigurimeve shoqërore. Kur flasim për "besimin" vëmendjen do ta ndalim, se sa beson shoqëria në pragjet e ndryshimit të shkallëve të kontributeve dhe normave të zëvendësimit.

Këto pragje krijojnë një segment politikisht të pranueshëm brenda të cilit shkallët e kontributeve mund të ndryshojnë, pa shpënë në reformimin e sistemit. "Parashikueshmëria" kërkon një shpërndarje të njohur apo të vlerësuar të rezultateve në një segment të pranueshëm.

Ajo që u tha më sipër për një individ, mund të thuhet edhe për një firmë. Në vendime që kanë të bëjnë me zgjedhjen e një vendi për të investuar, është mirë nëse firma ka një ide realiste të kostove të tërthorta të krahut të punës në të ardhmen. Shkallët e pakufizuara të kontributeve të pensionit mund të jenë një burim i madh risku.

Si përfundim, sfidat janë të shumëanshme. Plakja e popullsisë ushtron presione financiare ndaj sistemeve të pensioneve, duke kërkuar shkurtime jo të pëlqyeshme në përfitime dhe kohëzgjatjen e daljes në pension. Rritja makroekonomike dhe problemet e punësimit shtohen nga sistemet e pensioneve, në rast se dhe kur kontributet e pensioneve preceptohen si taksa shtrembëruese. Reformave mund t'u mungojë besueshmëria politike, njëlloj si sistemet bazë PAYG, që e kanë humbur besueshmërinë e tyre. Është e nevojshme të përmirësohen një mori elementesh të preceptimit të keq në nivel makroekonomik, me qëllim minimizimin e pasojave të stimujve negativë.

4.5 SFIDA SOCIALE

Sfida sociale konsiderohet një element shumë i rëndësishëm për sistemin e sigurimeve shoqërore të çdo shteti. Rëndësia e kësaj sfide lidhet me vetë qëllimin e krijimit të sistemit të sigurimeve shoqërore. Forcimi dhe zgjerimi i dialogut social ka qenë dhe vazhdon të mbetet prioritet i shtetit.

Njerëzit dhe shoqëritë i kanë zhvilluar në kohë të ndryshme në forma të ndryshme mbrojtjen e shoqërisë nga rreziqet sociale, kjo sipas nevojave të shoqërisë dhe modelit të zhvillimit social dhe ekonomik. Mbrojtja e shtetasve nga rreziqet sociale, mund të sigurohet brenda familjes dhe komunitetit, si dhe nga institucionet e shoqërisë civile, nga ndërmarrjet

dhe tregu komercial dhe nga institucionet publike²⁴⁷.

Duke theksuar se mbrojtja sociale ka zgjeruar ndjeshëm gamën e vet nga subjektet e punësuaras si në sektorin shtetëror, privat dhe të vetëpunësuarit dhe rrallëherë nga punë të rastit në ekonominë informale, nëpërmjet skemave vullnetare. Mirëpo për të rritur ndjeshëm efikasitetin e skemës së sigurimeve shoqërore, me qëllim realizimin e mbulimit me mbrojtje sociale, duhet të ekzistojnë forma të ndryshme të partneritetit dhe dialogut social.

Funskioni kryesor i mbrojtjes sociale është që të ofrojë siguri financiare dhe qasje në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale bazë. Nuk janë elemente të mbrojtjes sociale aktorë të ndryshëm si familjarët apo institucionet e shoqërisë civile, bashkësia ndërkombëtare.

Sindikatat, janë një element i rëndësishëm i këtij sistemi. Nëpërmjet sindikatave arrihet të realizohen marrëveshje kolektive për reformat në fushën e sigurimeve shoqërore, apo të kundërshtohen reformat kur ato të konsiderohen se nuk përmbushin si duhet qëllimin për të pasur një mbrojtje sociale më të mirë. Një tjetër element i sindikatave lidhet me përpjekjet për zgjerimin e rradhëve të tyre për të përfshirë në to edhe ata subjekte që ushtrojnë aktivitet në ekonominë informale. Por si mund të arrihet kjo? Duhet të kuptohet që ekonomia informale është një ndër elementet negative më të rrezikshme dhe më të vështira për sistemin e sigurimeve shoqërore.

Nëse duam që të gjithë këto subjekte informale t'i kthejmë në formale, duhet që t'u ofrojmë përfitime joshëse, jo vetëm nëpërmjet pagës së punës, por edhe nëpërmjet sigurimeve shoqërore, duke propozuar kështu rritje më të madhe mbrojtjeje. Në mënyrë që të jenë të rëndësishme për punëtorët e ekonomisë informale, sindikatat duhet të jenë në gjendje të ofrojnë përfitime të prekshme dhe rritjen e mbrojtjes.

Institucionet e shoqërisë civile, të cilat ndihmojnë për të ruajtur sigurinë e të ardhurave, nëpërmjet mbrojtjes sociale janë të llojeve të shumta. Këto institucione, ofrojnë ndihmë në natyrë ose në formën e punës mund të jenë shoqëritë e kursimeve, shoqatat, kooperativat, shoqëritë e përfitimeve reciproke, organet fetare, organizata bamirësie, etj. dhe roli e synimet e tyre ndryshojnë në përputhje me kontekstin kombëtar dhe lokal.

Ato mund të ofrojnë përfitime përveç atyre të ofruara nga institucionet publike, ose mund të jenë të krijuara për të përballuar një sasi të vogël të mbrojtjes sociale për njerëzit që nuk mbulohej nga një sistem tjetër. Gama e përfitimeve të cilat këto institucione mund të ofrojnë, është shumë e gjerë. Disa janë të përkushtuar për sigurinë e ushqimit, të tjerë në sigurimin shëndetësor ose sigurimin e pensioneve, të tjerë ofrojnë kompensim për vdekje ose për paaftësi. Të gjitha përfitimet financohen përgjithësisht nga kontributet e përfituesve, ndonjëherë me subvencione nga diku tjetër.

Për shkak se janë kaq afër përfituesve, ata janë përgjithësisht në gjendje

²⁴⁷ Në mënyrë të vazhdueshme, komuniteti ndërkombëtar ka mbajtur në vëmendje mbrojtjen sociale të shtetasve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes sociale në Samitin Botëror për Zhvillim Social (Samitin Social) në Kopenhagen në 1995 dhe "Samitin Sociale +5" të mbajtur në Gjenevë në vitin 2000. Ku vëmendje dhe shqetësim i është kushtuar ecurisë së sistemit të sigurimeve shoqërore, si pasojë e politikave globale sociale.

të ofrojë përfitime të cilat korrespondojnë me prioritetet kryesore të përfituesit. Disa sisteme të sigurimeve shoqërore kishin rrënjët e tyre në shoqëritë e përbashkëta me përfitime të cilat u përhapën gjerësisht dhe janë konvertuar në skemat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore. Në disa vende ata kanë vazhduar të luajnë një rol të rëndësishëm duke i plotësuar të mirat e sistemit të detyrueshëm, për shembull, në ofrimin e daljes në pension. Në vende të tjera, roli i tyre është i kufizuar në mbulimin me sigurime të grupimeve të papërfillshme. Në përgjithësi, kontributi i tyre në nivel global është rritur në vitet e fundit për shkak të përhapjes e marginalizimit të rritjes së boshllëqeve në mbrojtjen statutores sociale.

KAPITULLI

V

- 5.1 VLERËSIM TEORIK I SKEMAVE TË PENSIONEVE
- 5.2 ÇËSHTJE FISKALE DHE FINANCIARE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
- 5.3 KONCEPTI I KAPITALIT NOCIONAL DHE KARAKTERISTIKAT BAZË
- 5.4 MEKANIKA E FUNKSIONIMIT TË NJË SISTEMI NDC
- 5.5 LLOGARITJA E PËRFITIMEVE BAZUAR NË SKEMËN NDC
- 5.6 SISTEMI ME LLOGARI NOCIONALE AVANTAZHET E TIJ KRAHASUAR ME SISTEMIN DB
- 5.7 REFORIMIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË SHQIPËRI DREJT NJË SISTEMI ME LLOGARI NOCIONALE

KAPITULLI V

Hyrje

Në këtë kapitull jemi të fokusuar në analizën e skemës të sistemit të sigurimeve shoqërore në vendin tonë para hyrjes në fuqi të sistemi të ri. Ky mund të konsiderohet si një nga kapitujt më të rëndësishëm të këtij punimi. Kjo për arsye të ndryshmeve në formulën e përfitimeve. Ky kapitull ka si qëllim evidentimin e problematikave që ka hasur ky sistem që nga miratimi i tij e në vazhdim. Analiza e këtyre problematikave ka pasur si qëllim ballafaqimin e arsyeve që çuan në marrjen e masave nga e shtetit për ndryshimin e plotë të funksionimit ekonomik të tij. Problematikat e tij janë nxjerrë duke u mbështetur në studime statistikore të përgatitura nga ISSH dhe Banka Botërore.

Në mënyrë që analiza ndërmjet sistemit të vjetër të sigurimeve shoqërore dhe sistemit të ri të bëhet e plotë dhe e kuptimtë si dhe nisur nga fakti që sistemi i ri i sigurimeve shoqërore ka ndryshuar tërësisht formulën ekonomike të përfitimit duke kaluar nga një sistem DB në një sistem NDC dhe për efekte të nxjerrjes në pah të të mirave që sjell sistemi i ri jemi përqëndruar në një analizë të hollësishme të

- *Konceptit dhe karakteristikat bazë të sistemit NDC ku kemi krahasuar këtë sistem me sistemin DB*
- *Konceptin e kapitalit nocional dhe llogaritja e pensionit vjetor në sistemin NDC*

5.1 VLERËSIM TEORIK I SKEMAVE TË PENSIONEVE

SKEMAT E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Skemat e sigurimeve shoqërore janë ndërtuar dhe zhvilluar për një qëllim shumë të rëndësishëm, atë të mbrojtjes së individëve dhe familjeve të tyre në rastet e prekjes nga rreziku social. System of National Accounts 1993 (SNA) e përkufizon termin "Sigurim Shoqëror" si një aktivitet i cili synon garantimin e krijimit të një njësie financiare mbrojtëse kundër rreziqeve të jetës.²⁴⁸

Po ashtu është theksuar se element i përbashkët i të gjitha skemave të sigurimeve shoqërore është "shpërndarja e riskut".²⁴⁹

Skemat e sigurimeve shoqërore janë konsideruar si një element që kanë transformuar jetën e njeriut të zakonshëm në mënyrë radikale, kjo për faktin se këto skema, ndihmojnë individin kur ai humbet çdo të ardhur për shkak të aksidentit në punë, sëmundjes, papunësisë apo vdekjes, duke kontribuar që individit të mos preket nga varfëria e plotë.

Në rrugën drejt këtij transformimi, skemat e sigurimeve shoqërore janë menduar si shtyllat e para të sigurisë nga rreziqet sociale, të cilat futen në funksion dhe zvëndësojnë të ardhurat gjatë asaj periudhe kur të ardhurat e individit janë ndërprerë ose minimizuar si pasojë e prekjes nga ngjarjet

248 John Pitzer "The definition of Social Insurance Scheme and its Classification as Defined Benefit or Definite Contribution", 2003, fq 3.

249 John Pitzer "The definition of Social Insurance Scheme and its Classification as Defined Benefit or Definite Contribution", 2003, fq 3.

sociale. Pothuajse në mbarë botën njihen dhe funksionojnë këto skema mbi sigurimin shoqëror:

Skema e detyrueshme. Kjo skemë administrohet nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore dhe mbulon të punësuarit në shtet dhe në sektorin privat dhe të vetëpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë. Nëse një person ekonomikisht aktiv është pjesë e skemës së detyrueshme, ai do të përfitojë mbulim nga të gjitha degët e sigurimit shoqëror dhe më konkretisht:

"Dega e pensioneve". Kjo degë do të mbulojë me të ardhura një person kontribues i skemës së detyrueshme kur ai ka realizuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikon kjo degë për përfitim. Si të tilla mund të përmendim:

- *Rezidencën;*
- *Mosha;*
- *Vjetërsia e punës;*
- *Derdhje e përqindjes së kontributit;*
- *Tërheqje nga veprimtaria ekonomike;*
- *Raport invaliditeti;*

Kjo skemë jep përfitime për:

- *Pensione pleqërie;*
- *Pensione invaliditeti;*
- *Pensione familjar;*
- *Pensione suplementar;*
- *Pensione të posaçme;*

Të ardhurat nga pensioni (Pensionin) e përfitojnë të gjithë subjektet që plotësojnë kushtet e mësipërme, pavarësisht nga lloji i punës që ata kryejnë, apo nga shuma e të ardhurave që kanë përfituar gjatë periudhës së punësimit. Një tjetër skemë e detyrueshme është skema e sigurimit profesional²⁵⁰, e cila jep përfitime për kategori subjektësh që punojnë në punë të vështira si minierat etj.

Skema vullnetare sipas Ligjit të Sigurimeve shoqërore, "kur një person, për shkak të arsyeshme nuk mund të sigurohet, ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht"²⁵¹.

Nëpërmjet sigurimit vullnetar, bëhet e mundur:

- *Vazhdimësia e sigurimit shoqëror,*
- *Zgjerimi i sigurimit shoqëror,*
- *Mbulimi i periudhave të kaluara,*
- *Sigurimi për një shumë më të madhe të ardhurash.*

250 Neni 42 Ligji Nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

251 Neni 3, Ligji Nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Shqipëri" i ndryshuar.

Vazhdimësi sigurimi nëpërmjet sistemit vullnetar, do të kuptojmë që personi të ketë qënë më parë i siguruar në mënyrë të detyrueshme, por që për arsye të ndryshme largohet nga sigurimi i detyrueshëm. Ajo që duhet të mbahet parasysh për personat të cilët ndërpresin sigurimin e detyrueshëm është lloji i mbulimit me sigurime. Kjo do të thotë që të gjithë subjektet, të cilët kanë qënë më parë të mbuluar me sigurime të detyrueshme, do të vazhdojnë të sigurohen në të njëjtat degë dhe nëpërmjet sigurimit vullnetar, nëpërmjet kontributeve maksimale dhe jep përfitime maksimale. E drejta e përfitimit nga skema vullnetare vazhdon për atë kohë sa subjektit nuk i ka lindur e drejta për të përfituar nga skema e detyrueshme.

Zgjerimi i sigurimit vullnetar është e drejta që i njihet një subjekti të caktuar, i cili ka kontribuar për një vit pa ndërprerje në skemën e sigurimit vullnetar për të shtuar fushën e mbulimit me sigurime shoqërore. Zgjerimi i degëve të sigurimit vullnetar është i kufizuar si për subjektet, ashtu edhe për degët e sigurimit shoqëror.

Subjekteve që u lejohe të bëjnë zgjerim vullnetar janë:

- *Të vetëpunësuarit, duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi²⁵²;*
- *Punëdhënësit.*

Degët për të cilat lejohet sigurimi vullnetar janë:

- *Dega e paaftësisë së përkohshme në punë;*
- *Dega e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.*

Zgjerimi vullnetar në degët e sigurimit shoqëror duhet të realizohet vetëm për vitin në vazhdim nga dita që ka filluar ky lloj detyrimi. Përfitimet që do të realizohen nga degët e reja janë përfitime të nivelit minimal.

Mbulimi vullnetar i periudhave të kaluara Mbulimin me sigurime për periudhat e kaluara kanë të drejtë ta realizojnë subjektet e mëposhtme:

- *Të vetëpunësuarit (përjashtohen këtu të vetëpunësuarit në bujqësi);*
- *Punëdhënësit;*
- *Të punësuarit;*
- *Popullsia joekonomikisht aktive.*

Subjektete mësipërme të cilët paguajnë përqindje kontributi vullnetar për periudhat e kaluara, mbulohen me sigurime në degë të përcaktuara dhe kanë përfitime minimale nga skema e sigurimeve shoqërore.

Përveç subjekteve të cilët ne i kemi ndeshur vazhdimisht gjatë trajtimit të këtij punimi, shohim se kemi edhe një kategori tjetër subjektesh, ku përfshihen ata persona që kanë qënë të vetëpunësuar në bujqësi, të cilët kanë ndryshuar vendbanimin e tyre, për këtë arsye nuk u njihet e drejta e sigurimit të detyrueshëm. Këta persona, kanë të drejtë që të pagujnë kontribute deri në nivelin maksimal, për të përfituar nga degët në nivelin maksimal.²⁵³

252 Komentar për sigurimin vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

253 Neni 42 Ligji 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Këto subjekte marrin përfitime për:

- *pension pleqërie;*
- *pension invaliditeti;*
- *pension familjar;*
- *pagesa për vdekje;*

Sigurimi për përfitim të lartë të ardhurash. Këtë lloj sigurimi kanë të drejtë ta bëjnë këto subjekte:

- *Të vetëpunësuarit (përjashtim bëjnë të vetëpunësuarit në bujqësi);*
- *Të punësuarit;*
- *Punëdhënësit privat;*

Sigurimi për të përfituar të ardhura më të larta, realizohet duke derdhur kontribute të nivelit maksimal për degën e pensioneve. Miratimi për të derdhur kontribute maksimale nuk realizohet për periudhat e mëparshme, ku sigurimi mund të jetë realizuar në nivel minimal. Raste të tjera të mbulimit me sigurim vullnetar për personat të cilët kontribuojnë nëpërmjet skemës së detyrueshme mund të përmendim:

Leje pa të drejtë ²⁵⁴; Kujdesi për fëmijën deri në 8 vjeç; Kujdesi për fëmijën invalid deri në moshën 15 vjeç; Përkujdesje për prindërit e paaftë; Të punësuarit që nuk i siguron qendra e punës; Të papunët; Të punësuarit jashtë shtetit (emigrantët) ²⁵⁵.

Ky sistem jep përfitime minimale; Përfitimet që ofrohen nga sistemi vullnetar janë përfitime të nivelit bazë.

Skema suplementare, ofron përfitime për funksionet e larta kushtetuese, shërbimin civil dhe ushtarakët e punësuar në ushtri, në polici dhe shërbimin informativ. Pensionet suplementare financoheshin drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit. Qëllimi i skemës suplementare është mbulimi me të ardhura (përfitimet) shtesë, mbi përfitimet që jepen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror. Kjo skemë administron masën e kontributit suplementar që derdhen subjektet e përfshirë në këtë sistem. Sipas ligjit për pagesën e sigurimit suplementar, kontributet që derdhen për pension suplementar përfshijnë përfitime për të gjitha llojet e pagesave, si të tilla, mund të përmendim:

- *Pagesa kalimtare;*
- *Pension suplementar shtetëror;*
- *Pension suplementar pleqërie;*
- *Pension suplementar invaliditeti;*
- *Pension suplementar familjar;*

Ky sistem funksionon krahas sistemit të sigurimit të detyrueshëm²⁵⁶.

²⁵⁴ Legjislati i Sigurimeve Shoqërore, kapitulli II "Llojet e Sigurimit Vullnetar", "Vazhdimi i Sigurimit".

²⁵⁵ Kapitulli III "Kontributet", "Personat e siguruar", Ligji Nr. 7703 datë 11.05.1993 për Sigurimet Shoqërore në Shqipëri, i ndryshuar.

²⁵⁶ Proçedurat e mbledhje së këtij kontributi janë të njëjta si të kontributit i detyrueshëm.

Karakteristikë e këtij sistemi është subvencionimi i tij nga buxheti i shtetit për përfitimet që ofron kjo skemë.

Skema e pensioneve të veçanta, funksionon përata subjekte që kanë marrë pjesë në luftë, që kanë tituj në fushën e kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës si dhe të përndjekurit nga regjimi komunist. Mënyra e financimit të kësaj skeme realizohet nga buxheti i shtetit.

Skema e pensionit social,²⁵⁷ ofron përfitime. Këtë pension do ta përfitojnë të gjithë individët që nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për përfitimin e një pensioni do të përfitojnë një pension social, i cili mund të përfitohet vetëm nga individët mbi 70 vjeç që kanë qenë resident në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit. Masa e këtij pensioni do të jetë jo më e madhe sesa masa e pensionit të pjesshëm që arrihet nga skema e kontributeve. Ky pension do të jepet duke patur si kusht verifikimin e të ardhurave dhe do të financohet nga buxheti i shtetit.

Nga një perspektivë më e gjerë, përfshirja e individit në skemat e sigurimit shoqëror është konsoliduar në rangun e të drejtave individuale nga një numër aktesh ligjore, efektet e të cilave shtrihen jo vetëm brenda kufijve të një shteti, por në rang ndërkombëtar.

Ajo që duhet të theksohet në lidhje me skemën e sigurimeve shoqërore është se ato duhet të bazohen në programe të planifikuara dhe të zhvilluara, duke marrë në konsideratë nevojat me urgjente të një vendi si edhe aftësinë e organizimit dhe të administrimit të këtyre programeve në mënyrë sa më të efektshme për individët.

Sot në botë njihen dy tipe të sistemeve të financimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore të qeverisura në mënyrë publike.

- *Sistemi DB, njihet ndryshe si sistemi me përfitime të përcaktuara;*
- *Sistemi NDC, njihet ndryshe si sistemi me llogari nacionale;*

Të dy sistemet e mësipërme funksionojnë në bazë të sistemit PAYG.

PAYG, do të thotë se me kontributet e të punësuarve aktual, paguhen pensionet e përfituesve të skemës.

Në rajone të ndryshme të botës, sistemet e pensioneve të mandatuara me fonde të **menaxhuara** publikisht janë skemë dominante e daljes në pension, të paktën për një nëngrup kryesor të popullsisë së mbuluar. Këto fonde të natyrës së përcaktuar të kontributeve në sistemin e sigurimeve shoqërore, pasqyrojnë trashëgiminë ekonomike të çdo individi ekonomikisht aktiv si për sektorin publik dhe për atë privat.

Shumë sisteme të përcaktuara të llojit me përfitim, me fonde të konsiderueshme rezervë janë një trashëgimi e "sistemeve të fazës - premium" të promovuar nga ONP pas Luftës së Dytë Botërore, në të cilin një tepriçë e madhe e të ardhurave mbi shpenzimet kishte për qëllim që të lejonte norma të konsiderueshme, më të ulëta të kontributeve të ardhshme, nëse fondet e investuara do të jepnin norma mjaft positive të kthimit²⁵⁸

²⁵⁷ Neni i Ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

²⁵⁸ Michael Cichon, Krzysztof Hagemeyer, John Eoodal, "Changing the paradigm in social security: From Fiscal Burden to Investing People", 2004, fq.15.

Shumë prej këtyre sistemeve të financuara pjesërisht ose tërësisht janë në nevojë urgjente për reforma, dhe pjesa më e madhe e presioneve për reforma janë të ngjashme me ato të skemave të pafinancuara:

- *Paaftësia për të përmbushur objektivat sociale;*
- *Nevoja për të harmonizuar skemat e sektorit publik dhe privat;*
- *Mos Qëndrueshmëria financiare për shkak të normave të ulëta dhe në shumë raste negative të kthimit;*

Fondet e pensioneve të menaxhuara publikisht, kanë një rekord të dobët në normat e kthimit²⁵⁹. Në shumicën e rasteve, normat janë negative në terma reale (për një periudhë prej 20 e më shumë vitesh), por edhe në qoftë se ato janë pozitive, ata janë të rralla mbi rritjen e pagave dhe të krahasuara në mënyrë të favorshme me fondet e menaxhuara privatisht.

5.2 ÇËSHTJE FISKALE DHE FINANCIARE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Përfitimet e sigurimeve shoqërore kushtojnë një sasi parash prandaj duhet të ngrihen fondet e nevojshme për funksionimin e tyre me qëllim realizimin e qëllimit për të cilin ato janë krijuar. Duke qenë se ligji i sigurimeve shoqërore në përgjithësi u jep personave të përligjur të drejta reale subjektive të përfitimeve sociale, duhet të gjenden mjete të përshtatshme për të mbuluar shpenzimet me të cilat mund të ballafaqohet skema e sigurimeve shoqërore. Mund të ndodhë që në pak raste të cilat do të konsiderojmë si raste të jashtëzakonshme, një sasi e caktuar e kapitalit të një degë të sigurimit shoqëror do të shpenzohet deri në reduktim.

Buxheti i Sistemit të sigurimeve shoqërore në përgjithësi është i fiksuar nga autoritetet politike apo nga organi qeverisës. Dukshëm, sa më shumë sisteme apo skema të jenë të financuara nga mënyrat e qeverisë, aq më shumë kontroll duhet të ketë mbi këto. Mënyra më e zakonshme për të mbledhur mjetet financiare për sistemi e sigurimeve shoqërore, është që të mbështeten në kontributet e personave ekonomikisht aktivë dhe në subvencionet e qeverisë.

Në disa raste mund të paraqiten edhe forma të tjera kontributive si mundësi të tjera alternative të financimit, të tilla si të gjitha llojet e taksave të 'rezervuara' dhe 'të ndikuara', të ardhurat do të përbëhen nga fitimet në kapital të institucioneve të sigurimeve shoqërore dhe taksat e tyre duke gëzuar shërbimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore. Shumica e sistemeve të sigurimeve shoqërore financohet nga kontributet që paguan i siguruari dhe nga punëdhënësit e tyre.

Në sistemet e sigurimeve shoqërore për punonjësit, ekziston një dallim ndërmjet kontributeve të punëdhënëseve dhe të punëmarrësve. Kontributi i punëdhënësit është llogaritur zakonisht në kushtet e një përqindjeje të pagës nominale të punëmarrësit (që do të thotë paga e tij para zbritjes së kontributit të punëmarrësit dhe tatimit të pagës); Kontributet e punëmarrësve janë llogaritur në lidhje me pagën minimale dhe maksimale. Përqindja e Kontributit (ose shuma e kontributit) është fiksuar nga qeveria e cila në bashkëpunim me Insitutin e Sigurimeve

259 Robert Palacios, "Securing Public Pension Promises through Funding", 2002, fq.26.

Shoqërore rregullon skemën e sigurimeve shoqërore.

Paga që në këtë mënyrë përbën bazën për kontributin, mund të jetë paga reale apo një pagë subjekt i të ardhurave të kufirit të sipërm (asnjë kontribut nuk do të vihet mbi shumën me të cilën paga reale e kalon këtë kufi). Ky tavan ose caktimi i kufijve të bazës së kontributeve mund të zbatohet për kontributin e punonjësit, kontributin e punëdhënësit ose për të dyja.

Si rregull, kontributi i punëmarrësit nuk do ta kalojë atë të punëdhënësit. Kontributet e sigurimeve shoqërore janë proporcionale si rezultat i delimitimit, por nganjëherë ato mund të shfaqen madje edhe regresive, kjo në kundërshtim me tatimin mbi të ardhurat të cilat kanë një karakter progresiv.

Në një kundërshtim krahasues, ndarja ndërmjet kontributeve të punonjësve dhe të punëdhënësve bëhet e parëndësishme, duke qenë se kjo ndarje, që jep një bilanc të caktuar të pushtetit mes punonjësve dhe punëdhënësve dhe një situatë të caktuar të tregut të punës, bashkëpërcakton mënyrën në të cilën paga nominale përcaktohet. Shuma e pagës nominale nuk është neutrale sa i përket sigurisë sociale, por është krijuar në funksion të taksave dhe kontributeve të mëvonshme, që do të vendosen mbi të.

Natyrisht brenda një vendi, çdo ndryshim në ndarjen mes kontributeve të të punësuarve dhe punëdhënësve do të bëhet relevante, sapo marrëdhënia midis këtyre kontributeve të jetë e fiksuar dhe sapo pagat nominale të jenë përcaktuar. Çfarë mbetet e rëndësishme është spektri ndërmjet shumës që punëdhënësi ka për të paguar për të vendosur për të punuar një punonjës dhe shumës që merr punëmarrësi pas zbritjes së të gjitha kontributeve. Ky ndryshim, i ashtuquajtur 'pjesëz', shënon çmimin e kostos së sigurimeve shoqërore.

Natyrisht, sistemet e sigurimeve shoqërore për të vetëpunësuarit nuk mund të veprojnë me pagat që i nënshtrohen detyrimit të kontributeve. Baza e kontributit është e matur në terma të të ardhurave reale, vlerësuar apo të deklaruar profesional.

Në disa vende, kontributi mbledhet në bashkëpunim me zyrën e tatimeve.

Kur institucioni i sigurimit social që merret me mbledhjen e kontributeve të të vetëpunësuarit e ka të vështirë ose edhe të pamundur të përcaktojë të ardhurat reale, atëherë të ardhurat do të maten në bazë të të ardhurave të deklaruar nga personi i vetëpunësuar. Në këtë rast padyshim mbledhësit e kësaj takse duhet të sigurohen që personi i vetëpunësuar e ka të vlefshme (në aspektin e përfitimeve të mundshme) të deklarojë të ardhura të mjaftueshme profesionale. Në sistemet e sigurimeve shoqërore për të vetëpunësuarit, bazat e kontributit mund të jenë maksimale minimale, duke marrë parasysh të ardhurat reale.

Në shumicën e vendeve ka një prirje për të barazuar barrën e kontributeve për punësim dhe vetëpunësim. Kjo do të thotë, që kur përfitimet janë të barabarta, kontributi i vetëpunësimit do të duhet të jetë më i lartë se ai i punëmarrësit, pa qenë gjithmonë e mundur ose e nevojshme për të rritur kontributin e të vetëpunësuarit deri në nivelin e shumës së kontributeve të të dyve, punëdhënësve dhe punonjësve. Ndonjëherë, kontributet më

të ulëta kërkohej nga ana e nënpunësve shtetërorë. Kjo mund të jetë e legjitimuar nga natyra e veçantë e të ardhurave të tyre profesionale.

Përfitimet më të larta sociale, veçanërisht pensionet më të larta, janë duke u konsideruar si një lloj kompensimi për pagat që janë relativisht më të ulta se sa ato të fituara në sektorin privat. Megjithatë, aktualisht tendenca mbizotëron për të sjellë kontributin e nënpunësve civilë në një linjë me atë të të punësuarve.

Subvencionet qeveritare

Do të kuptojmë ato Kontribute që financohen nga buxheti i shtetit për të mbuluar pagesat për disa degë të sigurimit social. Të tilla mund të përmendim: pensionet e veçanta, suplementare dhe pagesën e papunësisë. Një tjetër formë e subvencionit shtetëror është dhe ndërhyrja me financim të drejtpërdrejtë në të gjitha degët e sigurimit shoqëror. Kjo ndodh në ato raste kur skema nuk ka kapacitetet e nevojshme financiare për të mbuluar shpenzimet e skemës për pagesa në drejtim të përfituesve.

Mbledhja e kontributeve organizohet nga tatimet në të njëjtën kohë me tatimin e të ardhurave, ky fakt mund të sjelli konfuzion për perceptimin e sigurimit shoqëror tek personat ekonomikisht aktivë, për faktin se në pamje të parë kontributi duket sikur është tatim, por në fakt kontributi është një e ardhur që depozitohet në llogari personale dhe i kthehet kontribuesit në formën e përfitimit. Pra kontributet nuk duhen parë si taksa. Ato duhen konsideruar si formë kursimi për të ardhurat.

Më lart theksuam se si punëdhënësit ashtu dhe punëmarrësit paguajnë kontribute për sigurime shoqërore. Por për punëdhënësin pagesa e kontributit konsiderohet shpenzim sepse ai përveçse paguan kontribute për veten e tij paguan kontribute edhe për punëmarrësin të ardhura këto që i nxjerr nga fitimet e tij. Në disa raste kontributet e sigurimeve shoqërore mund të mos mbulojnë dot pagesat në drejtim të përfituesve. Në një rast të tillë kjo situatë mund të jetë kaotike për skemën dhe kërkon zgjidhje të menjëhershme. Një nga mënyrat e zgjidhjes është *transferimi i fondit nëpërmjet degëve të sigurimit*.

Të ardhurat e një dege tjetër mund të transferohen me një përqindje të caktuar tek dega që ka probleme. Për sa më sipër, theksoj se përfitimet sociale që ofron skema e sigurimeve shoqërore përballohen nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore (FSSH) që është strukturë financiare e pavarur nga buxheti i shteti. Menaxhim i FSSH-së i është ngarkuar ISSH-së, i cili është institucion i pavarur publik në varësi dhe nën kontrollin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Fondi i sigurimeve shoqërore ndahet në pesë degë kryesore që janë: sëmundje, barrëlindje, pensione, aksidente dhe sëmundje profesionale dhe papunësi.

Sipas rregullores financiare të skemës së sigurimeve, lejohet huazimi i burimeve financiare nga njëra degë në tjetrën, kundrejt një interesi të përcaktuar.

Huazimi pa interes është i lejuar vetëm në rastet kur miratohet nga Parlamenti në buxhetin vjetor të ISSH. Duke qenë një institucion i specializuar ISSH-ja është e ngarkuar të administrojë disa programe të veçanta kompensuese, statute apo edhe skema suplementare, të cilat financohen totalisht nga buxheti i shtetit dhe kjo krijon një imazh

shqetësues për shkallën e pjesëmarrjes së shtetit në FSSH. Këto transferta duke qenë të konsiderueshme, duket sikur i shërbejnë reduktimit të varfërisë por duke evidentuar shtresat që i përfitojnë rezultojnë se ato faktikisht i përgjigjen më shumë pjesërisht reduktimit të varfërisë.

Një tjetër mundësi zgjidhje përsa i përket deficitit financiar të skemës mund të jetë huaja financiare, ku administratorët e sistemit të sigurimeve shoqërore detyrohen për të negociuar një hua me çmimin e tregut. Përveç kontributeve dhe subvencioneve të qeverisë si forma të financimit të skemës, në praktikë në shumë sisteme të sigurimeve shoqërore njihen edhe forma të tjera alternative të financimit.

Të ardhurat sociale të të gjitha llojeve, të rezervuara ose taksat e prekura. Këto të ardhura nuk do të shkrihen vetëm në të ardhurat e përgjithshme të Qeverisë, por do të caktohen në një skemë të sigurimeve shoqërore. *Të ardhurat nga veprimtari të tjera* të Institucioneve të sigurimeve shoqërore²⁶⁰. Në këtë rast, të ardhurat e këtyre mjeteve mund të shfrytëzohen për të financuar sigurinë sociale. Në skemën tonë të sigurimit shoqëror, të ardhurat që krijon insituti i sigurimeve shoqërore përdoren për shpenzime administrative operacionale, dhe një pjesë depozitohet në fondin rezervë të sigurimeve shoqërore. Si fondi i përgjithshëm, ashtu edhe fondi rezervë në përgjithësi nuk financohen.

TABELA 6/1 Skema e buxhetit të Sigurimeve Shoqërore

Të ardhura të rregullta	Përfitimet
Kontributet	Sigurime për pensione
-nga punëdhënësi	Sigurime për sëmundje
-nga punëmarrësit	Sigurime për barrëlindje
-nga të vetëpunësuarit	Sigurime për aksidente në punë
-nga buxheti i shtetit	Transferim në buxhetin e sigurimit të papunësisë
Interesa dhe komisione	
Të ardhura të parregullta	Kostot Administrative
Transferta nga buxheti i shtetit	Operacionale ose korente
-për indeksimin e pensioneve	Investimet
-për programet speciale	
-për financim të defiçitit të ISSH-së	
Të ardhura të tjera (gjoba, etj.)	
	Fondi Rezervë i Sigurimeve Shoqërore

Nëse do t'u referohemi skemave me financim do të theksojmë se nëse një skemë e sigurimeve shoqërore ka bërë një punë të mirë në lidhje me kapitalizmin, atëherë investimi i saktë i fitimit kapital do të jetë me rëndësi të madhe për financimin e skemës. Sapo një individ lidhet me një skemë të sigurimeve shoqërore nëpërmjet kontributit, ai mund të jetë i sigurt se sa herë ai do të përballlet me shfaqjen e një rreziku social të mbuluar

²⁶⁰ Këto të ardhura krijohen nga mbledhja e gjobave, kamatvonesave, dhuratave, ose mund të kenë të ardhurat të tyre, ose mund të kenë zhvilluar kapitalin e tyre në rrjedhën e kohës.

nga skema, atij i lind e drejta që të kërkojë përfitimin përkatës sipas objektit të aplikimit. Ky përfitim në përgjithësi do të jetë i përkohshëm ose i përhershëm.

Në rastin e përfitimit të përkohshëm, individi i rikthehet përsëri skemës ndërsa në rastin e përfitimit të përhershëm ai nuk financon më në skemë. Por ajo që kuptohet është se personave nuk u humbet kurrë e drejta e përfitimit nga kjo skemë.

Pavarësisht se përfitimi në drejtim të subjekteve për skemën përbën shpenzim, sigurimet shoqërore do të vazhdojnë të marrin përsipër një pjesë të shpenzimeve për një nga degët përfituese. Skema e sigurimeve shoqërore ka në fokus të organizimit të saj uljen e shpenzimeve që realizohen në degë të ndryshme të sigurimit shoqëror me qëllim efikasitetin e sistemit të përgjithësisë dhe skemës në veçanti.

Më konkretisht mund të themi se efikasiteti i uljes së shpenzimeve mbështetet në 2 kritere kryesore:

- *Zbatimit të kritereve ligjore;*
- *Kontrollit të vazhdueshëm financiar;*

Le t'i analizojmë këto dy rrugë për të kuptuar ndikimin e tyre në uljen e shpenzimeve dhe racionalizimin e skemës.

Zbatimit të kritereve ligjore.

Zbatim i kritereve ligjore do të thotë se të drejtën për të përfituar sigurim të detyrueshëm nga të 5 degët e sigurimit shoqëror, e kanë vetëm ato subjekte që plotësojnë kushtet e përcaktuara në "Ligjin për Sigurimet Shoqërore". Kriteri ligjor është një element shumë i rëndësishëm për funksionimin e gjithë sistemit të sigurimeve shoqërore, për këtë arsye do të tregojmë se si ndikon ai në këtë sistem. Gjithashtu, do të shohim se si këto kritere shpeshherë, bëhen shkak kryesor për rritjen e shpenzimeve të skemës dhe krijimin e disekuilibrave financiare të sistemit.

Në praktikë, fenomeni i shkeljes ligjore është i pashmangshëm. Si pasojë e shkeljes ligjore skema rëndohet me shumë shpenzime. Nëpërmjet shembullit të mëposhtëm referuar degës së sëmundjes, do të mund të kuptojmë më të qartë rëndësinë e zbatimit të kritereve ligjore.

Për të përfituar pagesa nga dega e sëmundjes duhet që përfituesi përveç kushtit të mbulimit me sigurime për sëmundje (pagesës së kontributit), duhet që të plotësojë edhe dy kushte të tjera kryesore:

të jetë i sëmurë;

të pajiset me raport mjekësor;

Kjo do të thotë se një person, vetëm kur është i sëmurë, ka të drejtë të përfitojë raport mjekësor. Me përfitimin e raportit mjekësor lind dhe e drejta për përfitime nga dega për sëmundje.

Në praktikë ne ndeshemi me një fenomen shumë të rrezikshëm, atë të "fiktivitetit diagnostikues". Kjo do të thotë se shumë individë mund të diagnostifikohen të sëmurë edhe kur nuk janë. Nëse nga ana e shtetit do të ushtrohej kontroll mbi vërtetësinë e diagnostifikimit, atëherë edhe

shpenzimet për këtë degë, do të jenë më të ulta²⁶¹.

Kontrolli vazhdueshëm financiar

Kontrolli vazhdueshëm financiar është një moment shumë i rëndësishëm për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore. Nëpërmjet kontrollit financiar evidentohet nëse mbledhja e kontributeve, shpërndarja e të ardhurave, janë realizuar në përputhje me zbatimin e politikave ekonomiko-financiare, politikave sociale si dhe në mbështetje të plotë në dispozitat ligjore. Por jo vetëm kaq, nëpërmjet kontrollit financiar, mund të evitohen shkeljet dhe abuzimet, jo vetëm në drejtim të skemës së sigurimeve shoqërore por edhe ato në drejtim të individëve.

Ulja e përqindjes së kontributit

Ulja e përqindjes së kontributit përbën qëllimin dhe tendencën e politikave sociale, që është reduktimi i taksave dhe rritja e përfitimeve. Një individ i cili gjatë kohës së punësimit rëndohet me pak taksa dhe, kur nuk ka mundësi të punojë, përfiton nga skema të ardhura të larta, padyshim që do të jetë shumë i ndërgjegjshëm dhe i ndjeshëm që të jetë kontribues i rregullt i skemës së sigurimeve shoqërore.

Ndonjëherë, punëdhënësi individual do të duhet të kryej shpenzimet e disa përfitimeve të sigurimeve shoqëruara të paguara te të punësuarit e tij. Punëdhënësi mandej mund të vendosë ose të risigurojë rreziqet në fjalë, ose t'i bëjë ato të tijat. Në rastin e fundit, "financimi" i marrëveshjes së sigurimeve shoqërore në fjalë do të jetë jo më shumë se një dispozitë, në librat e rezervave të nevojshme, për të mbuluar përfitime të tilla shoqërore që mund të lindin.

Rezervat e tilla të kontabilitetit mund të gjenden në skemat pensionale të krijuara nga kompanitë; disa punëdhënës gjithashtu veprojnë si sigurues për aksidentet e tyre në punë, ose duhet të marrin përsipër koston e përfitimeve, në rast sëmundje nga punonjësit e tyre. Shumica e sigurimeve shoqërore dhe skemat e asistencës sociale operojnë mbi baza "pay-as-you-go" ose baza ndarjeje: kontributet aktuale shërbejnë për të paguar përfitimet aktuale të sigurimeve shoqërore.

Vetëm pak skema statuore, skemat e sigurimit shoqëror të detyrueshëm operojnë me "kapitalizim" ose në një mënyrë "të financuar": Kontributet aktuale shërbejnë më pas për të financuar përfitimet që do të paguhen (ndoshta) më vonë, ndaj personit që ka paguar kontributet. Brenda kategorisë së marrëveshjeve të financuara ose të kapitalizuara, ne mund të bëjmë dallimin ndërmjet atyre skemave që organizohen me kontribute të përcaktuara NDC dhe atyre që organizohen mbi bazën e përfitimeve të përcaktuara DB.

Përveç skemave të përgjithshme të sigurimeve, elemente të tjera financimi për sigurim shoqëror janë edhe skemat suplementare private. Këto skema, kryesisht veprojnë në bazë të financimit. Në disa vende, sigurimet shoqërore përfshijnë krijimin e llogarive personale të kursimeve, të cilat mund të përdoren për qëllime të ndryshme sociale (për të blerë një shtëpi, për të mbuluar shpenzimet e kujdesit shëndetësor, sigurimin e

²⁶¹ Duke analizuar ndikimin që kanë kritetet ligjore në degën e sëmundjes, mund të bëjmë të njëjtën analogji edhe për degët e tjera të sistemit. Analogjia realizohet duke u mbështetur në kritetet baze të cdo dege.

jetës etj). Këto llogari kursimi personale gjithashtu mund të preceptohen sinjë formë ekstreme e financimit apo kapitalizimit.

Kalimi nga kapitalizimi ose sistemi i financuar në një sistem pay-as-you-go ose sistem me ndarje, nuk paraqet problem të veçantë. Pavarësisht faktit se, që pas tranzicionit popullsia aktive do të duhet të paguajë edhe për pensionistët aktualë (të cilët vetë kanë jetuar nën ndarje) dhe për pensionet e veta më pas. Një tranzicion i tillë nga ndarja tek kapitalizimi duket i realizueshëm pas falimentimit (real apo virtual) të sistemit ekzistues të ndarjes (repartition) dhe/ose kur kreditë (e huaja ose ndërkombëtare) lejohen për mbulimin e të drejtat e fituara sipas sistemit të mëparshëm të ndarjes.

Kohët e fundit, disa vende kanë reformuar skemat e tyre staturore të pensioneve në mënyrë për t'u dhënë atyre një karakter të përzier: Pjesa e madhe e mbetur në një bazë të një ndarje, të re, do të jenë pjesa më e vogël në bazë të kapitalizimit. Sistemi i ndarjes "pay-as-you-go" përgjithësisht do të veprojë në bazë vjetore: Kontributet e këtij viti do të llogaritet në mënyrë që të mundësojnë mbulimin e shpenzimeve të këtij viti. Megjithatë, sistemi i ndarjes (repartition) nganjëherë mund të punojnë me një strukturë kohe më të gjatë (periudhë shtatë-vjeçare për shembull), në të cilën mjete të mjaftueshme gjithmonë do të duhet të jenë në dispozicion, për të mundësuar që sistemi të mbulojë pretendimet që lindin gjatë periudhës më të gjatë.

Ka edhe skema (pensioni) të cilat përfshijnë kontribute të regjistruara në një llogari individuale, por, në formën e pikave të kontributeve. Çdo vit, vlera e pikave të tilla do të shprehet në aspektin e parave ose thënë ndryshe përfitimit (Pensioni), që do të shpërndahen më vonë dhe do të korrespondojë me numrin e pikëve të mbledhura, në kohën e pagesës.

Nga ana tjetër do të transferohen, në sasinë e parave që korrespondon me pikët në atë moment. Sistemi i kapitalizimit, ashtu si format e caktuara të ndarjes të tilla siç janë dy shembujt e lartpërmendur, në përgjithësi do të përfshijnë krijimin e një fondi nëpërmjet të cilit mjetet e sistemit të sigurimeve shoqërore do të mblidhen dhe menaxhohen. Në mënyrë evidente sa më shumë të ardhura të përmbajë një fond i tillë, aq më shumë ndikime do të fitojë ai në tregjet financiare.

Një Sistem ndarjeje nuk ka nevojë për një fond të tillë; ai mund të ketë të bëjë me disa kapitale qarkullues, një ofrim të caktuar të parave në dispozicion, për të përmbushur kërkesat e (aktuale) më shumë ose pa problem. Kur një Sistem ka ekzistuar për disa vjet me radhë, dallimi i vërtetë në mes ndarjes dhe kapitalizimit bëhet i qartë, duke qenë se të ardhurat e sjella nga pjesëmarrësit aktivë, në realitet do të përdoren në radhë të parë për të mbuluar përfitimet e paguara nga të pranishmit në pension. Lind pyetja: Cili është ndryshimi i vërtetë ndërmjet kapitalizimit dhe ndarjes (repartition)?

Në një qasje të kapitalizuar osë të financuar, përfitimet e paguara më pas do të jenë në funksion të zhvillimit të tregjeve financiare (kryesisht globale), ndërsa në një qasje ndarjeje ose pay-as-you-go, përfitimet e ardhshme do të ndjekin evolucionin e pagave në tregun e punës. Shumë skema të sigurimeve shoqërore (veçanërisht ato në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe të pensionet e pleqërisë) janë duke u përballuar

aktualisht me problem të mëdha financiare. Kjo po ngjet për shkak të rritjes së plakjes së popullsisë dhe rënies së normës së lindjeve. Për më tepër, të rinjtë gjithnjë e më shumë studiojnë për periudha gjithnjë e më të gjata kohore, ndërsa në të njëjtën kohë shumë e shumë vende kanë marrë masa për të tërhequr të punësuarin nga tregu i punës, në një fazë më të hershme për të luftuar papunësinë.

Ky fakt, ka rezultuar në një përkeqësim të raportit aktiv/pasiv një rënie e popullsisë për punës dhe një rritje e atyre që marrin përfitimet nga sigurimet shoqërore. Gjithashtu, normat e papunësisë në rritje ka kontribuar për këtë fenomen.

Së fundmi duhet të merret parasysh faktin se në shumë vende, që prej disa vitesh, skemat ekzistuese të sigurimeve shoqërore kanë arritur rritjen e tyre të plotë dhe për rrjedhojë, ajo është duke vazhduar të paguajë pensionet e plota. Për më tepër, këto sisteme të sigurimeve sociale janë rënduar edhe më shumë nga ekuacioni, në të shkuarën, i të gjithave llojeve të periudhave të mosaktivitetit (p.sh. ndërprerja e karrierës në mënyrë që të rrisë një fëmijë të vogël) me periudha pune aktive (subjekt i përgjegjësisë së kontributeve).

Sa më sipër duhet të kihet parasysh, po zhvillohet bindja që është arritur kufiri i sipërm i taksimit, dhe se qeveria nganjëherë tashmë e rënduar nga një borxh i konsiderueshëm publik, ka mangësi fondesh e kësaj aje është gjithnjë e më pak në gjendje të gjejë të ardhurat e nevojshme, për të mbështetur financiarisht sistemin e sigurimeve shoqërore.

Në të njëjtin rrjet solidariteti, padyshim mund të gjendet rrjedhja e parave nga të pasurit të varfërit, nga pjesa aktive në pjesën post apo para-aktive të popullsisë, nga një brez në tjetrin, apo nga një rajon në një rajon tjetër. Nëse situatë e fundit, d.m.th. transferimet financiare nga një rajon në tjetrin, është vazhdimisht e dobishme për një rajon në dëm të tjerëve, kjo ndoshta do të rezultojë në njerëz të cilët vënë në dyshim nevojën për të ruajtur një sistem të përbashkët solidariteti.

Për sa i përket bartjes së autonomisë, në drejtim të rajoneve, të (financimit) të sistemit të sigurimeve shoqërore ekzistuese brenda kufijve të një shteti: hulumtimi ka treguar se kjo nuk do të çojë në një ndarje të bashkimit monetar dhe ekonomik në vendin e përfshirë, të paktën për sa i përket ndihmës sociale, kujdesit shëndetsor dhe fondeve familjare. Në një rast ndryshe mund të jetë në rast të transferimit të autonomisë së përfitimeve të zvendësimit të të ardhurave.

Në një sistem Pay As You Go ose ndarjeje, duhet të mbahet parasysh gjithashtu parimi i solidaritetit mes brezave. Një solidaritet i tillë nënkupton që popullsia e punës është e gatshme të sigurojë të ardhurat për të përmbushur kërkesat e sigurimeve shoqërore të brezave të mëparshëm. Por ajo gjithashtu, përfshin një vetëdije të popullatës së sotme punuese për të mos krijuar një sistem të tillë të sigurimeve, që do të rëndojë brezat e ardhshëm me kosto që do të mund të bëhen të padurueshme.

Sistemet e sigurimeve shoqërore sigurojnë mbrojtje për ata që janë të prirur ndaj rrezikut social, por ka gjithashtu dhe mënyra të tjera për t'u marrë me rreziqet sociale. Në këtë drejtim, sistemi i taksave meriton vëmendje të veçantë. Me anë të mostaksimit apo zvogëlimit të taksimit të të ardhurave, që normalisht do të jenë të tatueshme, mund të prodhohet

një efekt i krahasueshëm me anë të krijimit të një skeme të përfitimeve të sigurimeve shoqërore.

A. KONCEPTI NDC DHE KARAKTERISTIKAT BAZË

Sistemi NDC u miratua me ligj në vitin 1994 në Suedi dhe në 1995 në Itali, dhe vende të tjera. Në Suedi, sistemi i ri u fut për të gjithë punëmarrësit me një periudhë tranzitore 15-vjeçare. Ky sistem do të zbatohet plotësisht pas disa viteve. Palmer (2000) bën një përshkrim të mirë të sistemit NDC suedez dhe implementimit të tij.

Në Itali, sistemi NDC u fut si pjesë e së ashtquajturës reforma 'Dini' me një periudhë shumë të gjatë tranzicioni. *Ajo do të jetë e përshtatshme vetëm për punëtorët që janë në moshë më të re se sa brezi i fëmijëve të lindur gjatë bumit të viteve '50-'60.* Franco dhe Sartor (2006) bëjnë një vlerësim kritik të këtij sistemi.

Ndërsa Suedia dhe Italia janë shembujt më të cituar të sistemeve NDC, Letonia dhe Polonia kanë shërbyer në fakt si vende provë për këtë refoma.²⁶²

Skema NDC është një skemë pensionesh *me kontribute të përcaktuara, pay as you go*, (PAYG). Kryesisht, në një skemë NDC, pjesëmarrësit - apo punëdhënësit në emër të tyre - paguajnë kontribute në bazë të të ardhurave gjatë gjithë karrierës së tyre të punës. Megjithëse ka një moshë minimale në të cilën mund të kërkohet një pension vjetor, për sa kohë që njerëzit vazhdojnë të marrin të ardhura nga puna, këto të ardhura prodhojnë kontribute për llogari individuale, kontributet e secilës periudhë *shënohen* në një llogari personale.

Kjo llogari nocionale individuale shtohet pas çdo kontributi të ri dhe kreditohet me një shkallë kthimi (fitimi). Në skemën e përgjithshme NDC, norma e kthimit është norma e brendshme e kthimit (fitimit). Përfitimi nga NDC-ja është një pension për gjithë jetën. Ai mund të kërkohet në çdo kohë, mjafton që individ të ketë arritur moshën minimale të daljes në pension. Kështu skema NDC shpërndan burimet financiare *individuale* gjatë ciklit të jetës, por brenda kuadrit të skemës së sigurimeve në shkallë vendi (universale) të sistemit PAYG.

Një karakteristikë e veçantë e kësaj skeme mbetet fakti se kjo skemë *sigurimi* dhe si e tillë, ajo rishpërndan kapitalin e një individ që vdes midis pjesëtarëve të gjallë të skemës. Ajo kryen funksionin e sigurimit në rastin kur një individ përballet me riskun e të jetuarit mbi moshën mesatare të pjesëmarrësve. Si NDC-ja ashtu edhe përfitimet e përcaktuara në bazë të kontributeve (*Pay As You Go*), që do të thotë, skemat e përfitimit të përcaktuar jo financiar, ndryshojnë nga skemat financiare në pikëpamje të efikasitetit ekonomik.

Përdorimi i termit kontribut financiar dhe jo financiar ka të bëjë me faktin se përveç skemës NDC ekziston dhe skema FDC, e cila është një skemë ku ndryshe nga NDC ku paratë në llogaritë individuale nuk investohen në instrumentet e tregjeve financiare, paratë e llogarive individuale në skemën FDC investohen në asete të tregjeve financiare.

Këto dy skema ndryshojnë shumë në pikëpamje të efikasitetit ekonomik,

²⁶² Shih Kutkoëski (1998); Gora dhe Rutkoëski (1998); Fox dhe Palmer (1999); Chlon -Dominczak dhe Gora (2006).

kjo për faktin se një skemë pension FDC jep një normë kthimi të përshtatur sipas riskut, duke krijuar një *shtesë tatimore* (tax wedge). Kjo do të thotë se pjesëmarrësit do të përfitonin një shkallë më të lartë të ardhurash për jetën. Megjithatë duke theksuar se skemat NDC, të paktën potencialisht, janë po aq efikase sa edhe skemat financiare të pensioneve FDC. Ato do të ishin po aq efikase sa edhe skemat financiare në një ekonomi me një gjendje të qëndrueshme (të mbyllur), të Rregullit të Artë, por jo detyrimisht të tilla²⁶³.

Një skemë FDC ka epërsi ndaj një skeme NDC, kjo për faktin se në skemën NDC përfitimet individuale lidhen vetëm me kontribute individuale, ndërsa në një skemë FDC përfitimet lidhen me investimin e kontributeve. Në një pamje të parë të krijohet mendimi se skemat FDC janë skema joshëse në drejtim të përfitimit, por në fakt është krejt ndryshe;

- *Një skemë FDC me një portofol ku dominon borxhi, apo të investuar në borxhin e vendit përkatës është e ekspozuar ndaj riskut të këtij vendi njëllor si një skemë NDC.*
- *Një skemë FDC kundërfaktike, që ka po ashtu vetëm apo kryesisht obligacione qeveritare mund të ngjasojë me një skemë NDC, plotësisht të monetarizuar me obligacione të tipit Buchananian. Megjithatë, kur norma e obligacioneve të qeverisë është më e madhe se IRR-ja, ky "avantazh" do të paguhet përmes taksave që i vihen të njëjtit kolektiv të sigurimeve në shkallë vendi, pra marrësve të fitimit më të madh;*

Gjithashtu, duhet të theksojmë se një skemë NDC ndryshon nga skemat me përfitim të përcaktuar, nëpërmjet të cilave individ merr aq sa paguan (DB-PAYG). Ky ndryshim qëndron në mënyrën se si ajo i trajton pasojat e ndryshimit të faktorëve demografike dhe ekonomike. Në një skemë NDC, pasojat e luhatjeve ekonomike dhe demografike zgjidhen në mënyrë organike (të brendshme), ku norma e brendshme e kthimit të skemës NDC i përshtat vlerat e llogarive gjatë fazave të akumulimit dhe të pagimit, dhe ku pensionet u përshtaten ndryshimeve të pritshmërive të jetëgjatësisë e grupmoshave të një viti lindjeje, në momentin e daljes në pension.

Në një skemë DB-PAYG, përfitimet janë të caktuara me "kontratë" dhe përshtatjet e sistemit ndaj tronditjeve të jashtme ekonomike dhe demografike rregullohen me anë të ndryshimeve në masën e kontributeve. Është e qartë se kjo qasje ndaj trajtimit të risqeve të jashtme ekonomike dhe demografike mund të prodhojë rezultate të ndryshme në shpërndarje krahasuar me NDC-në, e cila përshtatet, duke përshtatur llogaritë. Për shkak se një skemë NDC ka një shkallë konstante kontributesh në kohë, mund të pritët që breza të njëpasnjëshëm pjesëmarrësish të paguajnë të njëjtën përqindje fikse të të ardhurave të tyre në këtë skemë.

Në rast se zgjidhet kjo veçori për të përkufizuar drejtësinë nga njëri brez në tjetrin, atëherë një skemë NDC është e drejtë për secilin brez. Çdo brez dotë paguajë një përqindje fikse të të ardhurave gjatë jetës së tij në skemë, duke pritur që të presë të marrë një varg me përfitime që do të përcaktohen nga këto pagesa individuale dhe norma e kthimit e sistemit.

Nëse do t'i referohemi vendit tonë dhe të gjitha strategjive të hartuara në fushën e sigurimeve shoqërore, vihet re se parashikimet e nomrave

²⁶³ Shih Samuelson 1957

të fitimit realizohen mbi bazë të statistikave demografike. Aktualisht këto statistika të cilat janë marrë për bazë në parashikimin afatgjatë të skemës NDC, realisht përbëjnë një rrezik të madh për ecurinë e skemës tonë. Arsyet janë lëvizjet e pakontrolluara të mirgimit dhe emigrimit të cilat janë të evidentuara nga janari 2015 e në vazhdim.

Një tjetër problem i emigrimit është ekuilibri i solidaritetit të brezave. Fakti që solidariteti i brezave përbën çelësin e mirëfunksionimit të këtij sistemi natyrshëm lind shqetësimi për jetëgjatësinë e këtij sistemi dhe efikasitetin e tij për brezat e ardhshëm. Nisur nga sa u theksua më lart mund të thuhet se skemat NDC mund të japin rezultate të ndryshme edhe *brenda grupmohave*. Kjo vjen për shkak se vlera e përfitimeve individuale varet nga norma ndërkohore e kthimit, e cila do të ndryshojë nga një periudhë në tjetrën.

Por kjo gjë vlen për çdo skemë pensioni. Rezultatet individuale janë në funksion ose të normës së kthimit të tregut (në skemat financiare) ose të një forme indeksimi (në skemat jo financiare), kështu që edhe shpërndarja e rezultateve individuale me kohë do të jetë në funksion ose të zhvillimit të tregut financiar ose të ekonomisë, përkatësisht, ku rezultati i saktë do të varet nga mënyra se si rregullat e sistemit e lidhin skemën me njërën nga këto të dyja.

Ndryshimet e normës ndërkohore të kthimit në skemën NDC, do të thotë se rezultatet për sasi të caktuara kontributesh të vlerësuara realisht mund të ndryshojnë brenda të njejtës grupmohë, por edhe sipas personave në një grupmohë me të njëjtën vit lindje, në varësi të kohës kur ata hyjnë dhe dalin nga forca e punës.

Nëse do t'i referohemi asaj se çfarë bën më konkretisht skema NDC, mund ta përkufizojmë se nëpërmjet saj realizohet sigurimi i një organizimi për kontabilitet transparent të flukseve të parave, në sistemin e përgjithshëm dhe të burimeve të financimeve për këto flukse. Gjithashtu, duhet të theksojmë se NDC-ja nuk e eleminon riskun politik dhe ekonomik të një vendi. Në këtë kuptim, ajo siguron një kuadër transparent për balancën ndërmjet anëve të mira dhe të këqija që kanë vendimet politike në lidhje me taksat dhe transfertat, por edhe nga zhvillimet e ekonomisë vendase dhe asaj ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sistemin e pensioneve të një vendi.

Si përfundim, mund të themi se një skemë NDC është të paktën po aq pozitive sa, skema FDC për sa i takon efikasitetit të saj. Nëse një FDC e caktuar kundërfaktike ka epërsi në praktikë ndaj një sistemi NDC, kjo varet nga portofoli i investimeve të skemës FDC dhe nga mjedisi i regjimit tatimor të vendit.

Sistemi NDC ka disa karakteristika bazë të rëndësishme të cilat përcaktojnë dukshëm ndryshimin e saj nga skema FDC.

Sistemi NDC, në çdo kohë, vlera e tanishme e përfitimit individual për jetë është bërë baras me tepricën e llogarisë së individit.

Për secilin pjesëmarrës dhe në të gjitha kohët, sasia e parave në llogari, K, është vlera e tashme ose e pritshme e përfitimit të tij apo saj. Vlera e llogarisë përcaktohet nga kontributet e vetë individit dhe nga norma e brendshme e kthimit e sistemit. Ajo mund të shprehet (ku E tregon vlerën e pritshme) si

$$E (Pt) = Kt$$

Ruajtja e një norme fikse kontributesh, kërkon që totali i aktiveve të NDC-së të jetë i barabartë ose më i madh se totali i pasiveve të tij.

Në sistemin e përgjithshëm, të përshkruar më lart, aktivitetet janë gjithnjë të barabarta me pasivet. Kjo jep një veçori të dytë që përcakton një skemë NDC

$$At \geq Lt$$

Përmbushja e këtij tipari është e nevojshme për të ruajtur një shkallë konstante afatgjatë kontributesh. Kjo karakteristikë përputhet me skemën me kontribute financiare të përcaktuara ku $A=L$. Ky proces vlerësimi i llogarive individuale shpërndan fitimet midis pjesëmarrësve në sistemin e përgjithshëm NDC, duke plotësuar barazinë. Në praktikë, probleme që lidhen me hartimin e skemës vendosin kufizime të ndryshme. Për sa kohë që $A>L$, skemat NDC, përveçse skema të pastra të përgjithshme NDC, sipas këtij definicioni, mund të quhen edhe skema NDC.

Përfitimi i NDC-së është krijuar si një pension vjetor për jetë, duke pasqyruar pritshmërinë për jetën në kohën e daljes në pension

Një tipar kyç i një skeme NDC është se pensioni vjetor mbështetet në pritshmërinë e jetëgjatësisë. Një vlerësim korrekt i jetëgjatësisë shpie në një vlerësim korrekt të pasiveve (detyrimeve), që lidhen me pagesën e pensioneve vjetore. Edhe kur pagesa me një shumë të përgjithshme do të ishte teorikisht e mundur, kjo gjë nuk është një tipar i dëshirueshëm i një sistemi të detyruar, i cili aspirojnë të mbrojë njerëzit në moshë të vjetër (dhe taksapaguesit) nga ngasja e të menduarit sot për sot, apo ndryshe nga rezultatet e një planifikimi apo administrimi të dobët të parave.

Ekulibri financiar në sistemin e përgjithshëm kërkon që llogaritë të vlerësohen me normën e brendshme $g + \Delta + p$.

Në qoftë se në praktikë, norma e kthimit vendoset më e ulët, për shembull, duke mos e përfshirë rritjen reale në pensionin vjetor, që mund të jetë rezultat i një përkufizimi të politikës gjatë fazës së zbatimit, krahasuar me kundërfaktiken e NDC-së së përgjithshme, do të krijohet një tepriçë dhe nëse ajo përdoret për qëllime të tjera nga akreditimi i llogarive, atëherë kjo duhet parë si një taksë.²⁶⁴

Në rast se sistemi monetarizohet me obligacione Buchanan, atëherë procesi i monetarizimit do të shkaktojë një kosto transaksioni, e cila po ashtu është një taksë, edhe pse një taksë burimi financiar i të cilës gjendet jashtë sistemit të NDC-së. Në këtë rast, ajo nuk e pengon funksionin e normës së brendshme të kthimit.

5.3 KONCEPTI I KAPITALIT NOCIONAL DHE KARAKTERISTIKAT BAZË

Më lart theksuam se komponenti qëndror i skemës NDC është llogaria individuale *për jetë*, ku qëllimi kryesor mbeten përfitimet, pra mënyra se si rriten vlerat e llogarisë dhe si llogariten të ardhurat e pensioneve. Analizën në lidhje me konceptin e kapitalit nocional e kemi analizuar nga pikëpamja e vlerave *reale*. Megjithatë, në praktikë sistemi është neutral ndaj inflacionit, meqenëse ai është krijuar në bazë të *vlerave nominale*.

α - KAPITALI NOCIONAL

²⁶⁴ Shih Palmer 2006.

Sipas formulës NDC, për një individ, i , pagimi i kontributeve në bazë të pagave (apo të ardhurave), w , gjatë një periudhe kontabiliteti, t , me shkallën e kontributit, c , kapitali nocional në fund të çdo periudhe, T , është:

$$K_{i,t} = \sum_{t=1}^T cw_t I_t \quad \text{Formula (1)}$$

Ku, $cw_t I_t$, tregon kontributet e një individi në periudhën t . Vini re se zakonisht do të vendoset një tavan për të ardhurat që japin të drejta në sistem.

It është një indeks, i përlogaritur nga një normë e brendshme kthimi, at :

$$I_t = P(1+at) \quad \text{Formula (2)}$$

$$I_0 = 1$$

Me sa shohim kuptohet qartë se është pikërisht norma e kthimit ajo që ruan drejtpeshimin financiar gjatë kohës, për një shkallë të caktuar kontributi. Megjithatë, duhet theksuar se ndodh që shumë pjesëmarrës kontribues në skemë mund të mos jetojnë aq sa të gëzojnë përfitimin e tyre. Lind pyetja se çfarë ndodh me vlerën e kontributeve të depozituara. Vlera e kontributeve të depozituara për të gjithë ata persona të cilët nuk jetojnë më, njihet me emërtimin "kapital i trashëgimisë".

Kapitali i trashëgimisë është një sistem i mbyllur që do t'u shpërndahet vlerave të llogarive të të mbijetuarve në skemën e sigurimeve. Në praktikë, kjo gjë mund të bëhet në bazë të grupmoshës me vit të njëjtë lindjeje dhe në përputhje me përqindjen individuale të kapitalit në totalin e kapitalit të grupmoshës. Kapitali i trashëgimisë ndahet në përputhje me një moshë të caktuar, e tillë si moshë minimale kur mund të tërhiqen paratë e pensionit. Kjo gjë i shton një komponent tjetër kapitalit individual në kohën e daljes në pension, duke rritur kështu kthimin (fitimin) e kapitalit.

b- TIPARET E NDC-SË

NDC-ja identifikohet me anë të një grupi tiparesh, të cilat përmbushen me anë të ndërtimit të sistemit në mënyrën e përshkruar më lart. Këto tipare janë:

Tipari 1. Në çdo kohë, vlera e tanishme e përfitimit individual për jetë është baraz me tepricën e llogarisë së individit.

Për secilin pjesëmarrës dhe në të gjitha kohët, sasia e parave në llogari, K , është vlera e tashme ose e pritshme e përfitimit të tij. Vlera e llogarisë përcaktohet nga kontributet e vetë individi dhe nga norma e brendshme e kthimit të sistemit. Kjo është veçoria e parë e një skeme NDC. Ajo mund të shprehet (ku E tregon vlerën e pritshme) si:

$$E(P_t) = K_t$$

Tipari 2. Ruajtja e një norme fikse kontributesh, kërkon që totali i aktiveve të NDC-së të jetë i barabartë ose më i madh se totali i pasiveve të tij.

Në sistemin e përgjithshëm, të përshkruar më lart, aktivet janë gjithnjë të barabarta me pasivet. Kjo jep një veçori të dytë që përcakton një skemë NDC.

$$At \geq Lt$$

Përmbushja e këtij tipari është e nevojshme për të ruajtur një shkallë konstante afatgjatë kontributesh. Ky është gjithashtu një tipar që përputhet me skemën me kontribute financiare të përcaktuara ku $A=L$. Ky proces vlerësimi i llogarive individuale shpërndan fitimet midis pjesëmarrësve në sistemin e përgjithshëm NDC, duke plotësuar barazinë e shprehur në formulën e mësipërme. Sqarohet në paragrafin 2 fq 157.

Tipari 3. *Përfitimi i NDC-së është krijuar si një pension vjetor për jetë, duke pasqyruar pritshmërinë për jetën në kohën e daljes në pension*

Një tipar kyç i një skeme NDC është se pensioni vjetor mbështetet në pritshmërinë e jetëgjatësisë. Një vlerësim korrekt i jetëgjatësisë shpie në një vlerësim korrekt të pasiveve (detyrimeve) që lidhen me pagesën e pensioneve vjetore. Edhe kur pagesa me një shumë të përgjithshme (*lump sum*) do të ishte teorikisht e mundur, kjo gjë nuk është një tipar i dëshirueshëm i një sistemi të detyruar, i cili aspiron të mbrojë njerëzit në moshë të vjetër (dhe taksapaguesit) nga ngasja e të menduarit sot për sot, apo ndryshe nga rezultatet e një planifikimi apo administrimi të dobët të parave.

Tipari 4. *Ekulibri financiar në sistemin e përgjithshëm kërkon që llogaritë të vlerësohen me normën e brendshme $g + \iota + p$.*

Në qoftë se në praktikë, norma e kthimit vendoset më e ulët, për shembull, duke mos e përfshirë rritjen reale në pensionin vjetor, që mund të jetë rezultat i një kufizimi të politikës gjatë fazës së zbatimit, krahasuar me kundërfaktiken e NDC-së së përgjithshme, do të krijohet një tepricë – dhe nëse ajo përdoret për qëllime të tjera nga akreditimi i llogarive – atëherë kjo duhet parë si një taksë. Në rast se sistemi monetarizohet me obligacione Buchanan, atëherë procesi i monetarizimit do të shkaktojë një kosto transaksioni, e cila po ashtu është një taksë, edhe pse një taksë burimi financiar i së cilës gjendet jashtë sistemit të NDC-së. Në këtë rast, ajo nuk e pengon funksionin e normës së brendshme të kthimit.

5.3 / 1 HOLLËSI TË NDËRTIMIT TË SISTEMIT NDC

Këtu nuk është vendi të diskutohen çështjet e shumta të ndërtimit të sistemit NDC. Më poshtë do të trajtohen vetëm disa prej tyre që janë veçanërisht të rëndësishme:

- *Sikundër në çdo sistem tjetër PAYG, duhet të vendoset një moshë minimale se kur punëtorët e shëndetshëm mund të fillojnë të marrin një pension. Një moshë e tillë minimale e daljes në pension është e nevojshme, përveçse kur pjesëmarrja në sistemin PAYG lihet në dëshirën e njerëzve, gjë që nuk do të ishte një zgjidhje e qëndrueshme, sidomos në kohë plakjeje të popullsisë. Asnjë nga sistemet ekzistuese NDC nuk bën një përshtatje automatike të moshës minimale të pensionit me jetëgjatësinë. Si rrjedhojë, sistemet ekzistuese reagojnë vetëm ndaj ndryshimeve demografike.*
- *Specifikimi dhe përditësimi i tabelave të jetës kanë pasoja të menjëhershme të përfitimit. Shumica e vendeve deri tani kanë përdorur tabela jete të njëjta për të dy sekset (uniseks) bazuar në të dhëna të tërthorta. Ajo që është e saktë nga ana aktuariale janë tabelat e grupmoshave, me disa parashikime për ndryshimet e jetëgjatësisë. Shumë vende nuk kanë mekanizma të*

besueshme për të llogaritur tabela të tilla. Duhet që një bord i pavarur aktuarësh të mbikëqyrë ndërtimin e këtyre tabelave, ndërsa tabelat e jetës duhet të përputhen me ato që përdoren nga sektori i pensioneve private.

- *Interesi i brendshëm i kontributeve (norma e rritjes së faturës së kontributeve) duhet të zbutet me kohë. Për këtë ka disa modele. Zgjidhja e natyrshme duket se është një mesatare e lëvizshme përgjatë një cikli biznesi. Kulmet duhet të nivelohen për të shkuar në rezervat e likuiditetit, të përdorura për pikat e ulta të një cikli. Hartimi i mekanizmeve të tilla zbutëse nuk është punë e lehtë, duke qenë se amplituda dhe kohëzgjatja e një cikli biznesi nuk dihen që më parë, dhe nuk ka ndonjë mekanizëm të pagabueshëm që të dallojë tendencat nga ciklet.*
- *Megenëse norma e brendshme e kthimit të një sistemi PAYG është në përgjithësi shumë më e ulët se sa shkallët e skontimit që do të përdornin punëmarrësit, efektet nxitëse të daljes në pension para kohe mund të vazhdojnë të jenë ende të mëdha nëse thithjet e pensionit në një kohë të mëvonshme do të rregulloheshin nga neutraliteti aktuar. Nga një këndvështrim makroekonomik, nuk është e qartë nëse neutraliteti aktuar (duke përdorur normën e kthimit të sistemit PAYG), apo mungesa e efekteve nxitëse (duke përdorur normën e skontimit të punëtorëve) do të thotë maksimizim i mirëqenies.*
- *Ka mënyra të shumta për konceptimin e pensioneve vjetore. Ato mund të zgjidhen që të rriten me rritjen e inflacionit apo të pagave, apo sipas ndonjë plani tjetër; shkalla fillestare mund të përshtatet sipas rastit, duke e mbajtur PDV-në konstante përgjatë kohëzgjatjes së pritshme. Liria për të zgjedhur ka gjasa të jetë më e rëndësishme se problemet potenciale që vijnë nga përzgjedhja e keqe. Megjithatë, deri tani ka pak përvojë në botë nga kompromise të tilla.*
- *Përfitimet përcaktohen në fillim të pensionit, por pas përcaktimeve të tilla mjedisi demografik dhe ekonomik mund të ndryshojë papritur. Në rast se shkalla e rritjes së kontributeve, e matur në terma nominale, është shumë e ulët, pensionet mund të ulen në terma reale, gjë që nuk është tërheqëse nga pikëpamja politike. Një farë përshtatjeje në këtë mjedis të ri sigurisht do të ishte optimale, por me sa shihet, pensionistët e vlerësojnë mjaft të qenët të mbrojtur. Politika e përgjithshme e maksimizimit të mirëqenies nuk njihet deri më tani.*
- *Sikurse është theksuar më lart, në rast se pensionistët janë plotësisht të mbrojtur nga ndryshimet demografike dhe ekonomike, që mund të ndodhin pas daljes së tyre në pension, sistemet NDC humbasin një mekanizëm të rëndësishëm marrje mendimesh (feedback), që mund ta minojë qëndrueshmërinë afatgjatë financiare të tyre. Në rast se pensionet janë të mbrojtur nga një dysheme (për shembull, të mos ulen kurrë në terma reale apo nominale), sistemi mund të bëhej i paekuilibruar financiarisht, sepse shpenzimet dhe kontributet do të trajtoheshin në mënyrë asimetrike. Shpenzimet nuk mund të bien nën një dysheme të caktuar, ndërsa kontributet mundën.*
- *Rregullat e periudhës së tranzicionit duhet të ndjekin modelin suedez, jo atë italian. Koha jashtëzakonisht e gjatë e tranzicionit në Itali nuk e lejon sistemin NDC të trajtojë problemin më urgjent financiar: ngarkesën që do t'i vihet buxhetit të pensioneve, që do të ndodhë kur të dalë në pension*

brezi i bumit të fëmijëve. Një çështje edhe më e vështirë është shkalla në të cilën pensionet ekzistuese duhet të mbrohen. Rrugët “e natyrshme” të tranzicionit mund të ndërtohen kur përfitimet të jenë përcaktuar pro rata, në proporcion me kohën e shpenzuar sipas ligjit aktual dhe atij të ri.

Tranzicioni mund të jetë më i shpejtë, nëse ekzistojnë elemente të rëndësishme të hartimit të sistemit NDC. Në Gjermani, për shembull, një periudhë relativisht e shkurtër tranzicioni (nga 2005 deri në 2020) do të ishte e mundur, sepse sistemi ekzistues me pikë përmban ndërkohë një veçori të rëndësishme të sistemeve NDC.

5.4 MEKANIKA E FUNKSIONIMIT TË NJË SISTEMI NDC

Sistemet NDC janë mjete kontabël që një sistem PAYG e trajtojnë si një sistem DC. Përfitimet e pensionit paguhen nga kontributet aktuale, sikurse në një sistem konvencional PAYG; megjithatë, lidhja midis përfitimeve dhe kontributeve është e individualizuar dhe e përcaktuar nga mekanizmi kontabël i NDC-së. Në jetën reale, pothuaj të gjitha sistemet PAYG, dhe sidomos sistemet NDC, kanë një fond amortizues, i cili i bën ato sisteme “të përziera” të financuara” PAYG.

Si çdo sistem tjetër DC, sistemi fillon me kontribute individuale në sistemin e pensionit, të cilat kreditohen dhe akumulohen në llogari individuale që i mban sistemi i pensionit. Teprica është imagjinare (ose “notionale”), meqenëse nuk akumulohet kapital. Shuma e akumuluar përfaqëson pasurinë imagjinare (ose “nacionale”) të pensionit. Teprica fiton interes në një farë norme kthimi (fitimi). Madhësia e këtij kthimi është një parametër qendror i sistemit NDC. Meqenëse nuk akumulohet kapital dhe kërkesat ndaj tepricës nuk tregtohen, nuk ka ndonjë mekanizëm tregu për të përcaktuar normën e kthimit.²⁶⁵

E parë nga një perspektivë makroekonomike, norma “e natyrshme” e kthimit në një sistem NDC është kthimi i nënkuptuar (implicit) i një sistemi PAYG: pra, norma e rritjes së faturës së kontributeve. Megjithatë, disa sisteme NDC – siç është ai Suedez – kanë zgjedhur norma kthimi që, në rrethanat aktuale, janë më të larta, mund të përmendim normën e rritjes së pagës.

Kur personi del në pension, pasuria e pensionit notional konvertohet në një pension për jetë (“*Ndahet në pensione vjetore*”) sipas rregullave aktuale. Përfitimi i pensionit vjetor varet nga këto tre variabla:

- *Pasuria e pensionit nocional (proporcionaliteti garanton ekuivalencën)*
- *Norma e interesit e përdorur për në llogaritur pensionin vjetor (përdorimi i normës së nënkuptuar të sistemit PAYG garanton ekuivalencën brenda secilës grupmoshë); dhe*
- *Jetëgjatësia në momentin e daljes në pension (përdorimi i tabelave të përditësuara garanton qëndrueshmërinë aktuale).*

Dy elementet e fundit shpesh kombinohen dhe përmenden si “plotpjesëtuesit e pensionit vjetor”, ose “Vlera G” në Suedi dhe Letoni.²⁶⁶ Në Itali, këto vlera janë të llogaritur. Kështu përfitimet B janë:

²⁶⁵ Valdes-Prieto (2003) sugjeron një mekanizëm potencial tregëtimi.

²⁶⁶ Në Suedi vlera G është jetëgjatësia e mbetur njëlloj për të dy seksat në moshën e daljes në pension. Norma e supozuar e interesit është 1.6%. Kjo modifikohet nëse rritja e kontributeve është jashtëzakonisht e ulët, me anë të “mekanizmit balancues

$$B = PW/G$$

Ku NPW tregon pasurinë notionale të pensionit. Në reformën e pensioneve në Shqipëri pavarësisht sistemit të përmirësimit të parametrave ekzistues të pensioneve në materialin e paraqitur kam bërë një analizë krahasuese edhe me mundësinë e përfshirjes në sistemin ekzistues që sapo ka filluar të vihet në zbatim edhe sistemit me llogari nationale.

Në thelb ky sistem mbështetet në një reformim rrënjësor të skemës aktuale duke lëvizur drejt sistemit me llogari notionale. Sistemi notional paraqet një ndryshim thelbësor krahasuar me sistemin aktual. Kjo sepse ky sistem është dizenuar për të imituar një sistem privat me kontribute të përcaktuara ku masa e pensionit përcaktohet nga historia e kontributeve të individit dhe norma e fitimit të tyre. Në këtë sistem norma e fitimit nga kontributet është notionale, e përcaktuar nga qeveria, dhe jo produkt i investimit të tyre në tregjet financiare. Realizimi i kësaj reforme kërkon marrjen e masave të mëposhtme:

Ndryshimi i formulës së llogaritjes së masës së pensionit: Në një sistem të llogarive t, kontributet mujore regjistrohen dhe atyre iu cakohet një normë interesi. Norma e interesit lidhet me rritjen e pagave në shkallë vendi. Kështu, formula e llogaritjes së pensionit do të ishte:

$$P = (K_a + F) / J_m$$

Pra, pensioni do të jetë i barabartë me:

K_a që është shuma agregate e kapitalit të akumuluar gjatë gjithë viteve kur janë derdhur kontribute;

F që është fitimi notional i akumuluar gjatë viteve si rezultat i aplikimit të normës notionale të interesit;

J_m që është jetëgjatësia mesatare e popullsisë në moshën e daljes në pension. Përfshirja e normës së nënkuptuar të kthimit të një sistemi PAYG dhe përfshirja e kohëzgjatjes së pritshme të daljes në pension në përlllogaritjen e përfitimit i lidh përfitimet e pensionit me parametrat demografikë dhe të punësimit të mjedisit makroekonomik. Kjo i bën sistemet NDC më të qëndrueshme se sa sistemet konvencionalë DB në kuptimin që ndryshimet në mjedisin demografik dhe makroekonomik automatikisht i ulin përfitimet. Përfshirja e jetëgjatësisë së mbetur i lidh përfitimet me moshën e daljes në pension në nivel individual. Kjo i bën sistemet NDC neutral nga ana aktuale (me normën e interesit të përdorur).

Meqenëse vlera aktuale e zbritur (*PDV*) e përfitimeve të pensionit është e pavaruar nga mosha aktuale e daljes në pension, barra financiare e brezit më të ri është fikse për secilën grupmoshë dhe përcaktohet nga vlera *G*; pra, nga norma e interesit notional dhe kohëzgjatja mesatare e pritshme e pensionit. Veçoritë aktuale të një sistemi NDC varen nga shumë tipare të hollësishme të hartimit të skemës.

Së pari dhe më e rëndësishmja, përcaktimi i normës së interesit "notional" është thelbësor sepse ajo përcakton qëndrueshmërinë demografike dhe makroekonomike të sistemit dhe pasojat e stimujve makroekonomikë.

automatik*. Për hollësi shi Settergren (200).

Së dyti, ajo bën një diferencë të madhe në tabelat e përdorura për jetën.

Së treti, shkalla deri ku pensionistët janë të mbrojtur nga goditje të tjera, është një parametër i rëndësishëm që potencialisht bie ndesh me qëndrueshmërinë financiare.

Sistemet kontabël të NDC-ve nuk e ndryshojnë mekanikën e sistemeve PAYG: pra, nevojën për t'ju përshtatur qoftë kontributet, qoftë normën e zëvendësimit (ose të dyja) ndryshimeve në mjedisin demografik apo makroekonomik. Brezi aktual i ri paguan për brezin aktual të vjetër. Përcaktimi i normës së interesit notional dhe vlerësimi i jetëgjatësisë së mbetur është baras me përcaktimin e lidhjes midis përfitimeve (të përfaqësuara nga një normë zëvendësimi (replacement rate) dhe kontributeve (të përfaqësuara nga një shkallë takse mbi pagat). Duke e ndryshuar këtë lidhje, sistemi mund ta kalojë barrën e plakjes së popullsisë nga brezi më i ri te brezi më i vjetër.

Një sistem i pastër NDC, megjithatë, vazhdon ende të financohet sipas metodës PAYG dhe si i tillë nuk mund të imitojë një sistem të parafinancuar në kuptimin që barra financiare e vlerës së përfitimeve të pensioneve të një grupmoshe të mbahet po nga ajo grupmoshë. Rëndësia e kësaj pike shihet më së miri në kalimin e papritur nga një brez i bumit të fëmijëve te brezi që lindi pak fëmijë.

Në se brezi i bumit të fëmijëve do të financonte një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre të pensionit nga të ardhurat vetjake, dhe jo nga të ardhurat e brezit që ka lindur pak fëmijë, ata të brezit me shumë fëmijë duhet të heqin dorë nga një shkallë konsumi në moshë të re dhe t'ia transferojnë burimet korresponduese periudhës pas daljes në pension. Kjo kërkon kursime dhe krijimin e një stoku kapitali real nga brezi me shumë të lindur. Një stok kapitali notional nuk mund t'i shërbejë këtij qëllimi, sepse pensionet e llogaritura nga pasuria kombëtare e grumbulluar nga brezi me shumë të lindur, duhet të financohet nga kontributet e brezit me pak fëmijë.

5.4/ 1 THELBI EKONOMIK I NJË SISTEMI NDC

Në kontekstin ekonomik, një sistem NDC përmban disa mekanizma të rëndësishme që e bëjnë atë një sistem PAYG:

1. *Një mekanizëm kontabël që krediton të gjitha të ardhurat e jetës.*
2. *Një mekanizëm që e lidh tepricën përfundimtare me mjedisin demografik dhe makroekonomik.*
3. *Një rregull aktuar që e konverton tepricën përfundimtare në pension vjetor.*
4. *Kërkesat për përfitime të ardhshme nuk garantojnë (koletarizohen) me kapital të vërtetë, por me premtime nga (pothuaj gjithnjë) një entitet i lidhur me qeverinë.²⁶⁷*

Mekanizmi i parë, realizohet me anë të kreditimit të të gjitha kontributeve të jetës në një llogari individuale, njëlloj si planet DC të financuara. Në shumë drejtime, ky ngjan me sistemet gjermane dhe franceze me pikë, me përjashtim që njësia e kredisë është monedhë (euro) dhe jo pikë të

²⁶⁷ Për të theksuar pikën e fundit (Pika 3), mund të shtohet elementi i katërt, i cili bën dallimin midis planeve thjesht notionalë dhe planeve DC plotësisht të financuar.

ardhurash²⁶⁸. Ai dallon shumë nga mjaft sisteme pensionesh ku kreditohen X vitet më të mira (në rastet ekstreme, vetëm të ardhurat e vitit të fundit të punës), dhe sigurisht nga sistemet Beveridgiane, që japin përfitime të sheshta (të njëjtat).

Mekanizmi i dytë në sistemet NDC realizohet me anë të normës notionale të interest

-në rast se zgjidhet që ajo të jetë norma e brendshme e kthimit e një sistemi PAYG-e cila pasqyron ndryshimet demografike, ndryshimet e punësimit, dhe ndryshimet nëproduktivitet, meqenëse fatura e kontributeve rritet me ritmin me të cilin rriten numri i kontributeve dhe prodhimtaria e punës së tyre. Ky mekanizëm është analog me rregullat e indeksimit të sistemeve konvecionale DB.

Shumica e sistemeve të pensionit i indeksojnë përfitimet e tyre në momentin e daljes në pension me nivelin aktual të pagave. Shumica e sistemeve konvecionale PAYG ua shtojnë përshtatjet e matura (diskecionare) të normës së zëvendësimit ndryshimeve demografike; një nga tiparet kryesore të sistemeve NDC është lidhja e drejtëpërdrejtë dhe automatike me demografinë posa që interesi notional të përfshijë shkallën e rritjes së bazës së kontributeve.

Në plane DC të financuara, mjediset demografike dhe makroekonomike i fusin të ardhurat përmes, saktësisht, të njëjtit mekanizëm sikurse në sistemet NDC: pra *përmes normës së interesit*, edhe pse normat e zbatueshme të interest janë përgjithsisht të ndryshme.

Mekanizmi i tretë është thelbi i rregullit $B=NPW/G$.

Proporcionaliteti midis B-së dhe NPW-së dhe përcaktimi korrekt aktuale i vlerave të G-së e bën një sistem NDC neutral nga ana aktuale dhe, në secilën grupmoshë, edhe të drejtë nga pikpamja aktuale (shih Disney 2003për këtë taksonomi). Disa sisteme konvecionale PAYG bëjnë përshtatje aktuale, kryesisht sistemi i sigurimeve shoqërore të Amerikës nga mosha 62-65. Shumica e planeve DC të financuara janë automatikisht neutrale nga pikpamja aktuale, meqenëse konvertimi në pension ndodh në momentin aktual të daljes në pension. Shumë sisteme PAYG të tipit DB megjithatë, nuk kanë asnjë lidhje ose kanë pak lidhje midis përfitimeve vjetore dhe moshës së daljes në pension.²⁶⁹

5.4 / 2 KLASIFIKIMI (TAKSONOMIA) I SISTEMEVE TË PENSIONIT

Sa afër janë sistemet NDC dhe sistemet Dc të financuara? Dhe sa afër janë ata me sistemet konvecionale DB të financuara sipas metodës PAYG? Nga pikpamja e *kreditimit të kontributeve*, sistemet NDC në të vërtetë mbajnë një qëndrim ekstrem: kontributet kreditohen në bazë jete dhe kontributeve më të hershme u jepet një peshë më e madhe sipas normës së interest.

Sistemi gjerman më pikë po ashtu krediton të gjitha kontributet e jetës, ai i peshon të gjitha kontributet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga koha. Kjo është baras me mosmarrveshjen parasysh të interesit të principalit dhe interesit të përbërë (**compound**) (shih më poshtë). Sistemi francez me pikë krediton vetëm 25 vjetë më të mire. Sistemi amerikan i sigurimeve shoqërore lejon heqjen e pesë vjetëve më të këqijë, që krijon

²⁶⁸ Shih Legros (2006)

²⁶⁹ Shih Guber dhe Eise (1999)

më pak shtysa negative për ofertën për krahe pune se sa sistemi Francez. Shumë sisteme në vendet në zhvillim përdorin vetëm të ardhurat e vitit të fundit të punës.²⁷⁰

Në sistemet e prera Beveridgiane të tilla si pensionet holandeze apo britanike, njohja e meritave nuk luan asnjë rol në përcaktimin e përfitimeve, duke qenë se përfitimet janë fikse.²⁷¹ sistemet NDC paraqesin një rritje "natyrore" të interesit përmes mekanizmit të kreditimit. Megjithatë, faktori i konvertimit midis përfitimeve në momentin e daljes në pension dhe shumës së kontributeve gjatë jetës së punës, mund të interpretohet si kreditimi i gjithë interesit të grumbulluar në kohën e daljes në pension.²⁷²

Ndërsa mekanizmi i fundit nuk e merr parasysh interesin e përbërë sepse ai nuk ka rëndësi kur kontributet paguhen gjatë jetës së punës, nuk ka ndonjë dallim tjetër të vërtetë midis sistemeve NDC dhe formulës DB që (në mënyrë të nënkuptuar) krediton interesin e mbledhur në kohën e daljes në pension. Përcaktimi i normës së interesit është çështje tjetër. Në një sistem të financuar, norma e brendshme e kthimit është r , norma e interesit e tregut. Në një sistem PAYG, ajo është $n+g$, ku n është norma e rritjes së bazës së kontributeve, dhe g është norma e rritjes së prodhimit të punës.

Në Suedi, qeveria zgjodhi g -në si normë nocionale të interesit, duke lënë jashtë lidhjen e drejtëpërdrejtë të interesit të grumbulluar me demografinë.²⁷³ Në një popullsi në plakje, $n+g$ ka tendencën të jetë më e vogël se g -ja, meqenëse n -ja është negative, dhe në shumicën e rasteve më e vogël se r -ja.²⁷⁴ Dimensioni i tretë ka të bëjë me konvertimin e pasurisë notionale të grumbulluar në përfitime në momentin e daljes në pension dhe më pas. Dallojmë katër element në këtë konvertim.

Së pari, si lidhen kreditet individuale me përfitimet individuale?

Sistemet NDC kanë të njëjtën proporcionalitet si edhe sistemet me pikë në Francë dhe Gjermani apo sistemet me një rregull të thjeshtë të normës së rritjes. Sistemi Amerikan i sigurimeve shoqërore i krediton kontributet shtesë me vlerë në zbritje; sistemi rishpërndan përmes një funksioni lidhjeje konkave midis kontributeve dhe përfitimeve. Në një sistem të prerë Beveridge-ian, kreditit nuk luajnë asnjë rol, sikurse thamë më sipër.

Së dyti, në këtë dimension të tretë është mënyra e lidhjes së përfitimeve me mjedisin demografik dhe makroekonomik. Në sistemet NDC, kjo gjë shprehet me vlerat G . sistemet konvencionale DB zakonisht kanë rregulla të indeksimit të përfitimeve që lidhin përfitimet në momentin e daljes në pension me pagën apo normën aktuale të fitimeve, dhe pastaj vazhdojnë të indeksojnë përfitimet me çmimet, pagat, apo duke i kombinuar të dyja gjatë periudhës së daljes në pension.²⁷⁵

270 Shih Borsch-Supan Oakacuis dhe Tumbrello (1999).

271 Kjo është një e vërtetë ekskluzivisht vetëm për sistemet e përfitimeve fikse (të shpeshta) bazuar në shtetësinë apo vendbanimin, të tilla si Australia. Në Mbretësin e Bashkuar, numri maksimal i **kredive** përcakton të drejtën për përfitim.

272 Shih Rulan (2000)

273 Demografia hyn drejtëpërdrejtë me anë të pensioneve të mëshetura në jetëgjatësi dhe tërthorazi me anë të informacioneve që ndryshojnë g -në, të tilla si prodhimtaris sipas moshës specifike. Suedia po ashtu ka një mekanizëm ribalancues i cili reagon ndaj demografisë pasi që sistemi aktual dështon. (shih Settegren).

274 Mardhënia teorike midis r -së dhe $n+g$ dhe jashtë nga gjendjeje e qëndrueshme dhe lidhja e saj me efikasitetin dinamik ka mbushur vëllime të tëra dhe nuk është temë e këtij studimi. Shih Valdes-Prieto (1998). Për disa rezultate empirike informuese, shih Schnabel (1998).

275 Vini re dallimin midis indeksit fillestar në momentin e daljes në pension për fluksin e hyrësve të rinj dhe indeksimin e përfitimeve pas daljes në pension për stokun e pensionistëve ekzistues.

Ato nuk i përfshijnë drejtëpërdrejtë faktorët demografikë, edhe pse mund të ketë lidhje të tërthorta. *Indeksi me pagat neto, për shembull, ka neto do të thotë neto e taksavedhe kontributeve*, kërkon një lidhje indirekte, meqenëse kontributet në rritje, për shkak të plakjes së popullsisë, po ashtu do t'i ulin përfitimet. Megjithatë, nuk ka asgjë që t'i pengojë formulat DB të përfshijnë lidhje të drejtëpërdrejta me demografinë për të rritur elasticitetin e përfitimeve në lidhje me ndryshimet demografike.

Së treti, ka të bëjë me lidhjen midis moshës së daljes në pension dhe përfitimeve. Sistemet NDC janë automatikisht neutral nga ana aktuale në kuptimin që PDV-ja e përfitimeve nuk ndikohet nga mosha aktuale e daljes në pension kur PDV-ja llogaritet me normën e brendshme të kthimit të sistemit NDC. Megjithatë, punëtorët mund të përdorin një normë të ndryshme interesi kur llogarisin PDV-në me qëllim që të marrin vendime për kohën e daljes në pension. Kjo diferencë pastaj krijon një shtesë tatimore (wedge) midis neutralitetit aktuar dhe mungesës së stimujve negativë në ofertën e krahut të punës. Kjo e fundit përcaktohet si rasti ku PDV-ja e përfitimeve është e pavarur nga mosha e daljes në pension, kur PDV-ja përlllogaritet duke përdorur normën e skontimit personal të punëtorëve.

Në këtë rast çështja thelbësore është, cila është norma personale e skontimit të punëtorëve? Nëse është norma e interesit në treg, atëherë zakonisht ajo është më e madhe se norma e brendshme e kthimit të sistemit NDC, sidomos në kohë plakjeje të popullsisë.²⁷⁶

Kjo është një pikë e rëndësishme: Sistemet NDC mund të jenë neutral nga ana aktuale, por megjithatë, përsëri mund të krijojnë shtysa të mëdha negative në ofertën e krahut të punës. Shkaku bazë për këtë ndryshim është diferenca në normat e skontimit që përdoren në përshtatjet aktuale. Ekzistojnë tri mundësi:

- *Norma e brendshme e kthimit, e cila është $n+g$ në një sistem PAYG, pavarësisht nëse është sistem NDC apo sistemi konvencional DB;*
- *Norma e interesit në treg r , e cila është gjithashtu norma e kthimit të një sistemi të financuar; dhe*
- *Norma e performancës së kohës nga punonjësit që marrin vendim për të dalë në pension.*

Duket që norma e interesit në treg, r , ka tendencë të jetë më e madhe se $n+g$. Ndonëse dikush mund të argumentojë se norma mesatare e performancës kohore duhet të jetë përafërsisht e njëjtë me normën e interesit në treg, provat empirike tregojnë se norma e preferencës kohore të punëtorëve, e cila udhëheq mënyrën e sjelljes së tyre në lidhje me daljen në pension, është edhe më e madhe se r -ja. Pra, sistemet NDC mund të jenë edhe më neutral nga pikpamja stimuluuese se sistemet DB, kur përdorin norma më të larta skontimi, të cilat përdorin përshtatje shumë të vogla të përfitimeve vjetore e daljes në pension²⁷⁷.

Ndërkaq sistemet NDC mund ta shtrembërojnë vendimin për të dalë në pension më shumë se sisteme DB, të cilët përdorin një përshtatje

²⁷⁶ Normat e skontimeve personale të matura në mënyrën empirike kanë tendencë të jenë edhe më të mëdha se r -ja dhe me një marzh të konsiderueshëm. Shih vrojtimin e kryer nga Frederick, Loewenstrin, dhe O'Donoghue (2002).

²⁷⁷ (Shembull, përshtatja në Gjermani është 3.6 përqind për vit, që u fut gradualisht pas 2001).

mjaft më të madhe (si sistemi i Mbretërisë së Bashkuar, me përshtatje prej 9 përqind në vit, që ka të ngjarë të jetë më pranë normës personale të performancës kohore). Sistemet NDC mund të ofrojnë një mënyrë “natyrale” për të llogaritur përshtatjet specifike të moshës së daljes në pension, por përsëri, nuk ka asgjë të brendshme në këtë drejtim, që të dallojë një sistem NDC nga një sistem DB me përshtatje aktuale neutral (apo më të mëdha si ato të sistemit amerikan të sigurimeve shoqërore në moshën 62-65).

Së katërti, është indeksimi i përfitimeve pas daljes në pension (i ndryshëm nga indeksimi, apo mbajtja të sigurt, e përfitimeve në momentin e daljes në pension). Sistemet konvencionale DB indeksojnë përfitimet pas daljes në pension me koston e jetesës (Shtetet e Bashkuara, sistemi i ri i Italisë), apo pagat neto (Francë, Gjermani), apo njëfarë kombinimi midis tyre (Zvicra). Në sisteme DC të financuara, kjo përfaqësohet nga lloji i pensionit (real, apo nominal, apo ndonjë plan tjetër). Sistemi NDC Suedez i ngrin përfitimet realisht, duke i korresponduar një indeksimi të koston së jetesës, por sisteme të tjera NDC kanë mekanizma të tjera indeksimi. Përsëri, sistemet NDC nuk ofrojnë tipare të veçanta në këtë drejtim.

Nga shpjegimet e më sipërme bëhet e qartë se sistemet NDC janë mjete kontabël me tipare të tilla që mund të futen edhe në sistemet DB (pavarësisht se një gjë e tillë mund të mos jetë e lehtë politikisht). Ato mund të shërbejnë për të siguruar më shumë transparencë dhe besueshmëri sepse disa tipare vijnë më “natyrshëm” në një sistem NDC se sa përmes formulave të komplikuar të një sistemi DB; megjithatë, ajo që i dallon sistemet NDC nga ato DB është më shumë retorika se sa thelbi ekonomik. Në fakt ka kushte në të cilat skemat NDC dhe DB janë matematikisht ekuivalente skundër tregojnë Lindeman, Robalino, dhe Rutkowski. (2006)

Nga ndryshon një sistem NDC nga një plan DC i financiar?

Shumica e sistemeve PAYG kanë një lloj fondi rezervë, pavarësisht se madhësia e tij ndryshon shumë nga një vend në tjetrin. Fondi rezervë suedez është baras me shpenzimet e rreth pesë vjetëve, ndërsa rezerva e sistemit gjerman është minimale, aq sa për disa ditë shpezime. Çështja kyçe, megjithatë është nëse tepricat e grumbulluara janë të garantuara dhe cilat kërkesa përfaqësojnë kolateralin. Sistemet NDC janë “nacionale” në kuptimin që nuk kanë fare kolateral.

Tepricat janë kërkesa ndaj taksapagesave të ardhshme, dhe ato nuk mbështeten nga ndonjë instrument financiar.²⁷⁸ Planet DC të financuara zakonisht kuptohen si plane të garantuara me kapital fizik, kryesisht përmes instrumenteve financiare të tilla si obligacione apo stoqe tregtare. Termin “të financuara” e përdorim vetëm për këto plane që nga disa autorë i quajnë ato edhe plane DC, të cilat janë të garantuara me obligacione qeveritare “të financuara”. Mendoj se në këtë rast kemi të bëjmë me një keqpërdorim të termit “të financuara”.

Pavarësisht se kërkesat e planeve të tilla për përfitime janë të tregtueshme dhe japin një normë interesi të mirëpërcaktuar, ato nuk përfaqësojnë kërkesa për kapital fizik. Mendojmë se sistemet NDC mund të lejojnë një

²⁷⁸ Kjo mund të ndryshohet duke konvertuar kërkesat e nënkuptuara për kontibute nga punëtorët e ardhshëm në kërkesa të hapura për tatime të ardhshme, të mbështetura nga obligacionet e qeverisë (Shih Valdes-Prieto 2003).

mënyrë "të natyrshme" për ta bërë borxhin e nënkuptuar të një sistemi PAYG të shprehur qartë, duke lidhur tepricat e NDC-së me obligacionet e qeverisë, ndërsa idetë që dalin nga kjo, në lidhje me përfitimet dhe kontributet e adhshe, mund të krijojnë stimuj për të kursyer në nivel mikroekonomik ²⁷⁹. Megjithatë sistemet NDC dhe sistemet konvecionale DB kanë tipare të njëjta të rëndësishme makroekonomike me sistemet PAYG: Sistemet NDC nuk akumulojnë kursime në asete reale me efekte të mundshme anësore përfituese ndaj normës së kursimeve kombëtare, zhvillimit të tregjeve të kapitalit dhe rritje. Kjo do të thotë se sistemet NDC nuk e zëvendësojnë parafinancimin.

5.4/ 3 ANËT POZITIVE DHE DOBËSIT E SISTEMEVE ME KONTRIBUTE TË PËRCAKTUARA NOCIONALE

Duke thelluar analizën e sistemeve të reformës së pensioneve u konsiderua e nevojshme të japim një përgjigje se çfarë ofrojnë sistemet me kontribute nocionale në reformën e pensioneve. Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e tyre? Sistemet NDC mund të imitohen pothuaj plotësisht nga sistemet DB konvecionale. Në këtë kontekst në punim paraqiten disa argumente në aspektet psikologjike dhe politike të një retorike të re, e cila merr parasysh edhe implikimet mikroekonomike të transparencës dhe besueshmërisë.

Avantazhet

Sistemi NDC ka avantazhe të rëndësishme:

- *Sistemi përshtatet vetë automatikisht përmes mekanizmit të interesit të brendshëm ndaj ndryshimit të baraspeshë midis kontribuesve dhe pensionistëve (periudha e bumit të lindjeve (për shqipëri i përket viteve 50-60, të cilët aktualisht kanë mbushur moshën e daljes në pension dhe periudha e lindjeve të pakta që për shqipërinë është bërë më e theksuar pas vitit 2000 e në vazhdim), pa pasur nevojë për të ndërhyrë të paevitueshme.*
- *Sistemi përshtatet automatikisht ndaj ndryshimit të jetëgjatësië (problem i jetëgjatësisë) me anë të konvertimit aktual të pensionit nocional në pension për jetë. Skontimet për daljen e hershme në pensione bëhen automatikisht dhe po automatikisht i përshtaten situatës demografike. (Kjo përshtatje është e paplotë kur përfitimet ngrihen në momentin e daljes në pension dhe pensionistët janë efektivisht të mbrojtur ndaj ndryshimeve të mëvonshme të jetëgjatësisë).*
- *Sistemi shmang arbitraritetin e rregullave të indeksimit të përfitimeve, faktorëve të përshtatjes dhe kështu me radhë, ndryshimi i të cilëve ka minuar besueshmërinë e shumë sistemeve DB të pafinancuara.*
- *Sistemi forcon parimin e barasvlerës dhe për këtë arsye minimizon shtesën tatimore (wedge) midis të ardhurave bruto dhe neto, e cila rezulton nga ndikimi shtrembërues i timeve dhe i kontributeve në formë tatimesh.*
- *Sistemi rrit transparencën e shtyllës PAYG me anë të indentifikimit të qartë të kontributeve individuale dhe kërkesave për përfitime që rrjedhin prej tyre, duke ndimuar për rifitimin e besueshmërisë.*
- *Sistemi forcon parimi se pensionet mbështeten në të ardhurat e gjithë*

²⁷⁹ Shih Gora dhe Palmer (2003).

jetës, dhe nderon punëtorët që hyjnë në tregun e punës në moshë të re.

- *Sistemi bën të mundur indetifikimin me lehtësi të transfertave në vend të kontributeve: kryesisht kredi të financuara nga tatimet për arsimin e lartë dhe profesional dhe kredi të ngjashme për arsimin e fëmijëve.*
- *Sistemi krijon një kuadër që mund të zgjerohet në vijimësi dei në një "sistem kontabël" për të gjitha nënsistemet PAYG. Avantazhet dhe disavantazhet e bashkimit të nënsistemeve (të tilla si punonjës civilë dhe të vetëpunësuar) do të bëhet menjëherë e dukshme në një sistem të tillë kontabiliteti.*
- *Sistemi prodhon një kuadër të përshtatshëm për pensione më vete për bashkëshortët.*
- *Sistemi krijon një paradigmë homogjene për shtyllën e parë, të dytë dhe të tretë të një sistemi me shumë shtylla; kështu që, mund të rrisë pranimin e shtyllës së dytë dhe të tretë, të cilat konsiderohen si komponentë të "huaj" të sistemit në ato vende që kanë pasur një sistem pensionesh monolit, të mbizotëruar nga shtylla e parë.*
- *Sistemi bën të mundur ekzistencën e një shkalle të madhe fleksibiliteti për punonjësit në zgjedhjen e moshës për të dalë në pension; e bën të tepërt caktimin në mënyrë jo elastike të një moshe "normale" të daljes në pension, që edhe politikisht është problematike; dhe nxjerr në pah kompromisin midis kontributeve të akumuluar dhe moshës së daljes në pension si diçka që ndodh në mënyrë të brendshme konsistente.*
- *Sistemi bën të mundur lëvizshmërinë e të drejtave të pensionit nga njëra punë, profsion dhe sektor në tjetrin.*

Dizavantazhet

Një nga pikat kryesor të forta të sistemeve NDC, pra, transparenca, shoqërohet me dizavantazhe të dukshme në aspektin politik:

- *Situata financiare e një sistemi PAYG të paqëndrueshëm bëhet edhe më e dukshme meqenëse punëtorët "i shohin" përfitimet duke iu zvogluar (ndërsa shkalla e kontributeve rritet) në llogaritë e tyre vetjake – gjë që i përkthen njohuritë e përgjithshme rreth situatës financiare të sistemit të pensioneve në një shqetësim personal. Kjo është ana tjetër e avantazhit të transparencës: ajo mund të kthehet në disavantazh, sepse mund të minojë edhe më shumë besimin.*
- *Në rastin ku shkalla e kontributeve është e përcaktuar, norma e zëvendësimit bëhet e pasigurt, sepse varet nga ecuria e mëtejshme e të ardhurave dhe proceset demografike. Norma e zëvendësimit nuk mund të shërbejë më si një instrument politik. Ky është padyshim thelbi i një sistemi me kontribute të përcaktuara, duke përfshirë edhe sistemin notional, pasiguri që fatkeqësisht do të bëhet mjaft e dukshme në një sistem kontabiliteti NDC.*
- *Sistemi nuk ndryshon tensionin midis pakësimit të të ardhurave që varen nga cikli i biznesit dhe angazhimeve afatgjata të shpenzimeve. Prandaj, është e nevojshme të mbahet një rezervë e vërtetë likuiditeti. Në vende ku kjo rezervë është zbrazur, duhet rikrijuar edhe nëse kjo kërkon sakrifikimin e shkallëve më të ulëta të kontributeve apo vendosjen e normave më të larta, sidomos gjatë përmirësimeve të cikleve të biznesit. Disa vende, p.sh Suedia, kanë dhuntinë historike të pasjes së një fondi amortizues i cili është*

mjaftueshmërisht i madh për të zbutur edhe një pjesë të rëndësishme të tronditjeve demografike në dekadat e ardhshme.

- *Nëse pensioni vjetor ngrihet në momentin e daljes në pension, do të mungojë një mekanizëm ushqyes stabilizues në rast të rritjes së papritur të jetëgjatësisë. Me një shkallë fikse kontributesh, sistemi automatikisht do t' u bindet kufizimeve të buxhetit vjetor të një sistemi PAYG konvecional²⁸⁰. Për të kapërcyer këtë problem Suedia aplikoj një "mekanizëm" automatik, balancues, kompleks.*
- *Vendimet diskrecionare nuk mungojnë; thjesht janë më të fshehura. Ato bëhen në zgjedhjen e tabelës të jetës, rregullave të përlllogaritjeve (të tilla si nxjerrja e mesatares) për normën e brendshme të fitimit, përcaktimin e moshës minimale të daljes në pension, edhe kështu me radhë.*
- *Sistemi nuk e ndryshon faktin se vetëm parapagimi mund të ndryshojë brezin që duhet të paguajë për një përfitim të caktuar pensioni. Nëse dikush do që puntorët e brezit X të paguajnë të paktën pjesërisht për pensionin e tyre, në vend të fëmijëve të tyre në brezin X+1, është e nevojshme që të ketë një farë shkalle parafinancimi. Një sistem NDC nuk zëvendësohet dot një financim të tillë të pjesshëm. Ai është vetëm optimizmi i shtyllës PAYG.*

5.4 / 4 DISA NGA KOMPONENTËT MË TË RËNDËSISHËM TË NDËRTIMIT TË SISTEMIT NDC

- *Sikundër në çdo sistem tjetër sistem tjetër PAYG, duhet të vendos një moshë minimale se kur punëtorët e shëndetshëm mund të fillojnë të marrin një pension. Një moshë e tillë minimale e daljes në pension është e nevojshme, përveçse kur pjesmarrja në sistemin PAYG lihet në dëshirën e njerzive, gjë që nuk do të ishte një zgjidhje e qëndrueshme, sidomos në kohë plakjeje të popullsisë. Asnjë nga sistemet ekzistuese NDC nuk bën një përshtatje automatike të moshës miniamle të pensionit me jetëgjatësinë. Si rrjedhojë, sistemet ekzistuese reagojnë vetëm ndaj ndryshimeve demografik.*
- *Specifikimi dhe përditësimi i tabelave të jetës kanë pasoja të menjëhershme tëk përfitimet. Shumica e vendeve deri më tani kanë përdorur **tabela jete të njëjta për të dy sekset (uniseks)** bazuar në të dhëna të tërthotra.²⁸¹. Ajo që është e saktë nga ana aktuale janë tabelat e grupmoshave, me disa parashikime për ndryshimet e jetëgjatësisë. Shumë vende nuk kanë mekanizma të besueshëm për të llogaritur tabela të tilla. Duhet një bord i pavavrur aktuarësh të mbikëqyrë ndërtimin e këtyre tabelave, ndërsa tabelat e jetësduhet të përputhen me ato që përdoren nga seksioni i pensioneve private.*
- *Interesi i brendshëm i kontributeve (norma e rritjes së faturës së kontributeve) duhet të zbutete me kohë. Për këtë ka disa modele. Zgjidhja e natyrshme duket se është një mesatare e lëvizshme përgjatë një cikli biznesi. Kulmet duhet të nivelohen për të shkuar në rezervat e likuiditetit, të përdorura për pikat e të ulëta të ciklit. Hartimi i mekanizmave të tillë zbatues nuk është punë e lehtë, duke qënë se aplituda dhe kohëzgjatja e një cikli biznesi nuk dihen që më parë, dhe nuk ka një mekanizëm të pagabueshëm që të dallojë tendencat nga ciklet.*
- *Meqenëse norma e brendshme e kthimit të një sistemi PAYG është në përgjithësi*

²⁸⁰ Shih Holzmann (1997); Schmidt-Hebbel (1998); borsch-Supan dhe Einter (2001).

²⁸¹ Përrjashtim bën Letonia, e cila përdor tabelën e jetës së grupmoshave.

shumë më e ulët se sa shkalla e skontimit që do të përdorin punëmarrsit, efektet nxitëse të daljes në pension para kohe mund të vazhdojnë të jenë ende të mëdha nëse thithjet e pensionit në një kohë të mëvonshme do të rregulloheshin nga neutraliteti aktuar. Nga një këndvështrim makroekonomik, nuk është e qartë nëse neutraliteti aktuar (duke përdorur normën e kthimit të sistemit PAYG), apo mungesën e efekteve nxitëse (duke përdorur normën e skontimit të punëtorve) do të thotë maksimizim i mirëqenies.

- *Ka mënyra të shumta përkonceptimin e pensioneve vjetore. Ato mund të zgjidhen që të rriten me rritjen e inflacionit apo të pagave, apo sipas ndonjë plani tjetër; shkalla fillestare mund të përshtatet sipas rastit, duke e mbajtur PDV-në konstante përgjatë kohëzgjatjes së pritshme. Liria për të zgjedhur ka gjasa të jetë më e rëndësishme se problemet potenciale që vijnë nga përzgjedhja e keqe. Megjithatë, deri më tani ka pak përvojë në botë nga kompromise të tilla.*
- *Përfitimet përcaktohen në fillim të pensionit, por pas përcaktimeve të tilla mjedisi demografik dhe ekonomik mund të ndryshojë papritur. Në rastë se shkalla e rritjes së kontributeve, e matur me terma nominale, është shumë e ulët, pensionet mund të ulen në terma reale, gjë që nuk është tërheqëse nga pikëpamja politike. Një fare përshtatje në këtë mjedis të ri sigurisht do të ishte optimale, por mesa shihet, pensionistët e vlerësojnë mjaft të qenët të mbrojtur. Politika e përgjithshme e maksimizimit të mirëqenies nuk njihet deri më tani.*

Sikurse është theksuar në këtë punim, në rastë se pensionistët janë plotësisht të mbrojtur nga ndryshimet demografike dhe ekonomike, që mund të ndodhin pas daljes së tyre në pension, sistemet NDC humbasin një mekanizëm të rëndësishëm marrje mendimesh (feedback), që mund të minojë qëndrueshmërin afatgjatë financiare të tyre. Në rastë se pensionet janë të mbrojtur nga një dysheme (për shembull, të mos ulen në terma reale apo nominale), sistemi mund të bëhet i paekulibruar financiarisht, sepse shpenzimet dhe kontributet do të trajtoheshin në mënyrë asimetrike. Shpenzimet nuk mund të bien nën një dysheme të caktuar, ndërsa kontributet mundën.

- *Rregullat e periudhës së tranzicionit duhet të ndjekin modelin suedez, jo atë Italian. Koha jashtëzakonisht e gjatë e tranzicionit në Itali nuk e lejon sistemin NDC të trajtoj problemin më urgjent financiar: ngarkesën që do të vihet buxhetit të pensioneve, që do të ndodhë kur të dalë në pension brezi i bumit të fëmijëve. Një çështje edhe më e vështirë është shkalla në të cilën pensionet ekzistuese duhet të mbrohen.*

Rrugët "e natyrshme" të tranzicionit mund të ndërtohen kur përfitimet të jenë përcaktuar *pro rata*, në proporcion me kohën e shpenzuar sipas ligjit aktual dhe atij të ri. Tranzicioni mund të jetë më i shpejtë, nëse ekzistojnë elemente të rëndësishëm të hartimit të sistemit NDC. Në Gjermani, për shembull një periudhë relativisht e shkurtër tranzicioni (nga 2005 deri në 2020) do të ishte e mundur, sepse sistemi ekzistues me pikë përmban ndër kohë një veçori të rëndësishme të sistemit NDC.

5.5 LLOGARITJA E PËRFITIMEVE BAZUAR NË SKEMËN NDC

5.5/ 1 PENSIONI VJETOR

Në momentin që një individ arrin moshën e caktuar për përfitim të

pensionit të pleqëris ai ballafaqohet me totalin e kapiatlit ose e thën ndryshe me shumat e kontributeve të depozituara ndër vite. Kapitali total i kontributeve individuale në kohën e pensionit, duke filluar në periudhën τ , është shuma e kapitalit të krduar në llogarin individuale përpara periudhës së daljes në pension .

Kapitali i përgjithshëm në fund të periudhës para daljes në pension, K_{τ} , e përpjestuar me faktorin e pensionit vjetor, G , jep vlerën fillestare të pensionit vjetor, P_{τ} , për pensionistin, j , nga grupmosha me vit lindje k .

$$P_{j,\tau} = K_{j,r-1}$$

$$G(L_{EK}, a(L_{EK}))$$

Pensioni vjetor është i lidhur ngushtësisht me dy faktorë.

L pari, është jetëgjatësisht e bazuar në grupmoshë, LE , për grupmoshën K në momentin e daljes në pension.

L dyti, është norma e brendshme e kthimit, a , e llogaritur për një periudhë. kjo e fundit bëhet një formulë indeksimi në praktikë.

Faktori i jetëgjatësisë

Në parim, burrat dhe gartë do të kenë faktor të ndryshëm LE . Megjithatë në vende ku janë futur skemate NDC-së, pensioni vjetor përlllogaritet në bazë të një jetëgjatësie të njëjtë për të dy sekset (uniseks). Përdorimi i jetëgjatësisë uniseks në llogaritjen e pensionit vjetor fut për këtë arsye elementin e rishpërndarjes së shprehur qartë nga ata që jetojn më pak, tek ata që jetojn më shumë duke marrë parasysh modelet aktuale të jetëgjatësisë dhe faktorin uniseks LE , që kërkon një kalim nga burrat tek gratë.

Lidhja me përfitimet e paaftësis

Në shumicën e sistemeve të sigurimeve shoqërore, edhe në sistemin tonë paaftësia është një skemë e rëndësishme e këtij sistemi. Në analizën e mësipërme dukshëm u krijua ideja së skema NDC është një skemë e cila në përqëndrimin kryesor të ekzistencës së sajë ka skemën e pensioneve të pleqërisë. Por, për shkak se përfitimet e paaftësis kanë qenë dhe janë pjesë e rëndësishme e të gjitha sistemeve të krijuara gjatë shekullit të shkuar, përfitimet e paaftësis kanë qenë dhe janë pjesë e paketës së përgjithshme të pensioneve.

Nëse do ti referohemi skemës NDC, e cila është një skemë sigurimi për moshën e vjetër. Për shkak të kësaj, përfshirja e paaftësis në kuadrin e NDC-së është një çështje e rëndësishme. Për të përfituar të ardhura nga skema paaftësin, (invaliditeti), një punëtor normalisht duhet të ketë pasur një llogari në një sistem NDC. Në parim, mënyra e drejtëpërdrejtë për trajtimin e paaftësisë dhe NDC-së është të hartohet një rregull për të paguar, do të thotë financim me kontribute nga jashtë në llogari të subjektit pjesëmarrës në NDC.

Kontributet për të gjithë personat e paaftë të cilët janë duke përfituar nga skema gjatë periudhës së mbetur deri sa të arrijnë moshën minimale ose maksimale të daljes në pension dhe pastaj, të zëvendësohet pensioni i paaftësisë me një përfitim vjetërsie nga skema NDC. Rregulli i zgjedhur

për pagimin e kontributeve për financimin e përfitimit të paaftësis do të përcaktojë mbulimin me kontribute gjatë periudhës së paaftësis.

5.5/ 2 LLOGARITË E PËRBASHKËTA NDC MIDIS BASHKËSHORTËVE

Kjo temë paraqet një panoramë shumë interesante të ekzistencës së një lloji sigurimi i cili në legjislacionin Shqipëtar organizohet komplet ndryshe. Në vende si Suedia, Gjermania, ekziston mundësia për të pasur llogari kontributesh të përbashkëta midis bashkëshortëve në skemën NDC. Parimet e kodeve ligjore që drejtojnë çështjet financiare të bashkëshortëve mund të përdoren edhe në llogaritë NDC. Analiza në lidhje me këtë temë do të fokusohet në mënyrën se si kjo mund të funksionojë në praktikë. Në këtë analizë do të vë theksin në dallimin midis periudhës së akumulimit dhe periudhës së maturimit.

Gjatë periudhës së akumulimit, kapitali i NDC-së i vënë përpara martesë (ose ndonjë formë tjetër bashkëjetese, në varësi të legjislacionit të vendit) mund të mbetet individit, ndërsa kapitali i vënë gjatë martesës duhet të ndahet në mënyrë të barabartë midis bashkëshortëve.²⁸² Ky kapital do të ruhet edhe në rast divorci dhe do të mbete kapital i vetë individit kur ai ose ajo martohet përsëri.²⁸³

Të dy aspektet e përmendura janë të rëndësishme.

E para: Pasja e një llogarie të përbashkët e detyrueshme apo vullnetare.

E dyta: Opsioni automatik duhet të jetë llogaria e përbashkët apo llogari të veçantë.

Një argument kryesor kundër pasjes së detyrueshme të llogarive të përbashkëta në një vend ku bashkëjetesa njihet ligjërisht është se personat e painteresuar në pasjen e një llogarie të përbashkët do të zgjidhnin të mos martoheshin, ndërsa disa njerëz të martuar mund edhe të zgjidhnin divorcin, përveç bashkjetesës, si një mjet për të shpëruar një sistemi të detyrueshëm pasi ai të hynte në fuqi. Kjo e fundit do të thotë se duhet krijuar edhe një rregull për bashkjetesën, ose se një sjellje e tillë do duhej të pranohej.

Për shkak të këtyre reagimeve të mundshme të sjelljes, pasja me vullnet të lirë e llogarive të përbashkëta mund të duket më tërheqëse. Pastaj, çështja shtrohet nëse llogaritë e pavarura duhet të ishin forma automatike, ku të kërkohej vendimi pozitiv i të dy bashkëshortëve për të hapur llogari të përbashkëta, ose nëse, llogaritë e përbashkëta duhet të ishin forma automatike, ku të kërkohej një vendim i përbashkët për të krijuar llogari të veçanta. Vendosja e llogarive të përbashkëta si opsion automatik pa dyshim që përshtatet mirë edhe me rregullime të tjera përsa i takon pronave të përbashkëta të bashkëshortëve.

Llogaritë e përbashkëta do të ishin gjithnjë në të mirën e bashkëshortit apo bashkëshortes me të ardhura më të ulëta dhe do të ndimonin për të kompensuar kohën e shumtë të shpenzuar në aktivitete jo të tregut. Një tjetër hipotezë mund të jetë fakti se: a duhet një pension vjetor i përbashkët për bashkshortët (bashkëjetuesit) të jetë i detyrueshëm, vullnetar apo mos

²⁸² Legjislacioni ynë nuk e trajton fare pjesën e bashkëpronësis mbi kontributet e sigurimeve shoqërore. Në legjislacionin tonë Sigurimet shoqërore konsiderohen si pagesë personale dhe të drejtën e përfitimit e ka vetëm personi i cili është i siguruar.

²⁸³ Në rastin e divorcit legjislacioni ynë parashikon vetëm detyrimin ushqimor për bashkëshortin ose bashkëshorten me paaftësi.

të lejohet fare në NDC? Qëllimi i një pensioni vjetor të përbashkët është që të sigurojë një pension më të mirë vjetor për bashkëshortin, bashkëshorten që jeton më gjatë, që përgjithësisht janë gratë.

A do të realizohej kjo duke pranuar pensione vjetore të përbashkëta? Përgjigjia e kësaj pyetje është empirike. Nëse përdoret jetëgjatësia e njëjtë për të dy sekset në llogaritjen e pensionit vjetor individual, mund të gjenden shembuj që tregojnë se gratë do të humbin nga një pension vjetor NDC i përbashkët. *Një sistem i detyrueshëm* që kërkon pensione vjetore të përbashkëta në kohën e daljes në pension në fakt mund të bjerë ndesh me qëllimin e sigurimit të përfitimeve më të mira për gratë. E parë me afat të gjatë, ajo mund të kthehet edhe në kundërproduktive, kur hendeku i të ardhurave gjinore të zvogëlohet.

Një rregull vullnetar do të ofrojë një mundësi për bashkëshortët me dallime relativisht të mëdha në të ardhurat etyre gjate jetës për të pasur të njëjtën llogari, duke ofruar kështu një mundësi për bashkëshorten, bashkëshortin me të ardhura më të pakta në jetë që të sigurojë një përfitim më të mirë. Një masë vullnetare kërkon miratimin e të dy bashkëshortëve, pra, duke përfshirë edhe bashkëshortin me më shumë të ardhura gjatë jetës. Ndonjëherë kjo mund të mos japë rezultatin e dëshiruar, por si rregull do të ishte e pëlqyer në planin shoqëror.

Në përfundim, pasja vullnetare e një llogarie të përbashkët, si opSION automatik, është një alternativë në periudhën e akumulimit, që pasqyron rregullimet ligjore të shumicës së vendeve për ndarjen e pronës midis bashkëshortëve; megjithatë, kjo kërkon rregulla të posaçme në rastin e çifteve që bashkëjetojnë.

Ndarja vullnetare e pensioneve vjetore është e preferueshme ndaj ndarjes së detyrueshme të pensioneve vjetore, por alternativë automatike duhet të zgjidhet në lidhje me faktin se kush pritet që të jenë fituesit. Kjo ndodh, sepse sa më afër të jenë të ardhurat e grave me ato të burrave, pensionet e veçanta të llogaritura në bazë të jetëgjatësisë së njëjtë për të dy sekset, do të jetë në avantazh të grave që do të mbeten gjallë – që përbëjnë mbijetueset më të mundshme.

1.7 REFORMIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË SHQIPËRI DREJT NJË SISTEMI ME LLOGARI NOCIONALE

5.7/1 SISTEM ME LLOGARI NOCIONALE AVANTAZHET E TIJ KRAHASUAR ME SISTEMIN DB

Sistemi i sigurimeve shoqërore në vendin tonë është referuar rrënjësisht, nga një sistem më përfitime të përcaktuara (DB), ka lëvizur drejt sistemit me llogari sociale NDC. Arsyet e këtij reformimi i kemi analizuar më poshtë. Si definicion mund të them se: Nevoja për të menduar reformimin e sistemit të pensioneve në Shqipëri ka ardhur si një domosdoshmëri për t`i gjetur zgjidhje problemeve të shumta që ka ky sistem si dhe për të krijuar instrumentet dhe strukturat e nevojshme ekonomike, që mund t`i sigurojnë pensione të kënaqshme të gjithë njerzëve që derdhin kontribute mbi pagën e punës së tyre.

Sistemi me përfitime të përcaktuara është një sistem i cili ka vepruar në fushën e sigurimeve shoqërore në vendin tonë për një periudhë 21 vjeçare. Ky sistemi, mbështetet në bazë të formulave që mbështeten në pagat e punonjësive,

vitet e shërbimit, dhe financohet nga kontributet e atyre që paguajn sot, në bazë të sistemit. Në gjithë harkun kohorë sistemi i sigurimeve në vendin tonë ka pasur ndryshime të vazhdueshme dhe të rëndësishme në drejtim të skemës së sigurimeve shoqërore.

Për të kuptuar se përpjekjet nga ana e shtetit kanë qenë të vazhdueshme që në hapat e parë të këtij sistemi dhe për të dhënë një definicion të qartë se me të gjitha ndryshimet e bëra kjo skemë nuk po ofronte atë që duhej dhe kishte ardhur momenti për ndryshim, kemi paraqitur një tablo të shkurtër mbi të gjitha ndryshimet e zbatuara në këtë sistem ndër vite.

Ndryshimet e zbatuara në sistemin e sigurimeve shoqërore deri në vitin 1998

- *Ndër ndryshimet e para regjistrohet përfitimi i të drejtës për një pension familjar, në rastet se mbajtësi i familjes nuk kishte më shumë se një vit shkëputje nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm.*
- *U miratua që të njëjti si periudhë sigurimi edhe periudha kur një person trajtohet me pension invaliditeti të përfshihet.*
- *Reforma e pensioneve të fshatit dhe ndimi i një strategjie të barazimit gradual të pensioneve të reja të fshatit me ato të qytetit në një periudhë së paku, 14-15 vjeçare. Reforma e re e miartuar përcaktoi llogaritjen e një pensioni për personat e vetëpunësuar në bujqësi, i cili përbëhej nga dy pjesë: një pension fshati (bazë), i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe një shtesë e cila është 1 përqind e pagës minimale për çdo vit kontributiv.*
- *Një masë e tillë parashikohej që të koordinohet dhe harmonizohet me rritjen dhe barazimin gradual edhe të kontributit të fermerëve me atë të vetëpunësuarve në sektorin jo bujqësor. Fakti që pensioni i fshatit është sa 70% i atij të qytetit, ndërkohë që kontributi është sa 40% e atij të qytetit, tregon se çështjet nuk kanë shkuar si duhet.*
- *Nga ana tjetër mendojmë se mbeten për tu marrë në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm:*
- *Ekzistenca e skemës së pensioneve të fshatit me një volum aktual shpenzimesh prej 15% të shpenzimeve për pensione,*

mbulim me këtë skemë i rreth 160 mijë personave,

ekzistenca e të drejtës për të përfituar një pension qoftë edhe të përfshihet për të gjithë personat që kanë lindur në vitin 1956 e përpara edhe sikur këta të mos jenë kontribues në skemën e re.

niveli shumë i lartë i pjesëmarrjes së shtetit për mbulimin e diferencës së kontributit.

Aktualisht me subvencione buxhetore mbulohet rreth 70% e shpenzimeve të kësaj skeme.

Nisur nga këto çështje është shumë e qartë se skema kërkon një vëmendje të veçantë në kontekstin e të drejtave të fituara në fushën financiare. Duke patur parasysh edhe faktin që numri i femrave në shqipëri është shumë i lartë.

Reformat në vitin 2002

Reforma të rëndësishme të sistemit, të studiuara dhe miratuara në vitin 2002, kishin për shkak një sërë faktorësh, ndër të cilët:

- *defiçit i sistemit të pensioneve konsiderohej i lartë, duke arritur në 1% të PBB dhe parashikimet aktuariale llogaritnin një përkeqësim të kësaj gjëndjeje.*
- *pensionet rurale, që përfaqësojnë një pjesë të madhe të defiçitit, edhe pse ato luajn një rol të rëndësishëm të varfëris në fshat.*
- *Përqindja e lartë e kontributit për fondin e sigurimeve shoqërore që arrinte në 42.5% e pagës, i dekurajonte njerëzit për sigurimin formal.*

Mbi bazën e studimeve të kryera, edhe me konsulencën e FMN-së dhe Bankës Botërore, u miratuan nga Kuvendi dhe filluan të zbatohen:

- *Reforma e rritjes graduale të moshës së përfitimeve të pensionit, e cila përcakton rritjen me gjashtë muaj për çdo vit të moshës deri në arritjen në vitin 2012 të moshës 65 vjet për burrat dhe 60 për gratë.*
- *E drejta për të fituar një pension të reduktuar, para mbushjes së moshës së plotë të kërkuar, por jo më shumë se tre vjet nga moshja përfundimtare, duke reduktuar pensionin e plotë, koeficientin me 0.6% në muaj.*
- *Norma e kontributit të sigurimeve shoqërore u reduktua me 4%, ndërkohë që për të shmangur lëkundjet e mëdha financiare të skemës u realizua rritja e tavanit të pagës mbi të cilën u paguhen kontributet nga trefishin në pesfishin e pagës minimale.*
- *Në zbatim të strategjisë për sigurimet shoqërore në fshat, për vitin 2002 u rrit me 2.4 herë shuma e kontributit vjetor që paguajnë fermerët, e cila nuk ka vazhduar me të njëjtat ritme në vitet e mëpasme.*
- *U reformua rrënjësisht skema e kompensimeve që përfitojnë pensionistët për personat në vartësi të tyre.*
- *Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Tatim Taksave filloi të zbatohet strategjia e kalimit gradual të mbledhjes së kontributeve nga organet e sigurimeve shoqërore me ato të tatim taksave.*

Pasi ishin konstatuara gjithë këto probleme dhe pasi ishin bërë të gjitha këto ndryshime, përsëri skema nuk po bëhej atraktive për shoqërinë. Sidoqoftë, sistemi nocional paraqet një ndryshim thelbësor krahasuar me sistemin aktual. Kjo sepse ky sistem është dizenuar për të imituar një sistem privat me kontribute të përcaktuara ku masa e pensionit përcaktohet nga historia e kontributeve të individit dhe norma e fitimit të tyre.

Për të kuptuar më mirë analizën e ndryshimeve të bëra, si dhe për të dhënë një panoramë më të qartë në lidhje me atë se çfarë ka ndryshur, do të përqëndrojmë analizën e kësaj teme në problematikat e sistemit të shkuar të cilat detyruan të bëheshin dhe ndryshimet aktuale. Konkretisht:

Së pari: nëse do ti referohemi sistemit të pensioneve DB, i cili ka funksionuar në vendin tonë, kuptojmë se ky sistem për aq kohë sa paraqiste problem nuk ka funksionuar në mënyrë atraktive për popullsinë.

Një ndër problemet bazë mund të konsiderohet ofrimi i përfitimeve të ulta nga skema e pensioneve, si skema më e madhe e këtij sistemi me një normë kontributi prej 21.6% të pagës. Pensioni mujor i pelqërisë në sistemin DB, llogaritet në bazë të formulës ligjore të mëposhtme.

$$Pp = Mpb + Sh,$$

Ku:

Pp = pensioni i plotë mujorë i pleqërisë

Mpb = masa e pensionit bazë që u jepet të gjithë personave të siguruar, duhet të sigurojë një standard minimum jetese.

Ky komponent korrektohej çdo vit me indeksion e çmimeve të disa mallrave të përzgjedhura, siç parashikohet në rregulloren e ISSH-së dhe përcaktohet çdo vitë me vendim të Këshillit të Ministrave. Masa e tij ishte 8240 lekë në muaj, ndaj ky ka qenë një nga shkaqet që qeveria ka përdorur politika të veçanta kompensimi për të ardhurat minimale.

Sh = shtesa mbi pensionin bazë

Ky komponent që llogaritet, është individual, si i tillë ai varet nga madhësia dhe zgjatja e periudhës kontributive dhe është 1 përqind për çdo vit sigurimi shumëzuar me bazë mesatare të vlerësueshme (paga mbi të cilën janë paguar kontributet).

Referuar shumës së mësipërme të mënyrës se si llogaritet pensioni minimal dukshëm vëmë re se shuma e këtij pensioni nuk ka arritur as në kujfijtë e minimumit jetik. Ky kusht, përbënte një element shumë të rëndësishëm për ndryshim. Nuk mund të pretendojmë kurrë që kemi një skemë tërheqëse për shoqërinë ekonomikisht aktive, kur pensionet e ofruara nga kjo skemë nuk plotësojnë as minimumin jetik.

Pikërisht për këtë qëllim, ndryshimet në ligjin e sigurimeve shoqërore përsa i përket ndryshimit të formulës së llogaritjes së përfitimeve nga skema e pensioneve, konsidrohen ndër masat më të rëndësishme të skemës dhe pse jo më e rëndësishmja.

Në një sistem të llogarive nacionale NDC, kontributet mujore regjistrohen dhe atyre iu caktohet një normë interesi. Norma e interesit lidhet me rritjen e pagave në shkallë vendi. Kështu, formula e re e llogaritjes së pensionit është:

P – është masa e pensionit;

Ka – është shuma agregate e kapitalitë akumuluar gjatë viteve kur janë derdhur kontribute;

F – është fitimi nucional i akumuluar gjatë viteve si rezultat i aplikimit të normës nucionale të interesit;

Jm – është jetëgjatësia mesatare e popullsisë për moshën e daljes në pension.

Pra, në momentin e daljes në pension, shuma agregate e kapitalit të akumuluar dhe fitimet “nucionale” pjestohen me jetëgjatësin mesatare dhe kthehen në një pension vjetor, i cili më pas konvertohet në pensione

mujore.

Për të kuptuar më mirë llogaritjen e pensionit po i referohem një shembulli:

Shembull i pensionit të pleqërisë

Znj. V.C e datëlindjes 01.01.1995 ka 40vite punë , nga të cilat, 3 vite e 11 muaj shkolla e lartë, 15 vite e 1 muaj mësuese dhe pjesa tjetër nga viti 1994 deri në 2015 gazetare. Më datë 1.3.2015 i lind e drejta për pension pleqërie.

Kushtet e përfitimit të pensionit janë:

- *Mosha 60 vjeç e 2 muaj*
- *Minimalisht 15 vite sigurim*

Masa e pensionit të pleqërisë do të llogaritet konform nenit 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Llogaritja e bazës mesatare të vlersuar:

Periudhat e punës			Elementet e llogaritjes		
Nga	Deri	Muaj	Koefic	Paga mujore	Paga x koef x muaj
01.09.1974	20.08.1978	47.7	8.59	2`740.00	1`121`659.82
20.08.1978	16.09.1993	180.9	8.59	4`110.00	6`386`656.41
19.05.1994	31.12.1994	7.4	8.59	6`117.00	388`833.22
01.01.1995	31.12.1995	12.0	6.92	7`937.00	659`088.48
01.01.1996	31.12.1996	12.0	5.37	10`863.00	700`011.72
01.01.1997	31.12.1997	12.0	5.37	11`384.00	733`584.96
01.01.1998	31.12.1998	12.0	4.48	14`336.00	770`703.36
01.01.1999	31.12.1999	12.0	3.64	15`600.00	681`408.00
01.01.2000	31.12.2000	12.0	3.31	17`008.00	675`557.76
01.01.2001	31.12.2001	12.0	2.83	20`540.00	697`538.40
01.01.2002	31.12.2002	12.0	2.62	21`280.00	669`043.20
01.01.2003	31.12.2003	12.0	2.34	22`827.00	640`982.16
01.01.2004	31.12.2004	12.0	2.13	23`571.00	602`474.76
01.01.2005	31.12.2005	12.0	1.93	23`437.00	542`800.92
01.01.2006	31.12.2006	12.0	1.76	22`768.00	480`860.16
01.01.2007	31.12.2007	12.0	1.67	25`611.00	513`244.44
01.01.2008	31.12.2008	12.0	1.48	37`723.00	669`960.48
01.01.2009	31.12.2009	12.0	1.36	41`908.00	683`938.56
01.01.2010	31.12.2010	12.0	1.30	44`762.00	698`287.20
01.01.2011	31.12.2011	12.0	1.25	51`750.00	776`250.00
01.01.2012	31.12.2012	12.0	1.20	51`371.00	738`964.80
01.01.2013	31.12.2013	12.0	1.16	56`000.00	779`520.00
01.01.2014	31.12.2014	12.0	1.00	57`000.00	684`000.00
01.01.2015	31.12.2015	2.0	1.00	50`215.00	100`430.00
Totali		478.0		Shuma	21`396`834`.81

Baza mesatare e vlersuar = $21.396.834/478 = 44\ 763$ lekë

Llogaritja e pensionit të pleqërisë:

Pensionit i pleqërisë = (pensionin social x vitet e sigurimit/ vitet që duhen sipas nenit 92) + (1% x bazë mesatare të vlersuar x vitet e sigurimit)

Pensionit i pleqërisë= $(6.750 \times 40 / 35.33) + (1\% \times 44.763 \times 40)$

Pensionit i pleqërisë = $7.642 + 17.905$

Pensionit i pleqërisë = 25.547 lekë

Një tjetër element i ri i ndryshuar në formulën e llogaritjes, është rritja e vlerës për periudhat shtesë të kontributeve. Periudhë shtesë konsiderohen vitet e punës shtesë mbi ato të përcaktuara për moshën e daljes në pension. Pra, kur pas mbushjes së moshës së pensionit, personi vazhdon të punojë përsëri. Në formulën e llogaritjes së pensionit para ndryshimeve, kjo shtesë ishte 4% për çdo vit shtesë mbi moshën e pensionit. Me ndryshimet e reja zgjatja e periudhës kontributive shkoi në 6%.

Një ndryshim themelor në skemë lidhet me masën e përfitimeve të pensionit. Ligji i mëparshëm parashikonte tavan minimal dhe maksimal në llogaritjen e pensionit.

Pensionit minimal: përcaktohej cdo vit nga KM

Pensionit maksimal: ishte dyfishi i pensionit minimal.

Një limit tjetër i këtij ligji ishte përqindja e llogaritjes së pensionit të pleqërisë. Kjo përqindje nuk mund të ishte më e lartë se 75% e pagës mesatare neto, të indeksuar të tre viteve rrjesht në dhjetë vitet e fundit të punës.

(Pp= paga netox 75%).

Në parim mënyra e llogaritjes së përfitimit të pensionit të pleqërisë, merrte parasysh numrin e viteve të sigurimit e rrjedhimisht u jep pension më të madh atyre që kanë kontribuar më shumë në skemën e sigurimeve shoqërore; kufiri maksimal i pensionit, duke qenë taksativ, por edhe kufizimi i llogaritjeve me 75 përqind të pagës mesatare neto, faktikisht, e dobëson vartësinë e përfitimeve nga madhësia e kontributeve dhe lidhjen midis tyre.

Ndërsa në nivelin minimal arrihet një shkallë zëvendësimi pension/page neto prej 75%, ky raport për shkak të kufizimit nga tavanin e pensionit maksimal, tenton gjithmonë drejt uljes dhe teorikisht për pagën maksimale mbetet në kufirin 35%. Kjo mënyrë aplikimi e bënte situatën shumë pakë nxitëse për të kontribuar në skemë, për arsye se përfitimet janë të reduktuara për shkak të limiteve maksimale.

Ligji aktual eliminon tavanin minimal dhe maksimal të pensioneve. Ai do të ofrojë pensione sa niveli i kontributeve. Pra përfituesive do t'u mundësohen pensione më të larta.

Ndërsa kur bëhet fjalë për pensionet minimale ato do të jenë në të njëjtin nivel me minimumin jetik. Nëpërmjet ndryshimeve të mënyrës

se llogaritjes të përfitimeve për pension, konstatohet se formual e re propozon pensione më të larta, kjo do të thotë, që përpjekjet janë bërë më synim që skema të mund të bëhet më atraktive për kontribuesit.

Po të vërejmë tabelen e më poshtme dukshëm do të kuptojmë se sa peshë të madhe zënë përfituesit e pensionit në skemën e sigurimeve. Referuar tabelës kuptohet qartë se sa e madhe është diferenca që ekziston ndërmjet përfituesve urban dhe atyre rural. Megjithëse duhet kuptuar se përpjekjet e shtetit për të minimizuar diferencat e mëdha që ekzistonin ndërmjet përfituesive të skemave urbane dhe rurale kanë qënë të vazhdueshme përsëri ekziston ky llojë diferencimi. Një tjetër diferencimi i dukshëm ekziston edhe në masën e pensionit, ndër vite ky diferencim ka qënë shumë i madh dhe sot vazhdon të jetë i tillë edhe pse në bazë të përpjekjeve shtetërore diferenca është ngushtuar pak.

TAB-7²⁸⁴ Numri i përfituesive për vitë të përzgjedhura

Pensioni i invaliditetit. Personat e siguruar që nuk mund të vazhdojë periudhën e sigurimit për shkaqe shëndetësore të cilat nuk kanë lidhje me punësimin, apo për shkak të dëmtimeve profesionale të shaktuara në punë, fitojnë të drejtën e një pensioni invaliditeti. Periudha minimale e sigurimit e nevojshme për të përfituar një pension invaliditeti është sa moshë e invalidit minus 20 dhe rezultati pjestohet me 2. Ndërsa në rastet kur dëmtimi i shëndetit është shkaktuar si pasojë e një aksidenti në punë apo sëmundje profesionale e drejta për përfitim lind pavarësisht nga periudha e sigurimit.

Pensioni mujor i invaliditetit llogaritet me të njëjtat rregulla si pensioni i pleqërisë dhe mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, në varësi të gjendjes shëndetësore, ose i reduktuar për shkak të mosplotësimit të periudhës minimale të domosdoshme të sigurimit.

Shembull: për mënyrën e llogaritjes së pensionit të invaliditetit të plotë:

Kushtet e përfitimit:

Personi bëhet i paaftë për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundje personale;

- Për çdo veprimtari ekonomike;
- Kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është sa $\frac{3}{4}$ e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës, të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror.

Masa e pensionit të invaliditetit të plotë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë, por shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 përqind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Shembull i pensionit të invaliditetit: A.C burrë, i datëlindjes 01.05.1958 deklarohet i plotë me kohë fillimi invaliditeti data 12.02.2015. ka gjithsej 29 vite periudhë sigurimi dhe baza mesatare e vlerësuar i rezulton 47.500

284 Tabela është marrë nga Dokumenti Politikat e pensioneve përgatitur nga Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë. Fq16.

lekë. Në datën 12.02.2015 ai është 56 vjeç e 9 muaj.

Formula e llogaritjes së periudhës minimale të sigurimit:

Periudha minimale e sigurimit = $\frac{3}{4}$ x (Moshë -20 vite)

Periudha minimale e sigurimit = $\frac{3}{4}$ x (56 v 9 m -20)

Periudha minimale e sigurimit = 27 vite 6 muaj e 23 ditë

Llogaritja e pensionit është njëllorë si për pensionin e pleqërisë, pra

Pensionin i invaliditetit = (Pensionin social x vitet e sigurimit / vitet që duhen) + (1% x Bazë mesatare të vlersuar x vitet e sigurimit)

Pensionin i invaliditetit = $(6.750 \times 29 / 27.56) + (1\% \times 47.500 \times 29)$

Pensionin i invaliditetit = 7.103 + 13.775

Pensionin i invaliditetit = 20.878 lekë

Invaliditeti i pjesshëm

Kushtet e përfitimit:

Personi i siguruar kur:

- për çdo arsye, përveç aksidentit në punë dhe sëmundjes profesionale, bëhet i paaftë të kryejë punën e fundit, por mund të punojë në kushtet të veçanta pune;
- ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit, sipas nenit 34 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, (3/4 e diferencës së moshës së pensionit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë)

Masa e pensionit të pjesshëm të invaliditetit llogaritet njëllorë siç u llogarit pensioni i plotë i invaliditetit, por rezultati me 50% pensionit të plotë të invaliditetit.

Shembull i pensionit të pjesshëm të invaliditetit: A.C burrë, i datëlindjes 01.05.1958 deklarohet invlid i pjesshëm me kohë fillimi invaliditeti data 12.02.2015. ka gjithsej 29 vite periudhë sigurimi dhe baza mesatare e vlersuar i rezulton 47.500 lekë. Në datën 12.02.2015 ai është 56 vjeç e 9 muaj.

Formula e llogaritjes së periudhës minimale të siguruar:

Periudha minimale e sigurimit = $\frac{3}{4}$ x (Moshë -20 vite)

Periudha minimale e sigurimit = $\frac{3}{4}$ x (56 v 9 m -20)

Periudha minimale e sigurimit = 27 vite 6 muaj e 23 ditë

Pensionin i invaliditetit = (Pensionin social x vitet e sigurimit / vitet që duhen) + (1% x Bazën mesatare të vlerësuar x vitet e sigurimit)

Pensionin i pjesshëm i invaliditetit = 50% x pensionin e invaliditeti

Pensionin i invaliditetit = $(6.750 \times 29 / 27.56) + (1\% \times 47.500 \times 29)$

Pensionin i invaliditetit = 7.103 + 13.775

Pensionin i invaliditetit = 20.878 lekë

Pensioni i pjesshëm i invaliditetit = 20.878 lekë x 50%

Pensioni i pjesshëm i invaliditetit = 10.439 lekë

Invaliditeti i plotë i reduktuar

Kushtet e përfitimit

- *Plotësisht i paaftë për punë*
- *pornuk plotëson periudhën minimale të sigurimit*

Masa e përfitimit është njëlloj si për pensionin e plotë të invaliditetit, por të llogaritet duke shumëzuar masën e llogaritur të invaliditetit të plotë me koeficientin që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit, me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

Pensioni familjar

Kur një person, që ishte në pension, apo pritej të fitonte të drejtën e pensionit të pleqërisë apo të invalidit, vdes, atëherë personave që janë në ngarkim të tij iu lind e drejta për pensionin familjar. Llogaritja e masës së pensionit është e njëjta si në rastin e pensionit të pleqërisë, por pensioni mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, në varësi të anëtarëve pjesmarrës në këtë pension, të cilët mund të jenë: fëmijët, bashkëshortja ose bashkëshorti dhe prindi

Shembull për mënyrën e llogaritjes së pensionit Familjar

A.C burrë, i datëlindjes 01.05.1958 vdes në datën 12.02.2015. Ka gjithsej 29 vite periudhë sigurimi dha baza mesatare e vlerësuar i rezulton 47.500 lekë. Në datën 12.02.2015 ai është 56 vjeçe 9 muaj. Përfitues të pensionit familjar janë e veja e moshës 55 vjeç dhe jetimi i moshës 17 vjeç, të cilët përfitojnë respektivisht 50% dhe 25% të masës së pensionit.

Formula e llogaritjes së periudhës minimale të siguruar:

Periudha minimale e sigurimit = $\frac{3}{4}$ x (Moshë -20 vite)

Periudha minimale e sigurimit = $\frac{3}{4}$ x (56 v 9 m -20)

Periudha minimale e sigurimit = 27 vite 6 muaj e 23 ditë

Pensioni që do ti takonte të ndjerit = (Pensionin social x vitet e sigurimit / vitet që duhen) + (1% x Bazën mesatare të vlerësuar x vitet e sigurimit)

Pensioni që do ti takont të ndjerit = $(6.750 \times 29/27.56) + (1\% \times 47.500 \times 29)$

Pensioni që do ti takont të ndjerit = 7.103 + 13.775

Pensioni që do ti takont të ndjerit = 20.878 lekë

Pensioni familjar = 20.878 lekë x 75% (50% e veja + 25% jetimi)

Pensioni familjar = 15.569 lekë

Masa e pensionit familjar kur personi i siguruar kishte një përfitim, është sa 50% dhe/ose 25% e masës së pensionit që ai gëzonte, në varësi të përfituesive, por jo më shumë se 100% e masës së pensionit që gëzonte i ndjeri.

Pensioni social:

Është një i ri në fushën e përfitimeve të sistemit të sigurimeve shoqërore. Ky pension, do të përfitohet për të gjithë personat të cilët edhe pse nuk kanë kontribuar në masën e përcaktuar nga ligji për të marrë një pension nga sistemi nocional, përsëri do të kenë të drejtën për të përfituar një pension të tillë, i cili në përmbajtje është një pension minimal.

Ky pension do t' u jepet të gjithë personav mbi 70 vjeç që 5 vitet e fundit kanë qenë rezidentë në Shqipëri. Pensioni social hyn në kategorinë e përfitimeve me testim, kjo për faktin se për përfitimin e këtij pensioni, personi do të ketë si kushtë verifikimin e të ardhurave dhe do të financohet nga buxheti i shtetit.

Pensionet suplementare shtetërore

Në lidhje me pensionet suplementare ndryshimet e sollën disa masa:

- *Rritja e mshës së përfitimit të pensionit suplementar shtetëror me 5 vite;*
- *Rritja e normës së kontributeve proporcionalisht për të gjitha funksionet e larta shtetërore duke arritur në 5 % të pagës referuese;*
- *Njehësimi i normës së kontributeve për personat me tituj shkencor që punojnë në universitetet publike dhe private duke arritur në 5% të pagës referuese;*
- *Llogaritja e përfitimeve dhe kufizimeve mbi bazën e pagës neto.*

Paga neto përllogaritet duke zbritur nga paga referuese TAP dhe kontributin e Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore të detyrueshme dhe suplementare që paguhet nga të ardhurat e personit të siguruar. Indeksimi i këtyre përfitimeve bazuar në indeksin e pagave për personat e lartë shtetërore, por jo më shumë se sa rritja e indeksit të çmimeve.

Nga sa më sipër, si pasojë e përllogaritjes së përfitimeve bazuar në pagën referuese neto, në momentin e maturimit të këtyre parametrave përfitimet e ardhshme do të jenë rreth 28% më të ulta se përfitimet aktuale, ndërkohë që si pasojë e rritjes së kontributit ndaj pagës, do të arrihet një shtesë e të ardhurave nga kontributet me rreth 2%. Me marrjen e këtyre masave, barra e buxhetit të shtetit për skemat suplementare parashikohet të ulet me mbi 30%²⁸⁵.

Skemat profesionale për profesionet e vështira

Ndryshimi i formulës së llogaritjes së masës së pensionit. Në një sistem të llogarive nocionale, kontributet mujore regjistrohen dhe atyre iu caktohet një normë interesi. Norma e interesit lidhet me rritjen e pagave në shkallë vendi. Kështu, formula e llogaritjes së pensionit do të ishte:

- **-P** është masa e pensionit;
- **-Ka** është shuma agregate e kapitalit të akumuluar gjatë gjithë viteve kur janë derdhur kontribute;

²⁸⁵ Dokumenti i politikave të pensioneve Fq 36-36-38

-F është fitimi nocional i akumuluar gjatë viteve si rezultat i aplikimit të normës nocionale të interesit;

-Jm është jetëgjatësia mesatare e popullsisë në moshën e daljens në pension.

Pra, në momentin e daljes në pension, shuma agetate e kapitalit të akumuluar dhe fitimet "nocionale" pjestohen me jetëgjatësinë mesatare dhe kthehen në një pension vjetor, i cili më pas konvertohet në pensione mujore.

Mbi ndryshimin e skemës së sëmundjeve dhe barrë lindjeve.

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm, përveç degës së pensioneve, parashikon dhënien e përfitimeve edhe rastet e paaftësisë së përkoshme në punë për shkak të sëmundjeve si edhe për rastet e barrë lindjeve.

Kontributet në sistemet e sigurimeve shoqërore (si % e pagës)

Degët e sigurimeve	Totali	Punëdhënsi	Punëmarrsi
Pensione	21.6	12.8	8.8
Sëmundje	0.3	0.2	0.1
Barrë lindje	1.4	0.8	0.6
Aksidente në punë	0.3	0.3	0
Papunësia	0.9	0.9	0
Totali i sigurimeve shoqërore	24.5	15	9.5
Sigurimi shëndetësor	3.4	1.7	1.7

Në lidhje me këtë degë ndryshimet e reja lidhen me mënyrën e llogaritjes së përfitimit për sëmundje dhe barrë lindje. Më parë, përfitimet nga këto dy degë llogariteshin referuar, pagës mesatare të vitit të fundit kalendarik. Me ndryshimet e reja, referenca e llogaritjes së përfitimit do të jetë paga mesatare neto e 12 muajve të fundit kalendarik.

Kjo do të bënte që të ardhurat për barrë lindje dhe sëmundje për personat e siguruar të zëvendësojnë ardhurat neto të tyre në masë 80 dhe 70% respektivisht, ndërkohë që për gratë e vetëpunësuarat e ardhura për barrë lindje të mos jetë më e vogël se 65% të pagës minimale neto. Nëse në të ardhmendo të mund të reduktohen këto përfitime do të shmangë nevojën për rritjen e normës së kontributit ndërkohë që do të zbatohet një zëvendësim më të drejtë të të ardhurave të munguara.

Grupet e prekura nga këto ndryshime janë individët e siguruar sitë punësuar që kanë të ardhura më të larta se paga minimale, pasi për të vetëpunësuarit përfitimet për barrë lindje nuk mund të jenë më të vogla se 65% e pagës minimale neto.

Megjithatë vlen të theksohet se ndërsa të vetëpunësuarit i paguajnë kontributet për këto degë nga të ardhurat e tyre, kontributet e personave të punësuar ndahen midis tij dhe punëdhënësit në raportin 1:2 dhe një rritje e normës së kontributit do të sillte rrjedhimisht rritjen e kostos së punës.

Një tjetër problem i rëndësishëm i skemës ka qenë diferenca e ulët ndërmjet masës së pensionit në zonat urbane dhe rurale. Pavarësisht përpjekjeve që janë bërë, sidomos në vitin 2000 e në vazhdim, për rritjen

e pensioneve si dhe për ngushtimin e diferencave mes pensioneve të lidhura me legjislacionin para dhe pas vitit 1993, shkalla e zëvendësimit të pensionit, ose raporti i pensionit ndaj pagës, mbetet ende e ulët në 33.4% dhe me prirje të qarta drejt përkeqësimit.

Për sa më sipër mbërrijmë në përfundimet se:

Ndryshimet e skemës do të sjellin rivendosjen e parimit të kontributiv dhe forcimin e tij. Në skemën e ndryshuar parashikohet ripërcaktimi i formulës së përlogaritjes së pensionit, duke zëvendësuar pensioni bazë me pensionin social dhe duke rritur atë pjesë të pensionit që lidhet drejtëpërdrejt me madhësin dhe vitet e kontributeve të paguara. Ky ndryshim do të rrisë peshën e pjesës së pensionit që merr për bazë pagën mbi të cilën ka kontribuar gjatë jetës, si dhe gjatësinë e periudhës së sigurimit (vitet e sigurimit). Kështu për personat që kanë kontribuar më gjatë në skemë ose kanë kontribuar me paga të larta, masa e pjesës kontributive të pensionit do të jetë më e madhe, duke krijuar një lidhje më të drejtë midis kontributit të paguar ndër vitet dhe pensionit.

Ky ndryshim i mënyrës së llogaritjes do të shoqërohet edhe me eliminimin e dy kufizimeve duke lënë si pension që do të përfitohet vetëm masa e pensionit që del nga llogaritja sipas formulës. Sipas kësaj formule për personat që kanë kontribuar me paga mbi pagën mesatare, masa e pensionit do të rritet në nivele të pranueshme ndaj pensioneve aktuale dhe bazuar në shumat më të mëdha të dredhura si kontribut.

Pensionistët që do të dalin në pensione nga viti 2015 dhe për një periudhë afatmesme, do të kenë një rritje të moderuar të masës së pensionit, krahasuar me pensionistët aktualë. Ndërsa në periudhën afatgjatë, për personat që kontribuojnë me paga më të larta, pensionet do të jenë më të qënësishme dhe të mbështetura mbi pagat e tyre relae, të deklaruara në listpagesa dhe të indeksuar sipas rregullave të qarta dhe të qëndrueshme, të cilët do të japin një bazë të vlerësuar më të lartë e për rrjedhojë një masë më të madhe, për pjesën kontributive të pensionit (shtesa në formulë).

KAPITULLI **VI**

- 6.1 KONKLUZIONE
- 6.2 REKOMANDIME

KAPITULLI VI

6.1 KONKLUZIONE

Duke analizuar punimin “ Analiza e sistemit të sigurimeve shoqërore në kundërshkrimin juridik dhe ekonomik” kemi arritur në disa konkluzione përfundimtare, që do të ndahen me lexuesin e punimit.

- ✓ Nga studimi i të gjitha etapave të zhvillimit ekonomik historik, arrijmë në konkluzionin se lindja e këtij sistemi ka pasur si qëllim ardhjen në ndimë të popullsisë, në rastet e prekjes nga rreziku social. Të gjitha ndryshimet e këtij sistemi, si nga mënyra e financimit, fusha e mbulimit dhe ajo e subjekteve, ashtu edhe nga llojet e përfitimit kanë ardhur si domosdoshmërin e nevojës së subjekteve pjesmarrës në skemë.
- ✓ Studimet sociologjike zënë një vend të rëndësishëm në shkencën e sigurimeve shoqërore, nëpërmjet kësaj analize kontrollohen të gjithë faktorët e brendshëm e më të rëndësishëm, që ndikojnë drejtëpërdrejt në këtë sistem. Metodatat e studimit si ajo kuantitative, kualitative dhe historiko-krahasuese gjejnë një përdorim të gjerë në analizën e elementëve të sistemit të sigurimeve shoqërore. Trajtesat teorike të cilat kanë avancuar për të treguar zhvillimin e shtetit social, tregojnë rolin e këtyre teorive në përcaktimin e tezave bazë të krijimit të strukturës së shtetit social.
- ✓ Zbatimi në praktikë i parimeve bazë, u krijon shtetasve mundësin që ta njohin këtë sistem, të trajtohen në mënyrë të barabartë, të përfitojnë ndihma të kombinuara, me qëllim plotësimin sa më mirë të nevojave të tyre. Gjithashtu nëpërmjet parimeve realizohet më së miri garancia ligjore, që ka për qëllim zbatimin e të drejtave të njeriut dhe garancia ekonomike, e cila ka për qëllim përfitimet monetare të vazhdueshme nga ky sistem. Eksporti i përfitimeve është një parim bazë i rëndësishëm në kushtet e aderimit në familjen e madhe Europiane.
- ✓ Mbështetja në legjislacionin ndërkombëtar dhe atë Eurpoian dhe referimi në vendimet e gjykatës Eurpoiane të të drejtave të njeriut, luan rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin dhe përsosjen e mëtejshme të këtij sistemi në praktikë, duke u bërë një mekanizëm i rëndësishëm, jo vetëm në përmirsimin e këtij sistemi në drejtimin të funksionimit dhe organizimit të tij, por edhe në drejtim të subjekteve përfituese. Kjo për shkak se nëpërmjet këtyre burimeve ndryshojnë disa elementë të rëndësishëm që lidhen me drejtimin, organizimin dhe funksionimin e skemës, si dhe masën e përfitimit të subjekteve.
- ✓ Roli i akëtorve të ndryshëm social të përfshirë në sigurimin e të ardhurave dhe mbrojtjen sociale, duke filluar nga familja dhe rrjetet lokale të solidaritetit të komunitetit ndërkombëtarë. Qeveria qendrore, punëtorët dhe punëdhënësit përbëjnë partnerët kryesorë, por ky partneritet do të duhet të zgjerohet për ta bërë sigurimin social më efektiv dhe për të nxitur mbrojtjen sociale për punëtorët me të ardhura të ulëta nga vetëpunsimi dhe ekonomia informale. Ka nevojë për lidhje të përmirsuara në mes të pushtetit qendror dhe lokal, në mes të minsitrive të ndryshme dhe institucioneve që bashkrendojnë punën për sigurimet shoqërore si: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financës dhe Shëndetësis, etj. Një rol i rëndësishëm do të duhet të luhet nga qeveria

lokale, nga shoqatat që përfaqësojnë drejtpërdrejt punëtorët në ekonomin informale (si kooperativat, shoqërit e përfitimit të ndërsjellë nga komunitetet) atj. Përveç kësaj mund të ketë vend për partneritet me institucionet financiare private, për shembull në rastin e skemave të sigurimeve shoqërore që krijojnë shërbime të menaxhimit të investimeve, apo të skemave të mikrosigurimeve që kanë nevojë risigurimi dhe shërbime të tjera të specializuara.

- ✓ Përsosja e sistemit të sigurimeve shoqërore varet ndjeshëm dhe nga aftësia shtetërore për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale, aderimin në kovenatat apo organizatat ndërkombëtare. Këto marrdhënie ndërkombëtare, me ndikimin e tyre, ofrojnë përsosjen e mëtejshme të këtij sistemi, si dhe krijojnë mundësi të përqsjes së legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar.
- ✓ Në lidhje me kapitullin e tretë për çështjet e barazisë gjinore në përfundim, është e qartë se ndërsa gjinia është një çështje shumë e rëndësishme në lidhje me zhvillimin, strukturën aktuale dhe të ardhmen e shteteve sociale, ajo mbetet disi periferike te teoria e shtetit social. Në të vërtetë, çështja gjinore rrallë janë në qendër të debateve rreth reformave të vazhdueshme sociale, edhe pse shumë prej këtyre reformave kanë implikime të rëndësishme gjinore. Ekziston një nevojë e qartë për një zhvillim të mëtejshëm të instrumenteve gjinore, në shërbim të analizës edhe përdorimit të masave të tilla gjinore, në diskutimet e politikave shtetërore sociale.
- ✓ Sistemi i sigurimeve shoqërore nuk mund të jetë një sitem thjesht torik. Shteti duhet të harrojë të mabjë parasysh se si përballet me sfida të rëndësishme demografikë, ekonomikë, politikë dhe sociale. Luhatja e këtyre faktorëve ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në prishjen e ekuilibrave financiare të skemës, si në momentin e mbledhjes së kontributeve, shpërndarjes së të ardhurave, ashtu edhe në momentin e llogaritjes së shpenzimeve të skemës.
- ✓ Skema DB e financimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, linte për të dëshiruar nga pikëpamja e përfitimeve. Në parim mënyra e llogaritjes së përfitimit të pensionit të pleqërisë, merret parashysh numrin e viteve të sigurimit, e rrjedhimisht u jep pension më të madh atyre që kanë kontribuar më shumë në skemën e sigurimeve shoqërore. Kufiri maksimal i pensionit, duke qenë taksativ, por edhe kufizimi i llogaritjeve me 75 përqind të pagës mesatare neto, faktikisht e dobëson vartësin e përfitimeve nga madhësia e kontibuteve dhe lidhjen midis tyre. Ndërsa në nivelin minimal arrihet një shkallë zëvendësimi pension/ pagë neto prej 75%. Ky raport për shkak të kufizimit nga tavan i pensionit maksimal, gjithmonë tenton të shkojë drejt uljes dhe teorikisht për pagën maksimale mbetet në kufirin 35%. Kjo e bën sistemin pak nxitës për të kontribuar, për arsye se përfitimet janë të reduktuara prej limiteve maksimale.
- ✓ NDC-të janë një formë ndërtimi e një skeme pensionesh shtetërore, por jo forma e vetme e ndërtimit të tyre. Megjithatë, mbështetja e pensioneve NDC është plotësisht e logjikshme, koherente dhe një ide që mund të mbrohet.

- ✓ NDC-të mund të marrin forma të ndryshme. Rasti i parë. Sistemi i pensionit është një sistem NDC, plus një garanci minimale ose pensione të financuara nga tatimet, që mund të jenë ose fikse, ose me një komponent që lidhet me të ardhurat dhe një element NDC. Pensionet NDC bëjnë pak për të adresuar çështjen thelbësore të financimit. Rrënjët e problemit afatgjatë të paqëndrueshmërisë qëndrojnë në faktin se, pothuaj në të gjitha vendet, skemat e pensioneve përfshijnë një moshë pensionimi prej 60 deri në 65 vjeç, e cila mbetet në masën më të madhe fikse, ndërsa jetëgjatësia është në rritje.

6.2 REKOMANDIME

Sistemi i sigurimeve shoqërore është një sistem shumë delikat si nga qëllimi për të cilin ai është krijuar ashtu edhe në aplikimin e tij praktikë. Duke qenë një sistem relativisht i ri, i ndryshëm me të gjithë sistemet e mëparshme, nuk mund të themi se ai funksionon shkëlqyer, aq më tepër që me ndryshimet e fundit që i janë bërë sistemit të kontributeve, ende nuk dimë impaktin e tij tek individët.

Shumë probleme evidentohen në këtë sistem si në drejtim të mënyrës së funksionimit dhe organizimit të tij. Duke njohur mirë problematikat e këtij sistemi, është më e lehtë të propozohen edhe rrugët për përmirsimin e tij në të gjitha hallakt përbërëse, në mënyrë që të realizojë si duhet qëllimin për të cilin ai është krijuar. Ky punim ka evidentuar disa nga problematikat që janë konstatuar, ndaj në vijim do të jepen rekomandimet përkatëse në lidhje me to.

- *Rekomandojmë që duhet të bëhen më shumë projekte në lidhje me informimin e shoqërisë, për të mirat që sjell sistemi i sigurimeve shoqërore. Fushata informuese duhet të ofrojë më shumë informacion se çfarë përfitimesh kanë kontribuesit e skemës. Nëse kjo fuashtë do të bëhet më e fortë dhe më e shpeshtë, atëherë shoqëria do të ndërgjegjësohet për tu bërë kontribues në këtë sistem.*
- *Rekomandojmë se në marrjen e nismave për ndryshime në sistemin e sigurimeve, këtu u referohem edhe ndryshimeve aktuale që janë bërë në skemën e financimit të këtij sistemi, instrumentet shoqërore duhet të mbështeten në analiza kuantitative, kualitative dhe historiko-krahasuese. Politikat sociale janë mjaft deliakte, fakti që ato i shërbejnë subjekteve në kushtet e rrezikut social, i bëjnë subjektet të ndjeshme ndaj tyre. Prandaj në politikë e ndërmarrë pa një studim të mirëfilltë të faktorëve bazë dhe që rezulton negative, do të mund të silltet një gjndje të riparueshme të subjekteve pjesmarëse në skemë.*
- *Gjatë gjithë punimit është vënë re se skema e sigurimeve është e lidhur ngushtësisht me faktore ekonomike dhe demografike. Rezultati i reformave në lidhje me sistemin mbështet në analizat ekonomike dhe demografike me të dhëna statistikore të supozuara për afat të gjatë. Në fakt ndodh që sikur njëri nga elementët të mos funksionojë ose të shfaqë problem, atëherë do të ketë pikëpyetje të mëdha për skemën. Prandaj do të rekomandim krijimin e disa indikatorëve kontrollues, të ngritur me ligj, për të realizuar zbatueshmërinë dhe efektet e këtyre reformave.*

- *Informaliteti mbetet një plagë e rëndë për sistemin e sigurimeve shoqëror. Ne do të sugjeronim hartimin e një plani masash atraktive dhe jo shtrënguese. Masa atraktive mund të konsidrohen zgjerim i mbulimit me sigurime për subjektet pjesmarrës. Në lidhje me këtë do të rekomandonim:*
 - *Rritjen e periudhës së përfitimit të lejes së lindjes*
 - *Përfitimin e pagesës së lejes së lindjes të pandryshueshme gjatë gjithë periudhës së lejes*
- *Gjatë punimit një tematikë interesante ishte llogaria e përbashkët kontributive ndërmjet bashkëshortëve. Ashtu sikundër bashkëshortët ndajnë më njëri-tjetrin pasurin e vënë gjatë martesës, le të jetë kjo një formë e re dhe atraktive dhe e ndarjes së të ardhurave. Gjatë periudhës së akumulimit, kapitali i NDC-së i vënë përpara martese (ose ndonjë formë tjetër bashkëjetese, në varësi të legjislacionit të vendit) mund t'i mbetet individit, ndërsa kapitali i vënë gjatë martesës duhet të ndahet në mënyrë të barabartë midis bashkëshortëve.*
- *Ky kapital do të ruhet edhe në rast divorci dhe do të mbetet kapiatli i vetë individit, kur ai ose ajo martohet përsëri. Kjo gjë mund të vlejë edhe për bashkëjetesën. Për aq kohë sa bashkëjetesa rregullohet në Kodin e Familjes, vlen që ky nocion i ri të përfshihet edhe në skemë. Të mirat e këtij ndryshimi lidhen edhe me mbrojtjen e femarve në familje. Nëse një grua nuk punon por i shërben familjes do të ishte një mjet më shumë mbrojtës për pozitën e saj në rast divorci.*
- *Në pamje të parë skema e sigurimeve shoqërore duket se çdo gjë shkon perfekt, në lidhje me parimin e diskriminimit. Por në fakt, për aq kohë sa ekziston një disnivel i pensioneve ndërmjet zonave rurale dhe atyre urbane, pvarësisht arsyes, në këtë drjetin skema konsiderohet diskriminuese. Rritja e pensioneve të pensionistëve rural, ka një diferencë të ndjeshme me ritmet e rritjes së pagës mesatare.*
- *Niveli i jetesës rritet duke u bazuar në pagën mesatare. Duke iu referuar këtij fakti konstatoj se- shumica e pensionit që përfitojnë pensionistët rural, nuk do të jetë e mjaftueshme për të jetua. Pra stadarti i jetesës do të jetë i ulët krahasuar me pensionet, por i lartë krahasuar me pagat. Del detyrë e shtetit që të vërë dorë dhe të minimizojë këtë disnivel pagesash pensionesh.*
- *Me ndryshimet e skemës së sigurimeve shoqërore duhet të mbahet parasysh edhe një element i rëndësishëm ai i parimit të solidaritetit. Karakteristikë e këtij sistemi mbetet solidariteti i brezave, ku brezi i ri mbulon pagesat e brezit të vjetër. Jemi të mendimit se nisur nga e gjithë kjo periudhë e gjatë tranzicioni, shqipëria ka humbur ndjeshëm krahun e ri të punës. Nisur dhe nga situatë aktuale e emigrimit të pa kontrolluar brezi i mesëm rrezikon të ardhmen në lidhje me përfitimet në skemë.*
- *Për sa më sipër do të rekomandonim përgaditjen e strategjive afatshkurtra, bazuar në të dhënat reale demografike dhe jo hipotetike. Kjo do të ndihmonte*

ndjeshëm për të pasur panoramë reale në lidhje me parashikimin e kontribuesve të ardhshëm të skemës. Kështu do të kemi një tablo të qartë të problematikave që mund të hasen gjatë harimit të strategjive afatëshkurta, kjo do të na ndimonte në marrjen e masave të menjëhershme të parandalimit të fenomeneve negative.

- *Nëse do ti referohemi mënyrës së llogaritjes së përfitimeve për barrëlindje formulat për llogaritjen e tyre kanë si qëllim që për këtë kategori zëvendësimi i të ardhurave bëhet në masën 80% dhe 70%. Ndërsa për të vetëpunësuarat në bujqësi ligji ka parashikuar se përfitimet e barrëlindjes për këtë kategori nuk duhet të jenë më poshtë se 65%. Vendosijen e kësaj diference në zëvendësimin me të ardhura ndërmjet kategorive pjesëmarrëse në skemë do ta konsideroja një formë diskriminimi brenda grupit. Fakti që ne kemi një shoqëri e cila ka tendencë të shkojë drejt plakjes, stimulimi i lindjeve duhet të jetë një fakt që duhet marrë në konsideratë. Vendosija e diferencave të tilla nuk e përmirson situatën.*
- *Në lidhje me pensionin social do të sugjeroja se moshë e përfitimit në 70% vjeç, është një moshë shumë e lartë referuar moshës mesatare të popullsisë. Sugjerimi ynë është se meqë në thelb pensioni social është përfitim për rrezikun e moshës së vjetër, nuk ka asnjë arsye që ai të mos jepet menjëherë me mbushjen e moshës për pension të caktuar nga ligji, pra 65 vjeç.*
- *Krijimin e skemave profesionale për të vetëpunësuarit në profesionet e rënda (miniera, etj)*

PYETËSOR

Në përfundim të këtij punimi kemi vendosur të paraqesim një përmbledhje të shkurtër të pyetësorit të realizuar me ndihmën e kompanisë IPKOS.

Qëllimi i hartimit të këtij pyetësori ka në fokus ofrimin e informacioni të raportit ndërmjet shoqërisë dhe skemës së sigurimeve shoqërore. Sa e njëj shoqëria ekzistencën e kësaj skeme dhe përfitimet që rrjedhin prej saj?

Idea për të hartuar këtë pyetësor lindi gjatë analizës së temave të punimit. Fakti që gjatë trajtimit të punimit ballafaqoheshim me problematikat që përballëj skema, natyrshëm lindën pyetjet e mësipërme dhe përgjigja më e mirë e tyre ishte hartimi i pyetësorit për të parë gjëndjen reale të mentalitetit të shoqërisë sonë në lidhje me këtë sistem.

Popullata e studimit

Ky studim është realizuar me 1040 qytetarë të Tiranës të grupmoshës 18-46 vjeç, përkatësisht 599 femra dhe 599 meshkuj

Kampioni i studimit u përzgjedh nëpërmjet përzgjedhjes të probabilitetit të kombinuar fazash stratifikimi

Metodologjia e studimit

Pjesëmarrësit u pyeten nëpërmjet intervistave ballë për ballë, të cilat u realizuan në shtëpitë e tyre.

Një pyetësor i dizenuar me pyetje të mbyllura u përdor për të mbledhur të dhënat e nevojshme. Paraprakisht përgjatë periudhës Dhjetore 2013 u realizuan 4 fokus grupe me qytetarë të Tiranës (meshkuj dhe femra) për të hulumtuar paraprakisht mbi njohuritë e sigurimeve shoqërore. Si rezultat i studimit kualitativ, u hartua edhe pyetësori sasior/kuantitativ për marrjen e informacionit në fusha të përcaktuara.

Intervistat u realizuan përgjatë Shkurt 2014.

Rezultatet e studimit

Arsimi i pjesëmarrësve

Në përgjithësi, pjesa dominante e pjesëmarrësve të intervistuar kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional

Përkatësisht, 40.4% e pjesëmarrësve (si meshkuj dhe femra) kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional 4 vjeçar, e shoqëruar me 11.8% të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional 3 vjeçar.


Ndërkohë që 15.1% e pjesëmarrësve (si meshkuj dhe femra) kanë ndjekur ose janë duke përfunduar arsimin e lartë/ universitet dhe kryesisht ata që u përkasin zonave urbane (12%)

Ndërkohë që pjesa më dominante e pjesëmarrësve të intervistuar në vendbanimet jo urbane të qytetit të Tiranës kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm (8 vjeçar)

Gjithashtu, të dhënat e tableës të detajuara si më poshtë në përqindje, paraqesin diferencat midis meshkujve dhe femrave të intervistuar lidhur me arsimin e tyre.

Sic vihet re, ka më shumë meshkuj të cilët kanë përfunduar arsimin profesional 3 vjeçar (15%) dhe më shumë femra të cilat kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8 vjeçar (27%)

Grafiku 1. Të dhënat në përqindje të meshkujve dhe femrave lidhur me arsimin



Njohuritë mbi sigurimet shoqërore


Sa të mirëinformuar jeni ju rreth sigurimeve shoqërore në Shqipëri?

Të intervistuarit janë të informuar në nivele të ndryshme me skemen e sigurimeve shoqërore, megjithatë rezultatet tregojnë se në përgjithësi niveli i informacionit mbi sigurimet shoqërore nuk është i mjaftueshëm ose në nivele shumë të ulta.

Vetëm 53% e pjesëmarrësve të intervistuar kishin sigurime shoqërore ndërkohë që 47% e tyre nuk kishin sigurime shoqërore dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre punonin “në të zezë”

Në total, rreth 35% e të intervistuarve u shprehën se ishin të painformuar mbi skemen e sigurimeve shoqërore ose nuk kishin dëgjuar prej tyre, ndërkohë që po 35% deklaruan se kishin informacion të mjaftueshëm dhe 30% e të intervistuarve, rezultoi se ishin disi të informuar rreth skemës së sigurimeve shoqërore.

Grafiku 3. Niveli i informimit në lidhje me sigurimet shoqërore nga pjesëmarrësit në total




Gjysma e pjesëmarrësve që kanë sigurime shoqërore u shprehën se janë të informuar mirë ose shumë mirë rreth skemës. Po kështu rreth gjysma e atyre që nuk kanë sigurime shoqërore pohojnë se nuk kanë dëgjuar kurrë apo janë pak të informuar rreth skemës së sigurimeve shoqërore.

Vetëm 16% e pjesëmarrësve në total u shprehën se ishin të kënaqur me

skemën e sigurimeve shoqërore, ndërkohë që 40% e tyre u shprehen të pakënaqur dhe pjesa më e madhe (44%) deklaruan të qenët neutralë “as të kënaqur dhe as të pakënaqur”

Grafiku 4. **Niveli i kënaqësisë ndaj skemës së sigurimeve shoqërore**

Sa të kënaqur jeni me sigurimet shoqërore?




Cilat kategori të individëve janë të siguruar/ ose mund të sigurohen në Shqipëri?

Të punësuarit formalisht dhe të vetë-punësuarit janë sipas të intervistuarve kategoritë e qytetarëve që mund të sigurohen/ose janë të siguruar në Shqipëri.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, 95 % u shprehen se janë pikerisht të punësuarit formalisht/zyrtarisht ata që janë të siguruar apo mund të sigurohen dhe gjithashtu në mënyrë relevante 67 % e të intervistuarve pranonin se edhe të vetëpunësuarit mund të hyjnë te kategoria e personave që përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore apo mund të bëhen pjesë e saj.

Më pas vijjnë me rradhë kategoritë e tjera të identifikuara, të cilat zenë një përqindje shumë më të ulët për sa l perket perceptimit të të intervistuarve rreth përfshirjes së tyre në skemën e sigurimeve shoqërore ku bien në sy fakti se vetëm 18 % e të intervistuarve mendojnë se të punësuarit në të zezë janë apo mund të bëhen pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore dhe vetëm 4% e pjesëmarrësve në studim, mendojnë se shtëpiaket mund të sigurohen apo janë të siguruar.


Grafiku 5. **Perceptime mbi kategoritë e siguruarat në Shqipëri**



Sic mund të vihet re nga grafiku i mëposhtem, si të intervistuarit që kanë sigurime shoqërore dhe ata që nuk kanë mendojnë gati të gjithë se të punësuarit formalisht janë kategoria kryesore e individëve të siguruar në Shqipëri. Një vend të rëndësishëm zënë të vetëpunësuarit që njihen në masë (si nga të intervistuarit me dhe nga ata pa sigurime shoqërore) si kategoria që janë të siguruar apo mund të sigurohen në Shqipëri.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet raporti mes të pasurit apo jo sigurime shoqërore me përshtypjet mbi kategoritë e personave që janë të siguruar apo mund të sigurohen në Shqipëri.

Grafiku 6. Raporti mes të pasurit apo jo sigurime shoqërore me përshtypjet mbi kategoritë e personave që janë të siguruar/ apo mund të sigurohen në Shqipëri.




Kush i paguan sigurimet për personat e punësuar?

Ekziston një larmi opinionesh rreth faktit nëse është vetëm punëdhënësi apo edhe vetë punonjësi që mund të paguajë sigurimet shoqërore. Niveli i saktë i informacionit mbi funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore mungon në përgjithësi te pjesëmarrësit.

Të ndarë gati në mënyrë të barabartë, 44 % e tyre mendojnë se sigurimet shoqërore i paguan dhe punëdhënësi edhe punëmarrësi, 43 % e tyre mendojnë se kjo është kompetencë apo mundësi vetëm e punëdhënësit, ndërkohë që pjesa e mbetur pra 13% mendojnë se është vetë punonjësi ai që paguan sigurimet e tij shoqërore.

Grafiku 7. Niveli i informacionit lidhur me kontributet shoqërore nga punëdhënësi dhe punëmarrësi




A e lejon ligji punonjësin të zgjedhë nëse ai/ajo do të sigurohet ose jo?

Ekziston një opinion mbizotërues mes të intervistuarve sipas të cilit legjislacioni aktual në Shqipëri nuk e lejon punonjësin të zgjedhë nëse do të sigurohet ose jo.

80% e të intervistuarve i janë përgjigjur që nuk ka mundësi zgjedhje dhe vetëm 20% e tyre mendojnë se ligji e lejon personin e punësuar të zgjedhë nëse do ose jo të sigurohet.


Grafiku 8. Perceptimi mbi legjislacionin aktual lidhur me zgjedhjen për sigurimet shoqërore



A mund të zgjedhë punonjësi në cilin fond ti paguhet siguracioni?

Duket se qytetarët nuk e kanë të qartë nëse i punësuar mund të zgjedhë apo jo fondin ku mund të derdhen sigurimet e tij shoqërore. Rreth gjysma besojnë që kjo gjë mund të realizohet, ndërkohë që pjesa tjetër, rreth 53% nuk besojnë se kjo mund të ndodhë.

Grafiku 9. Perceptimi mbi zgjedhjen e pagesës së sigurimeve shoqërore




Çfarë lloj fondesh për sigurimet shoqërore ekzistojnë sot në Shqipëri?

Qytetarët e intervistuar gjithashtu nuk janë të sigurtë apo njëlloj të informuar mbi tipet e fondeve që ekzistojnë dhe të disponueshme në fushën e sigurimeve shoqërore.

Rreth 2/3 besojnë se ka edhe fonde shtetërore edhe private në Shqipëri, ndërkohë që çereku i tyre njih vetëm ekzistencën e fondeve shtetërore.

5 % e të intervistuarve mendonin se ekzistonin vetëm fondet private të sigurimeve shoqërore dhe po caq nuk kishin asnjë lloj informacioni rreth llojeve të fondeve ekzistuese për sigurimet shoqërore në Shqipëri.

Grafiku 10. **Fondet e disponueshme në Shqipëri për sigurimet shoqërore**




Si shpenzohen paratë e mbledhura nga sigurimet shoqërore sipas jush?

Perceptimi i qytetarëve të Tiranës, pjesëmarrësve në këtë studim është që paratë e përftuara nga sigurimet shoqërore, shpenzohen për qytetarët kryesisht në pensione, së dyti në sistemin shëndetësor dhe së treti për përfitime sociale.

Përkatësisht, rreth 74% besojnë se këto para shkojnë për të paguar pensionet, 49% e të intervistuarve mendojnë se shkojnë për sistemin shëndetësor, 46% se shkojnë për ndihmat sociale, çereku I të intervistuarve mendojnë se humbasin në korrupsionin qeveritar dhe është 9% pjesa e të intervistuarve që nuk ka asnjë ide rreth mënyrës se si shpenzohen paratë e grumbulluara nga sigurimet shoqërore

Grafiku 11. **Perdorimi i fondeve të grumbulluara nga sigurimet shoqërore**



Eksperiencia me sigurimet shoqërore

Cfarë statusi punësimi keni ju?

Vetëm 53% e pjesëmarrësve të intervistuar kishin sigurime shoqërore ndërkohë që 47% e tyre nuk kishin sigurime shoqërore.

Në përgjithësi, gati të gjithë të intervistuarit, qytetarë të Tiranës të moshës 18 deri në 46 vjeç janë duke punuar, por me statuse të ndryshme punësimi: 35 % janë të punësuar jo-formalisht (në të zezë), 33% janë të vetë-punësuar dhe 32% e tyre janë të punësuar formalisht, zyrtarisht. Vetëm 1% e të pyeturve deklaruan se ishin aktualisht të papunë.


Grafiku 12. Punësimi i pjesëmarrësve të intervistuar (në total)



A keni ju sigurime shoqërore për momentin?


Më shumë se gjysma e të intervistuarve që i perkasin grupmoshës 18-24 vjec, janë të punësuar në mënyrë joformale (pra në të zezë). Kjo tendencë bie disi në grupmoshat e tjera dhe vihet re se përgjithësisht mbi 30% e të intervistuarve të punësuar që janë mbi 24 vjec, janë të punësuar formalisht/zyrtarisht. Ndër të punësuarit mbi 40 vjec vihet re se rreth gjysma e tyre janë të vetëpunësuar.

Grafiku 13. Statusi i punësimit sipas grupmoshave



Në përputhje më të dhënat e studimit, 63% e të intervistuarve të punësuar të grupmoshës 18-24 vjec nuk kanë sigurime shoqërore. Po kaq përqind e të punësuarve mbi 40 vjec kanë sigurime shoqërore. Në dy grupmoshat e tjera brenda këtij intervali (pra 24-40 vjec) më shumë se gjysma e të intervistuarve të punësuar (58%) kanë sigurime shoqërore.

Grafiku 14. Sigurimet shoqërore sipas grupmoshave të pjesëmarrësve të intervistuar




Pse nuk keni sigurime shoqërore?

Baza: Ata që nuk kanë sigurime shoqërore (47% e popullatës së kampionuar)

Një pjesë e të intervistuarve që nuk kanë sigurime shoqërore, rreth 56% e tyre, deklarojnë se nuk mund të kenë sigurime shoqërore për shkak se nuk plotësojnë kushtet për këtë gjë. Pjesa tjetër, 44% e tyre, shprehet se mund t'i ketë sigurimet shoqërore por nuk i paguan ato.


Grafiku 15. Arsyet e përfitimit të sigurimeve shoqëror



Vihet re se pjesa më e madhe e të punësuarve ligjërish që nuk kanë sigurime shoqërore, pohojnë se nuk mund t'i përfitojnë sigurimet shoqërore për mosplotësim të kushteve, ashtu si dhe në mënyrë të kuptueshme vlen e njëjta gjë edhe për ata që janë të papunë apo në rrethana të tjera.

Për sa i perket kategorisë së të vetëpunësuarve që nuk kanë sigurime shoqërore, rreth 60% e tyre shprehen se mund t'i kenë sigurimet shoqërore por zgjedhin të mos i paguajnë ato.

Grafiku 16. Arsyet e mospërfitimit të sigurimeve shoqëror në raport me statusin e punësimit



Pse nuk paguani sigurime shoqërore?

Baza: Ata që mund ti kenë por nuk i paguajnë sigurimet shoqërore (21% e popullatës së kampionuar)


Motive të ndryshme u pohuan nga pjesëmarrësit lidhur me kontributet për skemën e sigurimeve shoqërore.

Rreth 30% e atyre që mund t'i kenë, por që aktualisht nuk paguajnë sigurime shoqërore shprehen se punëdhënësi nuk pranon t'ia paguajë

kontributet e sigurimeve shoqërore.

Një pjesë tjetër, 16% e po kësaj kategorie, shprehen se i kanë kërkuar punëdhënësit të mos paguajnë sigurime shoqërore, dhe ndërkohe ti marrin ato si para në dorë. Më shumë se gjysma e të intervistuarve të kësaj baze, shprehen se kjo vjen si pasojë e arsyeve të tjera të cilat lidhen me kostot, situatën financiare dhe pamundësinë ekonomike për t'i paguar.

Grafiku 17. Arsyet e mospagimit të sigurimeve shoqërore.




Nga studimi vihet re se kategoria e atyre janë të punësuar ligjërisht (dhe që i përkasin bazës së mësipërme të kampionit), asnjë nuk referon se i ka kërkuar punëdhënësit që të mos paguajnë sigurime dhe tu jap atyre para në dorë. Ndërkohë që pjesa dërrmuese (86%) referon se punëdhënësi nuk do që t'ua paguajnë sigurimet shoqërore në fondin përkates. Një pjesë e vogël e tyre shprehet se ka arsye të tjera që i cojnë të mos paguajnë sigurimet shoqërore.

Mes të vetëpunësuarve që mund ti kenë sigurimet shoqërore, por nuk i paguajnë ato, një përqindje e lartë (86% e tyre) shprehet se arsyet e mospagimit të sigurimeve shoqërore nga ana e tyre nuk lidhen me punëdhënësin por me arsye të tjera.

Ndërkohë që gjysma e kategorisë së të papunëve dhe të tjerëve që i përkasin bazës së mësipërme referojnë se punëdhënësi nuk pranon të paguajë për ta sigurimet shoqërore, dhe gjysma e tjetër, gati në mënyrë të barabartë referojnë për dy arsyet e tjera.

Grafiku 18. Arsyet e mospagimit të sigurimeve shoqërore sipas statusit të punësimit



Pse keni vendosur kështu?


Baza: Ata që i kanë kërkuar punëdhënësit mos ti paguajnë sigurimet për ta por tu jape atyre para (3% e popullatës së kampionuar)

Të intervistuarit e punësuar të cilët u kishin kërkuar punëmarrësve të tyre që të merrnin paratë në dorë, në vend që këto të derdheshin për sigurimet shoqërore, e kanë zgjedhur këtë opsion për shkak të kostove të larta të sigurimeve shoqërore dhe jo sepse nuk kishin nevojë apo nuk e vlerësojnë rendësinë e sigurimeve shoqërore.

Rreth 90% e të intervistuarve që nuk paguajnë sigurime shoqërore por marrin para në dorë, nuk i paguajnë ato për shkak të pamundësisë ekonomike.

Janë vetëm 9 % e atyre që nuk paguajnë sigurime të cilët pranojnë se nuk i shohin aspak të nevojshme sigurimet shoqërore.

Grafiku 19. Arsyet e mospagimit të sigurimeve shoqërore (për punëmarrësit që kanë kërkuar para në vend të derdhjes së kontributeve)




Një përqindje e vogël në rradhët e meshkujve po ashtu edhe femrave të kësaj kategorie, pohojnë se nuk kanë nevojë për sigurime shoqërore.

Më shumë se gjysma e meshkujve të kësaj kategorie pohojnë se kontributet janë në shuma të mëdha për t'u paguar dhe se do t'i paguanin po të ishin më të ulëta.

Rreth 2/3 e femrave të kësaj kategorie, pohojnë se kontributet nuk janë shumë të larta për t'u paguar, por se nuk kanë mjaftueshëm para për t'i paguar ato.

Grafiku 20. Arsyet e mospagimit të sigurimeve shoqërore por marrjes së parave në dorë sipas gjinisë




Nqs ju mund të zgjidhni ti paguani sigurimet shoqërore, ose mos ti paguani ato por të merrni para shtesë nga punëdhënësi "cash", në vend të sigurimeve, cilën do të zgjidhni?

Baza: Ata që nuk mund të kenë sigurime shoqërore (47% e popullatës së kampionuar)

Shumica e të punësuarve që nuk kanë sigurime shoqërore (më shumë se 2/3), do të zgjidhnin kryesisht alternativën e sigurimeve shoqërore, përkundrajt asaj të parave kesh.


Grafiku 20. Preferencat midis pasjes së sigurimeve shoqërore përkundrajt marrjes së parave "cash"



Të marrë të gjitha së bashku, për sa vjet gjithsej keni paguar sigurimet shoqërore?

Në përputhje më të dhënat e mbledhura nga studimi, shumica e qytetarëve, ka më pak se 11 vjet sigurime shoqërore të paguara ose pa sigurime shoqërore të paguara ndonjëherë.

Vetëm 26% kanë paguar sigurime shoqërore përgjatë 4 vjeteve dhe një pjesë e konsiderueshme (rreth 37%) nuk kanë paguar kurrë sigurime shoqërore




Numri mesatar i viteve: 7.5

Në të dhënat e ilustruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re se mes atyre që paguajnë tashmë sigurime shoqërore, pjesa më e madhe e tyre i kanë paguar për gati 10 vjet. (39 % e tyre për 1-4 vjet dhe 35 e tyre për 5-10 vjet). 16 % e tyre i kanë paguar për 11-20 vjet dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (4%) duket se janë brenda skemës së sigurimeve shoqërore për një kohë më të vogël se 1 vit.


Në kategorinë e popullatës së intervistuar që nuk ka aktualisht sigurime shoqërore vihet re se një pjesë shumë e madhe e tyre, gati 3/4, nuk kanë paguar kurrë sigurime shoqërore. Ata që kanë kontribuar për kohën 1-4 vjet dhe 5-10 vjet zënë përkatësisht nga 11% të kategorisë së atyre që nuk paguajnë aktualisht sigurime shoqërore. Vetëm 4% e kategorisë që nuk paguan aktualisht sigurime shoqërore i ka paguar ato për një periudhë 11-20 vjet.

Grafiku 21. **Sigurimet shoqërore sipas viteve**



Për sa kohë keni punuar ju pa paguar sigurimet?

Vetëm 1/3 e punonjësve kanë paguar sigurime gjatë gjithë kohës që kanë punuar, kurse të tjerët kanë kryesisht deri në 10 vjet punë pa sigurime.




Numri mesatar i viteve: 5.5

Në përputhje më të dhënat e detajuara në grafikun e mëposhtëm rezulton se rreth 60% e të intervistuarve të cilët janë aktualisht të siguruar, i kanë paguar gjithmonë sigurimet shoqërore. Rreth 1/4 e tyre kanë punuar për 1-4 vjet pa paguar sigurime, 13% e tyre kanë punuar pa sigurime shoqërore për 5-10 vjet. Vetëm 2% e tyre ka punuar mbi 11 vjet pa sigurime shoqërore.

Në grupin e atyre që nuk kanë aktualisht sigurime shoqërore vërehet se gjysma e tyre kanë punuar për 1-4 vjet pa sigurime shoqërore, 1/3 e tyre ka punuar pa sigurime shoqërore për 5-10 vjet. 13% e atyre që nuk

paguajnë aktualisht sigurime shoqërore kanë punuar të pasiguruar për mbi 11 vjet. Vetëm 5% e tyre kanë paguar gjithmonë sigurimet shoqërore kur kanë punuar.




Sa të kënaqur ose jo, jeni ju sot me skemën e sigurimeve shoqërore në Shqipëri?

Ka më shumë qytetarë të intervistuar, të cilët nuk janë të kënaqur me skemën e tanishme të sigurimeve shoqërore.

Vetëm 16% e pjesëmarrësve në total u shprehën se ishin të kënaqur me skemën e sigurimeve shoqërore, ndërkohë që 40% e tyre u shprehën të pakënaqur dhe pjesa më e madhe (44%) deklaruan të qenët neutralë “as të kënaqur dhe as të pakënaqur”


Grafiku 22. Niveli i kënaqësisë ndaj skemës së sigurimeve shoqërore



Nga analiza studimore, vërehet se pjesëmarrësit të cilat janë të kënaqur me skemën e tanishme, janë rreth 16%, deri diku në përqindje të njëjtë pavarësisht grupmoshave. Ndërkohë, që për sa i përket të pakënaqurve ndaj skemës aktuale të sigurimeve shoqërore vihet re një rritje progresive e tyre sipas grupmoshave, duke u luhatur nga 31-51% .

Përkatësisht kategoria e pjesëmarrësve të pyetur mbi moshën 40 vjec, shprehen si më të pakënaqur nga skema e sigurimeve shoqërore.

Grafiku 23. Niveli i kënaqësisë ndaj skemës së sigurimeve shoqërore në raport me grupmoshat e pjesëmarrësve



Cilat janë problemet kryesore sot me sigurimet shoqërore sipas jush?


Sipas të dhënave, problemet kryesore me sigurimet shoqërore raportohen të jenë : kontributet e larta, përfitimet e ulta, ekonomi dhe vende pune jo-stabël dhe korrupsioni.

Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve të intervistuar referojnë si problem primar të skemës aktuale të sigurimeve shoqërore faktin që kontributet për t'u paguar janë të larta ndërkohë që përfitimet nga skema janë të ulëta. Rreth gjysma e të intervistuarve fajësojnë ekonominë e dobët dhe mos stabilitetin e vendeve të punës.

Një tjetër problem i identifikuar në masë (rreth 40% e të intervistuarve) është korrupsioni. Gati çereku i respondentëve identifikojnë si problem mungesën e transparencës në skemën aktuale të sigurimeve shoqërore dhe mungesën e informacionit në popullatë rreth saj.

Janë shumë pak ata mes të intervistuarve që mendojnë se nuk ka konkurrencë në fushën e sigurimeve shoqërore apo që mendojnë se skema nuk është funksionale.

Grafiku 24. Problematikat kryesore të skemës së sigurimeve shoqërore




A mendoni se skema ekzistuese e sigurimeve shoqërore, duhet të ndryshojë ose qendrojë njëloj?

Shumica e pjesëmarrësve të intervistuar (77%) shprehen se skema aktuale duhet të ndryshojë.

Logjikisht, rreth 90% e atyre që janë të pakënaqur ndaj skemës aktuale të sigurimeve shoqërore pohojnë që ajo duhet të ndryshojë. Interesant është dhe fakti që mes atyre që janë neutralë që do të thotë “as të kënaqur e as pakënaqur” me skemën, më shumë se 3/4 e tyre mendojnë që skema duhet të ndryshojë. Akoma më interesant është fakti që dhe mes atyre që janë shprehur të kënaqur ndaj skemës aktuale të sigurimeve shoqërore, shihet se gati gjysma e tyre mendojnë gjithashtu që kjo skemë ka nevojë të ndryshojë.

Grafiku 25. Perceptimet mbi ndryshimet në skemën e sigurimeve shoqërore



Si do të përshkruanit kontributet e tanishme për sigurimet shoqërore?


Gjysma e pjesëmarrësve të intervistuar (50%) i perceptojnë normat e tanishme të kontributeve si shumë të larta. Pjesa tjetër janë të ndarë gati përgjysmë në idetë se nuk janë mjaftueshëm të larta (23%) dhe janë tamam sic duhet të jenë (27%).

Mes kategorisë së të pakënaqurve nga skema vihet re se më shumë se 2/3 e tyre mendojnë se kontributet e tanishme për sigurimet shoqërore janë shumë të larta. Në kategorinë e atyre që janë "as të kënaqur e as të pakënaqur" shihet se rreth 40% e tyre i cilësojnë kontributet si shumë të larta. Më shumë se gjysma e tyre janë të ndarë në mënyrë të barabartë mes ideve se nuk janë mjaftueshëm të larta dhe janë tamam sic duhet të jenë.

Në kategorinë e atyre që janë të kënaqur nga skema bie në sy se vetëm 29% e tyre mendojnë se kontributet janë shumë të larta. Gjysma e tyre mendojnë se kontributet janë ashtu sic duhet të jenë.

Rreth 22% e tyre mendojnë se kontributet nuk janë mjaftueshëm të larta.

Grafiku 26. Vlerësim mbi nivelin e kontributit



Në opinionin tuaj, duhet që sigurimet shoqërore të jenë vullnetare apo të imponuara tek njerëzit?

Opinionet janë pothuajse gati të ndara përgjysmë mbi faktin nëse sigurimet shoqërore duhet të jenë vullnetare apo të imponuara tek njerëzit, me një avantazh shumë të lehtë të atyre që mendojnë se duhen imponuar.


53% e të intervistuarve mendojnë se kontributet duhet të imponohen, ndërkohë që 47% mendojnë që ato duhet të jenë totalisht vullnetare.

A duhet që norma e kontributit të jetë e përcaktuar, apo personi të ketë mundësi të zgjedhë vetë nivelin e normës që do të paguajë (përfitimet do të vareshin nga niveli i normës së paguar në këtë rast)

Gjithashtu, opinionet janë pothuajse të ndara përgjysmë, nëse norma e kontributit duhet të përcaktohet, apo t'i lihet në dorë vetë personit që t'a zgjedhë atë. Gjithësesi vihet re se me një diferencë të lehtë janë në shumicë (58%) ata që mendojnë që duhet të jetë e përcaktuar, përkundrajt atyre (42%) mendojnë që niveli i kontributit duhet të zgjidhet vetë.

Nqse ju vetë mund të zgjidhni, do ti paguanit sigurimet shoqërore në fondin shtetëror, apo në një fond privat?

Pjesa dërrmuese e qytetarëve të Tiranës të intervistuar do zgjidhnin fondin shtetëror për të derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore kundrejt atyre private.



Pse do ta zgjidhnit fondin shtetëror ose privat?

Në të dyja rastet, si atë të zgjedhjes së fondit privat ose shtetëror, dy arsytet relevante (dhe jo në diferenca të dallueshme nga njera tjetra) janë siguria dhe besueshmëria.

- *Arsyet kryesore për zgjedhjen e fondit shtetëror janë, para së gjithash, siguria e këtij fondi (56%) dhe pastaj besimi (19%) dhe me shumë kredibiliteti (13%)*
- *Arsyet për zgjedhjen e fondit privat janë gjithashtu, siguria (46%), por edhe kushtet më të mira dhe përfitimet më të larta (18%).*

Niveli i besueshmërisë është gati i njëjtë për të dyja fondet, në përputhje me opinionet e pjesëmarrësve të intervistuar. Ndërkohë që niveli i sigurisë te strukturat shtetërore lidhur me fondin është më i lartë, krahasimisht me sigurinë të fondi privat.

Vihet re se fondi privat vlerësohet të jetë më transparent në krahasim me fondin shtetëror. Rreth 10% e pjesëmarrësve shprehen të tillë dhe vetëm 2% e shohin fondin shtetëror si transparent.

Grafiku 27. Arsyet e zgjedhjes së fondit privat përkundrejt atij shtetëror



KONKLUZIONE

Qytetarët e Tiranës janë të informuar në mënyra të ndryshme rreth sigurimeve shoqërore në Shqipëri. Ndërsa 1/3 prej tyre është e informuar mirë ose shumë mirë, është një tjetër një e tretë e qytetarëve, që nuk janë të informuar rreth kësaj çështje.

Sic pritej, qytetarët që kanë sigurime shoqërore janë më mirë të informuar (50% prej tyre – të informuar mjaftueshëm). Më të informuar se mesatarja e pjesëmarrësve të pyetur, janë qytetarët më të arsimuar, ata më të medhenj se 40 vjec, që punojnë formalisht, e vetë-punësuarit dhe qytetarët që janë të kënaqur me skemën e tanishme të sigurimeve shoqërore.

Të punësuarit formalisht dhe të vetëpunësuarit janë të vetmet kategori të popullatës që njihen si kategoritë që mund të sigurohen në Shqipëri: 95% besojnë që të punësuarit formalisht mund të sigurohen, ndërsa shumë më pak besojnë të njëjtën gjë për të vetëpunësuarit (67%).

Të vetëpunësuarit, deklarojnë që kategoria e tyre mund të sigurohet. Vlerëson të theksohet që konkluzioni duhet konsideruar në kuadër të kampionit të pyetur (jo çdo person i vetëpunësuar është përfshirë në këtë studim, por vetëm 80% e tyre)

Opinionet variojnë në varësi se kush paguan sigurimet për qytetarët e punësuar: 43% besojnë që vetëm punëdhënësi i paguan kostot, ndërsa e njëjta përqindje e qytetarëve (44%), besojnë që është kontribut i përbashkët edhe i punëdhënësit edhe i punëmarrësit. Vetëm 13% ndajnë opinionin që është punonjësi që mbulon totalisht këtë kosto.

Çdo i teti qytetar i Tiranës mendon që ligji nuk e lejon punonjësin të zgjedhë nëse ai/ajo do të ketë sigurime shoqërore apo jo.

Nuk është e qartë për qytetarët nëse punonjësi mund të zgjedhë në cilin fond sigurimet shoqërore të tij/saj, do të paguhet: gjysma besojnë është e mundur të zgjedhësh (53%), kurse gjysma tjetër besojnë që kjo nuk është e mundur (47%).

Gjithashtu, nuk është e qartë cili lloj fondesh për sigurimet shoqërore ekziston: shumica besojnë që ka edhe fonde shtetërore edhe private që punojnë në Shqipëri (65%), kurse 25% shprehen të njohin vetëm fondet shtetërore.

Perceptimi i popullatës së Tiranës është që paratë nga sigurimet shoqërore harxhohen për qytetarët, që është: pensionet (74%), sistemi shëndetësor (49%) dhe përfitimet sociale (46%). Megjithatë, një e katërta besojnë që këto fonde, gjithashtu shpenzohen për qeverinë.

Gati të gjithë qytetarët e Tiranës të intervistuar, të moshës 18 deri në 46 vjec janë duke punuar, por ata kanë statuse të ndryshme punësimi. Më të rinjtë (18-24 vjec), në përqindje më të lartë se mesatarja, punojnë në të zeza, kurse ata më të mëdhenj se 40 vjec, janë më shpesh të vetë-punësuar, në ndryshim nga ata të moshës 25 deri në 32, që janë më shpesh të punësuar formalisht. Gjithashtu, qytetarët që kanë arsim më të lartë, janë më shpesh të punësuar në ekonominë formale, kurse njerezit me edukim më të ulët, më shpesh punojnë në menyrë informale ose si të vetë-punësuar.

Vetëm pak më shumë se gjysma e qytetarëve të intervistuar, të moshës 18 deri në 46 vjec (53%) kanë sigurime shoqërore. Në pozicionin më të keq janë ata që punojnë në mënyrë informale, pasi vetëm 15% e tyre kanë sigurime, krahasuar me 95% të atyre të punësuar formalisht. Ndërmjet biznesmenëve situatat variojnë (53% e të vetë-punësuarve kanë sigurime shoqërore).

Ka arsye të ndryshme për mospasjen e sigurimeve shoqërore: 56% e atyre që nuk i kanë nuk i plotësojnë kushtet për sigurime, kurse 44% mund ti kenë, por nuk i paguajnë ato.

Punëtorët në ekonominë hije/të zezë, më shpesh nuk kanë sigurime si pasojë e mospasjes së kushteve (65%) kurse të vetë-punësuarit më shpesh zgjedhin mos ti paguajnë (61%).

Ka arsye të ndryshme pse këta njerëz që i kanë kushtet për pasjen e sigurimeve akoma nuk i kanë ato: për 29% prej tyre, punëdhënësi nuk do t'i paguajë, 16% i kërkuan punëdhënësit t'u japë atyre para në vend të sigurimeve, kurse të tjerët deklaruan arsye të tjera lidhur me kostot dhe situatën financiare : kosto e lartë e sigurimeve, mospasja e të ardhurave të mjaftueshme ose shumë të ulta.

Punonjësit në ekonominë informale më shpesh kanë probleme me punëdhënësin që nuk do ti paguajë sigurimet për ata (50%), kurse të vetë-punësuarit nuk paguajnë sigurime kryesisht për disa arsye të tjera të lidhura me kostot (norma të larta pagesash, të ardhura të ulta).

Qytetarët që u kërkuan punëdhënësve tu japin atyre para në vend të pagimit të sigurimeve e bënë këtë kryesisht për shkak të kostove, dhe jo se nuk kishin nevojë për sigurime (vetëm 9% deklaruan që ata nuk kishin nevojë për sigurime). Ata vendosen ta bëjnë këtë sepse kontributet janë shumë të larta (48%), ose sepse atyre u duhen ato para megjithatë kontributet nuk janë të larta (43%).

Punonjësit që nuk kanë sigurime do të zgjedhin kryesisht sigurimet shoqërore përkundërt parave kesh (69% prej tyre). Megjithatë, akoma është gati 1/3 e tyre, që do të merrnin më mirë paratë kesh se sigurimet.

Në përgjithësi, njerëzit e intervistuar që punojnë në Tiranë dhe janë deri në 46 vjec, zakonisht kanë më pak se 11 vjet me sigurime shoqërore: 26% kanë ndërmjet 1 dhe 4 vjet me sigurime, 24% kanë 5 deri në 10 vjet, kurse 37% kurrë nuk kanë pasur sigurime dhe vetëm 3% kanë më shumë se 20 vjet. Mesatarisht, ata kanë 7.5 vjet me sigurime shoqërore.

Gati 2/3 e njerëzve që punojnë në të zezë dhe 1/3 e të vetë-punësuarve nuk kanë pasur kurrë sigurime. Sic pritej, personat më të vjetër kanë më shumë vite me sigurime

Vetëm 1/3 e punonjësve të intervistuar ka pasur sigurime gjatë gjithë kohës që kanë qenë duke punuar. Nga ana tjetër, është 37% e punonjësve që kanë nga 1 deri në 4 vjet periudhë punë pa sigurime të paguara gjatë kësaj kohë, 22% e tyre që kanë nga 5 deri në 10 vjet duke punuar në kushte të tilla pune dhe 7% që kanë 10 vjet punë pa sigurime. Mesatarisht, qytetarët e intervistuar, punuan për 5.5 vjet pa paguar sigurimet shoqërore.

Mesatarisht, më shumë vjet pune pa sigurime, kanë ata që janë më të mëdhenj në moshë, ata me edukim të ulët dhe të vetë-punësuarit.

Ka shumë më tepër qytetarë të intervistuar të Tiranës që nuk janë të kënaqur me sigurimet shoqërore të tanishme (40%) apo as të kënaqur as të pakënaqur (44%), sesa ata që janë të kënaqur (16%). Qytetarët më të kënaqur janë të punësuarit formalisht dhe ata që kanë sigurime shoqërore për momentin.

Si problemet kryesore me sigurimet shoqërore, qytetarët perceptojnë: Kontribute të larta, përfitime të ulta (51%), Ekonomi dhe vende pune jo-stabël (46%), Korrupsioni (40%), Nuk ka mjaftueshëm informacion për to nga popullata (24%) dhe Skema e sigurimeve nuk është mjaftueshëm transparente (21%). Të vetëpunësuarit më shpesh se të tjerët përmendën : Kontribute të larta, përfitime të ulta si problem.

Shumica, që është 77% e qytetarëve, besojnë që skema e sigurimeve shoqërore në Shqipëri duhet të ndryshojë. Të punësuarit formalisht dhe qytetarët që janë të kënaqur me skemën ekzistuese, në përqindje më të lartë se mesatarja mbështesin idenë që sigurimet shoqërore të qendrojnë njëllor / të njëjtat.

Gjysma e qytetarëve të intervistuar, përshkruan kontributet e tanishme për sigurimet shoqërore, si të larta, kurse 27% besojnë që ato janë aq sa duhet të jenë. Vetëm 23% i perceptojnë kontributet si jo shumë të larta. Të vetë-punësuarit, personat që nuk kanë sigurime shoqërore për momentin dhe ata që nuk janë të kënaqur me skemën ekzistuese, më shpesh deklarojnë që kontributet janë shumë të larta.

Opinionet janë të ndara nëse sigurimet shoqërore duhet të jenë vullnetare (47%) apo tu imponohen njerëzve (53%). Opinionet janë po të ndara nëse norma e kontributeve duhet të përcaktohet (58%), apo ti lihet vetë personit të zgjedhë nivelin e kontributit që do të paguajë (42%).

Personat që janë të pakënaqur me skemën aktuale më shumë se mesatarja mbështesin idenë që personi duhet ta ketë opsionin të zgjedhë vetë normen e pagesës.

Tetë nga dhjetë qytetarë të intervistuar (83%) do të zgjidhnin fondin shtetëror për sigurimet shoqërore ndaj atij privat. Më të rinjtë, më shpesh se mesatarja, zgjedhin fondin privat (21%), por prapë shumica e këtij grupi, do të paguante sigurimet në fondin shtetëror.

BIBLOGRAFI

Legjislacion

- *Kushtetuta e Shqipërisë*
- *Kodi i Punës*
- *Ligji Nr 7703, datë 11.05.1993 Për Sigurimet Shoqërore në RSH i ndryshuar*
- *Ligji Nr 252/2013 për nënpunësin civil i ndryshuar*

Literaturë e huaj

- *The Sociological Imagination* New York Oxford University Press, 1959
- *The Constitution of Society* University of California Press, 1986
- *Kerr et al.-Sw (1960), studim "Industrializmi dhe Njeriu Industrial" (1960)*
- *The Welfare State and Equality* Harold L.Wilensky (California, 1975)
- *Welfare policy and industrialization in Europe, America and Russia, Gaston V.Rimlinger (1971).*
- *Political Theories of the Welfare State* John Myles and Jill Quadagno (2002: 36).
- *The Fiscal Crisis of the State* James O'Connor, 1973
- *The Development of Welfare States in Europe and America* autorët Peter Flora, Arnold Joseph Heidenheimer (1981).
- *On the history and Current Problems of the Welfare State, Perter Flora, 1986.*
- *Social Policy and distributional conflict in the capitalist democracies. A preliminary comparative framework* Walter Korpi, 1980.
- *"Power, politics, and state autonomy in the development of social citizenship"* Walter Korpi, 1989
- *From poor relief to institutional Welfare states: the development of Scandinavian social policy, Esping-Andersen, 1989.*
- *The politics of Social Risk: Business and Welfare State Development, Isabela Mares, 2003.*
- *Social Calitalism: A study of Christian Democracy and the Welfare State, Kess Van Kersbergen, 1995.*
- *Capitalist against Markets: The Making of Labor Markets and Welfare States in the United States and Sweden, Peter Swenson, 2002.*
- *The Politics of Social Risk: Business and Welfare State Development, Isabela Mares, (2003)*
- *Employers and the Welfare State: The Political Economic Organization of Firms and Social Policy in Contemporary Capitalist Democracies, Duane Swank dhe Cathie Jo Martin, 2001.*
- *Social Democracy & Welfare Capitalism: A Century of Income Security*

- Politics*, Alexander M. Hicks 1999.
- *Development and Crisis of the Welfare State*, Evelyne Huber and John D. Stephens, 2001
 - *Social Democracy & Welfare Capitalism: A Century of Income Security Politics*, Alexander M. Hicks, (1999:10)
 - *The Transformation of Old Age Security: Class and Politics in the American Welfare State*, Jill Quadagno, 1988.
 - *Contradictions of the Welfare State*, Claus Offe (1984)
 - *Bringing the State Back In*, Peter B. Evans, Dietrich Rueschemeyer, Theda Skocpol, 1985
 - *State Structures and the Possibilities for the 'Keynesian' Responses to the Great Depression in Sweden*
 - *Gender and the Social Rights of Citizenship: the comparative analysis of gender relations and Welfare states*, Ann Shola Orloff, 1993
 - *Institutional Politics and the Origins of Modern American Social Policy*, Edwin Amenta, 1998.
 - *State Formation and Social Policy in the United States*, Theda Skocpol, 1992.
 - *Health Politics: Interests and Institutions in Western Europe*, Ellen Immergut, 1992.
 - *It's the institutions, stupid! Why comprehensive national health insurance always fails in America*, Sven Steinmo and Jon Watts, 1995.
 - *Parties and Policies in Global Markets*, Evelyne Huber and John D. Stephens, 2001.
 - *The Australian Welfare state: Key Documents and Themes*, Castle, (1994)
 - *Older People's Preferences for Employment and Retirement in Ireland*. Tony Fahey, 2002.
 - *Clinical social work with maltreated children and their families: An introduction to practice*. New York: New York University Press
 - *Social security, inequality and the third world*. James Midgley Wiley, Chichester, 1984
 - *Hug Henc Modern Social Politics in Britain and Sweden: From Relief to Income Maintenance (Yale studies in political science) 1974*

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

- GJDKE 4 Maj 2004, Haacker, çështja C-303/02, Rec. fq. I-2195; Europe 2004, fq. 20.
- GJDKE 16 Shkurt 1982, Burton, çështja 19/81, Rec. fq. 554; CMLR 1982, fq. 629.
- GJDKE 23 Maj 2000, Buncher, çështja C-104/98, Rec. fq. I-3625.
- GJDKE 28 Shtator 1994, Beune, çështja C-7/93, Rec. fq. I-4471; RJS 1994, fq. 803, shënime Ph. Laigre; JDI 1995, fq. 435 shënime D. Simone.
- GJDKE 22 Dhjetor 1993, Neath, çështja C-152/91, Rec. fq. I-6935; JDI 1994, fq. 480, shënime D. Simon; CMRL 1994, fq. 1387, shënime T.K. Hervey; Dr. soc. 1995, fq. 156, shënime M. De Vos.
- GJDKE 28 Shtator 1994, Coloroll, çështja C-200/91, Rec. fq. I-4389; RJS 1994, fq. 803, shënime Ph. Laigre; Dr. soc. 1995, fq. 424, shënime Ph. Langlois.
- GJDKE 17 Maj 1990, Barber, lartpërmendur.
- GJDKE 8 Prill 1976, Defrenne, lartpërmendur.
- GJDKE 11 Korrik 2006, Chacon Navas, çështja C-13/05, Rec. fq. I-6467; Europe 2006, fq. 17, shënime L. Idot; Dr. Soc. 2006, fq. 1117, shënime J. Savatier; RJS 2006, fq. 757, shënime F. Kessler; CMLR 2007, fq. 487, shënime L. Éaddington.
- GJDKE 1 Prill 2008, Maruko, çështja C-267/06, Rec. fq. I-1757; Europe 2008, fq. 13, shënime L. Driguez; Dr. Soc. 2008, Fq. 712, shënime J-Ph. Lhernould; JCP S 2008, 1416, shënime J. Cavallini; RJS 2008, fq. 688, shënime M. Le Barbier Le Bris.
- GJDKE 17 Korrik 2008, Coleman, çështja C-303/06, Rec. fq. I-5603; RDSS 2008, fq. 865, shënime A. Boujeka; RJS 2008, fq. 883, shënime M. Le Barbier-Le Bris; Europe 2008, fq. 27, shënime L. Driguez; JCP S 2008, 1549, shënime J. Cavallini.
- GJDKE 12 Janar 2010, Wolf, çështja C-229/08
- GJDKE 22 Nëntor 2005, Mangold, çështja C—144/04, Rec. fq. I-9981; RAE 2005, fq. 723, shënime E. Dubout; JCP 2005, 1414, shënime J. Cavallini; Europe 2006, fq. 19, shënime L. Idot; RJS 2006, fq. 257, shënime H. Tissandier; RDUE 2006, fq. 466, shënime E. Muir; RDT 2006, fq. 31, shënime M. Schmitt.
- GJDKE 19 Janar 2010, Kucukdeveci, çështja C-555/07, nuk është botuar ende.
- GJDKE 18 Qershor 2009, Hutter, çështja C-88/08, nuk është botuar ende. Europe 2009, fq. 26, shënime L. Driguez.
- GJDKE 16 Tetor 2007, Palacios de la Villa, çështja C-411/05, Rec. fq. I-8531; Europe 2007, fq. 25, shënime L. Idot; RJS 2008, fq. 97, shënime H. Tissandier; JPC 2008, 1152, shënime J. Cavallini; CMLR 2008, fq. 859, shënime L. Éaddington.
- GJDKE 5 Mars 2009, Age Concern England, çështja C-388/07, i pabotuar

akoma. Europe 2009, nr. 190, shënime L. Driguez; RJS 2009, fq. 443, shënime M. Le Barbier- Le Bris.

- *GJDKE 12 Janar 2010, Petersen, çështja C-341/08, i pabotuar ende.*
- *Direktiva 1999/70/KE e Këshillit e 28 qershorit 1999, në lidhje me Marrëveshjen Kuadër CES, UNI CE et CËP mbi punën me kohë të caktuar, FZ L 175 e 10 Korrikut 1999, fq. 43.*
- *GJDKE 23 Shtator 2008, Bartsch, çështja C-427/06, Rec. fq. I-7245; JCP S 2008, 1595, fq. 19, shënime*

Direktivat dhe Konventat e KE

- *Direktiva 86/378/KE e Këshillit e 24 Korrikut 1986 në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në skemat profesionale të sigurimeve shoqërore.*
- *Direktiva 96/97/KE e Këshillit e 20 Dhjetorit 1996 që ndryshon Direktivën 86/378/KE në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në skemat profesionale të sigurimeve shoqërore.*
- *Konventa nr. 111 e 1958, në lidhje me diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesioneve.*
- *Konventa e fëmijëve.*
- *Direktiva 2000/43/CE e Këshillit e 29 Qershorit 2000, në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes personave pa dallim race ose origjine etnike, FZ L 180 e 19 Korrikut 2000, fq. 22.*
- *Direktiva 2000/78/CE e Këshillit e 27 nëntorit 2000, mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm në favor të trajtimit të barabartë në fushën e punësimit dhe të punës, FZ L 303 e 2 Dhjetorit 2000.*